



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 1020/ Prot.
20

Tiranë, më 30 . 12 .2025

Raporti i Inspektimit

MBI KRYERJEN E INSPEKTIMIT TEMATIK ME OBJEKT: "MBI NDARJEN E ÇËSHTJEVE ME SHORT, SI EDHE KONTROLLIN E RAPORTEVE TË SISTEMIT ELEKTRONIK NË GJYKATËN E LARTË, GJYKATËN E AELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DHE GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR PËR PERIUDHËN 01.01.2024-31.12.2024"

(Vendimi nr. 17, datë 01.04.2025 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë)

Tiranë, më 30 . 12 .2025

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME MBI RAPORTIN

Titulli:

Raporti i inspektimit, mbi kryerjen e inspektimit tematik me objekt: "Mbi ndarjen e çështjeve me short, si edhe kontrollin e raporteve të sistemit elektronik në Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për periudhën 01.01.2024-31.12.2024", në zbatim të Vendimit nr. 17, datë 01.04.2025 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Data e përgatitjes:

30.12.2025

Përgatitur nga inspektorët:

Z. Albert Kazia Z. Eugen Nasufi



Për shqyrtim nga:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

Z. Artur Matani



Miratoi ☐ Ktheu ☐ Ndryshoi ☐

Datë: 30.12.2025

I. PJESA HYRËSE

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, është përcaktuar¹¹ si institucioni, që ndër të tjera, kryen edhe inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përmbushje të detyrave të tij të përcaktuara në Kushtetutë, nenin 147/d, në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, neni 194, pika 4 dhe nenit 204, pika 1, shkronjat "dh", "ë" dhe "k" të, si dhe në ligjin nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 25, pika 4¹², ka miratuar me vendimin nr. 5, datë 31.01.2025 është vendosur: "Miratimi i planit të inspektimeve për vitin 2025". Pjesë e planit të inspektimeve për vitin 2025, është bërë edhe kryerja e inspektimit tematik me objekt mbi ndarjen e çështjeve me short, si edhe kontrollin e raporteve të sistemit elektronik në gjykata, por në ndryshim nga vitet pararendëse, pjesë e këtij inspektimi nuk do të përfshihen të gjithë gjykatat, por vetëm tre gjykata, nga një për secilin nivel gjykimi. Konkretisht Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka nxjerrë për këtë qëllim, vendimin nr. 17, datë 01.04.2025, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Mbi ndarjen e çështjeve me short, si edhe kontrollin e raporteve të sistemit elektronik në Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për periudhën 01.01.2024-31.12.2024". Për kryerjen e tij (*inspektimit*), u angazhuan 2 (dy) inspektorë, inspektor Albert Kazia (*kryetar grupi*) dhe inspektor Eugen Nasufi, si edhe 4 (katër) ndihmës inspektorë. Ndarja e punëve në këtë proces u bë si më poshtë:

Inspektori Albert Kazia, i asistuar nga ndihmës inspektorët Ilir Rabdishti dhe Vildan Kaloshi, inspektuan Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, si dhe, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Inspektori Eugen Nasufi, i asistuar nga ndihmës inspektorët Armand Dumani dhe Hajdar Noka, inspektuan Gjykatën e Lartë.

Fillimisht grupi i punës, më datë 01.04.2025, brenda afatit të përcaktuar në Vendimin nr. 17, datë 01.04.2025, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përgatiti një plan pune, lidhur me hapat që do të ndiqen në arritjen e një produkti final që të përmbushë, jo vetëm qëllimin për të cilin ka nisur ky inspektim por dhe të respektojë edhe afatin e përcaktuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, për përfundimin e tij.

1/1. Arsyeja e inicimit të këtij inspektimi

¹¹ Neni 194, pika 4 e Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar;

¹² Neni 25, pika 4 e ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcakton se Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen rregullisht inspektime të ndarjes së çështjeve me short dhe kontrollon raportet e sistemit elektronik të pakatën një herë në vit;

Shqyrtimi i një çështje nga një "gjykatë e caktuar me ligj" është një parimet kryesore sa i përket gjykimit sipas një procesi të rregull ligjor, e lidhur kjo me të drejtat e individit dhe e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Ndaj dhe përmbushja e këtij parimi, kaq të rëndësishëm dhe të lidhur me të drejtën e individit të ngritur në nivel kushtetues, është e lidhur me mënyrën dhe procedurat nëpër të cilat gjykatat kryejnë ndarjen apo rindarjen e çështjeve me short si edhe kontrollin e raporteve të sistemit elektronik çka përbën dhe shkakun për të cilin iniciohet ky inspektim.

Me rëndësi në këtë proces është njohja dhe vlerësimi i akteve e Urdhërave që kanë lëshuar drejtuesit e këtyre institucioneve për të normuar procedurat e shortit; transparenca me të cilën është dokumentuar procesi i shortit, afatet e organizimit dhe mënyra e njoftimit paraprak të tij; kriteret për sigurimin e ndarjes së drejtë të çështjeve ndërmjet gjyqtarëve; rastet dhe kriteret e rindarjes së çështjeve me short, kur është e nevojshme për shkaqe të justifikuara; kriteret transparente dhe objektive për procedurën e përjashtimit të gjyqtarëve nga shorti për shkak të ngarkesës ose për shkak të angazhimit të gjyqtarëve në veprimtari të tjera në funksion të gjykatës apo të pushtetit gjyqësor, si dhe, kriteret transparente dhe objektive për ndarjen e çështjeve në rast mosfunksionimi të sistemit elektronik të çështjeve; mënyra e zbatimit në praktikë e akteve që ka lëshuar Këshilli i Lartë Gjyqësor, për rregullat e ndarjes në short të çështjeve dhe përmbushja e detyrimeve ligjore që kanë kryetarët e kancelarët e gjykatave, për realizimin e këtij procesi; dhe mënyra e zbatimit të dispozitave të legjislacionit procedural civil (*Kodi i Procedurës Civile*), legjislacionit procedural penal (*Kodi i Procedurës Penale*) edhe sa i përket në lidhje me kërkesat e hetimit paraprak, në rastet e caktimit të çështjeve me short dhe detyrimet ligjore që kanë kryetarët e kancelarët e gjykatave, për këtë proces të rëndësishëm të këtij aktiviteti që kryen gjykata.

1/2. Objekti i inspektimit

Objekti i këtij inspektimi është i lidhur me vlerësimin në terësi, nëse çështjet gjyqësore të paraqitura për gjykim, përpara gjykatave që i janë nënshtruar këtij inspektimi, ndahen me short të rastësishëm nëpërmjet sistemit elektronik, duke krijuar kështu një praktikë solide të shpërndarjes së çështjeve, pas asnjë ndërhyrje kundër këtij rregulli nga drejtuesi i gjykatës. Në këtë aspekt, veprimtaria administrative e kryetarëve/drejtuesve të gjykatës është e lidhur drejtpërdrejt me efikasitetin e sistemit të drejtësisë, me dhënien e drejtësisë pa influenca të papërshtatshme dhe me masën e besimit publik tek gjyqësori si një i tërë.

Në arritjen e objektivit të këtij inspektimi kërkohet:

- Analizim, të masave administrative dhe procedurale në kuadër të organizimit të shortit të çështjeve, për rrjedhojë të akteve të nxjerra nga drejtuesit e gjykatave në ushtrim të kompetencave të tyre, sa i përket përputhshmërisë apo harmonizimit të tyre me nenin 23, pika 6, nenin 25, pikat 1 e 2, nenin 37, shkronja "b", nenin 39, pika 1, shkronja "c" të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me vendimin nr. 554, datë 29.12.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", vendimi nr. 724, datë 07.12.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore", nenin 278 dhe nenin

- Monitorim i performancës dhe efektivitetit të kryetarëve të gjykatave në administrimin e brendshëm në gjykata jo vetëm në drejtim të ndarjes së çështjeve me short por edhe të organizimit të gjyqtarëve në dhoma apo seksione.

Më konkretisht në lidhje me objektin e inspektimit, ILD, ka marrë indicje edhe nga konstatimet që kanë bërë organizmat ndërkombëtarë, përmendim këtu Komisionin Evropian, Komisionin e Venecias ashtu dhe Këshillin e Evropës. Komisionin Evropian në Raport Progresin për Shqipërinë në vitin 2014, është shprehur se: "... çështjet gjyqësore duhet të ndahen me short të rastësishëm nëpërmjet sistemit elektronik dhe se duhet të eliminohen praktikatat e ndarjes së çështjeve drejtpërdrejt nga Kryetari i Gjykatës^[3]... etj.", ndërsa po ky institucion në "Raportin për Shqipërinë 2020" thekson ndër të tjera se: "... Në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve të gjykatave kanë dalë në dukje shumë mangësi. Ky i fundit duhet të forcohet ndjeshëm dhe të përdoret në mënyrë efektive, veçanërisht për të siguruar shpërndarjen me short të çështjeve....etj."^[4].

Komisioni i Venecias në Opinionin (CDL-AD (2010) 004 ose CDL-AD (2002) 026) në paragrafin 74-81 argumenton se: "Për sa i përket shpërndarjes së rasteve, Rekomandimi (94) 12 përmban parimet (parimi 1.2.e dhe f), të cilat mund të shihen si thelbësore për pavarësinë e sistemit gjyqësor në të cilin sanksionet se: "Shpërndarja e rasteve nuk duhet të ndikohet nga dëshirat e asnjërës palë në një rast ose ndonjë person i interesuar për rezultatet e rastit. Një shpërndarje e tillë mund, për shembull, të bëhet me short ose një sistem për shpërndarje automatike sipas renditjes alfabetike apo një sistemi të ngjashëm".

Ndërkohë, në Rekomandimin nr. R (94) 12, të Këshillit të Evropës "Mbi pavarësinë, eficientën, dhe rolin e gjyqtarëve" parashikon se: Në parimin I "Parimet e përgjithshme të pavarësisë së gjyqtarëve", në pikën 2, shkronjat "e" dhe "f" përcakton se: "Shpërndarja e rasteve nuk duhet të ndikohet nga dëshirat e asnjërës palë në një rast ose ndonjë person i interesuar për rezultatet e rastit. Një shpërndarje e tillë mund, për shembull, të bëhet me short ose një sistem për shpërndarje automatike sipas renditjes alfabetike apo një sistemi të ngjashëm". Në vijim Këshilli thekson se: "Një gjyqtar nuk mund të heqë dorë nga gjykimi pa një shkak të arsyeshëm siç mund të jetë sëmundje e rëndë apo konflikti i interesit. Procedurat dhe shkaqet e heqjes dorë duhet të jenë të parashikuara në ligj dhe të pandikuara nga interesat e qeverisë ose administratës. Vendimi për heqjen e një gjyqtari nga gjykimi i një çështjeje duhet të merret nga një autoritet që gëzon të njëjtën pavarësi si gjyqtari".

Gjithë sa më sipër, janë arsye për të ndërmarrë nisma inspektimi me këtë objekt, për verifikimin e procedurave të ndarjes së çështjeve me short nga gjykatat. Ky proces, si pjesë e garantimit të një gjykimi nga një gjykatë e "pavarur" dhe "e paanshme" lidhet drejtpërsëdrejti me liritë dhe të drejtat e njeriut, ndaj dhe është e mbrojtur, në kuadër të

^[3] Shih faqen 50 të Raportit të Progresit, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-albania-progress-report-en.pdf.

^[4] Shih faqen 23 të Raportit për Shqipërinë 2020, https://integrimi-nc-be.puneteshme.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/Raporti-KE_2020_DBE_8.03.2021_final.pdf

këtyre garancive që duhet të ofrojnë, deri në nivel kushtetues. Nisur nga rëndësia që paraqet procesi i ndarjes së çështjeve, në funksion të një gjykimi të drejtë që në nisje të tij, dhe për të eliminuar mangësi dhe praktika që devijojnë nga caktimi në mënyrë të drejtë dhe të pavarur e gjykatës të çështjes, ligjvënësi, i ka atribuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përgjegjësinë për të inspektuar edhe procesin e ndarjes së çështjeve me short të gjykatës.

1/3. Rëndësia e inspektimit tematik

Në përgjithësi qëllimi i institutit të inspektimit dhe mekanizmave të kontrollit është në mbrojtjen e interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë, ndaj, në veçanti, inspektimi tematik i ndarjes së çështjeve me short paraqet rëndësi edhe sa i përket: rritjes së standardeve në veprimtarinë e gjykatave nëpërmjet misionit monitorues e mekanizmave të inspektimit, të cilat synojnë që sistemi gjyqësor të respektojë Kushtetutën, ligjet, të jetë i aftë për të realizuar dhe mbrojtur dinjitetin, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe të kontribuojë në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik dhe të integritetit evropian të Republikës së Shqipërisë.

Në këtë kuadër Inspektori i Lartë i Drejtësisë në respektim të Kushtetutës dhe kuadrit ligjor aktual vlerëson detyrimin dhe përgjegjësinë që kanë kryetarët e gjykatave në lidhje me menaxhimin e përgjithshëm gjyqësor dhe kujdesin që duhet të tregojnë për organizimin dhe funksionimin e administrimit gjyqësor në gjykatë. Ndaj përpos vlerësimit të respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit; këshillimit të subjektit të inspektuar për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore; urdhërimit të korrigjimit të shkeljeve të kërkesave ligjore dhe eliminimit të pasojave që rrjedhin prej tyre; marrjes së masave të tjera administrative për shmangien e rreziqeve që mund t'u shkaktohen interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë, sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara në ligj. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, thekson së në veprimtarinë e tij udhëhiqet dhe nga parimi i ligjshmërisë, në kuptimin që si organ kompetent ka detyrimin të hetojë, nëse ka dyshime të arsyeshme se magjistrati ka kryer një shkelje disiplinore sa i përket edhe mospërmbushjes nga ana e kryetarit e detyrimeve të përcaktuara në ligj, në veçanti detyrat e lidhura me sistemin e menaxhimit të çështjeve.

1/4. Burimet e së drejtës

Kuadri ligjor mbi të cilën është mbështetur ky inspektim si dhe veprimtaria e inspektorëve në kuadër të tij, bazohet në aktet ligjore në nënligjore të poshtëshënuara:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (në vijim "Ligji nr. 98/2016")
- Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar;

- Ligji nr. 37/2017 "Kodi i Drejtësisë penale për të mitur";
- Vendimi nr. 554, datë 29.12.2022, i Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore"^[5] (në vijim "Vendimi nr. 554, datë 29.12.2023");
- Vendimi nr. 724, datë 07.12.2023, i Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore"^[6] (në vijim "Vendimi nr. 724, datë 07.12.2023");
- Urdhërat për miratimin e rregulloreve të brendshme të gjykatave;
- Raporti i Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e KLGJ për vitin 2024.

1.5 Rekomandime nga inspektimi pararendës i të njëjtës natyre dhe zbatimi i tyre

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka realizuar më herët një inspektim të ndarjes së çështjeve me short dhe kontroll të raporteve të sistemit elektronik lidhur me këtë proces për periudhën **01.01.2023 - 31.12.2023**. Kontrollit iu nënshtruan 20 gjykata, konkretisht: Gjykata e Lartë, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; Gjykata Administrative e Apelit, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe Lushnjë; Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Tiranë, Elbasan, Durrës, Lezhë, Kukës, Shkodër, Berat, Fier, Vlorë, Korçë, Gjirokastrë, Sarandë.

Përmbushja e qëllimit të inspektimit që është i lidhur ngushtë jo vetëm me monitorimin e performancës dhe efektivitetin e veprimtarisë së kryetarëve të gjykatave në drejtim të ndarjes së çështjeve gjyqësore me short nuk mund të kuptohet pa adresimin e rekomandimeve për ato raste në të cilat janë evidentuar gjetje nga ana e grupit të punës. Edhe në këtë rast, adresimi i rekomandimeve ka qenë në tre drejtime, si ndaj gjykatave të të gjitha niveleve [9 rekomandime], sipas gjetjeve, ashtu dhe ndaj Këshillit të Lartë Gjyqësor [3 rekomandime] si dhe ndaj vetë institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë [3 rekomandime].

Numri total i rekomandimeve drejtuar gjykatave të të gjitha niveleve, konsiston në nëntë prej tyre, ku disa rekomandime janë dhënë për të gjitha gjykatat e vendit, ndërsa disa të tjerë janë specifike për gjykata të caktuara. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kërkuar^[7] informacion gjykatave në lidhje me masat e marra për zbatimin e këtyre rekomandimeve. Lidhur me zbatimin e këtyre rekomandimeve rezulton se gjykatat objekt të këtij verifikimi ka përcjellë informacionin lidhur me ecurinë e zbatimit të tyre.

Gjykata e Lartë në informacionin e dërguar^[8] shpreh se (i) Lidhur me rekomandimin nr. 1, Urdhëri gjendet tashmë i publikuar në faqen zyrtare të kësaj gjykate; (ii) Lidhur me

^[5] Botuar në fletoren zyrtare nr. 1, datë 04 janar 2023.

^[6] Botuar në fletoren zyrtare nr. 181, datë 15 dhjetor 2023.

^[7] Shkresa nr. 2521/1 prot., datë 12.09.2025 adresuar Këshillit të Lartë Gjyqësor; dhe, Shkresa nr. 2521/2 prot., datë 12.09.2025 adresuar të gjitha gjykatave objekt inspektimi për shortin e vitit 2023.

^[8] Shkresa nr. 4436/1 prot., datë 02.10.2025, (i) lidhur me gjetjet që i referohen Gjykatës së Lartë për publikimin e urdhrit nr. 54, datë 09.03.2023 "Për enktimin e orarit të hedhjes së shortit elektronik për ndarjen e çështjeve gjyqësore", theksojnë se ky urdhër gjendet tashmë i publikuar në faqen zyrtare të kësaj gjykate, dhe ky rekomandim konsiderohet plotësisht i

zbatimin e rekomandimit nr. 2, rekomandimi nuk gjen zbatim në procedurat gjyqësore të Gjykatës së Lartë; (iii) Lidhur me zbatimin e rekomandimit nr. 3, rekomandimi zbatohet rregullisht nga Gjykata e Lartë; (iv) Lidhur me zbatimin e rekomandimit nr. 8, rekomandimi zbatohet rregullisht nga Gjykata e Lartë.

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në informacionin e dërguar me anë të shkresës nr. 19310/1 prot., datë 24.09.2025, shprehet se: lidhur me rekomandimin nr. 1, kjo gjykatë ka zbatuar vendimin nr. 3, datë 04.01.2023, të Zv.Kryetarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në të cilin përcaktohen qartë dita, ora dhe vendi i hedhjes së shortit. Publikimi i shortit bëhet automatikisht në faqen zyrtare të gjykatës pas replikimit të KLGJ-së, ku është hostuar platforma. Lidhur me rekomandimin nr. 2 aktualisht po punohet për përgatitjen e formatit të regjistrit në bashkëpunim me strukturat përkatëse dhe kalimin për miratim në Këshillin e Gjykatës. Lidhur me rekomandimin nr. 3, ka krijuar një regjistër të veçantë për kërkesat për heqje dorë të gjyqtarëve të saj dhe të Kryetarëve të Gjykatave të Shkallës së Parë që ka në varësi. Ky regjistër administrohet nga sekretarja e Kryetarit. Lidhur me rekomandimin nr. 4^[9], ka zbatuar rekomandimin për pasqyrimin e aryetimit në rastet e ndryshimit të grafikut të gatishmërisë së gjyqtarëve. Lidhur me rekomandimin nr. 5^[10] ka marrë masat organizative për zbatimin e procedurës së shortit elektronik në rastet e kërkesave për: - Përfjashtim të gjyqtarëve; - Zëvendësim të anëtarëve të trupit gjykues; - Plotësim të trupit gjykues. Lidhur me rekomandimin nr. 6^[11], ka marrë masat përkatëse organizative dhe rregullatore për adresimin e problematikave të

përmbyshur nga ana e Gjykatës së Lartë; (ii) Lidhur me zbatimin e rekomandimit nr. 2, sqarojnë se rekomandimi nuk gjen zbatim në procedurat gjyqësore të Gjykatës së Lartë, për shkak se kjo gjykatë shqyrton rekursat vetëm lidhur me çështje të ligjit, dhe nuk shqyrton çështjet në themel si gjykatat e tjera të juridiksionit të përgjithshëm; (iii) Lidhur me zbatimin e rekomandimit nr. 3, theksojnë se ky rekomandim zbatohet rregullisht nga Gjykata e Lartë; (iv) Lidhur me zbatimin e rekomandimit nr. 8, theksojnë se ky rekomandim zbatohet rregullisht nga Gjykata e Lartë. Çdo ditë, pas realizimit të shortit elektronik për përzgjedhjen e gjyqtarit që do të shqyrtojë çështjen gjyqësore, strukturat administrative të Gjykatës së Lartë publikojnë në faqen zyrtare raportin ditor me të dhënat e shortit për çdo çështje gjyqësore, dhe në këtë aspekt, ky rekomandim konsiderohet plotësisht i përmbyshur nga ana e kësaj gjykate.

^[9] Gjykata deklaron se ka zbatuar rekomandimin për pasqyrimin e aryetimit në rastet e ndryshimit të grafikut të gatishmërisë së gjyqtarëve. Në çdo rast kur është kërkuar ndryshim nga ana e gjyqtarëve, drejtuesi i gjykatës ka nxjerrë aktin përkatës duke reflektuar qartë arsyet që kanë diktuar ndryshimin, si dhe janë përcaktuar qartësisht kategoritë e çështjeve të karakterit urgjent që mbulohen nga gjyqtarët në gatishmëri. Të gjitha çështjet gjyqësore duke përfshirë edhe masat e sigurimit me karakter shtrëngues hidhen në short elektronik midis gjyqtarëve sipas listës së gatishmërisë.

^[10] Procesi i përzgjedhjes së gjyqtarëve është realizuar në disa raste me short manual për kërkesat penale shuarje mase për relatorin apo anëtarin sipas urdhrit të kryetarit. Kjo është realizuar nëpërmjet shortit manual nga kancelari i gjykatës, nën mbikëqyrjen e kryetarit të gjykatës dhe pjesëmarrjen e gjyqtarëve, të cilët njoftohen paraprakisht për zhvillimin e shortit. Çdo short manual dokumentohet me procesverbal, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullat e brendshme të gjykatës. Gjatë vitit 2025, është respektuar edhe për kërkesat penale, shuarje mase sigurimi për qat sa është e mundur plotësimi me short elektronik, sipas urdhrit të kryetarit. Gjatë vitit 2023 për shkak të fluksit të lartë të çështjeve në gjykim të filluara nga ish gjykatat e apeleve dhe kërkesa për plotësimi trupi si fillim është trajtuar me short manual për shkak të kufizimeve teknike të sistemit (për të kryer një veprim të tillë në sistem duhet të çaktivizojë gjithë gjyqtarët e seksionit për të lënë vetëm dy aktivë, sipas vendimit të Këshillit për plotësimin e trupës, për të zgjedhur njërin prej tyre, gjë që për përfundimin e një dosje duhet minimumi 60 minuta). Për të plotësuar në kohë dhe pa vonesa dosjet gjyqësore është realizuar shorti manual për anëtarët e trupit gjykues, dhe në asnjë rast nuk ka patur kundërshtim nga gjyqtarët plotësues. Këtu theksojnë se çdo ditë janë plotësuar më shumë se 20-30 dosje gjyqësore, të cilat ishin në gjykim në ish gjykatat e apeleve, me një gjyqtar.

^[11] Konkretisht, është organizuar puna në mënyrë që çdo kërkesë oër përfjashtim, zëvendësim apo plotësim të anëtarëve të trupit gjykues të trajtohet në përputhje me legjisllacionin në fuqi, duke aplikuar shortin elektronik për përcaktimin e gjyqtarëve, në zbatim të udhrrave përkatës të lëshuara nga zv. Kryetari i gjykatës. Për sa i përket masave disiplinore, informojnë se për rastet e evidentuara gjatë vitit 2023, janë kryer verifikimet e nevojshme. Pas analizimit të situatave konkrete dhe duke marrë në konsideratë volumin shumë të lartë të punës që kanë përbërur strukturat e burimeve njerëzore gjatë periudhës së zbatimit të hartës së re gjyqësore, këto problematike janë vlerësuar si gabime njerëzore të ndodhura në kontekst të mbingarkesës, dhe nuk kanë rezultuar në shkelje të natyrës disiplinore. Këtu theksojnë se stafi administrativ i gjykatës ka punuar me orare të zgjatura për të regjistruar dosjet gjyqësore, për shpërndarjen e tyre, për rishortime në një kohë sa më të shpejtë ka krijuar vonesa, duke punuar çdo ditë 12-16 orë.

evidentuara në raportin përkatës. Lidhur me rekomandimin nr. 7, ka marrë masat për pasqyrimin në sistemin ICMIS të të gjitha arsyeve që lidhen me kalimin automatik të çështjeve pranë të njëjtit gjyqtar, duke respektuar parimin e transparencës dhe objektivitetit të shortit elektronik. Në çdo rast bëhen shënimet përkatëse në sistemin ICMIS. Lidhur me rekomandimin nr. 8^[12], në faqen e gjykatës automatikisht bëhet publik shorti çdo ditë pas hedhjes si dhe rishortimet, po kështu dhe kalimet e çështjeve manualisht nëpërmjet sistemit të menaxhimit të çështjeve. Lidhur me rekomandimin 9^[13], që i përket përjashtimit të gjyqtarëve nga shorti vetëm për çështje me afate të ngutshme, gjykata ka zbatuar këtë praktikë.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, në informacionin^[14] e dërguar shprehet se lidhur me rekomandimin 2, ka përcjellë kopje të kopertinave të indekseve të çështjeve penale dhe civile për të cilat gjykata ka dhënë vendim jopërfundimtar. Lidhur me rekomandimin 7, ka përcjellë të dhëna mbi caktimet manuale që i përkasin periudhëve 01.04.2025-10.04.2025; datë 01.07.2025-07.07.2025 dhe një jashtë periudhës datë 01.10.2025-10.10.2025, ndërkohë lidhur me rekomandimin 8, ka përcjellë të dhëna nga nga sistemi dhe faqja zyrtare për dy data si shembull, përkatësisht një në periudhën e verifikimit të zbatimit datë 06.03.2025 dhe një në periudhën objekt të inspektimit atë të datës 05.10.2023.

1.6 Mënyra e kryerjes së inspektimit

Kryerja e inspektimit është bazuar në vendimin e dalë për këtë qëllim dhe përfshin periudhën kohore nga 01.04.2025 - 31.12.2025. Në funksion të këtij inspektimi grupi i punës hartoi një plan pune më datë 01.04.2025, në respektim të vendimit nr. 17, datë 01.04.2025. Bazuar në këtë plan pune i gjithë inspektimi u zhvillua, i ndarë në 4 faza, konkretisht:

1. Faza e parë "Përgatitja e planit të punës, hartimi i kërkesave për informacion dhe akte, si dhe zhvillimin e verifikimeve apo vizitave pranë gjykatave", siç dhe ishte parashikuar, përfshiu: (i) Përgatitjen e planit të punës nga data 01.04.2025-10.04.2025; (ii) Përgatitjen e shkresave drejtuar institucioneve objekt inspektimi nga data 10.04.2025-11.04.2025; (iii) Grumbullimin e dokumentacionit administrativ nga data 10.06.2025 deri në datë

^[12] Të gjitha dosjet e rishortuar në vitin 2023 janë hedhur në faqe për t'i aksesuar publiku dhe media. Kjo gjykatë për çdo veprim në sistemin e menaxhimit të çështjeve pasqyron arsyen dhe aktin përkatës ku bazohet veprimi. Nëse afishimi i arsyes së rishortimit dhe caktimit manual me qëllim shfaqjen e tyre për publikun në portal është i domosdoshëm, ky rekomandim duhet t'i adresohet KLGJ-së, i cili mirëmban dhe zhvillon portalin e gjykatave. Për sa i përket procesverbaleve të shortit manual për kërkesat penale shuarje mase sigurimi nuk janë hedhur për shkak se deri në muajin korrik 2025, në organikën e gjykatës ka qenë i punësuar vetëm një specialist i teknologjisë së informacionit, i cili, për shkak të ngarkesës së lartë dhe natyrës së detyrave të shumta teknike, nuk ka pasur mundësi të realizojë në mënyrë të vazhdueshme publikimin në fjalë.

^[13] Konkretisht, gjyqtari z. Fuat Vjerdha, për shkak të gjendjes së tij shëndetësore, është përjashtuar vetëm nga shorti i çështjeve që kërkojnë shqyrtim të menjëhershëm apo që lidhen me afate procedurale të shkurtra, në përputhje me vendimin përkatës të KLGJ-së mbi rregullat e shortimit të çështjeve. Gjykata ka zbatuar edhe vendimin e KLGJ-së lidhur me përjashtimin nga shorti të gjyqtarëve sipas vendimeve përkatëse. Gjykata është angazhuar për përmirësimin e situatës dhe mirjen e transparencës institucionale dhe me shtimin e stafit teknik, ka marrë dhe do të marrë masa për të garantuar zbatimin e rregullt dhe të vazhdueshëm të këtij procesi. Deklarojnë se sigurojnë se zbatimin i rekomandimeve të ILD-së është prioritet i kësaj gjykate, në përputhje me standartet e transparencës, përgjegjëshmërisë dhe mirëqeverisjes institucionale.

^[14] Shkresa nr. 1638/3 prot., datë 21.11.2025;

10.07.2025; (iv) Kryerjen e verifikimeve apo vizitave në terren nëse çmohet nga inspektorët për një tematikë të caktuar.

Kërkesat për informacion dhe dokumentacion u formuluan në mënyrë të tillë, që në përgjigje të tyre, të mund të administrohet dokumentacioni i domosdoshëm për këtë inspektim^[15].

Gjithashtu dokumentacioni shkresor, që u vlerësua të administrohej gjatë kësaj faze, duhet të ishte i mjaftueshëm për të konkluduar në grumbullimin e atyre të dhënave për përmbushjen e qëllimit të inspektimit^[16]. Për mbledhjen e këtij informacioni, u vlerësua e nevojshme që kryetarëve të gjykatave (*kancelarëve / kryesekretarëve*) t'u lihet në dispozicion një afat i mjaftueshëm për përgatitjen e informacionit dhe dokumentacionit, afat ky 60 ditore nga momenti që drejtuesit e gjykatave marrin dijeni me kërkesat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për marrje informacioni.

Për të lehtësuar këtë proces, informacioni u kërkuar dhe u dërguar sipas një modeli tabelor, për secilën kategori gjykate më vete (*kjo dhe në funksion të veprimtarisë gjyqësore që kryejnë*). Tabelat për secilën gjykate u hodhën në CD, për lehtësi në përpunimin e të dhënave. Materiali nga gjykatat, siç dhe u kërkuar, krahas rrugës zyrtare u dërgua edhe në rrugë elektronike me CD (*reader*).

II. Faza e dytë "Përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur" përfshiu këto hapa:

(i) Përpunimin e dokumentacionit administrativ dhe studimin e materialeve nga data 10.07.2025 deri në datë 15.09.2025, si dhe (ii) Kryerjen e vizitave nga data 01.09.2025-30.09.2025 (ose sipas vlerësimit të inspektorit përkatës).

Përpunimi i dokumentacionit administrativ, bazuar në planin e punës, u bë nga secili grup inspektimi për gjykatat përkatëse^[17]. Në përfundim të kësaj faze, inspektorët përgjegjës

^[15] Shkresa nr. 1020/5 prot., datë 07.04.2025 drejtuar Gjykatës së Lartë; shkresa nr. 1020/4 prot., datë 07.04.2025 drejtuar Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm si dhe shkresa nr. 1020/3 prot., datë 07.04.2025 drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;

^[16] U vlerësua të administroheshin të dhëna në lidhje me: (i) Numrin e gjyqtarëve të përfshirë në shorte; (ii) Veprimet normuese të kryetarit të gjykatës; (iii) Vendimet e Këshillit të Gjykatës për ndarjen e gjyqtarëve në trupa gjyqësore apo caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur viktimë nga vepra penale si dhe vendimmarrjen e Këshillit të Gjykatës së Lartë, në lidhje me caktimin e gjyqtarëve në përbërje të Kolegjeve të Gjykatës së Lartë; (iv) Çështjet e shortuara; (v) Ngarkesën sanjore të gjyqtarëve; (vi) Afatet e shortimit të çështjeve; (vii) Shortimin e çështjeve sipas gjyqtarit specifik; (viii) Largimin e gjyqtarëve nga çështjet gjyqësore për: a) për kërkesa për dorëheqje gjyqtari, të miratuara nga Kryetari i Gjykatës; b) për kërkesa për përjashtim gjyqtari nga gjykimi, për të cilat është ka vendim gjyqësor; c) për raste kur gjyqtari është larguar për shkak të procedurave të zbatimit të ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" ose për arsye të tjera të ligjshme; (ix) Kushtet fizike të organizimit të shortit; (x) Verifikimin e ankesave në lidhje me procedurat e shortit nga palët që i janë drejtuar gjykatës ose aktorët e procesit që janë të përfshirë në procedurat e shortit (trupa gjyqësore, kancelari, punonjësi i IT-së, kryesekretari);

^[17] Gjatë kësaj faze inspektorët do të përqendrohen në: (i) Filtrimin e informacionit dhe identifikimin e fakteve të nevojshme në përputhje me qëllimin e inspektimit. (ii) Vlerësimin nëse ka të dhëna të tjera që nevojiten për t'u administruar. (iii) Vlerësimin nëse ka nevojë për verifikim të mëtejshëm të ndonjë aspekti të caktuar. (iv) Identifikimin e çështjeve të caktuara për të cilat është e nevojshme kryerja e vizitave/vëzhgimeve në gjykatat ku është kryer inspektim. (v) Kryerjen e vizitave përkatëse të cilat do të shërbejnë për verifikimin e informacionit të dërguar, për të vëzhguar kushtet aktuale të punës si dhe për të marrë shpjegime, nëse do të jetë e nevojshme, nga drejtuesit e institucioneve/trupa e gjyqtarëve/administrata gjyqësore (*kancelar, kryesekretar, sekretar regjistruar, sekretar gjyqësor dhe punonjës IT-je*).

raportuan pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për plotësimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm dhe për fillimin e hartimit të raportit të inspektimit.

III. Faza e tretë "Hartimi i raportit të inspektimit", përfshiu këto hapa: (i) Hartimin e raporteve të veçanta nga secili prej grupeve të inspektimit për gjykatat që janë ngarkuar për inspektim nga data 01.11.2025-20.11.2025, sipas një model/strukture të njëjtë; (ii) Hartimin e projekt raportit të inspektimit 21.11.2025-01.12.2025; (iii) Dërgimin i projekt raportit për shqyrtim pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë brenda datës 19.12.2025.

Në këtë fazë secili nga të dy grupet e punës, sipas planit të punës, hartuan pjesën e veçantë të raportit për gjykatat, për të cilat është ngarkuar të inspektojë, sipas të njëjtit model. Brenda datës 20.11.2025 grupi tjetër i inspektimit vuri në dispozicion të kryetarit të grupit të inspektimit, raportin e hartuar për gjykatën që kishte në ngarkim. U sigurua gjatë kësaj periudhe për një grumbullim të informacionit në një dokument të vetëm dhe një harmonizim të dhënave dhe standartizim sipas një modeli.

IV. Faza e katërt "Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve dhe rezultateve të inspektimit", me këtë fazë në planin e punës, grupi ka planifikuar të ndjekë këto hapa: (i) Njohja e institucioneve me raportin e inspektimit brenda datës 15.01.2026; (ii) Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve 01.01.2026-01.06.2026.

Me shkresën nr. 2201 prot., datë 17.07.2025, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kërkoi nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndër të tjera dërgimin e një kopje të manualit të përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, *(përfshirë rubrikën e shortimit elektronik)*, që Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar për këtë qëllim *(së bashku me publikimet periodikisht të këtij manuali, nëse ka pasur të tilla)*. Në përgjigje të shkresës së dërguar nga ILD, me nr. 4102/1 prot., datë 29.07.2025 *(regjistruar me nr. 2201/1 prot., datë 29.07.2025)*, vihem në dijeni për zhvillimet e sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore të sistemit ICMIS në gjykatat e shkallës së parë, apelit, administrative, të cilat janë kryer në vitin 2021; 2022; 2023 dhe vitin 2024.

1.6 Periudha e zhvillimit të inspektimit

Gjatë periudhës së zhvillimit të inspektimit janë konstatuar në mënyrë të përmbledhur problematika të lidhura me:

- Paraqitjen me vonesë të informacionit dhe të dhënave të kërkuara në funksion të realizimit të këtij inspektimi nga disa gjykata;
- Paraqitjen e paplotë të informacionit dhe të dhënave, si dhe kërkesës për sqarime të mëtejshme nga kryetari e kancelari i Gjykatës së Lartë për plotësimin e kërkesave të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- Ridërgimin e kërkesave me qëllim plotësimin e këtij informacioni nga Gjykata e Lartë;
- Mosparaqitjen e informacionit sipas formatit të kërkuar në korrespondencën shkresore edhe në formë tabelore.
- Problematikë në kryerjen e këtij inspektimi kanë qenë sistemi informatik CCMIS që përdor Gjykata e Lartë, i cili edhe si sistemi i ARK-it nuk të jep mundësinë e gjurmimit

të çështjeve në rastet e shortimeve manuale dhe rishortimeve.

II. FAKTET E KONSTATUARA DHE ANALIZA LIGJORE

Inspektimi tematik u zhvillua bazuar në vendimin nr. 17, datë 01.04.2025, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për periudhën 01.04.2025-31.12.2025. Kontrollit iu nënshtuan 3 gjykata, konkretisht: Gjykata e Lartë, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, si dhe Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

➤ Gjykata e Lartë

1. Rregullimi ligjor mbi bazën e të cilit gjykata organizon procedurat e shortit.

Për organizimin e procedurave të ndarjes së çështjeve me short, gjykata bazohet kryesisht në ligjin nr. 98/2016, dhe në kërkesat e Vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore"^[18] dhe nr. 724, datë 07.12.2023 "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore".^[19]

Për kohën e inspektuar kjo gjykatë është drejtuar nga kryetari z. Sokol Sadushi^[20] dhe kancelare në detyrë është znj. Anila Kulo.

Për periudhën e inspektimit, numri i gjyqtarëve efektivë në detyrë kanë qenë:

- (i) për periudhën Janar-Mars 2024 - 18 gjyqtarë;
- (ii) për periudhën Prill-Dhjetor 2024 - 17 gjyqtarë;

Numri total i gjyqtarëve sipas strukturës organike të miratuar për vitin 2024 është: 19 (18+1 gjyqtar anëtar i KLGJ), ndërsa gjyqtarë efektivë kanë qenë 17.

2. Sistemi elektronik i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore që gjykata ka për ndarjen e çështjeve gjyqësore me short.

Gjykata e Lartë, për periudhën e inspektimit ka në përdorim Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, të njohur si ICMIS, si dhe sistemin ARKIT. Nëpërmjet këtyre sistemeve gjykata bën regjistrimin e çështjeve, hedhjen në short të tyre si dhe realizon në vazhdim procedurat e zhvillimit të gjykimeve, duke përfshirë këtu procedurat e planifikimit e menaxhimit të secilës çështje gjyqësore.

Në përgjigje të shkresës nr.1020/5 prot., datë 07.04.2025, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në funksion të inspektimit me objekt: "Mbi ndarjen e çështjeve me short, si edhe kontrollin e raporteve të sistemit elektronik në gjykata për periudhën 01.01.2024 -

^[18] Botuar në fletoren zyrtare nr. 1, datë 04 janar 2023.

^[19] Botuar në fletoren zyrtare nr. 181, datë 15 dhjetor 2023.

^[20] Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, zhvilluar më datë 7.7.2020 zgjodhi z. Sokol Sadushi Zëvendëskryetar të kësaj Gjykate. Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, zhvilluar më datë 17.10.2023, zgjodhi z. Sokol Sadushi Kryetar të kësaj Gjykate.

31.12.2024", nga Gjykata e Lartë, nga Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, janë nxjerrë e dërguar në formë shkresore si dhe në formë elektronike, aktet e kërkuara.

Me shkresën nr. 1936/1 prot., datë 06.06.2025, ^[21] Gjykata e Lartë sqaron se : "aktet e kërkuara siç parashikohen në pikat "iii", "iv", "vi", "viii", "xii", "xiii", të shkresës nr. 1020/5 prot., datë 07.04.2025 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nuk janë verifikur në praktikë dhe për këtë arsye nuk gjenden bashkëlidhur kësaj shkrese.

Lidhur me pikën xi, bashkëlidhur është dërguar raporti për periudhën 02.10.2024-31.12.2024, duke sqaruar se funksionaliteti i gjenerimit automatik të raportit të shorteve ditore është implementuar në Gjykatën e Lartë me datë 02.10.2024.

Në përmbushje të kërkesave të pikës "xi", Gjykata e Lartë, me shkresën nr. 3450 prot., datë 27.06.2025^[22] i ka kërkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, asistencë teknike për vënien në dispozicion të të dhënave të kërkuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, për periudhën 01.01.2024 - 01.10.2024.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën nr.3681/1 prot., datë 01.07.2025^[23] ka sqaruar se nga sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve nuk është e mundur të gjenerohet automatikisht raporti që pasqyron listën e çështjeve të shortuara për periudhën përpara datës 02.10.2024, për shkak se moduli i shortit nuk ka qenë i integruar dhe funksional në sistem para kësaj date. Për rrjedhojë, për periudhën para datës 02.10.2024, përpunimi dhe sigurimi i të dhënave të realizohet në mënyrë manuale nga Gjykata e Lartë, nga sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve ose nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit të arkivuar sipas praktikës së asaj kohe.

Në vijim, me shkresën nr.1936/2 prot., datë 10.09.2025, ^[24] Gjykata e Lartë ka dërguar në formë elektronike (CD) raportin që pasqyron çështjet e shortuara për periudhën 01.01.2024-01.10.2024.

Me shkresën nr. 3454 prot., datë 27.06.2025, Gjykata e Lartë sqaron se:

- nuk rezultojnë të jetë mbajtur ndonjë procesverbal për pikat "iii", "iv" të shkresës nr. 1020/5 prot., datë 07.04.2025 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- nuk rezultojnë të jetë miratuar ndonjë urdhër apo vendim i Kryetarit të Gjykatës, për pikat "vi", "viii", "xii" të shkresës nr. 1020/5 prot., datë 07.04.2025 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- nuk rezultojnë të jetë miratuar ndonjë vendim i Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve për pikën "xiii" të kësaj shkrese.

^[21] Administruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr.1020/8 prot., datë 05.06.2025

^[22] Kopje e kësaj shkrese i është dërguar për dijeni edhe Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, administruar me nr.1020/10 prot., datë 30.06.2025.

^[23] Kopje e kësaj shkrese i është dërguar për dijeni edhe Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, administruar me nr.1020/12 prot., datë 02.07.2025.

^[24] Kjo shkresë është administruar pranë Zyrës së ILD-së, me nr.1020/18 prot., datë 11.09.2025;

Në periudhën e inspektimit nga aktet e dërguara nga gjykata, si dhe nga konfirmimi i dhënë prej gjykatës, ka rezultuar që Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, ka qenë funksional dhe nuk ka pasur probleme, dhe për këtë arsye nuk ka pasur procesverbal, që të jetë mbajtur nga kryetari i gjykatës, gjyqtarët, kancelari apo kryesekretari i gjykatës dhe punonjësi i IT-së për dokumentimin e hedhjes së shortit të çështjeve në mënyrë manuale.

3. Transparenca e dokumentimit të përgatitjes së shortit.

Gjatë periudhës së inspektuar 01 janar - 31 dhjetor 2024, në Gjykatën e Lartë ushtronin detyrën për një periudhë 18 gjyqtarë por efektivisht kanë qenë 17 gjyqtarë: Sokol Sadushi, Ervin Pupe, Ilir Panda, Sokol Binaj, Albana Boksi, Sander Simoni, Artur Kalaja, Asim Vokshi, Arbena Ahmeti, Gentian Medja, Darjel Sina (për periudhën janar-mars), Sokol Ngresi, Margarita Buhali, Enton Dhimitri, Enkelejda Metaliaj, Vojsava Kola, Valbon Çekrezi, Medi Bici.

Sipas kolegjeve, organika e trupës gjyqësore ka qenë e ndarë në trupa gjykues si më poshtë:

(i) Kolegji Administrativ

Përbërja e kolegjit: Sokol Sadushi, Asim Vokshi, Arbena Ahmeti, Gentian Medja; Sokol Ngresi, Enkelejda Metaliaj;

Trupi gjykues 1. Sokol Sadushi, Sokol Ngresi, Gentian Medja;

Trupi gjykues 2. Asim Vokshi, Arbena Ahmeti, Enkelejda Metaliaj;

(ii) Kolegji Civil

Përbërja e kolegjit: Artur Kalaja, Ervin Pupe, Darjel Sina; Margarita Buhali, Enton Dhimitri; Vojsava Kola, Valbon Çekrezi;

Trupi gjykues 1. Artur Kalaja, Ervin Pupe, Enton Dhimitri;

Trupi gjykues 2. Margarita Buhali, Vojsava Kola, Valbon Çekrezi;

Trupi gjykues 3. Artur Kalaja, Ervin Pupe, Darjel Sina;

(iii) Kolegji Penal

Përbërja e kolegjit: Ilir Panda, Sander Simoni; Albana Boksi, Medi Bici, Sokol Binaj.

Trupi gjykues 1. Ilir Panda, Sokol Binaj, Sander Simoni;

Trupi gjykues 2. Ilir Panda, Albana Boksi, Medi Bici

3.1 Urdhërat e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, që kanë lidhje me procedurat e hedhjes së shortit gjatë vitit 2024:

(i) Urdhër nr. 56 prot., datë 20.02.2024 "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore të gjyqtarit Dariel Sina", sipas të cilit: "1. Çështjet gjyqësore në të cilat gjyqtari Dariel Sina është caktuar në përbërje të trupit gjykues dhe për të cilat janë shpallur datat e gjykimit, si dhe kërkesa që konsiderohen urgjente me relator /anëtar gjyqtarin Dariel Sina (kërkesa lidhur me kompetencën, juridiksionin dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit), të rindahen me short ndërmjet gjyqtarëve të tjerë të Kolegjit Civil. 2. Rindarja me short të bëhet për çështjet e shpallura për gjykim në datat 06 mars, 13 mars, 20 mars dhe 27 mars

2024. Për kërkesat urgjente, shorti hidhet sipas radhës së trajtimit". Urdhëri cakton hyrjen në fuqi menjëherë.

(ii) Urdhër nr. 64 prot., datë 01.03.2024 "Për disa masa organizative lidhur me menaxhimin e çështjeve gjyqësore". Sipas këtij Urdhëri, çështja gjyqësore me nr. akti (31003-01625-00-2017), me gjyqtar relator z. Sokol Sadushi, e cila është shortuar gabimisht në datë 31.01.2024, të kalojë përsëri në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve në emër të gjyqtarit z. Sokol Sadushi."

Urdhëri cakton hyrjen në fuqi menjëherë.

(iii) Urdhër nr. 56/1 prot., datë 19.03.2024 "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore të gjyqtarit Daniel Sina". Sipas këtij Urdhëri: "1. Çështjet gjyqësore në të cilat gjyqtari Daniel Sina është caktuar në përbërje të trupit gjykues dhe për të cilat janë shpallur datat e gjykimit, si dhe kërkesa që konsiderohen urgjente me relator /anëtar gjyqtarin Daniel Sina (kërkesa lidhur me kompetencën, juridiksionin dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit), të rindahen me short ndërmjet gjyqtarëve të tjerë të Kolegjit Civil. 2. Rindarja me short të bëhet për çështjet e shpallura për gjykim sipas datave të planifikuara në kalendrin e gjyqësor të muajit prill 2024. Urdhëri cakton hyrjen në fuqi menjëherë.

(iv) Urdhër nr. 81 prot., datë 19.03.2024 "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore për shqyrtimin e të cilave janë caktuar gjyqtarë të Gjykatës së lartë që i kanë gjykuar ato më parë gjatë ushtrimit të detyrës në gjykatat më të ulta". Sipas këtij Urdhëri: "1. Çështjet gjyqësore të regjistruara para hyrjes në fuqi të vendimit nr. 554, datë 29.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", në të cilat një gjyqtar është shortuar si anëtar i trupit gjykues dhe ka gjykuar çështjen në shkallë të tjera të gjykimit t'i nënshtrohen procesit të ri shortimit kur konstatohet haptazi se është në kushtet e papajtueshmërisë për shqyrtimin e tyre. 2. Në rastin e caktimit me short të relatorit, procesi i rishortimit të këtyre çështjeve referuar vendimit nr.26, datë 05.10.2023 të Këshillit të Gjykatës së Lartë, të bëhet ndërmjet gjyqtarëve të tjerë të Kolegjit". Urdhëri cakton hyrjen në fuqi menjëherë.

(v) Urdhër nr. 89 prot., datë 02.04.2024 "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore të gjyqtarit Daniel Sina". Sipas këtij Urdhëri: "1. Çështjet gjyqësore për të cilat gjyqtari Daniel Sina është caktuar gjyqtar relator, të rindahen me short ndërmjet gjyqtarëve të tjerë të Kolegjit Civil, sipas rregullave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.724, datë 07.12.2023 "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore", duke mbajtur në vëmendje një ndarje proporcionale të këtyre çështjeve në raport me ngarkesën aktuale individuale të secilit gjyqtar të Kolegjit, me qëllim sigurimin e një ngarkese të barabartë mes tyre në përfundimin e një procedure. 2. Rindarja e çështjeve gjyqësore të gjyqtarit Daniel Sina, të bëhet për të gjitha çështjet që i përkasin regjistrimit të vitit 2015". Urdhëri cakton hyrjen në fuqi menjëherë.

(vi) Urdhër nr. 116 prot., datë 30.04.2024 "Për zëvendësimin e gjyqtarit Daniel Sina në shqyrtimin e çështjeve gjyqësore në të cilat është caktuar anëtar i trupit gjykues". Sipas këtij Urdhëri: "1. Për çështjet gjyqësore për të cilat gjyqtari Daniel Sina është caktuar në

përbërje të trupit gjykues dhe gjyqtarët relatorë të çështjeve planifikojnë datën e shqyrtimit, të bëhet zëvendësimi i këtij gjyqtari me gjyqtar të tjerë të kolegjit Civil. 2. Zëvendësimi i gjyqtarit Daniel Sina të bëhet për çështjet gjyqësore sipas datave që planifikohen nga gjyqtarët relator të Kolegjit Civil, në kalendarin e gjykimit të çështjeve” 3. Kancelari i Gjykatës, Kryesekretari dhe Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit dhe Sigurisë të evidentojë në një kohë sa më të shpejtë çështjet gjyqësore të gjyqtarit Daniel Sina, në të cilat ai është anëtar i trupit gjykues, të bëjë rindarjen me short mes gjyqtarëve të tjerë sipas pikës 1 të këtij udhri, si dhe të bëjë menjëherë njoftimin përkatës në sistem”. Urdhëri cakton hyrjen në fuqi menjëherë.

(vii) Urdhër nr. 123 prot., datë 14.05.2024 “Për zëvendësimin e gjyqtarit Daniel Sina në shqyrtimin e çështjeve gjyqësore në të cilat është caktuar gjyqtar relator”. Sipas këtij Urdhëri: “1. Gjyqtari Daniel Sina të zëvendësohet me gjyqtarë të tjerë të Kolegjit Civil, për shqyrtimin e çështjeve gjyqësore që konsiderohen me natyrë urgjente në të cilat është caktuar gjyqtar relator. 2. Gjyqtari Daniel Sina të përjashtohet nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore që kanë të bëjnë me zëvendësimin e gjyqtarëve të tjerë. 3. Kancelari i Gjykatës, Kryesekretari dhe Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit dhe Sigurisë të evidentojë në një kohë të shpejtë çështjet që konsiderohen me natyrë urgjente, të bëjnë zëvendësimin e gjyqtarit me gjyqtarë të tjerë sipas pikës 1 të këtij udhri, si dhe të bëjë menjëherë njoftimin përkatës në sistem”. Urdhëri cakton hyrjen në fuqi menjëherë.

(viii) Urdhër nr. 144 prot., datë 03.06.2024 “Për zëvendësimin e gjyqtarit Daniel Sina në shqyrtimin e çështjeve gjyqësore në të cilat është caktuar anëtar i trupit gjykues”. Sipas këtij Urdhëri: “1. Për çështjet gjyqësore në të cilat gjyqtari Daniel Sina është caktuar si relator i çështjeve gjyqësore, të bëhet zëvendësimi i këtij gjyqtari me gjyqtar të tjerë të kolegjit Civil. 2. Rindarja me short të bëhet për çështje me vit regjistrimi 2016, në ngarkim të gjyqtarit Daniel Sina”. 3. Kancelari i Gjykatës, Kryesekretari dhe Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit dhe Sigurisë të evidentojë në një kohë të shpejtë çështjet gjyqësore të gjyqtarit Daniel Sina, në të cilat ai është caktuar gjyqtar relator në çështjet që i përkasin vitit të regjistrimit 2016, të bëjnë rindarjen me short mes gjyqtarëve të sipas pikës 1 të këtij Urdhëri, si dhe të bëjë menjëherë njoftimin përkatës në sistem”. Urdhëri cakton hyrjen në fuqi menjëherë.

(ix) Urdhër nr. 188 prot., datë 30.07.2024 “Për pezullimin e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore”. Sipas këtij Urdhëri: “1. Ndarja e çështjeve gjyqësore me short elektronik pezullohet gjatë periudhës së pushimeve vjetore nga datat 01 gusht - 28 gusht 2024. 2....” Urdhëri cakton hyrjen në fuqi menjëherë.

(x) Urdhër nr. 192 prot., datë 31.07.2024 “Për gjykimin e çështjeve të ngutshme në periudhën e pushimeve verore”. Sipas këtij Urdhëri: “1. Çështjet dhe kërkesat procedurale me natyrë të ngutshme të shpallura dhe të shpallura për gjykim para hyrjes në fuqi të Urdhërit nr. 186, datë 30.07.2024 “Për dhënien e pushimit vjetor për vitin 2024”, por gjykimi i të cilave nuk ka përfunduar, të vijojë të gjykohen në muajn gusht 2024. 2. Gjyqtarët që bëjnë pjesë në trupat gjyqësore të ngarkuar për gjykimin e çështjeve dhe kërkesave procedurale me natyrë të ngutshme, si dhe këshilltarët ligjor të ngarkuar me

studimin e tyre, nëse pjesëmarrja e tyre çmohet e nevojshme nga gjyqtari relator, të ndërpresin pushimet vjetore në ditët e caktuara për gjykimin e tyre. 3. Ditët e pushimeve vjetore në të cilat gjyqtarët kanë gjykuar çështjet dhe kërkesat procedurale të ngutshme, si dhe këshilltarët ligjor përkatës sipas këtij Urdhëri, të zëvendësohen në një periudhë tjetër sipas kërkesës së gjyqtarit/këshilltarit ligjor dhe prashikimeve ligjore". Urdhëri cakton hyrjen në fuqi menjëherë.

xi) Urdhër nr. 269 prot., datë 20.11.2024 "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore të gjyqtarit Daniel Sina" Sipas këtij Urdhëri: "1. Të gjitha çështjet gjyqësore për të cilat gjyqtari Daniel Sina ishte caktuar relator, të rindahen me short mes gjyqtarëve të tjerë të Kolegjit Civil. [...] 3. Kancelari i Gjykatës, Kryesekretari dhe Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit dhe Sigurisë të evidentojë në një kohë sa më të shpejtë çështjet gjyqësore të gjyqtarit Daniel Sina, në të cilat ai ishte caktuar relator, të bëjnë rindarjen me short mes gjyqtarëve të tjerë sipas pikës 1 të këtij Urdhëri, si dhe të bëjë menjëherë njoftimin përkatës në sistem". Urdhëri cakton hyrjen në fuqi menjëherë.

Në lidhje me nxjerrjen e akteve sa i përket mënyrës së ndarjes së çështjeve me short, rezulton se për periudhën janar-dhjetor 2024 Kryetari i Gjykatës ka nxjerrë Urdhëra për rregullimin e kushteve dhe rrethanave të krijuara në Gjykatë, konform vendimit të Këshillit të Lartë të Gjyqësor nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore".

3.2 Vendimet e Këshillit të Gjykatës së Lartë gjatë vitit 2024:

Në lidhje me nxjerrjen e akteve sa i përket mënyrës së ndarjes së çështjeve me short, konform vendimit të Këshillit të Lartë të Gjyqësor nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", rezulton se për periudhën janar-dhjetor 2024 nuk janë nxjerrë akte të reja për procedurën e hedhjes së shortit, por kanë qenë të vlefshëm dhe janë aplikuar aktet e mëparshme, të nxjerra nga Këshilli i Gjykatës për këtë qëllim.

4. Përjashtimet nga hedhja në short e gjyqtarëve^[25]

• Heqjet dorë të gjyqtarëve nga gjykimi i çështjeve

Në kohën e inspektuar 01 janar 2024 – 31 dhjetor 2024, në Gjykatën e Lartë janë paraqitur nga gjyqtarët **448** kërkesa për heqje dorë nga gjykimi, për të cilat për 446 është pranuar dorëheqja, për 1 rast është refuzuar nga Kryetari Gjykatës z. Sokol Sadushi.

Në mënyrë të përmbedhur jepen rastet për secilin gjyqtar që ka paraqitur kërkesa për heqje dorë, të cilat janë miratuar, konkretisht:

- Gjyqtari Sokol Sadushi ka paraqitur gjithësej **15** kërkesa dorëheqje, të cilat janë

^[25] Kjo pikë e raportit përfshin largimin e gjyqtarëve nga çështjet gjyqësore: a)-për kërkesa për dorëheqje gjyqtari, të miratuara nga Kryetari i Gjykatës; b)-për kërkesa për përjashtim gjyqtari nga gjykimi, për të cilat ka vendim gjyqësor; dhe c)-për raste kur gjyqtari është larguar për shkak të procedurave të zbatimit të ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" ose për arsye të tjera të ligjshme.

pranuar^[26];

- Gjyqtari Gentian Medja ka paraqitur gjithësej 16 kërkesa dorëheqje, të cilat janë pranuar;
- Gjyqtare Albana Boksi ka paraqitur 34 kërkesa për dorëheqje, të cilat janë pranuar;
- Gjyqtari Vojsava Kola ka paraqitur gjithësej 13 kërkesa dorëheqje, të cilat janë pranuar;
- Gjyqtari Ervin Pupe ka paraqitur gjithësej 11 kërkesa për dorëheqje, të cilat janë pranuar;
- Gjyqtari Valbon Çekrezi ka paraqitur gjithësej 38 kërkesa dorëheqje, që janë pranuar;
- Gjyqtarja Margarita Buhali ka paraqitur gjithësej 50 kërkesa dorëheqje, që janë pranuar;
- Gjyqtari Ilir Panda ka paraqitur gjithësej 27 kërkesa për dorëheqje, të cilat janë pranuar;
- Gjyqtari Sokol Binaj ka paraqitur gjithësej 34 kërkesa për dorëheqje, të cilat janë pranuar;
- Gjyqtari Sander Simoni ka paraqitur 34 kërkesa për dorëheqje, të cilat janë pranuar;
- Gjyqtari Medi Bici ka paraqitur 14 kërkesa për dorëheqje, të cilat janë pranuar;
- Gjyqtari Enton Dhimitri ka paraqitur gjithësej 31 kërkesa dorëheqje, të cilat janë pranuar;
- Gjyqtarja Arbena Ahmeti ka paraqitur gjithësej 25 kërkesa dorëheqje, që janë pranuar;
- Gjyqtari Sokol Ngresi ka paraqitur gjithësej 28 kërkesa dorëheqje, të cilat janë pranuar;
- Gjyqtari Asim Vokshi ka paraqitur gjithësej 13 kërkesa dorëheqje, të cilat janë pranuar;
- Gjyqtarja Enkelejda Metaliaj ka paraqitur gjithësej 27 kërkesa dorëheqje, 26 pranuar, 1 refuzuar;
- Gjyqtari Artur Kalaja ka paraqitur gjithësej 38 kërkesa dorëheqje, të cilat janë pranuar;

Nga tërësia e kërkesave të gjyqtarëve për heqjen dorë nga gjykimi i çështjeve të caktuara, vetëm një kërkesë është refuzuar nga Kryetari i Gjykatës, kurse të tjerat janë miratuar pasi janë gjetur në përputhje me kriteret ligjorë për heqjen dorë nga gjykimi.

Në lidhje me heqjet dorë nga gjykimi të Kryetarit të Gjykatës, këto kërkesa janë trajtuar nga trupi gjykues i zgjedhur me short sipas parashikimeve ligjore dhe për çdo rast, kërkesat janë pranuar, pasi janë gjetur në përputhje me kriteret ligjorë për heqjen dorë nga gjykimi.

• Përjashtimet e gjyqtarëve nga gjykimi i çështjeve

Në kohën e inspektuar 01 janar 2024 - 31 dhjetor 2024, në Gjykatën e Lartë janë paraqitur nga palët ndërgjyqëse 2 "kërkesa për përjashtim gjyqtari nga gjykimi", për të cilat është vendosur:

- Për gjyqtaren Enkelejda Metaliaj kërkesë për përjashtim nga çështja administrative nr.(31003-00018-00-2018), datë regjistrimi 04.01.2018, **rrëzuar**;
- Për gjyqtarin Medi Bici kërkesë për përjashtim nga çështja penale nr. (52105-00378-00-2019), datë regjistrimi 05.04.2019, **pranuar**;

Rezulton se ka patur vetëm dy kërkesa për përjashtim, nga të cilat, njëra është pranuar dhe tjetra është rrëzuar, pasi nuk është gjetur e mbështetur në prova dhe në ligj.

^[26] Kërkesat për heqje dorë të kryetarit të gjykatës janë trajtuar nga trupi gjykues i zgjedhur me short sipas parashikimeve ligjore;

- Afatet kohore të miratimit / refuzimit nga Kryetari i Gjykatës, të kërkesave për heqje dorë të gjyqtarëve.

Duke krahasuar të dhënat, rezulton se koha nga paraqitja e kërkesës për dorëheqje e gjyqtarit, deri në miratimin ose refuzimin e saj nga Zv/Kryetari apo Kryetari i Gjykatës, afati kohor varion: për 7 raste vendimi është dhënë brenda ditës; për 12 raste vendimi është dhënë pas 1 dite; për 22 raste vendimi është dhënë pas 2 ditësh; për 13 raste vendimi është dhënë pas 3 ditësh; për 12 raste vendimi është dhënë pas 4 ditësh; për 12 raste vendimi është dhënë pas 5 ditësh; për 18 raste vendimi është dhënë pas 6 ditësh; për 22 raste vendimi është dhënë pas 7 ditësh; për 16 raste vendimi është dhënë pas 8 ditësh; për 19 raste vendimi është dhënë pas 9 ditësh; për 13 raste vendimi është dhënë pas 10 ditësh; për 13 raste vendimi është dhënë pas 11 ditësh; për 23 raste vendimi është dhënë pas 12 ditësh; për 14 raste vendimi është dhënë pas 13 ditësh; për 19 raste vendimi është dhënë pas 14 ditësh; për 18 raste vendimi është dhënë pas 15 ditësh; për 8 raste vendimi është dhënë pas 16 ditësh; për 10 raste vendimi është dhënë pas 17 ditësh; për 6 raste vendimi është dhënë pas 18 ditësh; për 11 raste vendimi është dhënë pas 19 ditësh; për 7 raste vendimi është dhënë pas 20 ditësh; për 8 raste vendimi është dhënë pas 21 ditësh; për 12 raste vendimi është dhënë pas 22 ditësh; për 15 raste vendimi është dhënë pas 23 ditësh; për 6 raste vendimi është dhënë pas 24 ditësh; për 3 raste vendimi është dhënë pas 25 ditësh; për 2 raste vendimi është dhënë pas 26 ditësh; për 3 raste vendimi është dhënë pas 27 ditësh; për 46 raste vendimi është dhënë pas 28 ditësh; për 1 rast vendimi është dhënë pas 29 ditësh; për 4 raste vendimi është dhënë pas 30 ditësh; dhe për 3 raste vendimi është dhënë pas 31 ditësh;

Vendimet për pranimin e heqjes dorë të gjyqtarëve nga trupat gjykuese për shkaqet e parashikuara në ligj, janë dhënë nga kryetari i Gjykatës së Lartë brenda afateve ndërsa për tre raste është bërë përtej 31 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesave për heqje dorë nga gjykimi.

• Plotësimet e trupave gjykues pas miratimit të dorëheqjeve

Nga 448 kërkesa për heqje dorë nga gjykimi i një çështje të caktuar, 15 raste janë dorëheqje të kryetarit të Gjykatës së Lartë, Sokol Sadushi. Në të gjitha këto raste, çështjet janë rishortuar elektronikisht për plotësimin e trupës gjykuese.

Në rastet e tjera, konkretisht për 307 kërkesa të heqjeve dorë të gjyqtarëve nga gjykimi i çështjeve, plotësimi i trupave gjykuese janë bërë me anë të shortit manual, pasqyruar në proces-verbalet, përkatëse pjesë e dokumentacionit.

Vetëm në 1 rast është aplikuar shorti elektronik për plotësimin e trupit gjykues, kur shkak për mosgjykimin e çështjes ka ekzistuar për të gjithë trupën gjykuese (çështja penale nr. 802/23 me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët I. Panda, S. Simoni, S. Binaj).

Sa i përket kërkesave të gjyqtarëve për përjashtimin nga pjesëmarrja në shorte dhe mënyrën e trajtimit të tyre nga kryetari i gjykatës, referuar shkresës nr. 1936/1 prot., datë 06.06.2025

të Gjykatës së Lartë, rezulton se në periudhën objekt inspektimi nuk ka pasur raste të kërkesave të gjyqtarëve për përjashtim nga pjesëmarrja në short.

5. Çështjet e hedhura më parë në short.

Ky seksion nuk aplikohet në rastin e Gjykatës së Lartë pasi natyra e veprimtarisë së kësaj gjykate është e ndryshme nga ajo e gjykatave të juridiksioneve dhe niveleve të tjera të sistemit gjyqësor.

6. Zëvendësimi i anëtarit të trupit gjykues dhe plotësimi me anëtar i trupit gjykues.

Referuar dokumentacionit të dërguar nga Gjykata e Lartë, rezulton se në vitin 2024, pas pranimit të kërkesave për heqje dorë të gjyqtarëve nga çështje të caktuara, zëvendësimi i anëtarit të trupit gjykues është bërë me anë të shortit manual, pasqyruar në proces-verbalet, përkatëse pjesë e dokumentacionit.

7. Të dhënat mbi organizimin e shortit

Nga të dhënat e paraqitur nga Gjykata e Lartë në lidhje me shpërndarjen e çështjeve të regjistruara gjatë vitit 2024 nëpërmjet shortit elektronik, shorti manual dhe rishortimit elektronik, rezulton se:

7.1 Çështjet e shpërndara me short elektronik

Nga analiza e të dhënave statistikore të përpunuara konstatohet se në periudhën 01 janar - 31 dhjetor 2024 në Gjykatën e Lartë, gjyqtarët kanë marrë me short elektronik **2551^[27]** çështje, prej të cilave: **768** çështje civile-**127** kërkesa civile, **732** çështje penale, **48** kërkesa penale dhe **688** çështje administrative-**188** kërkesa administrative^[28] (shih aneksin 1 bashkëlidhur).

a) Çështjet e shpërndara me short elektronik sipas Kolegjeve:

• Çështjet civile

Nga 768 çështje civile dhe 127 kërkesa civile (në total 895), gjyqtarët e Kolegjit Civil kanë marrë me short 669 çështje civile dhe 83 kërkesa civile (në total 752), gjyqtarët e Kolegjit Penal kanë marrë me short 98 çështje civile dhe 25 kërkesa civile (në total 123), kurse

^[27] Kjo shifër ka dalë nga të dhënat që ka sjellë Gjykata e Lartë, ndërkohë nga të dhënat e deklaruara në Raportin Vjetor të Këshillit të Lartë Gjyqësor për gjendjen e sistemit gjyqësor për vitin 2024 çështje të reja për vitin 2024 pranë kësaj gjykate janë 2469.

^[28] Sipas të dhënave të dërguar nga Gjykata e Lartë në formatin excel për shortin elektronik të vitit 2024, rezulton se: 1. tabela përmbljedhëse e përgatitur nga Gjykata ka këto të dhëna: 2561 çështje në total, prej të cilave 768 civile, 731 penale, 692 administrative, 136 kërkesa civile, 48 kërkesa penale, 186 kërkesa administrative. Nga përpunimi i të dhënave: a) shumatorët e çështjeve të shortuara për çdo muaj, b) rekordët sipas datave të shortit elektronik të hodhur, rezulton se janë: 2551 çështje në total, prej të cilave: 468 civile, 732 penale, 688 administrative, 127 kërkesa civile, 48 kërkesa penale, 188 kërkesa administrative.

gjyqtarët e Kolegjit Administrativ kanë marrë me short 1 çështje civile dhe 19 kërkesa civile (në total 20). Konkretisht:

Nga 752 çështje dhe kërkesa civile të shqyrtuara në Kolegjin Civil, gjyqtari Valbon Çekrezi ka marrë me short elektronik 196 (ose 26.06%), Vojsava Kola 177 (ose 23.54%), Margarita Buhali 107 (14.23%), Artur Kalaja 97 (12.9%), Darjel Sina 95 (12.63%), Ervin Pupe 80 (10.64%). Nga çështjet dhe kërkesat civile të shpërndara me short elektronik normal, ngarkesa për gjyqtar ka qenë e pabarabartë.

Nga 123 çështje dhe kërkesa civile të shqyrtuara në Kolegjin Penal, gjyqtari Enton Dhimitri ka marrë me short elektronik 112 çështje (ose 91.06%), Albana Boksi 3 (2.44%), Sokol Binaj 3 (2.44%), Ilir Panda 2 (1.63%), Medi Bici 2 (1.63%), Sander Simoni 1 (0.81%). Nga 20 çështje dhe kërkesa civile të shqyrtuara në Kolegjin Administrativ, gjyqtari Sokol Ngresi ka marrë me short elektronik 5 (ose 25%), Arbena Ahmeti 4 (20%), Asim Vokshi 3 (15%), Gentian Medja 3 (15%), Sokol Sadushi 3 (15%), Enkelejda Metaliaj 1 (5%) dhe një tjetër 1 (5%).

- **Çështjet penale**

Nga 732 çështje penale dhe 48 kërkesa penale (në total 780), gjyqtarët e Kolegjit Penal kanë marrë me short 729 çështje penale dhe 30 kërkesa penale (në total 759), gjyqtarët e Kolegjeve Civil kanë shqyrtuar 11 (3 çështje / 8 kërkesa) dhe gjyqtarët e Kolegjit Administrative 10 kërkesa penale, konkretisht:

Nga 780 çështje dhe kërkesa penale të shqyrtuara në Kolegjin Penal, gjyqtari Sokol Binaj ka marrë me short elektronik 165 çështje dhe kërkesa (ose 21.74%), Albana Boksi 155 (20.42%), Ilir Panda 137 (18.05%), Medi Bici 123 (16.21%), Sander Simoni 178 (10.28%), Enton Dhimitri 1 (0.13%).

Nga 11 çështje dhe kërkesa penale të shqyrtuara në Kolegjin Civil, gjyqtari Valbon Çekrezi ka marrë me short elektronik 3 çështje (27.27%), Darjel Sina 2 (18.18%), Ervin Pupe 2 (18.18%), Vojsava Kola 2 (18.18%), Artur Kalaja 1 (9.09%), Margarita Buhali 1 (9.09%). Nga 10 çështje dhe kërkesa penale të shqyrtuara në Kolegjin Administrativ, gjyqtari Asim Vokshi ka marrë me short elektronik 3 çështje (30%), Enkelejda Metaliaj 2 (20%), Sokol Sadushi 2 (20%), Arbena Ahmeti 1 (10%), Gentian Medja 1 (10%), Sokol Ngresi 1 (10%).

- **Çështjet administrative**

Nga 688 çështje administrative dhe 188 kërkesa administrative (në total 876), gjyqtarët e Kolegjit Administrativ kanë marrë me short 688 çështje administrative dhe 136 kërkesa administrative (në total 824), gjyqtarët e Kolegjit Penal kanë marrë me short 28 kërkesa administrative dhe gjyqtarët e Kolegjit Civil 24 kërkesa administrative. Konkretisht:

Nga 824 çështje dhe kërkesa administrative të shqyrtuara në Kolegjin Administrativ, gjyqtari Gentian Medja ka marrë me short elektronik 150 çështje dhe kërkesa ose 18.2% e

totalit të tyre, Enkelejda Metaliaj 146 (17.72%), Sokol Ngresi 135 (16.38%), Arbena Ahmeti 131 (15.9%), Asim Vokshi 131 (15.9%), Sokol Sadushi 131 (15.9%).

Nga 24 kërkesa administrative të shqyrtuara në Kolegjin Civil, gjyqtari Valbon Çekrezi ka marrë me short elektronik 8 (ose 33.33%), Ervin Pupe 6 (25%), Margarita Buhali 5 (25%), Vojsava Kola 3 (12.5%), Artur Kalaja 1 (4.17%), Darjel Sina 1 (4.17%).

Nga 28 kërkesa administrative të shqyrtuara në Kolegjin Penal, gjyqtari Medi Bici ka marrë me short elektronik 7 kërkesa (ose 25%), Enton Dhimitri 6 (21.43%), Ilir Panda 4 (14.29%), Sander Simoni 4 (14.29%), Sokol Binaj 4 (14.29%), Albana Boksi 3 (10.7%).

b) Çështjet e shpërndara me short elektronik sipas gjyqtarëve për çdo muaj

Shorti është hedhur në 2024 është hedhur në 226 ditë të vitit *(shih aneksin 1 bashkëlidhur)*.

Rezulton se shorti elektronik është hedhur çdo ditë, gjatë ditëve të punës (në 226 ditë), pavarësisht numrit të çështjeve të regjistruara për çdo ditë.

7.2 Çështjet e rindara me short

Gjatë vitit 2024, gjyqtarët kanë marrë nëpërmjet rindarjes së çështjeve me short 1173 çështje, të gjitha në Kolegjin Civil. Gjyqtarët e Kolegjit Civil kanë marrë 1173 çështje civile të ish gjyqtarit Darjel Sina, bazuar në Urdhërin nr. 269, datë 20.11.2024 të Kryetarit të Gjykatës së Lartë "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore të gjyqtarit z. Darjel Sina" konkretisht: Artur Kalaja 200, Valbon Çekrezi 196, Margarita Buhali 195, Enton Dhimitri 194, Ervin Pupe 194, Vojsava Kola 194.

Nga çështjet civile të rindara me short në Kolegjin Civil, ngarkesa për gjyqtar ka qenë e barabartë: Artur Kalaja 17.1%, Valbon Çekrezi 16.7%, Margarita Buhali 16.6%, Enton Dhimitri 16.5%, Ervin Pupe 16.5%, Vojsava Kola 16.5%.

a) Caktimi i çështjeve civile të rindara sipas muajve:

Për 1173 çështjeve civile është hedhur short në 3 ditë të vitit kalendarik 2024, konkretisht:
- Në muajin **dhjetor 2024**, shorti është hedhur në datat 20, 23 dhe 30.

Gjyqtari	Data 20/12/2024		Data 23/12/2024		Data 30/12/2024	
Artur Kalaja	75	17,08	70	17,16	55	16,87
Enton Dhimitri	73	16,63	67	16,42	54	16,56
Ervin Pupe	72	16,40	67	16,42	55	16,87
Margarita Buhali	72	16,40	69	16,91	54	16,56
Valbon Çekrezi	75	17,08	67	16,42	54	16,56
Vojsava Kola	72	16,40	68	16,67	54	16,56
Total	439	100,00	408	100,00	326	100,00

Ky proces ka vazhduar edhe gjatë vitit 2025, por që është jashtë periudhës së këtij inspektimi.

Referuar Urdhërit nr. 269 prot., datë 20.11.2024 "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore të gjyqtarit Danel Sina", "1.Të gjitha çështjet gjyqësore për të cilat gjyqtari Danel Sina ishte caktuar relator, të rindahen me short mes gjyqtarëve të tjerë të Kolegjit Civil. [...] 3. Kancelari i Gjykatës, Kryesekretari dhe Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit dhe Sigurisë të evidentojë në një kohë sa më të shpejtë çështjet gjyqësore të gjyqtarit Danel Sina, në të cilat ai ishte caktuar relator, të bëjnë rindarjen me short mes gjyqtarëve të tjerë sipas pikës 1 të këtij udhri, si dhe të bëjë menjëherë njoftimin përkthës në sistem".

Ky akt, përpos faktit të konstatuar, të barazisë së krijuar në rindarjen e çështjeve, zbatimi i tij, evidentohet se ka filluar pas gati një muaj nga hyrja në fuqi, si dhe i ndarë në tre faza, respektivisht në datat 20, 23 dhe 30 Dhjetor 2024, duke vijuar për disa çështje edhe në fillim të vitit 2025. Kjo kohë e marrë në dispozicion për më shumë se një muaj dhe e aplikuar në ditë të ndryshme, megjithë kohën që kërkon në dispozicion ky proces, nuk është në përputhje me Vendimin nr. 724, datë 7.12.2023 "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore", që përcakton se në raste të tilla, çështje rindahen me short menjëherë.

b. Çështjet të tjera të rindara me short

Gjatë vitit 2024, gjyqtarët kanë marrë me rishortim elektronik 842 çështje, prej të cilave: 283 çështje civile, 152 çështje penale, 228 administrative dhe 69 kërkesa civile, 25 kërkesa penale dhe 85 kërkesa administrative.^[29]

Kolegji	Çështje civile	Kërkesa civile	Çështje penale	Kërkesa penale	Çështje administrative	Kërkesa Adm.	Total
Civil	242	32	7	7	0	23	311
Penal	41	16	142	10	1	26	236
Administrativ	0	21	3	8	227	36	295
Total	283	69	152	25	228	85	842

• Çështjet e rindara me short elektronik në Kolegjin Civil:

Gjyqtarët e Kolegjit Civil kanë marrë 352 çështje dhe kërkesa civile nga rishortimi elektronik, konkretisht: Ervin Pupe 78, Vojsava Kola 74, Valbon Çekrezi 66, Artur Kalaja 52, Margarita Buhali 36, Darjel Sina 5 çështje.

^[29] Sipas të dhënave të dërguar nga Gjykata e Lartë në formatin excel për rishortimin elektronik të vitit 2024, rezultojnë se: 1. tabela përmblledhëse e përgatitur nga Gjykata ka këto të dhëna: 841 çështje në total, prej të cilave 281 civile, 139 penale, 228 administrative dhe 77 kërkesa civile, 31 kërkesa penale dhe 85 kërkesa administrative. Nga përpunimi i të dhënave ka rezultuar se shumatorët e çështjeve të rishortuara për çdo muaj kanë qenë: 842 çështje në total prej të cilave, 283 civile, 152 penale, 228 administrative dhe 69 kërkesa civile, 25 kërkesa penale, 85 kërkesa administrative.

Nga çështjet civile të shpërndara me rishortim elektronik në Kolegjin Civil, ngarkesa për gjyqtar ka qenë e pabarabartë: Ervin Pupe 25.08%, Vojsava Kola 23.79%, Valbon Çekrezi 21.22%, Artur Kalaja 16.72%, Margarita Buhali 11.58%, Darjel Sina 1.61% çështje.

• **Rindarja e çështjeve civile sipas muajve:**

Rishortimi i 311 çështjeve civile është hedhur në 213 ditë të vitit 2024, konkretisht *(shih edhe aneksin 1 bashkëlidhur)*:

- Në muajin **janar** 2024 janë rindarë 13 çështje;
- Në muajin **shkurt** 2024 janë rindarë 25 çështje;
- Në muajin **mars** 2024 janë rindarë 22 çështje;
- Në muajin **prill** 2024 janë rindarë 39 çështje;
- Në muajin **maj** 2024 janë rindarë 52 çështje;
- Në muajin **qershor** 2024 janë rindarë 34 çështje;
- Në muajin **korrik** 2024 janë rindarë 43 çështje;
- Në muajin **shtator** 2024 janë rindarë 16 çështje;
- Në muajin **tetor** 2024 janë rindarë 33 çështje;
- Në muajin **nëntor** 2024 janë rindarë 20 çështje;
- Në muajin **dhjetor** 2024 janë rindarë 14 çështje.

• **Rindarja e çështjeve civile sipas gjyqtarëve:**

- Në muajin **janar** 2024 janë rindarë 13 çështje civile: gjyqtari Vojsava Kola ka marrë 5 çështje, Valbon Çekrezi 4, Artur Kalaja 3, Ervin Pupe 1.
- Në muajin **shkurt** 2024 janë rindarë 25 çështje civile: gjyqtari Vojsava Kola ka marrë 9 çështje, Ervin Pupe 8, Valbon Çekrezi 5, Margarita Buhali 2, Artur Kalaja 1.
- Në muajin **mars** 2024 janë rindarë 22 çështje civile: gjyqtari Vojsava Kola ka marrë 12 çështje, Valbon Çekrezi 4, Ervin Pupe 3, Margarita Buhali 2, Artur Kalaja 1.
- Në muajin **prill** 2024 janë rindarë 39 çështje civile: gjyqtari Valbon Çekrezi 13, Artur Kalaja 8, Ervin Pupe 7, Vojsava Kola 7, Margarita Buhali 4.
- Në muajin **maj** 2024 janë rindarë 52 çështje civile: gjyqtari Ervin Pupe 21, Artur Kalaja 13, Vojsava Kola 6, Valbon Çekrezi 5, Margarita Buhali 3.
- Në muajin **qershor** 2024 janë rindarë 34 çështje civile: gjyqtari Valbon Çekrezi 10, Vojsava Kola 8, Ervin Pupe 6, Artur Kalaja 5, Margarita Buhali 4, Darjel Sina 1.
- Në muajin **korrik** 2024 janë rindarë 43 çështje civile: gjyqtari Vojsava Kola 12, Artur Kalaja 11, Ervin Pupe 9, Valbon Çekrezi 6, Margarita Buhali 5.
- Në muajin **shtator** 2024 janë rindarë 16 çështje civile: gjyqtari Ervin Pupe 7, Valbon Çekrezi 5, Artur Kalaja 2, Margarita Buhali 2.
- Në muajin **tetor** 2024 janë rindarë 33 çështje civile: gjyqtari Ervin Pupe 9, Artur Kalaja 7, Vojsava Kola 7, Margarita Buhali 5, Valbon Çekrezi 5.
- Në muajin **nëntor** 2024 janë rindarë 20 çështje civile: gjyqtari Ervin Pupe 7, Valbon Çekrezi 6, Vojsava Kola 4, Margarita Buhali 2, Artur Kalaja 1.
- Në muajin **dhjetor** 2024 janë rindarë 14 çështje civile: gjyqtari Margarita Buhali 7, Vojsava Kola 4, Valbon Çekrezi 3.

• **Çështjet e rindara me short në Kolegjin Penal:**

Gjyqtarët e Kolegjit Penal kanë marrë me rishortim **236** çështje penale, konkretisht: Enton Dhimitri 52, Ilir Panda 48, Sokol Binaj 37, Sandër Simoni 35, Medi Bici 33, Albana Boksi 31.

Nga çështjet penale të shpërndara me rishortim elektronik, ngarkesa për gjyqtar ka qenë e pabarabartë, Enton Dhimitri 22.03%, Ilir Panda 20.34%, Sokol Binaj 15.68%, Sandër Simoni 14.83%, Medi Bici 13.98%, Albana Boksi 13.14%.

• **Rishortimi elektronik i çështjeve penale sipas muajve (shih aneksin 1 bashkëlidhur):**

- Në muajin **janar** 2024 janë rindarë **19** çështje penale;
- Në muajin **shkurt** 2024 janë rindarë **20** çështje penale;
- Në muajin **mars** 2024 janë rindarë **27** çështje penale;
- Në muajin **prill** 2024 janë rindarë **28** çështje penale;
- Në muajin **maj** 2024 janë rindarë **19** çështje penale;
- Në muajin **qershor** 2024 janë rindarë **19** çështje penale;
- Në muajin **korrik** 2024 janë rindarë **23** çështje penale;
- Në muajin **gusht** 2024, rishortimi elektronik është hedhur për **1** çështje;
- Në muajin **shtator** 2024 janë rindarë **28** çështje penale;
- Në muajin **tetor** 2024 janë rindarë **24** çështje penale;
- Në muajin **nëntor** 2024 janë rindarë **15** çështje penale;
- Në muajin **dhjetor** 2024 janë rindarë **13** çështje penale.

• **Rindarja e çështjeve penale sipas gjyqtarëve:**

Rishortimi elektronik i çështjeve penale sipas gjyqtarëve është:

- Në muajin **janar** 2024 janë shpërndarë **19** çështje penale me rishortim elektronik: gjyqtari Sandër Simoni 6, Ilir Panda 5, Enton Dhimitri 3, Sokol Binaj 3, Albana Boksi 1, Medi Bici 1.
- Në muajin **shkurt** 2024 janë shpërndarë **20** çështje penale me rishortim elektronik: gjyqtari Medi Bici 5, Sandër Simoni 4, Albana Boksi 3, Ilir Panda 3, Sokol Binaj 3, Enton Dhimitri 2.
- Në muajin **mars** 2024 janë shpërndarë **27** çështje penale me rishortim elektronik: gjyqtari Sokol Binaj 7, Ilir Panda 5, Medi Bici 5, Albana Boksi 4, Enton Dhimitri 4, Sandër Simoni 2.
- Në muajin **prill** 2024 janë shpërndarë **28** çështje penale me rishortim elektronik: gjyqtari Ilir Panda 9, Albana Boksi 6, Enton Dhimitri 4, Sandër Simoni 4, Medi Bici 3, Sokol Binaj 2.
- Në muajin **maj** 2024 janë shpërndarë **19** çështje penale me rishortim elektronik: gjyqtari Enton Dhimitri 6, Ilir Panda 4, Medi Bici 4, Sokol Binaj 4, Sandër Simoni 1.
- Në muajin **qershor** 2024 janë shpërndarë **19** çështje penale me rishortim elektronik: gjyqtari Sokol Binaj 6, Enton Dhimitri 5, Ilir Panda 4, Medi Bici 2, Sandër Simoni 2.
- Në muajin **korrik** 2024 janë shpërndarë **23** çështje penale me rishortim elektronik:

gjyqtari Enton Dhimitri 7, Albana Boksi 6, Ilir Panda 4, Sandër Simoni 3, Sokol Binaj 2, Medi Bici 1.

- Në muajin **gusht** 2024 është shpërndarë **1** çështje penale gjyqtarit Sokol Binaj.
- Në muajin **shtator** 2024 janë shpërndarë **28** çështje penale me rishortim elektronik: gjyqtari Enton Dhimitri 8, Sandër Simoni 5, Sokol Binaj 5, Ilir Panda 4, Medi Bici 4, Albana Boksi 2.
- Në muajin **tetor** 2024 janë shpërndarë **24** çështje penale me rishortim elektronik: gjyqtari Sandër Simoni 6, Albana Boksi 5, Enton Dhimitri 5, Medi Bici 4, Ilir Panda 2, Sokol Binaj 2.
- Në muajin **nëntor** 2024 janë shpërndarë **15** çështje penale me rishortim elektronik: gjyqtari Ilir Panda 5, Enton Dhimitri 4, Medi Bici 3, Albana Boksi 1, Sandër Simoni 1, Sokol Binaj 1.
- Në muajin **dhjetor** 2024 janë shpërndarë **13** çështje penale me rishortim elektronik: gjyqtari Enton Dhimitri 4, Albana Boksi 3, Ilir Panda 3, Medi Bici 1, Sandër Simoni 1, Sokol Binaj 1.

a) Rindarja e çështje me rishortim elektronik në Kolegjin Administrativ:

Gjyqtarët e Kolegjit Administrativ kanë marrë **295** çështje administrative me rishortim elektronik, konkretisht: Asim Vokshi 75, Sokol Ngresi 54, Arbena Ahmeti 51, Sokol Sadushi 48 çështje, Gentian Medja 41, Enkelejda Metaliaj 26.

Nga çështjet administrative të shpërndara me short elektronik normal, ngarkesa për gjyqtar ka qenë e pabarabartë: Asim Vokshi 25.42%, Sokol Ngresi 18.31%, Arbena Ahmeti 17.29%, Sokol Sadushi 16.27% çështje, Gentian Medja 13.9%, Enkelejda Metaliaj 8.81%.

• Rindarja e çështjeve administrative sipas muajve (shih aneksin 1 bashkëlidhur:

Rishortimi elektronik i 295 çështjeve administrative është kryer në ditë të vitit kalendarik 2024, konkretisht:

- Në muajin **janar** 2024, rishortimi elektronik për 34 çështje administrative;
- Në muajin **shkurt** 2024, rishortimi elektronik për 19 çështje administrative;
- Në muajin **mars** 2024, rishortimi elektronik për 11 çështje administrative;
- Në muajin **prill** 2024, rishortimi elektronik për 54 çështje administrative;
- Në muajin **maj** 2024, rishortimi elektronik për 23 çështje administrative;
- Në muajin **qershor** 2024, rishortimi elektronik për 20 çështje administrative;
- Në muajin **korrik** 2024, rishortimi elektronik për 33 çështje administrative;
- Në muajin **gusht** 2024, rishortimi elektronik është hedhur për 1 çështje administrative;
- Në muajin **shtator** 2024, rishortimi elektronik për 33 çështje administrative;
- Në muajin **tetor** 2024, rishortimi elektronik për 23 çështje administrative;
- Në muajin **nëntor** 2024, rishortimi elektronik për 26 çështje administrative;
- Në muajin **dhjetor** 2024, rishortimi elektronik për 18 çështje administrative.

• Rindarja e çështjeve administrative sipas gjyqtarëve:

- Në muajin **janar** 2024 janë shpërndarë **34** çështje me rishortim elektronik: gjyqtari Asim Vokshi 19, Arbena Ahmeti ka marrë 6, Gentian Medja 5, Enkelejda Metaliaj 2, Sokol Ngresi 1, Sokol Sadushi 1.
- Në muajin **shkurt** 2024 janë shpërndarë **19** çështje me rishortim elektronik: gjyqtari Asim Vokshi 5, Sokol Sadushi 4, Arbena Ahmeti 3, Gentian Medja 3, Enkelejda Metaliaj 2, Sokol Ngresi ka marrë 2 çështje.
- Në muajin **mars** 2024 janë shpërndarë **11** çështje me rishortim elektronik: gjyqtari Sokol Ngresi 5, Asim Vokshi 3, Enkelejda Metaliaj 2, Arbena Ahmeti ka marrë 1.
- Në muajin **prill** 2024 janë shpërndarë **54** çështje me rishortim elektronik: gjyqtari Arbena Ahmeti 14, Sokol Ngresi 12, Sokol Sadushi 10, Asim Vokshi 9, Gentian Medja 7, Enkelejda Metaliaj ka marrë 2 çështje.
- Në muajin **maj** 2024 janë shpërndarë **23** çështje me rishortim elektronik: gjyqtari Asim Vokshi 8, Arbena Ahmeti ka marrë 5, Sokol Ngresi 5, Enkelejda Metaliaj 3, Sokol Sadushi 2.
- Në muajin **qershor** 2024 janë shpërndarë **20** çështje me rishortim elektronik: gjyqtari Sokol Sadushi 6, Sokol Ngresi 4, Arbena Ahmeti 3, Asim Vokshi 3, Enkelejda Metaliaj 2, Gentian Medja ka marrë 2 çështje.
- Në muajin **korrik** 2024 janë shpërndarë **33** çështje me rishortim elektronik: gjyqtari Gentian Medja 7, Sokol Sadushi 7, Sokol Ngresi 6, Asim Vokshi 6, Enkelejda Metaliaj 4, Arbena Ahmeti ka marrë 3.
- Në muajin **gusht** 2024 është shpërndarë **1** çështje me rishortim elektronik: gjyqtari Arbena Ahmeti ka marrë 1 çështje.
- Në muajin **shtator** 2024 janë shpërndarë **33** çështje me rishortim elektronik: gjyqtari Sokol Sadushi 11, Asim Vokshi 6, Gentian Medja 6, Enkelejda Metaliaj 4, Sokol Ngresi 4, Arbena Ahmeti 2.
- Në muajin **tetor** 2024 janë shpërndarë **23** çështje me rishortim elektronik: gjyqtari Sokol Ngresi ka marrë 7 çështje, Arbena Ahmeti 6, Gentian Medja 4, Asim Vokshi 3, Sokol Sadushi 3.
- Në muajin **nëntor** 2024 janë shpërndarë **29** çështje me rishortim elektronik: gjyqtari Asim Vokshi 9, Gentian Medja 5, Sokol Sadushi 4, Enkelejda Metaliaj 3, Sokol Ngresi 3, Arbena Ahmeti ka marrë 2 çështje.
- Në muajin **dhjetor** 2024 janë shpërndarë **18** çështje me rishortim elektronik: gjyqtari Arbena Ahmeti ka marrë 5 çështje, Sokol Ngresi 5, Asim Vokshi 4, Enkelejda Metaliaj 2, Gentian Medja 2.

Rezulton se ndarja e çështjeve me short është hedhur çdo ditë, gjatë ditëve të punës dhe nuk u konstatuan problematika gjatë inspektimit tematik.

7.3 Ngarkesa sasiore e gjyqtarëve

Lidhur me ngarkesën sasiore të secilit gjyqtar që është pjesë e trupës gjyquese e Gjykatës së Lartë, në periudhën e inspektuar janar - dhjetor 2024, është konstatuar se ajo varion :

I. Ngarkesa e gjyqtarëve në lidhje me çështjet e shpërndara me short elektronik.

Nga **2155** çështje të shpërndara me short elektronik:

- a) Gjyqtarët e **Kolegjit Civil** kanë marrë me short 787 çështje dhe kërkesa civile, penale dhe administrative, konkretisht:

Gjyqtari	çështje civile	kërkesa civile	çështje penale	kërkesa penale	çështje adm.	kërkesa adm.	Totali	
Valbon Çekrezi	180	16	0	3	0	8	207	26,30
Vojsava Kola	159	18	0	2	0	3	182	23,13
Margarita Buhali	97	10	1	0	0	5	113	14,36
Artur Kalaja	90	7	0	1	0	1	99	12,58
Darjel Sina	73	22	1	1	0	1	98	12,45
Ervin Pupe	70	10	1	1	0	6	88	11,18
Total	669	83	3	8	0	24	787	100,00

Ngarkesën më të lartë e ka patur gjyqtari Valbon Çekrezi me 207 çështje dhe kërkesa ose 26.3% e totalit të çështjeve dhe kërkesave të shqyrtuara nga Kolegji Civil. Gjyqtarja Vojsava Kola po ashtu ka patur 182 çështje dhe kërkesa ose 23.13% e totalit të tyre.

- b) Gjyqtarët e **Kolegjit Penal** kanë shqyrtuar 910 çështje dhe kërkesa penale, civile dhe administrative, konkretisht:

Gjyqtari	çështje civile	kërkesa civile	çështje penale	kërkesa penale	çështje adm.	kërkesa adm.	Totali	
Sander Simoni	0	1	169	9	0	4	183	20,10
Sokol Binaj	0	3	161	4	0	4	172	18,90
Albana Boksi	0	3	146	9	0	3	161	17,69
Ilir Panda	0	2	134	3	0	4	143	15,71
Medi Bici	0	2	119	4	0	7	132	14,51
Enton Dhimitri	98	14	0	1	0	6	119	13,08
Total	98	25	729	30	0	28	910	100,00

Ngarkesën më të lartë e ka patur gjyqtari Sander Simoni me 183 çështje (20.1%) dhe gjyqtari Sokol Binaj me 172 çështje (18.9 %) e totalit të çështjeve dhe kërkesave të shqyrtuara nga Kolegji Penal. Gjyqtarja Albana Boksi po ashtu ka patur 161 çështje dhe kërkesa ose 15.71% e totalit të tyre.

- c) Gjyqtarët e **Kolegjit Administrativ** kanë shqyrtuar 910 çështje dhe kërkesa penale, civile dhe administrative, konkretisht:

Gjyqtari	çështje civile	kërkesa civile	çështje penale	kërkesa penale	çështje adm.	kërkesa adm.	Totali	
Gentian Medja	0	3	0	1	127	23	154	18,03

Enkelejda Metaliaj	0	1	0	2	119	27	149	17,45
Sokol Ngresi	0	5	0	1	113	22	141	16,51
Asim Vokshi	0	3	0	3	102	29	137	16,04
Arbena Ahmeti	0	4	0	1	114	17	136	15,93
Sokol Sadushi	0	3	0	2	113	18	136	15,93
(blank)	1	0	0	0	0	0	1	0,12
Total	1	19	0	10	688	136	854	100,00

Ngarkesën më të lartë e ka patur gjyqtari Gentian Medja me 154 çështje dhe kërkesa ose 18.03% e totalit të çështjeve dhe kërkesave të shqyrtuara nga Kolegji Administrativ. Gjyqtarja Enkelejda Metaliaj po ashtu ka patur 149 çështje dhe kërkesa ose 17.45% e totalit të tyre.

ii. Ngarkesa e gjyqtarëve në lidhje me çështjet e shpërndara me short manual.

Nga 1173 çështje dhe kërkesa të shortuara manualisht mes gjyqtarëve të Kolegjit Civil,

- Gjyqtari Artur Kalaja ka marrë 200 çështje/kërkesa (ose 17.05 %), të totalit të tyre.
- Gjyqtari Valbon Çekrezi ka marrë 196 çështje/kërkesa (ose 16.71 %), të totalit të tyre.
- Gjyqtarja Margarita Buhali ka marrë 195 çështje/kërkesa (ose 16.62 %), të totalit të tyre.
- Gjyqtari Enton Dhimiri ka marrë 194 çështje/kërkesa (ose 16.54 %), të totalit të tyre.
- Gjyqtari Ervin Pupe ka marrë 194 çështje/kërkesa (ose 16.54 %), të totalit të tyre.
- Gjyqtari Vojsava Kola ka marrë 194 çështje/kërkesa (ose 16.54 %), të totalit të tyre.

iii. Ngarkesa e gjyqtarëve në lidhje me çështjet e rindara me short

Nga 842 çështje / kërkesa të rishortuara elektronikisht në Gjykatën e Lartë,

- Gjyqtarët e **Kolegjit Civil** kanë shqyrtuar 311 çështje / kërkesa civile, penale dhe administrative, konkretisht:

Gjyqtari	Çështje civile	Kërkesa civile	Çështje penale	Kërkesa penale	Çështje Adm.	Kërkesa Adm.	Totali	
Ervin Pupe	61	9	2	0	0	6	78	25,08
Vojsava Kola	58	10	1	2	0	3	74	23,79
Valbon Çekrezi	47	3	2	4	0	10	66	21,22
Artur Kalaja	48	2	0	1	0	1	52	16,72
Margarita Buhali	23	8	2	0	0	3	36	11,58
Darjel Sina	5	0	0	0	0	0	5	1,61
Grand Total	242	32	7	7	0	23	311	100,00

Ngarkesën më të lartë e ka patur gjyqtari Ervin Pupe me 78 çështje dhe kërkesa ose 25.08% e totalit të çështjeve dhe kërkesave të shqyrtuara nga Kolegji Civil. Gjyqtarja Vojsava Kola ka patur 74 çështje dhe kërkesa ose 23.79 % e totalit të tyre. Po ashtu gjyqtari Valbon Çekrezi ka patur 66 çështje dhe kërkesa ose 21.22% e totalit të tyre.

- b) Gjyqtarët e **Kolegjit Penal** kanë shqyrtuar **236** çështje / kërkesa civile, penale dhe administrative, konkretisht:

Gjyqtari	Çështje civile	Kërkesa civile	Çështje penale	Kërkesa penale	Çështje Adm.	Kërkesa Adm.	Totali (%)	
Enton Dhimitri	41	5	1	0	1	4	52	22,03
Ilir Panda	0	2	42	1	0	3	48	20,34
Sokol Binaj	0	3	28	2	0	4	37	15,68
Sandër Simoni	0	1	25	4	0	5	35	14,83
Medi Bici	0	2	22	2	0	7	33	13,98
Albana Boksi	0	3	24	1	0	3	31	13,14
Total	41	16	142	10	1	26	236	100,00

Ngarkesën më të lartë e ka patur gjyqtari Enton Dhimitri me 52 çështje dhe kërkesa ose 22.03% e totalit të çështjeve dhe kërkesave të shqyrtuara nga Kolegji Penal. Gjyqtari Ilir Panda ka patur 48 çështje dhe kërkesa ose 20.34 % e totalit të tyre.

- a) Gjyqtarët e **Kolegjit Administrativ** kanë marrë me short **295** çështje / kërkesa civile, penale dhe administrative, konkretisht:

Gjyqtari	Çështje civile	Kërkesa civile	Çështje penale	Kërkesa penale	Çështje Adm.	Kërkesa Adm.	Totali (%)	
Asim Vokshi	0	3	0	2	62	8	75	25,42
Sokol Ngresi	0	4	0	1	45	4	54	18,31
Arbena Ahmeti	0	4	0	1	41	5	51	17,29
Sokol Sadushi	0	4	0	2	35	7	48	16,27
Gentian Medja	0	4	2	1	29	5	41	13,90
Enkelejda Metaliaj	0	2	1	1	15	7	26	8,81
Total	0	21	3	8	227	36	295	100,00

Ngarkesën më të lartë e ka patur gjyqtari Asim Vokshi me 75 çështje dhe kërkesa ose 25.42% e totalit të çështjeve dhe kërkesave të shqyrtuara nga Kolegji Penal.

Rezulton se ndarja e çështjeve me short si dhe rindarja e tyre, ka krijuar barazi në shpërndarjen e çështjeve, gjatë vitit 2024, dhe nga ana tjetër, ndonëse ekzistojnë diferenca me çështje ndërmjet gjyqtarëve ato janë të pakonsiderueshme.

8. Afatet e shortimit të çështjeve

Në periudhën objekt të kontrollit të inspektimit tematik, nga gjykata nuk u paraqit ndonjë procesverbal, për dokumentimin e shtyrjes së datës dhe orës së shortit, i mbajtur nga kryetari i gjykatës, gjyqtarët, kancelari apo kryesekretari i gjykatës, dhe punonjësi i IT-së.

Shorti elektronik i çështjeve është ditor pasi në momentin e regjistrimit të çështjeve, ato shorthen automatikisht pranë gjyqtarit relator dhe për rrjedhojë nuk gjen zbatim dispozitat e parashikuara në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore".

9. Shortimi i çështjeve sipas gjyqtarit specifik

Ky seksion nuk aplikohet në rastin e Gjykatës së Lartë dhe për rrjedhojë dhe as në muajin gusht pasi Gjykata e Lartë aplikon procedura të tjera krahasuar me gjykatat e juridiksionit dhe niveleve të tjera.

10. Verifikimi i ankesave

Në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, referuar të dhënave të marra në Zyrën e Arkiv-Protokollit dhe pranë Drejtorisë së Hartimit të Akteve dhe Shërbimeve Juridike për vitin 2024^[30], rezulton se nuk është paraqitur asnjë ankesë për organizimin e shortit në Gjykatën e Lartë nga përdoruesit e gjykatës (*përfshirë gjyqtar, kancelar, sekretar gjyqësor, kryesekretar, sekretar regjistruar, përfaqësues të organit të akuzës...etj.*), ndërkohë që rezulton se nga ana e shtetasi Eduart Kurti, është paraqitur një ankesë.

Referuar qëllimit dhe objektivit të inspektimit, analizimit të të dhënave të grumbulluara nga ky inspektim, trajtimi në mënyrë shteruese të problematikave të dalta gjatë realizimit të inspektimit si dhe nga këqyrja e dokumentacionit e bërë nga grupi i inspektimit rezulton se:

Shtetasi Eduart Kurti ka paraqitur ankesat nr. 2706 prot., datë 07.10.2024 dhe nr. 2706/2 prot., datë 10.10.2024 nëpërmjet të cilave ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magistratëve Medi Bici, Albana Boksi dhe Ilir Panda, me detyrë gjyqtarë pranë Gjykatës së Lartë, në kohën kur pretendohet shkelja e kryer, duke kërkuar që mos t'i bjerë shorti asnjërit që ka lidhje shoqërore apo miqësore me gjyqtarët e sipërpërmendur, çështja gjyqësore e paraqitur prej tij në Gjykatën e Lartë dhe e regjistruar me nr. (71012-00623-00-2024), akti datë regjistrimi 22.10.2024, me objekt: "Rishikimin e vendimit penal nr. 2597, datë 05.11.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,...etj".

Referuar kësaj ankese rezulton se Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pasi ka shqyrtuar pretendimet e ankuesit edhe për pjesën e shortit, me vendim nr. 3244/11 prot., datë 09.12.2025, ka vendosur: "Arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të ankuesit z. Eduart Kurti, regjistruar me nr. 2706 prot., datë 07.10.2024 dhe nr. 2706/2 prot., datë 10.10.2024, ndaj magistratëve z. Medi Bici, znj. Albana Boksi dhe z. Ilir Panda, me detyrë gjyqtarë pranë Gjykatës së Lartë, në kohën kur pretendohet shkelja e kryer".

Në rrethanat si më sipër grupi i inspektimit, çmon se nuk ka vend më për të trajtuar ankesën e paraqitur nga shtetasi Eduart Kurti.

^[30] Në datën 22.12.2025, i drejtuar Zyrës së Arkiv-Protokollit, ndërsa në datën 23.12.2025 Drejtorisë së Hartimit të Akteve dhe Shërbimeve Juridike, pranë ILD-së me: "Kërkesë për informacion dhe dokumentacion".

11. Të tjera

Me shkresën nr. 2201 prot., datë 17.07.2025, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kërkoi nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndër të tjera dërgimin e një kopje të manualit të përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, *(përfshirë rubrikën e shortimit elektronik)* ^[31], që Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar për këtë qëllim *(së bashku me publikimet periodikisht të këtij manuali, nëse ka pasur të tilla)*.

Në përgjigje të shkresë së dërguar nga ILD, me nr. 4102/1 prot., datë 29.07.2025 *(regjistruar me nr. 2201/1 prot., datë 29.07.2025)*, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka dërguar raport analitik "Mbi zhvillimet që janë kryer në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS Gjykata e Lartë në vitin 2024".

Në aktet e mësipërme prezantohen zhvillimet e sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS në Gjykatën e Lartë, të cilat janë kryer në vitin 2024 dhe që kanë bërë të mundur implementimin e modulit të shpërndarjes së çështjeve me short elektronik sipas vendimit nr. 554, datë 29.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore" ^[32].

➤ Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

1. Rregullimi ligjor mbi bazën e të cilit gjykata organizon procedurat e shortit

Për organizimin e procedurave të ndarjes së çështjeve me short, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ^[33] bazohet kryesisht në ligjin nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe në kërkesat e Vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore" ^[34], dhe nr. 724, datë 7.12.2023 "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore" ^[35].

Vlen të theksojmë se Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, përfshin kompetencën e saj tokësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me qendër të ushtrimit të veprimtarisë, në qytetin Tiranë. Ajo ka në vitin 2024 në organikën e saj 78 gjyqtarë ^[36]. Në kohën e inspektuar kjo gjykatë është drejtuar nga gjyqtare znj.Valdete

^[31] Kjo kërkesë bazohet në pikën 15 Kreu III "Procedurat dhe rregullat e ndarjes së çështjeve me short" të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", në të cilin thuhet se: "...15. Këshilli i Lartë Gjyqësor publikon periodikisht manualin e përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, përfshirë rubrikën e shortimit elektronik...etj".

^[32] Në "Raportin mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor viti 2024", rezultoi se KLGJ ka pasqyruar këtë rregullim të sistemit ICMIS në Gjykatën e Lartë *(shif faqen 55 të raportit)*.

^[33] Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm funksionon nga data 01.02.2023, mbi bazën e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 505, datë 21.11.2022 për "Fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm".

^[34] Botuar në fletoren zyrtare nr. 1, datë 04 janar 2023.

^[35] Botuar në fletoren zyrtare nr. 181, datë 15 dhjetor 2023.

^[36] Këshilli i Gjykatës së Apelit Tiranë, me vendimin nr.1, datë 04.01.2023, ka miratuar strukturën organike dhe përshkrimet e punës së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Hoxha^[37], e zgjedhur nga Këshilli i Gjykatës së Apelit Tiranë, me vendimin nr.10 prot., datë 10.01.2022, në detyrën e zëvendëskryetarës për një mandat 3-vjeçar, pa të drejtë rizgjedhje, (ku referuar nenit 26 të ligjit nr.98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, zëvendëskryetari ushtron edhe detyrën e kryetarit të gjykatës, me që nuk ka të emëruar një të tillë). Kancelare e gjykatës është znj.Lertida Balili.

Fillimisht deri në datën 07.02.2024 kanë qenë 25 (njëzet e pesë) gjyqtarë efektivë, pas datës 07.02.2024, kanë ushtruar detyrën 26 (njëzet e gjashtë) gjyqtarë^[38] deri në datën 31.07.2024, pas datës 31.07.2024 kanë ushtruar detyrën 27 (njëzet e shtatë) gjyqtarë^[39] deri në datën 09.10.2024, pas datës 09.10.2024 kanë ushtruar detyrën 28 (njëzet e tetë) gjyqtarë^[40] ose sipas një mesatarje kanë qenë efektiv 26 (njëzet e gjashtë) gjyqtar efektiv ose 33.33% e tyre^[41].

Për periudhën e inspektuar, organika e gjykatës nuk është e plotësuar me 78 gjyqtarë, aq sa janë në organikë, por kjo shifër ka ndryshuar në periudha të ndryshme kohore, kjo për shkak të mungesës së gjyqtarëve për shkak të implementimit të Hartës së Re Gjyqësore të vitit 2022 dhe suprimimit të ish-gjykatave të apelit në fund të janarit të vitit 2023 dhe të emërimit nga KLGJ të 3 (tre) gjyqtarëve që kanë aplikuar për "ngritje në detyrë". Për periudhën 01.01.2024 deri 31.12.2024, organika është plotësuar me 31 (tridhjetë e një) gjyqtar, kanë punuar 28 (njëzet e tetë) gjyqtar, por kanë qenë mesatarisht efektiv 26 (njëzet e gjashtë) gjyqtar ose 33.33 % e tyre.

2. Sistemi elektronik i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore që gjykata ka për ndarjen e çështjeve gjyqësore me short.

Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, ka në përdorim Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, të njohur si ICMIS, sistem i cili është i instaluar në vitin 2008 dhe që u konfigurua i plotë në vitin 2012. Nëpërmjet këtij sistemi gjykata bën regjistrimin e çështjeve, hedhjen në short të tyre si dhe realizon në vazhdim procedurat e zhvillimit të gjykrimeve, duke përfshirë këtu procedurat e planifikimit e menaxhimit të sejcilës çështje gjyqësore.

Nga të dhënat e dërguara nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, në funksion të inspektimit me objekt: "Mbi ndarjen e çështjeve me short, si edhe kontrollin e raporteve të sistemit elektronik në gjykata për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024", për të cilin ILD,

^[37] Me urdhërin "Për delegimin e kompetencave" (shkresa nr. 250 prot., datë 25.07.2024), zv/kryetaria e gjykatës mbështetur në nenin 26 pika 2 dhe nenin 37 të ligjit nr. 98/2016 si dhe nenin 23 të ligjit nr.96/2016, ka bërë delegimin e kompetencave të kryetarit të gjykatës në mungesë të tij zëvendëskryetarit, të caktuar nga ligji nr. 98/2016 dhe akteve nënligjore dalë në zbatim të ligjit gjyqtarëve: "...-znj. Elona Toro, për datat 29 korrik-04 gusht 2024; -z. Qemal Zaimi, për datat 05 gusht-11 gusht 2024; -znj. Miranda Andoni, për datat 12 gusht-18 gusht 2024; -znj. Alma Kolgjoka, për datat 19 gusht-25 gusht 2024; dhe -znj. Beikerna Ukperaj, për datat 26 gusht-01 shtator 2024;...etj".

^[38] Gjyqtare Diamela Goxha, është emëruar me vendimin nr.59, datë 07.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

^[39] Gjyqtare Enkela Vlora, është emëruar me vendimin nr.483, datë 31.07.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

^[40] Gjyqtare Anila Karanxha, është emëruar me vendimin nr. 591, datë 09.10.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

^[41] Referuar "Raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor vitit 2024", rezultton se Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, organikën e ka të plotësuar deri në fundin e vitit 2024 me 31 gjyqtar nga 78 gjyqtar që ka në organikë, por gjyqtar efektiv kanë qenë me një mesatare 26 gjyqtarë (shifra qenë 88 të raportit).

ka lëshuar vendimin nr.17, datë 01.04.2025, rezulton se nga Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, janë nxjerrë e dërguar:

- a) -raporti periodik për shortimin normal të çështjeve, për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024;
- b) -raporti periodik për shortet e realizuara në mënyrë manuale për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024;
- c) -raporti për çështjet të cilat janë rishortuar për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024;
- d) -tabelë që përmban informacion mbi masat e sigurimit viti 2024; , dhe
- e) -tabelat e plotësuara me të dhënat që ILD i ka dërguar në funksion të realizimit të inspektimit.

Në periudhën e inspektimit nga aktet e dërguara nga gjykata, rezulton se Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, ka qenë funksional për gjatë vitit 2024, përjashtuar një rast (ku rezulton se është dërguar procesverbal i datës 28.06.2024, që është mbajtur nga kryetari i gjykatës, gjyqtarët, kancelari, kryesekretari i gjykatës, dhe punonjësi i IT-së që vërteton faktin se sistemi nuk ka qenë jo funksional, për më shumë se dy ditë pune dhe që nga zv/kryetarja e gjykatës është lëshuar edhe urdhëri i brendshëm nr. 224 prot., datë 28.06.2024^[42]).

Konkretisht me procesverbalin nr.224/1^[43] prot., datë 28.06.2024, evidentohet fakti se është organizuar një short manual nga një komision i përbërë nga zv/kryetarja e gjykatës znj. V.Hoxha, gjyqtarët L.Celami, I.Brahimi, M.Dervishi, kancelarja L.Balili, kryesekretare R.Bubjaku, sekretaret gjyqësore B.Xhelo, A.Liçollari, dhe punonjësi i IT-së R.Papa, për caktimin e relatorit për çështjet penale me afat të ngutshëm me:

- a) nr. (61011-04083-30-2024) akti, datë 28.06.2024 regjistrimi, me palë kërkues Renaldo Hoxha, me objekt: "Humbje e fuqisë së masës". Pas hedhjes së shortit midis gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, L.Celami, I.Brahimi, M.Dervishi, ka rezultuar se shorti manual ka përzgjedhur gjyqtaren znj. M.Dervishi;
- b) nr. (61005-04087-30-2024) akti, datë 28.06.2024 regjistrimi, me palë kërkues Gezim Marashi, me objekt: "Vleftësim arrestimi e caktim mase sigurimi". Pas hedhjes së shortit midis gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, L.Celami, I.Brahimi, M.Dervishi, ka rezultuar se shorti manual ka përzgjedhur gjyqtaren znj. L.Celami;

^[42]Ky urdhër është lëshuar për shkak se me emailin e datës 28.06.2024 ora 12:17 të KLGJ-së është urdhëruar gjykata të ndërprerë shërbimet, për shkak të shkëputjes së VPN që KLGJ do të bëjë rregullime në sistem. Kjo ndërprerje do të vazhdojë deri në njoftimin e një urdhëri të dytë. Në këtë urdhër gjykata ka vendosur që: "...1-Çështjet e regjistruara në datën 28.06.2024 (penale dhe civile) në sistemin e menaxhimit të çështjeve sipas raportit bashkëlidhur, për shkak se sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve nuk funksionin do të luhet në short elektronik në datë 01.07.2024 ora 15:00. 2-Çështjet me karakter të ngutshëm sipas raportit bashkëlidhur të ndahen me short manual ndërmjet gjyqtarëve të gatshëm ditën e sotme. 3-Ngarkohet Specialisti i IT-së z.Ramiz Papa dhe Fatjon Lili, Kancelari, për zbatimin e këtij urdhëri. 4-Vendimi publikohet në faqen zyrtare të internetit të gjykatës. 5-Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë... etj".

^[43]Pas verifikimit të 6 (gjashë) RIV në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, rezulton se dosjet janë kaluar tek gjyqtarët në datën 01.07.2024 dhe se procesverbali që është vënë si shkak justifikimi, ka nr. 255 prot., datë 28.06.2024, dhe jo nr. 244/1 prot., datë 28.06.2024, që ka sjellë fizikisht gjykata në kuadër të inspektimit me shkresën nr. 7987/3 prot., datë 10.07.2025. Hedhja e të dhënave në sistem me gabime i ngarkohet punonjësit të IT-së, i cili me urdhërin e brendshëm nr. 224 prot., datë 28.06.2024, është ngarkuar për zbatimin e këtij urdhëri, por duke mos anashkaluar edhe zv/kryetaren e gjykatës, e cila me komanda të saj, ka ekzekutuar veprimet në sistem.

- e) nr. (61005-04090-30-2024) akti, datë 28.06.2024 regjistrimi, me palë kërkues Mieshkovo Roslyslai, me objekt: "Vlefësim arrestimi e caktim mase sigurimi". Pas hedhjes së shortit midis gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, L.Celami, I.Brahimi, M.Dervishi, ka rezultuar se shorti manual ka përzgjedhur gjyqtaren znj.I.Brahimi;
- d) nr. (61005-04091-30-2024) akti, datë 28.06.2024 regjistrimi, me palë kërkues Bledar Doraci, me objekt: "Vlefësim arrestimi e caktim mase sigurimi". Pas hedhjes së shortit midis gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, L.Celami, I.Brahimi, M.Dervishi, ka rezultuar se shorti manual ka përzgjedhur gjyqtaren znj.M.Dervishi;
- e) nr. (61005-04092-30-2024) akti, datë 28.06.2024 regjistrimi, me palë kërkues Martin Hysa, me objekt: "Vlefësim arrestimi e caktim mase sigurimi". Pas hedhjes së shortit midis gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, L.Celami, I.Brahimi, M.Dervishi, ka rezultuar se shorti manual ka përzgjedhur gjyqtaren znj.L.Celami;
- f) nr. (61005-04093-30-2024) akti, datë 28.06.2024 regjistrimi, me palë kërkues Haris Stamo, me objekt: "Vlefësim arrestimi e caktim mase sigurimi". Pas hedhjes së shortit midis gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, L.Celami, I.Brahimi, M.Dervishi, ka rezultuar se shorti manual ka përzgjedhur gjyqtaren znj.I.Brahimi;

Në rastin e organizimit të shorteve manuale, rezulton se në periudhën e inspektimit, shortet manuale janë hedhur duke qenë të pranishëm gjyqtarët, zv/kryetari i gjykatës, kancelari, kryesekretari, dy sekretare gjyqësore dhe punonjësi i IT-së. Në këto raste janë zbatuar kërkesat ligjore që kërkohet të përmbushen, referuar pikës 2 Kreu IV "Ndarja e çështjeve me short manual" të Vendimi të Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", në të cilin thuhet se: "...2. Ndarja e çështjeve me short manual realizohet nga Kancelari, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Gjykatës, si dhe pjesëmarrjen e gjyqtarëve të gjykatës, pasi janë njoftuar paraprakisht për zhvillimin e shortit manual....etj".

Në kohën e inspektimit janë konstatuar edhe raste, ku disa çështje gjyqësore, janë hedhur e regjistruar në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore, të cilat më pas janë fshirë e ri regjistruar dhe shortuar mes 2 (dy) gjyqtarëve të gatshëm nga 3 (tre) gjyqtarë që kanë qenë të gatshëm sipas grafikut të gatishmërisë. Kjo gjë ka ndodhur për shkak se nga punonjësi i IT-së një gjyqtare nuk ka qenë e aktivizuar me komanda në sistem. Në funksion të kësaj problematike rezulton se zv/kryetarja e gjykatës ka lëshuar urdhërin e brendshëm nr. 219 prot., datë 19.06.2024, në të cilin ndër të tjera ka konstatuar se: "... për periudhën 17 qershor deri 23 qershor 2024, ku çështjet e karakterit urgjent do të gjykohen nga gjyqtarët^[44] znj. Alma Ahmeti, znj. Miranda Andoni dhe znj. Irida Kacerja, pas hedhjes së shortit elektronik 6 (gjashtë) masa sigurimi, janë shortuar vetëm ndërmjet gjyqtarëve Alma Ahmeti, Miranda Andoni, ndërkohë që gjyqtare Irida Kacerja nuk është aktive si gjyqtare

^[44]Vendim i zv/kryetarit të gjykatës nr.729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", të përditësuar me Vendimin nr.213, datë 14.06.2024 "Për zëvendësimin dhe caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente".



e gatshme në sistem, dhe nuk i ka rënë asnjë çështje në short (masa sigurimi), për shkak se specialisti i IT-së z.Ramiz Papa, nuk e ka bërë aktive në short, tek masat e sigurimit. Në këto rrethana menjëherë është mbajtur procesverbali i konstatimit¹⁴⁵⁾ nr. 217 datë 19.06.2024... etj.", dhe është urdhëruar: "... 1. Anullimi i procedurave të shortit të hedhur në datën 19.06.2024 ora 15:⁰⁹, për çështjet e regjistruara masa sigurimi, në total 6 (gjashtë) sipas raportit bashkëlidhur¹⁴⁶⁾. 2. Çështjet të fshihen nga sistemi, të ri regjistrohen dhe të hidhen në short elektronik sot në datë 19.06.2024 midis 3 (tre) gjyqtarëve të gatshëm, Irida Kacerja, Miranda Andoni, Alma Ahmeti. 3. Ngarkohet Specialisti i It-së z.Ramiz Papa dhe Fatjon Lili, Kancelari dhe sekretarja rregjistruese, për zbatimin e këtij urdhëri. 4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë... etj. ”.

Në rastin e fshirjeve të 6 (gjashtë) dosjeve të masave të sigurimit nga sistemi, rezulton se është lëshuar akt shkresor nga zv/kryetaria e gjykatës që kryesekretaria e gjykatës apo Kancelari i gjykatës, të justifikojnë arsyen e fshirjes së tyre. Këto veprime janë marrë në përputhje me kërkesat ligjore që kërkohej të përmbushen, sipas udhëzuesit për sistemin ICMIS "Funksionalitetet dhe të drejtat e përdoruesve në sistemin ICMIS", pika 7.2 "Fshirja e çështjeve", të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë në janar 2016, në të cilin thuhet se: "...Kancelari mund të bëjë fshirjen e çështjeve duke kërkuar fillimisht çështjen përkatëse tek forma e kërimit pasi gjen çështjen që dëshiron të fshijë e përzgjedh atë dhe klikon butonin Fshij. Në këtë moment përdoruesi duhet të përcaktojë arsyen e fshirjes të çështjes dhe të klikojë butonin Ok....etj", kërkesat e nenit 37 të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe kërkesat ligjore të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore".

Gjatë veprimtarisë së hedhjes dhe regjistrimit të çështjeve në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore, është konstatuar mangësi në zbatimin e udhëzuesit për sistemin ICMIS "Funksionalitetet dhe të drejtat e përdoruesve në sistemin ICMIS", të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë në janar 2016, si dhe të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore" si dhe rregulloret e brendshme që parashikojnë detyrat për të gjithë punonjësit e administratës gjyqësore dhe urdhërat e brendshëm të lëshuar nga zv/kryetari i gjykatës për qëllimet e mësipërme. Kjo mangësi konsiston në rastet e zbatimit të grafikut të gadishmërisë nuk janë çaktivizuar llogaritë e gjyqtarëve, të cilëve u ka mbaruar gatishmëria, dhe nuk janë aktivizuar llogaritë të atyre gjyqtarëve që u ka filluar gatishmëria, duke sjellë si pasojë regjistrime të gabuara dhe kalime të dosjeve tek gjyqtarët të cilëve nuk duhet të ishin përfshirë në short.

¹⁴⁵⁾ Nga verifikimi i të dhënave rezulton se pas konstatimit masat e sigurimit të hedhur gabim, janë ndarë në short ndërmjet gjyqtarëve: çështjet gjyqësore nr.(61005-03777-30-2024) akti Oltjan Kukeli [I Arrestuar]; nr. (61005-03787-30-2024)akti Vilson Zelia [I Arrestuar]; e nr. (61006-03790-30-2024) akti Lindita Ndroqi [I Arrestuar] gjyqtare M.Andoni, çështjet gjyqësore nr. (61005-03781-30-2024) akti Renshi Mema [I Arrestuar]; nr. (61005-03784-30-2024) akti Rigers Hakrama [I Arrestuar], e nr. (60614-03800-30-2024) akti Gjon Brähja [Palë e Interesuar], gjyqtare A.Ahmeti.

¹⁴⁶⁾ Nga verifikimi i të dhënave rezulton se pas anulimit të shortit sipas urdhërit të brendshëm nr.219 prot., datë 19.06.2024, të zv.kryetarës, çështjet janë shortuar ndërmjet gjyqtarëve: çështjet gjyqësore nr. (61005-03803-30-2024) akti Oltjan Kukeli [Persona Nën Hetim], e nr. (60614-03806-30-2024) akti Gjon Brähja [Palë e Interesuar] gjyqtare A.Ahmeti; çështjet gjyqësore nr. (61005-03804-30-2024) akti Renshi Mema [Persona Nën Hetim], e nr. (61006-03807-30-2024) akti Lindita Ndroqi [I Arrestuar] gjyqtare I.Kacerja; çështjet gjyqësore nr. (61005-03805-30-2024) akti Rigers Hakrama [I Arrestuar], e nr. (61005-03806-30-2024) akti Vilson Zelia [Persona Nën Hetim] gjyqtare M.Andoni.

3. Transparenca e dokumentimit të përgatitjes së shortit.

Në kohën e inspektuar 01 janar - 31 dhjetor 2024, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ushtronin detyrën efektivisht 28 gjyqtarë: Alma Ahmeti, Alma Kolgjoka, Anila Karanxha (jo të gjithë periudhën pasi Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 591, datë 09.10.2024, ka vendosur "ngritjen në detyrë" të saj, pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë), Arta Duka, Astrit Kalaja, Brikena Ukperaj, Diamela Goxha (jo të gjithë periudhën pasi Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr.59, datë 07.02.2024, ka vendosur "ngritjen në detyrë" të saj, pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë), Dritan Hasani, Edlira Petri, Elona Mihali, Elona Toro, Enkela Vlora (jo të gjithë periudhën pasi Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr.483, datë 31.07.2024, ka vendosur "ngritjen në detyrë" të saj, pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë), Fatri Islamaj, Fuat Vjerdha, Genti Dokollari, Genti Shala, Iliba Bezati, Irena Brahimi, Irida Kacerja, Lutfije Celami, Marsela Dervishi, Marsela Pepi, Miranda Andoni, Ornela Naqellari, Qemal Zaimi, Sokol Pina, Valbona Vata, dhe Valdete Hoxha.

Gjatë periudhës së analizuar për shortet ka patur mungesë në punë të justifikuar të gjyqtarëve:

- a) Fuat Vjerdha, për arsye objektive (gjendje e rënduar shëndetësore i shtruar në Spitalin Rajonal të qytetit Shkodër) për periudhën 02.09.2024 deri datë 08.09.2024, për të cilën është lëshuar vendimi nr.267 prot., datë 02.09.2024 nga zv/kryetarja e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Për sa më lart gjyqtari Fuat Vjerdha, është përjashtuar nga shorti i gatishmërisë (masat e sigurimit) të cilat janë me afat procedural të ngutshëm dhe këto çështje u janë shpërndarë me short 3 (tre) gjyqtarëve të tjerë që kanë qenë të planifikuar në urdhër të gatishmërisë me këtë gjyqtar znj. B.Ukperaj, znj. V.Vata dhe z. Q.Zaimi si dhe për rishortimin e 2 (dy) çështjeve që këtij gjyqtari, i ishin shortuar po në datën 02.09.2024^[47]. Në nxjerrjen e këtij vendimi rezulton se zv/kryetarja e Gjykatës, ka lënë rezervën që periudha e gatishmërisë së gjyqtarit të kryhet në një periudhë tjetër, si dhe ky vendim është bazuar nën 37 shkronja "b" të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".
- b) Fuat Vjerdha, për arsye objektive (gjendje e rënduar shëndetësore i shtruar në Spital) për periudhën 04.11.2024 deri datë 10.11.2024, për të cilën është lëshuar vendimi nr.338 prot., datë 04.11.2024 nga zv/kryetarja e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Për sa më lart gjyqtari Fuat Vjerdha^[48], është përjashtuar nga shorti i gatishmërisë (masat e sigurimit) të cilat janë me afat procedural të ngutshëm dhe këto çështje u janë shpërndarë me short 2 (dy) gjyqtarëve të tjerë që kanë qenë të planifikuar në urdhër të gatishmërisë me këtë

^[47] Pas kryerjes së procedurave të rishortimit rezulton se çështja nr. (61005-05019-30-2024) akti, datë 02.09.2024 që i përket shtetasit Marselo Guraj [I Arrestuar], i është rishortuar gjyqtarës znj. B.Ukperaj dhe çështja nr. (61005-05025-30-2024) akti, datë 02.09.2024 që i përket shtetasit Ennal Ademi [I Arrestuar], i është rishortuar gjyqtarës znj. V.Vata

^[48] Gjyqtari F.Vjerdha, ka dërguar si justifikim pranë zv/kryetarës së gjykatës "Raport për pasafësi të përkohshme në punë, që lëshohet nga institucione shëndetësore me shtretër" nr. regjistri A325196 datë 05.11.2024 që fillon me periudhën nga data 27.10.2024 deri 20.11.2024.

gjyqtar z.Q.Zaimi dhe znj. A.Karaxha. Në nxjerrjen e këtij vendimi rezulton se zv/kryetaria e Gjykatës, ka lënë rezervën që periudha e gatishmërisë së gjyqtarit të kryhet në një periudhë tjetër, si dhe ky vendim është bazuar nënin 37 shkronja "b" të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

- e) Edlira Petri, për miratim kërkesë për dhënie leje tre ditë pune, për periudhën 24.12.2024 deri 27.12.2024, për të cilën është lëshuar urdhëri nr. 376 prot., datë 13.12.2024 nga zv/kryetaria e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Për sa më lart gjyqtaria Edlira Petri, është përjashtuar nga shorti i gatishmërisë (*masat e sigurimit*) të cilat janë me afat procedural të ngutshëm dhe këto çështje u janë shpërndarë me short dy gjyqtarëve të tjerë që kanë qenë të planifikuar në urdhër të gatishmërisë me këtë gjyqtare z. Genti Shala dhe znj. Elona Toro. Në nxjerrjen e këtij urdhëri rezulton se zv/kryetaria e Gjykatës, është bazuar në kreun V. "Përjashtimi i gjyqtarit nga shorti", pika 4 të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", në shkronjën "b" të pjesës së "shënimeve" të vendimit nr. 1 prot., datë 01.02.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente" dhe se urdhëri është lëshuar nga zv/kryetaria e gjykatës përpara hedhjes në short të çështjeve.

Mungesa në detyrë e gjyqtarëve z.Fuat Vjerdha dhe znj. Edlira Petri ka qenë e justifikuar dhe nuk ka ndikuar në zhvillimin e shorteve sa i përket çështjeve të karakterit urgjent në kohën e inspektuar. Në këtë rast nga ana e zv/kryetarës së gjykatës është zbatuar kreu V. "Përjashtimi i gjyqtarit nga shorti", pika 4 e Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", si dhe shkronja "a" e pjesës së "shënimeve" të vendimit nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", i përditësuar.

Me shkresën nr. 7987/1 prot., datë 03.06.2025, me lëndë: "Kthim përgjigje", kancelaria e Gjykatës znj.Lertida Balili, ka dërguar një pjesë të përgjigjeve të pyetjeve^[49] në lidhje me dokumentacionin që është kërkuar me shkresën nr. 1020/4 prot., datë 07.04.2025 nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në kuadër kryerjes së inspektimit tematik me objekt: "*Mbi ndarjen e çështjeve me short, si edhe kontrollin e raporteve të sistemit elektronik në gjykata për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024*", ndërsa pjesën tjetër të dokumentacionit e ka dërguar me shkresën, nr.7987/2 prot., datë 05.06.2025, me lëndë: "Kthim përgjigje"^[50].

^[49] Konkretisht ka dërguar:- raport analizën vjetore të vitit 2024;-rregulloren e brendshme të miratuar me vendimin nr. 1, datë 04.01.2023 të Këshillit të Gjykatës;-vendime përjashtim gjyqtari;-vendime pranimit kërkesë për heqje dorë nga gjykimi;-vendime të Këshillit të Gjykatës;-urdhëra dhe vendime të zv/kryetarit të Gjykatës; si dhe kopje të CD (ku është hedhur dokumentacioni sa i përket raporteve të gjenorazura nga sistemi ICMIS lidhur me shortin normal, shortin manual, rishortimet, masat e sigurimit si dhe shortin normal të muajit janar 2025).

^[50] Konkretisht ka dërguar formularët e plotëzuar për:- shortin normal të vitit 2024;-kërkesat për pranimit dorëheqje çështje civile;-kërkesat për pranimit dorëheqje çështje penale;-kërkesat për pranimit, përjashtim gjyqtari çështje civile; si dhe -kërkesat për pranimit, përjashtim gjyqtari penale.

emailin e datës 24.06.2025, me lëndë: "Dërgim të dhënash"^[51], si dhe shkresën nr.7987/3 prot., datë 10.07.2025, me lëndë: "Kthim përgjigje"^[52].

Në vazhdim Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me shkresën nr.7987/4 prot., datë 09.09.2025, *(e cila është bërë hyrje në zyrën e protokoll-arkivit në ILD me nr. 1020/17 prot., datë 09.09.2025)* ka dërguar tabelat e plotësuara sa i përket shortit manual, rishortimeve, CD që përmban materialin në formatin excel *(të këtyre formularëve)* si dhe raportet mbi të cilat është punuar për plotësimin e formularëve.

Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me shkresën nr. 7987/5 prot., datë 01.10.2025, *(e cila është bërë hyrje në zyrën e protokoll-arkivit në ILD me nr. 1020/19 prot., datë 02.10.2025)* ka dërguar kthim përgjigje dhe kësaj shkrese i ka bashkëlidhur edhe 66 akte që kanë të bëjnë me objektin e inspektimit si dhe një kopje të CD që pasqyron tabelat e hedhura në excel.

Duke bërë krahasimin e akteve të lëshuara nga zv/kryetarja e gjykatës në raport me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë procedurat e shortit në gjykatë, për të cilat edhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, po bën këtë inspektim tematik dhe për të kontrolluar se sa janë zbatuar procedurat ligjore në këtë drejtim, rezulton se:

I. Zv/kryetari i Gjykatës ka lëshuar urdhër nr.3 prot., datë 04.01.2024 "Për caktimin e orës së shortit të çështjeve gjyqësore", në të cilin ka përcaktuar se:

"...1.Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm shorti elektronik i ndarjes së dosjeve gjyqësore do të realizohet çdo ditë pune ora 15.⁰⁰. 2.Në rast pamundësie të realizimit të shortit brenda ditës së punës, çështjet e regjistruara shortohen jo më vonë se dita nesërme e punës. 3.Në short përfshihen të gjitha çështjet e regjistruara në sistemin e menaxhimit të çështjeve, deri në momentin e orës së publikuar të shortit.Shorti realizohet në sallë gjykimi dhe shfaqet në kohë reale në monitorët e vendosur në ambientët e hyrjes së gjykatës.Raporti i shortit është publik dhe pasqyrohet menjëherë në faqen zyrtare të internetit të gjykatës. 4.Përfshihen nga ndarja me short: a)Kërkesat për të cilat ligji parashikon afate shqyrtimi, jo më shumë se 10 ditë për gjykatën e apelit, të cilat shqyrtohen nga gjyqtarët e listës së gatishmërisë, në zbatim të shkronjës "b", të nenit 37, të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; b)Kërkesat e paraqitura rishtazi, për të cilat ligji procedural parashikon shqyrtimin nga gjyqtari i hetimeve paraprake apo nga gjyqtari i seancës

[51] Konkretisht ka dërguar formularët e plotësuar për:- shortin normal në formatin excel; dhe -kërkesat për miratim dorëheqje nga gjykimi dhe përjashtim gjyqtari për çështjet civile dhe penale.

[52] Në këtë shkresë në mënyrë narrative ka përcjellë informacion të detajuar sipas kërkesave të ILD-së si dhe ka dërguar dokumentacion e konkretisht:-urdhër nr. 733 prot., datë 26.12.2023"Mbi mbartjen e dosjeve gjyqësore për vitin e ri kalendarik dhe shortin gjyqësor gjatë kësaj periudhe...etj";-urdhër i brendshëm nr. 224 prot., datë 28.06.2024"Për caktimin e orës së shortit për çështjet e regjistruara në datën 28.06.2024";-procesverbal nr. 224/1 prot., datë 28.06.2024"Për shortin e datës 28.06.2024";-vendim nr. 10 prot., datë 10.01.2022"Për zgjedhjen e zv/kryetarit të gjykatës së Apelit Tiranë";-email i datës 07.02.2024 i KLGJ-së për njoftim vendimi nr. 59, datë 07.02.2024;-email i datës 09.10.2024 i KLGJ-së për njoftim vendimi nr. 591, datë 09.10.2024;-vendim nr. 483, datë 31.07.2024 i KLGJ-së;-urdhër nr. 20 prot., datë 10.01.2024"Për zëvendësim gjyqtari për gjykimin e rasteve urgjente";-tabele për çështje penale (masa sigurimi) nënshkruar nga I.Bezati;-RM koke datë ekzaminimi 10.01.2024;-recetë e datës 10.01.2024, lëshuar nga German Hospital lëshuar për I.Bezati;-raport për publlësi në punë për sëmundje të përgjithshme që paguhet nga punëdhënësi i datës 11.01.2024 lëshuar për I.Bezati....etj.

paraprake; c)Çështjet e caktuara me short, për të cilat është disponuar më parë nga gjykata me vendim jopërfundimtar, si edhe çdo vendim tjetër, që pa e zgjidhur çështjen në themel, i jep fund procesit gjyqësor të filluar sipas ligjit;d)Çdo kërkesë apo çështje gjyqësore për të cilat ligji ka parashikuar shqyrtimin nga i njëjti trup gjykues. 5.Kryesekretaria, nën mbikëqyrjen e kancelarit, kryen verifikimin paraprak të çështjeve të paraqitura, me qëllimin për të përjashtuar nga ndarja me short të çështjeve gjyqësore, sipas parashikimeve të pikës 1 të Kreut IV si dhe për përjashtimin e gjyqtarit nga shorti i cili ndodhet përpara njëres prej pengesave ligjore, sipas parashikimeve të pikës 1 të Kreut V, të vendimit nr. 554 datë 29.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. 6.Kur nga të dhënat paraprake evidentohet se çështja është e njëjtë, me atë për të cilën gjykata më parë ka disponuar në mënyrë jopërfundimtare, atëherë çështja kalohet automatikisht tek e njëjta trup gjykuese, nëpërmjet sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Në rastet kur çështja nuk mund të shqyrtohet nga i njëjti trup gjykues, ajo përfshihet në shortin elektronik të radhës. 7.Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhëri, dhe nënshkrimin e kalimit të praktikës së regjistrimit të çështjeve sipas formës standarde e cila gjendet bashkëlidhur vendimit nr. 554 datë 29.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ngarkohet Kancelari i Gjykatës. 8.Një kopje e këtij urdhëri për komunikim gjyqtarëve, kancelarit, Kryesekretarisë, Sektorit të IT-së, sekretarëve regjistruese dhe të seancës gjyqësore. 9. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të internetit të gjykatës. 10.Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë...etj”.

Zv/Kryetari i gjykatës ka lëshuar urdhër në lidhje me procedurat e hedhjes së shortit të çështjeve, për ditët dhe orarin për hedhjen e tyre, për vitin 2024, në përputhje me pikës 3 të kreut III. “Procedurat dhe rregullat e ndarjes së çështjeve me short”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 554, datë 29.12.2022 “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore”, si dhe kërkesat e ligjit nr.98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, lidhur me përgjegjësinë që ka për menaxhimin e përgjithshëm gjyqësor (nenet 37 shkronja “h” e 26 pika 2 të këtij ligji).

Zv/kryetari i Gjykatës ka lëshuar urdhër nr.428 prot., datë 31.12.2024 “Për caktimin e orës së shortit të çështjeve gjyqësore”, për vitin 2025^[53]...etj.

II.Këshilli i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ka marrë 5 (pesë) vendime konkretisht:

a. Vendimin nr. 7, datë 26.02.2024 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1 datë 02.02.2023, të Këshillit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, “Mbi krijimin e seksioneve dhe caktimin e gjyqtarëve në trupat gjykues, si dhe për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur

^[53] Në të cilin ka përcaktuar se: “...1.Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm shorti elektronik i ndarjes së dasjeve gjyqësore për vitin 2025 do të realizohet çdo ditë pune ora 15.⁰⁰. 2.Në rast pamundësie të realizimit të shortit brenda ditës së punës, çështjet e regjistruara shortohen jo më vonë se dita nesërme e punës...etj” dhe ka përcaktuar në detaje se kush janë çështjet që do t’i nëshkrohen shortit normal dhe rregullat që do të ndiqen për zbatimin e këtij urdhëri, deri tek nënshkrimi i kalimit të praktikës së regjistrimit të çështjeve, sipas formës standarde e cila gjendet bashkëlidhur vendimit nr. 554 datë 29.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ngarkohet Kancelari i Gjykatës. Në këtë urdhër është përcaktuar gjithashtu se një kopje e tij do të komunikohet gjyqtarëve, kancelarit, Kryesekretarisë, Sektorit të IT-së, sekretarëve regjistruese dhe të seancës gjyqësore, si dhe ky akt do të publikohet edhe në faqen zyrtare të internetit të gjykatës...etj.

viktimit nga vepra penale", i ndryshuar (shkresa nr. 84 prot., datë 26.02.2024), vendim i cili është nxjerrë si rezultat i rregullimit të aktivitetit të gjykatës, pas ngritjes në detyrë në gjykatë të gjyqtarës znj. Diamela Goxha me vendimin nr. 59, datë 07.02.2024, të KLGJ-së...etj, ku seksioni penal do të përbëhet nga 14 gjyqtarë, ndërsa seksioni civil do të përbëhet nga 12 gjyqtarë. Në këtë vendim ndër të tjera është cituar që shkronja "e" e pikës 1 e vendimit nr. 1 datë 02.02.2023, i ndryshuar, të ndryshohet si më poshtë: "...Trupi i pestë përbëhet nga gjyqtarët: Valdete Hoxha dhe Diamela Goxha si dhe një anëtar nga gjyqtarët e tjerë të trupave gjyqësor të seksionit penal, të cilët caktohen me short...etj". Në këtë vendim janë përcaktuar edhe detaje të tjera për mënyrën e funksionimit në praktikë të vendimit të këshillit.

b. Vendimin nr.8, datë 26.02.2024 "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore" (shkresa nr. 85 prot., datë 26.02.2024), ku ndër të tjera është përcaktuar se në kushtet e caktimit rishtazi (ngritjes në detyrë) në këtë gjykatë të gjyqtarës znj.Diamela Goxha, me vendimin nr. 59, datë 07.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, shpallur me vendimin nr.29, datë 01.04.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në funksion dhe të barazisë së ngarkesës së punës për gjyqtarët e seksionit penal, kur është e nevojshme për shkaqe të justifikuara, në funksion të miradministrit gjyqësor, bazuar dhe në praktikën e Këshillit të Lartë Gjyqësor në rastet e caktimit të gjyqtarëve të skemës së delegimit, për periudha afatgjata, pasi analizo i ngarkesën e punës së gjyqtarëve në detyrë, deri në shtimin e gjyqtarëve të kësaj gjykate, me propozim të zv/kryetares së Gjykatës, Këshilli i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm mbështetur në nenet 25 dhe 38 të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 724, datë 7.12.2023 "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore", pika 7 e tij, ka vendosur:

"...I. Për rindarjen e çështjeve penale.

I.Rindarjen me short midis gjyqtarëve Diamela Goxha, caktuar rishtazi, dhe gjyqtarëve Miranda Andoni, Qemal Zaimi, Brikena Ukperaj dhe Marsela Pepi, të çështjeve penale të cilat nuk janë shpallur për gjykim nga gjyqtarët Fatri Islamaj, Valdete Hoxha, Genti Shala, Edlira Petri, Lutfije Celami, Dritan Hasani, Fuat Vjerdha, Irena Brahimi, Genti Dokollari, të ngarkuar aktualisht si relator. Në funksion të shpërndarjes së drejtë dhe të barabartë të çështjeve penale, ngarkesa e punës së gjyqtarëve, Diamela Goxha, Miranda Andoni, Qemal Zaimi, Brikena Ukperaj dhe Marsela Pepi, nga rindarja e çështjeve me short, është deri në ngarkesën mesatare të ponderuar të çështjeve penale sipas Tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi. Në këtë ngarkesë, për aq sa është e mundur dhe në mënyrë proporcionale, përfshihen çështjet të të njëjtës vjetërsi sipas viteve të regjistrimit të tyre në gjykatë. Numri i çështjeve penale sipas viteve të regjistrimit të tyre, që rindahen me short sipas pikës 1, përcaktohen në tabelat numër 1 dhe 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Procedura e rindarjes së çështjeve penale

2.Rindarja e çështjeve sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet me short elektronik.

3.Për rindarjen e çështjeve me short ndiqet kjo procedurë:

a) Nëpërmjet shortit elektronik përcaktohen çështjet e regjistruara aktualisht me relatorë gjyqtarët Fatri Islamaj, Valdete Hoxha, Genti Shala, Edlira Petri, Lutfije

Celami, Dritan Hasani, Fuat Vjerdha, Irena Brahim, Genti Dokollari, çështje të cilat pakësohen nga ngarkesa e tyre. Për realizimin e këtij shorti të përdoret programi elektronik i vënë në dispozicion nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, krijuar për përzgjedhjen e çështjeve në funksion të procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve;

b) Çështjet e përzgjedhura me short sipas shkronjës "a", të kësaj pike, me pas shortohen midis gjyqtarëve, Miranda Andoni, Qemal Zaimi, Brikena Ukperaj, Marsela Pepi, dhe Diamela Goxha nëpërmjet programit të Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore CCMIS/ICMIS.

4. Ngarkohet Kancelari i Gjykatës për mbikëqyrjen e procesit të organizimit dhe dokumentimit të rindarjes me short të çështjeve penale sipas këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë...etj".

c. Vendimin nr.44, datë 08.10.2024 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 1 datë 02.02.2023, të Këshillit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, "Mbi krijimin e seksioneve dhe caktimin e gjyqtarëve në trupat gjykues, si dhe për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur viktimë nga vepra penale", i ndryshuar (shkresa nr. 297 prot., datë 08.10.2024), vendim i cili është nxjerrë si rezultat i rregullimit të aktivitetit të gjykatës, pas ngritjes në detyrë në gjykatë të gjyqtarës znj. Enkela Vlora (Bajo) me vendimin nr. 484, datë 31.07.2024, të KLGJ-së...etj, ku ndër të tjera thuhet se:

"...1.Pika 1 ndryshohet si më poshtë: Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm seksioni penal do të përbëhet nga 14 gjyqtarë, ndërsa seksioni civil do të përbëhet nga 13 gjyqtarë. Në këtë vendim është caktuar, që pas pikës 4 "trupat gjykues të seksionit civil" shtohet shkronja "e", si më poshtë: "e)...Trupi i pestë përbëhet nga gjyqtarët: Enkela Vlora si dhe dy anëtarë nga gjyqtarë të tjerë të trupave gjykues të seksionit civil, të cilët caktohen me short, sipas kësaj skeme: i) në çështjet e planifikuara për muajt tek, për dy javët e para, nga anëtarët e trupit gjykues të parë dhe për dy javët e dyta nga anëtarët e trupit gjykues të dytë; ii) në çështjet e planifikuara për muajin çift, për dy javët e para, nga anëtarët e trupit gjykues të tretë dhe për dy javët e dyta nga anëtarët e trupit gjykues të katërt. Trupi i pestë gjykues si rregull do të gjykojë ditën e hënë dhe të mërkurë, në sallën ku gjykojnë trupat gjykues plotësues. Nëse për gjyqtarin plotësues sipas shkronjës "e" të këtij vendimi konstatohet papajtueshmëri për ushtrimin e funksionit në një çështje, plotësimi i trupit të pestë gjykues do të bëhet me gjyqtarin tjetër të trupit gjykues ku bëjnë pjesë gjyqtarët plotësues. 2. Ngarkohet Kancelari i Gjykatës për mbikëqyrjen e procesit të organizimit dhe dokumentimit të ndarjes me short të çështjeve sipas këtij vendimi. 3. Ky vendim hyn në fuqi me menjëherë dhe i shtrin efektet deri në shtimin e gjyqtarëve...etj".

Në këtë vendim janë përcaktuar edhe detaje të tjera për mënyrën e funksionimit në praktikë të vendimit të këshillit.

d. Vendimin nr.47, datë 21.10.2024 "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore" (shkresa nr. 318 prot., datë 21.10.2024), ku ndër të tjera është përcaktuar se në kushtet e caktimit rishtazi (ngritjes në detyrë) në këtë gjykatë të gjyqtarës znj. Enkela Vora, dhe znj. Anila Karanxha, në funksion dhe të barazisë së ngarkesës së punës për gjyqtarët e seksionit penal, kur është e nevojshme për shkaqe të justifikuara, në funksion të miradministrit

gjyqësor, bazuar dhe në praktikën e Këshillit të Lartë Gjyqësor në rastet e caktimit të gjyqtarëve të skemës së delegimit, për periudha afatgjata, pasi analizo i ngarkesën e punës së gjyqtarëve në detyrë, me propozim të zv/kryetares së Gjykatës, Këshilli i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, mbështetur në nenet 25 dhe 38 të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 724, datë 7.12.2023 "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore", neni 5 "Rastet e rindarjes me short të çështjeve gjyqësore" shkronja gj) "shtimi i gjyqtarëve në gjykatë", neni 7 pika 7 e tij, ka vendosur:

"...I. Për rindarjen e çështjeve civile.

1. Rindarjen me short midis gjyqtarëve znj. Enkela Vlora dhe znj. Anila Karanxha, caktuar rishitazi, të çështjeve civile të cilat nuk janë shpallur për gjykim nga gjyqtarët, Sokol Pina, Valbona Vata, Arta Duka, Astrit Kalaja, Irida Kacerja, Elona Mihali, Elona Toro, Iliba Bezati, Alma Ahmeti, Marsela Dervishi, Ornella Naqellari, Alma Kolgjoka të ngarkuar aktualisht si relator. Përfshihen nga rindarja me short dhe çështjet gjyqësore ku gjyqtarët, znj. Enkela Vlora dhe Anila Karanxha kanë marrë pjesë në dhënien e vendimit në shkallë të parë. **2.** Në funksion të shpërndarjes së drejtë dhe të barabartë të çështjeve civile, ngarkesa e punës së gjyqtarëve, znj. Enkela Vlora dhe Anila Karanxha, nga rindarja e çështjeve me short, është deri në ngarkesën mesatare të ponderuar të çështjeve civile sipas Tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi. Në këtë ngarkesë, për aq sa është e mundur dhe në mënyrë proporcionale, përfshihen çështjet sipas viteve të regjistrimit të tyre dhe çështje të kategorive të ndryshme. **3.** Numri i çështjeve civile sipas viteve të regjistrimit të tyre, që rindahen me short sipas pikës 1, përcaktohen në tabelën numër 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Procedura e rindarjes së çështjeve civile

- 4.** Rindarja e çështjeve sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet me short elektronik.
- 5.** Për rindarjen e çështjeve me short ndiqet kjo procedurë: **a)** Nëpërmjet shortit elektronik përcaktohen çështjet e regjistruara aktualisht me relatorë gjyqtarët Sokol Pina, Valbona Vata, Arta Duka, Astrit Kalaja, Irida Kacerja, Elona Mihali, Elona Toro, Iliba Bezati, Alma Ahmeti, Marsela Dervishi, Ornella Naqellari, Alma Kolgjoka, çështje të cilat pakësohen nga ngarkesa e tyre. Për realizimin e këtij shorti të përdoret programi elektronik i vënë në dispozicion nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, krijuar për përzgjedhjen e çështjeve në funksion të procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve; **b)** Çështjet e përzgjedhura me short sipas shkronjës "a", të kësaj pike, me pas shortohen midis gjyqtarëve, Enkela Vlora dhe Anila Karanxha nëpërmjet programit të Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore CCMIS/ICMIS.
- 6.** Ngarkohet Kancelari i Gjykatës për mbikëqyrjen e procesit të organizimit dhe dokumentimit të rindarjes me short të çështjeve penale sipas këtij vendimi.
- 7.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherëetj".

e. Vendimin nr. 48, datë 28.10.2024 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 1 datë 02.02.2023, të Këshillit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, "Mbi krijimin e seksioneve dhe caktimin e gjyqtarëve në trupat gjykues, si dhe për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur viktimë nga vepra penale", i ndryshuar (shkresa nr. 326 prot., datë 28.10.2024), vendim i cili është nxjerrë si rezultat i rregullimit të aktivitetit të gjykatës, pas ngritjes në detyrë në

gjykatë të gjyqtarës znj. Anila Karanxha me vendimin nr. 591, datë 09.10.2024, të KLGJ-së...etj, ku ndër të tjera thuhet se:

“...1.Pika 1 ndryshohet si më poshtë: Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm seksioni penal do të përbëhet nga 14 gjyqtarë, ndërsa seksioni civil do të përbëhet nga 14 gjyqtarë. 2. Pika 2 ndryshon si vijon: Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm krijohen dhe funksionojnë pesë trupa gjykues të seksionit civil. 3.Në këtë vendim është cituar, që pas pikës 4 “trupat gjykues të seksionit civil” shkronja “b” dhe “e” ndryshohet si më poshtë: Trupi i dytë gjykues përbëhet nga gjyqtarët Astrit Kalaja, Enkela Bajo dhe Elona Mihali. Veprimtaria gjyqësore me këtë përbërje fillon me datë 01.11.2024. Për çështje civile në gjykim dhe të shpallura për gjykim, nga gjyqtarët Astrit Kalaja, Irida Kacerja dhe Elona Mihali do të vijojë gjykimi me këtë trup gjykues. Për çështje civile në gjykim dhe të shpallura për gjykim, nga gjyqtarja Enkela Vlora, nëse është bërë plotësimi i trupit gjykues sipas vendimit nr. 44 datë 08.10.2024 të Këshillit të Gjykatës do të vijojë gjykimi me atë trup gjykues. Trupi i pestë përbëhet nga gjyqtarët: Anila Karanxha, Irida Kacerja si dhe plotësohet me një prej gjyqtarëve të tjerë të trupit të dytë të seksionit civil, sipas kësaj skeme: i)Në çështjet e planifikuara për 10 ditëshin e parë të muajit nga gjyqtari Astrit Kalaja, në 10 ditëshin e dytë nga gjyqtare Enkela Vlora, në 10 ditëshin e tretë nga gjyqtare Elona Mihali. ii)Nëse për gjyqtarin plotësues sipas shkronjës “e” të këtij vendimi konstatohet papajtueshmëri për ushtrimin e funksionit në një çështje, plotësimi i trupit të pestë gjykues do të bëhet me gjyqtarin tjetër të trupit gjykues të dytë ku bëjnë pjesë gjyqtarët plotësues. Nëse konstatohet papajtueshmëri në një çështje, për ushtrimin e funksionit për të tre gjyqtarët plotësues, trupi do të plotësohet me short ndërmjet gjyqtarëve të tjerë që gjykojnë në të njëjtin seksion. Trupi i pestë gjykues si rregull do të gjykojë ditën e martë dhe të enjte në sallën nr. 8, ose me mirëkuptim ditën e hënë dhe të mërkurë në sallën ku gjykon trupi gjykues plotësues.Ngarkohet Kancelari i Gjykatës për mbikëqyrjen e procesit të organizimit dhe dokumentimit të ndarjes me short të çështjeve sipas këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi me menjëherë dhe i shtrin efektet deri në shtimin e gjyqtarëve. Një kopje e vendimit për komunikim gjyqtarëve...etj”.

Në këtë vendim janë përcaktuar edhe detaje të tjera për mënyrën e funksionimit në praktikë të vendimit të këshillit.

Këshilli i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me propozim të zv/kryetarës së gjykatës, ka lëshuar 3 (tre) vendime në lidhje me krijimin dhe caktimin e gjyqtarëve në trupa gjykues si dhe për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur viktimë nga vepra penale”, për vitin 2024, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, lidhur me përgjegjësinë që ka për menaxhimin e përgjithshëm gjyqësor (nenet 23 dhe 38 shkronja “ç” të këtij ligji), nenet 27 dhe 28 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, udhëzimin nr. 79, datë 30.05.2019 “Mbi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor si dhe kërkesat e pikës 11 të kreut III. “Procedurat dhe rregullat e ndarjes së çështjeve me short” të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 554, datë 29.12.2022 “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore”.

Këshilli i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me propozim të zv/kryetarës së gjykatës ka lëshuar 2 (dy) vendime në lidhje me procedurat e rindarjes me short të çështjeve gjyqësore, për vitin 2024, në kundërshtim me kërkesat e Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 724, datë 7.12.2023 "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore", neni 5 "Rastet e rindarjes me short të çështjeve gjyqësore" shkronja gj) "shtimi i gjyqtarëve në gjykatë", neni 7 pika 7-e tij, si dhe kërkesat e ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, lidhur me përgjegjësinë që ka për menaxhimin e përgjithshëm gjyqësor (nenet 25 dhe 38 shkronja "ç" të këtij ligji), pasi: *".... Kryetari i gjykatës është autoriteti që vendos për rindarjen me short të çështjeve në rastin e shtimit të gjyqtarëve në gjykatë, si dhe për përcaktimin e rrethit të çështjeve që do të rishortohen, me qëllim që ngarkesa e punës për gjyqtarët e ardhur rishtazi në gjykatë, për aq sa është e mundur, të përfshijë çështje të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre në gjykatë.....etj"* dhe jo Këshilli i Gjykatës.

II. Kryetari i Gjykatës së Apelit të Judiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka nxjerrë aktin e titulluar:

a) vendim: "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente" (shkresa nr. 729 prot., datë 21.12.2023). Në këtë vendim i cili ka bazë ligjore nenet 26/2, e 37/b të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.505 datë 21.11.2022 "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm", dhe nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", për çështjet të cilat ligji procedural penal, parashikon afate të ngutshme të parashikuara në K.Pr.Penale dhe konkretisht: nga nenet 22/3, 147 pika 4, 202/a pika 3, 212, 222 pika 4, 246 pika 6, 249 pika 5, 278 pika 2, 320, 325, dhe 476 pika 3, do të merren në shqyrtim nga gjyqtarët e gatshëm. Në këtë vendim janë parashikuar se si do veprohet me:

- i) kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, parashikuar nga neni 278 pika 2 e K.Pr.Penale;
- ii) kërkesat për përjashtimin e gjyqtarit kur ajo është e përsëritur (kërkesa do të caktohet të njëjtit gjyqtar, që ka shqyrtuar kërkesën e parë të përjashtimit); dhe,
- iii) kërkesën kur kërkohet përjashtimi i gjyqtarit, i cili ka radhën e gatishmërisë, ose është në të njëjtin kolegji që gjykon çështjen me gjyqtarin për të cilin kërkohet përjashtimi (kërkesa do të shqyrtohet nga një gjyqtar i gatshëm, që nuk është në përbërje të trupit gjyqësor me gjyqtarin për të cilin kërkohet përjashtimi).

Vendimi i nxjerrë nga zv/kryetari ka përcaktuar që për masat e sigurimit, kërkesat e tjera të hetimit paraprak, si dhe ato çështje që ligji parashikon afat të ngutshëm. (shih aneksin 2 bashkëlidhur). Në vendim nuk është përfshirë në grafikun e gatishmërisë gjyqtarja znj. Valdede Hoxha, e cila në të njëjtën kohë mbulon edhe detyrën e zv/kryetarit të gjykatës.

b) urdhër "Për zëvendësim gjyqtari për gjykimin e rasteve urgjente" (shkresa nr. 20 prot., datë 10.01.2024), ku në kushtet e pamundësisë objektive për mosparaqitje në punë (arsye shëndetësore të gjyqtarës Ilirja Bezati, në datën 11.01.2024, dhe që ka planifikuar

për gjykim 7 çështje¹⁵⁴, të marra për shqyrtim si gjyqtare e periudhës së gatishmërisë nga data 01.01-07.01.2024), ku prej saj është paraqitur raport mjekësor (që fillon nga data 11.01.2024 e afte për punë në datën 12.01.2024), me qëllim që këto çështje për shkak të natyrës urgjente dhe mosshqyrtimit brenda afatit, ju humbet fuqia, të rishortohen tek gjyqtarët Alma Ahmeti dhe Miranda Andoni, të cilat kanë qenë të gatshme në këtë periudhë së bashku me gjyqtarën Iliba Bezati.

e) vendim "Për zëvendësim dhe caktim gjyqtari për gjykimin e rasteve urgjente" (shkresa nr. 97 prot., datë 06.03.2024), sipas të cilit bëhet e qartë fakti se për periudhën 18 mars deri 24 mars 2024, në grafikun e gatishmërisë janë planifikuar të shqyrtojnë çështjet e karakterit urgjent gjyqtarët z. F. Islamaj, znj. I. Kacerja dhe z. A. Kalaja. Në kushtet kur gjyqtarja znj. I. Kacerja ka bërë kërkesë për marrjen e lejes vjetore të pakryer për vitin 2023, leje e cila është miratuar me urdhërin e zv/kryetarit nr. 1981 prot., datë 01.02.2024, dhe që kjo leje të kryhet nga data 25.03.2024 - 29.03.2024, nga zv.kryetarja e gjykatës, është vendosur që kjo gjyqtare të zëvendësohet nga gjyqtare znj. Diamela Goxha, e cila është caktuar rishtazi (ngritje në detyrë) me vendimin e KLGJ-së nr. 59 datë 07.02.2024. Për arsyet e sipërcituara zv/kryetarja e gjykatës bazuar në nenin 37 shkronja "b" të ligjit nr. 98/2016, ka vendosur: "...1. Përditësimin e vendimit nr. 729 prot., dt. 21.12.2023, "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", duke zëvendësuar gjyqtarën znj. Irida Kacerja, në listën e gatishmërisë për periudhën 18 mars - 24 mars 2024, me gjyqtarën e caktuar rishtazi në detyrë znj. Diamela Goxha, listë në të cilën për këtë periudhë janë të gatshëm dhe gjyqtarët Fatri Islamaj dhe Astrit Kalaja. 2. Gjyqtarja Irida Kacerja si rregull do të përmbushë funksionin si gjyqtar i gatshëm në një periudhë tjetër...etj".

d) Vendim "Për caktim gjyqtari për gjykimin e rasteve urgjente" (shkresa nr. 173 prot., datë 02.05.2024), ku në kushtet e caktimit rishtazi (ngritje në detyrë) të gjyqtarit Diamela Goxha me vendimin e KLGJ-së nr. 59 datë 07.02.2024, është përditësuar vendimi nr. 1 prot., datë 01.02.2023¹⁵⁵, duke u caktuar për gjykimin e rasteve urgjente dhe gjyqtari Diamela Goxha, për periudhën e gatishmërisë nga data 06 maj në vijim (shih aneksin 2 bashkëlidhur).

e) vendim "Për zëvendësim dhe caktim gjyqtari për gjykimin e rasteve urgjente" (shkresa nr. 213 prot., datë 14.06.2024), sipas të cilit bëhet e qartë fakti se për periudhën 17 qershor deri 23 qershor 2024, në grafikun e gatishmërisë janë planifikuar të shqyrtojnë

¹⁵⁴ Këto 7 (shtatë) çështje janë me: nr. (61005-00008-30-2024) 56 akti datë 04.01.2024 regjistrimi i arrestuar Elvis Salku. Në shortin e rishortimin e datës 10.01.2024, i ka kaluar gjyqtarës Miranda Andoni; -nr. (61005-00013-30-2024) 61 akti datë 04.01.2024 regjistrimi i arrestuar Njazi Rrokoman. Në shortin e rishortimin e datës 10.01.2024, i ka kaluar gjyqtarës Alma Ahmeti; -nr. (61005-00015-30-2024) 63 akti datë 04.01.2024 regjistrimi i arrestuar Ervis Kurti. Në shortin e rishortimin e datës 10.01.2024, i ka kaluar gjyqtarës Miranda Andoni; -nr. (61005-00018-30-2024) 66 akti datë 04.01.2024 regjistrimi i arrestuar Alben Meko. Në shortin e rishortimin e datës 10.01.2024, i ka kaluar gjyqtarës Alma Ahmeti; -nr. (61005-00027-30-2024) 75 akti datë 05.01.2024 regjistrimi i arrestuar Ervis Kolici. Në shortin e rishortimin e datës 10.01.2024, i ka kaluar gjyqtarës Miranda Andoni; -nr. (60610-00023-30-2024) 71 akti datë 04.01.2024 regjistrimi i ndaluar Kejvi Alikaj. Në shortin e rishortimin e datës 10.01.2024, i ka kaluar gjyqtarës Alma Ahmeti; -nr. (60005-00024-30-2024) 72 akti datë 05.01.2024 regjistrimi me kërkuese Irida Guma. Në shortin e rishortimin e datës 10.01.2024, i ka kaluar gjyqtarës Miranda Andoni; Në 7 (shtatë) çështjet si arsye rishortimi është vendosur: "...Në bazë të urdhërit nr. 20 prot., dt. 10.01.2024 të zv/kryetarës së gjykatës Valdete Hoxha...etj".

¹⁵⁵ Vendimi nr. 1 prot., datë 01.02.2023, është ligësuar që është cituar nga zv/kryetari i Gjykatës së Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, pasi në fakt është vendimi nr. 729 prot., datë 21.12.2023, që është përditësuar për caktim gjyqtari për gjykimin e rasteve urgjente.

çështjet e karakterit urgjent gjyqtarët znj. Alma Ahmeti, znj. Miranda Andoni dhe znj. Iliba Bezati. Në kushtet kur gjyqtarja znj. I. Bezati ka bërë kërkesë për zëvendësimin e saj për periudhën e gatishmërisë me argumentin se çështjet, do të gjykohen javën pasardhëse dhe se gjatë kësaj jave po i nënshtrohet procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve, konkretisht në datën 26.06.2024, ku është seanca dëgjimore dhe se është e ngarkuar me punë, si dhe në kushtet kur më parë i është miratuar leje gjyqtarës znj. I. Kacerja me vendimin 87 prot., datë 08.03.2024, bëhet zëvendësimi i këtyre dy gjyqtarëve. Për arsyet e sipërcituara zv/kryetarja e gjykatës bazuar në nenin 37 shkronja "b" të ligjit nr. 98/2016, ka vendosur: "...1. Përditësimin e vendimit nr. 729 prot., dt. 21.12.2023, "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", duke zëvendësuar gjyqtaren znj. Iliba Bezati, në listën e gatishmërisë për periudhën 17 qershor - 23 qershor 2024, me gjyqtarën znj. Irida Kacerja, listë në të cilën për këtë periudhë janë të gatshëm dhe gjyqtarët znj. Alma Ahmeti dhe znj. Miranda Andoni. 2. Gjyqtarja Iliba Bezati si rregull do të përmbushë funksionin si gjyqtar i gatshëm në një periudhë tjetër...etj".

f) Vendim "Për zëvendësim dhe caktim gjyqtari për gjykimin e rasteve urgjente" (shkresa nr. 239 prot., datë 11.07.2024), sipas të cilit rezulton se gjyqtarja znj. Alma Kolgjoka, me kërkesën e datës 11.07.2024^[56], drejtuar zv/kryetarës znj. Valdete Hoxha, për arsye familjare e ka në pamundësi objektive të kryejë gatishmërinë në datat 15 korrik deri 21 korrik 2024 dhe ka kërkuar brenda mundësive, që këtë gatishmëri ta kryejë një javë më vonë pra në datat 22 korrik deri 28 korrik 2024. Në kërkesë ndër të tjera, kjo gjyqtare shprehet se gjyqtare Ornella Naqellari, e cila është e gatshme në ato data, ka shprehur mirëkuptimin dhe pëlqimin e saj që të ndërrojë javën e gatishmërisë me kërkuuesen. Për arsyet e sipërcituara zv/kryetarja e gjykatës bazuar në nenin 37 shkronja "b" të ligjit nr. 98/2016, ka vendosur: "... 1. Përditësimin e vendimit nr. 729 prot., dt. 21.12.2023, "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", përditësuar me vendimin nr. 173, datë 02.05.2024, duke zëvendësuar gjyqtaren Alma Kolgjoka, në listën e gatishmërisë për periudhën 15-21 korrik 2024, me gjyqtarën znj. Ornella Naqellari. 2. Gjyqtarja Alma Kolgjoka do të përmbushë funksionin si gjyqtar i gatshëm në periudhën 22-28 korrik 2024, duke zëvendësuar gjyqtarën Ornella Naqellari...etj".

g) vendim "Për caktim gjyqtari për gjykimin e rasteve urgjente" (shkresa nr. 301 prot., datë 08.10.2024), ku në kushtet e caktimit rishtazi (ngritje në detyrë) të gjyqtarit Enkela Vlora me vendimin e KLGJ-së nr. 483 datë 31.07.2024, është përditësuar vendimi nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", për vitin 2024, duke u caktuar për gjykimin e rasteve urgjente dhe gjyqtari Enkela Vlora, për periudhën e gatishmërisë nga data 28 tetor e në vijim, sipas kësaj renditje:

- i) për periudhën 28 tetor 2024 deri në 03 nëntor 2024, do të gjykohen nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (sipas rendit alfabetik me bazë shkronjën e parë të mbiemrit) si më poshtë vijon: -Gjyqtarët Ukperaj Brikena, Vata Valbona dhe Vlora Enkela;

^[56] Me aktet e inspektimit tematik Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, ka dërguar edhe kërkesën e datës 11.07.2024, të gjyqtarës znj. A. Kolgjoka që i është drejtuar zv/kryetarit të Gjykatës për ndryshim grafiku gatishmërie, që ndodhet bashkëlidhur këtij raporti.

- ii) për periudhën 04 nëntor 2024 deri në 10 nëntor 2024, do të gjykohej nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (sipas rendit alfabetik me bazë shkronjën e parë të mbiemrit) si më poshtë vijon: -Gjyqtarët Vjerdha Fuat dhe Zaimi Qemal;

h) vendim "Për caktim gjyqtari për gjykimin e rasteve urgjente" (shkresa nr. 322 prot., datë 23.10.2024), ku në kushtet e caktimit rishtazi (ngritje në detyrë) të gjyqtarit Anila Karanxha me vendimin e KLGJ-së nr. 591 datë 09.10.2024, është përditësuar vendimi nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", për vitin 2024, duke u caktuar për gjykimin e rasteve urgjente dhe gjyqtari Anila Karanxha^[57], e cila do të gjykojë së bashku me gjyqtarët Fuat Vjerdha dhe Qemal Zaimi;

i) urdhër i brendshëm "Për rishortim çështje penale" (shkresa nr. 375 prot., datë 13.12.2024), ku sipas të cilit zv/kryetarja e gjykatës, pasi ka konstatuar se janë regjistruar 12 masa sigurimi dhe se këto çështje u kanë kaluar për shqyrtim gjyqësor gjyqtarëve F.Islamaj, D.Hasani dhe I.Kacerja, në një kohë që duhet tu kalonin gjyqtarëve A.Kalaja, E.Mihali dhe A.Kolgjoka, që kanë qenë të gatshëm, sipas grafikut të gatishmërisë në referim të vendimit: "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente" (shkresa nr. 729 prot., datë 21.12.2023) i ndryshuar, dhe se kjo gjë ka ndodhur për shkak të gabimit, ku janë aktivizuar në sistem si gjyqtarë të gatshëm F.Islamaj, D.Hasani dhe I.Kacerja që të cilët kanë qenë gjyqtarë të gatshëm për periudhën 02.12.2024-08.12.2024, mbështetur në nenin 26, pika 2 dhe 37/b të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ka vendosur: "Të bëhet rishortim i çështjeve penale të regjistruara dhe hedhur në short në datën 13.12.2024, pranë gjyqtarëve F.Islamaj, D.Hasani dhe I.Kacerja, për gjyqtar relator tek gjyqtarët e gatshëm A. Kalaja, E.Mihali dhe A.Kolgjoka...etj."^[58].

[57] Nga zv/kryetarja e gjykatës është konstatuar se me vendimin nr. 301 prot., datë 06.10.2024 të marrë prej saj, është vendosur përditësimi i vendimit nr. 792 prot., datë 21.12.2023, "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", për vitin 2024, duke u caktuar edhe gjyqtare Enkela Vlora e caktuar rishtazi për periudhën 28.10.2024-03.11.2024 dhe duke ju shtuar gjyqtarëve Ukperaj Brikena, Vata Valbona, ndërkohë që për periudhën 04.11.2024-10.11.2024, kanë mbetur të gjykojnë vetëm dy gjyqtarë nga tre e konkretisht: Vjerdha Fuat dhe Zaimi Qemal. Duke u shtuar edhe gjyqtare Karanxha Anila edhe ky trup gjyqësor është bërë me tre gjyqtarë.

[58] Në datën 13.12.2024, 12 (dymbëdhjetë) çështjet penale që janë shortuar janë: -nr. (60610-07383-30-2024) 2942 akti, datë 13.12.2024 regjistrimi që i përket personit nën hetim Hermes Bollguri dhe i është shortuar gjyqtarit F.Islamaj, pas rishortimit të datës 13.12.2024, i ka rënë për gjykim gjyqtarës A.Kolgjoka; -nr. (61005-07389-30-2024) 2944 akti, datë 13.12.2024 regjistrimi që i përket personit nën hetim Mario Përlleshi dhe i është shortuar gjyqtarit D.Hasani, pas rishortimit të datës 13.12.2024, i ka rënë për gjykim gjyqtarës E.Mihali; -nr. (61005-07391-30-2024) 2902 akti, datë 13.12.2024 regjistrimi që i përket personit nën hetim Rahim Bajraktari dhe i është shortuar gjyqtarës I.Kacerja, pas rishortimit të datës 13.12.2024, i ka rënë për gjykim gjyqtarit A.Kalaja; -nr. (61005-07393-30-2024) 2946 akti, datë 13.12.2024 regjistrimi që i përket personit nën hetim Artur Farruku dhe i është shortuar gjyqtarit D.Hasani, pas rishortimit të datës 13.12.2024, i ka rënë për gjykim gjyqtarit A.Kalaja; -nr. (60610-07396-30-2024) 2947 akti, datë 13.12.2024 regjistrimi që i përket personit nën hetim Pellumb Hysko dhe i është shortuar gjyqtarës I.Kacerja, pas rishortimit të datës 13.12.2024, i ka rënë për gjykim gjyqtarës E.Mihali; -nr. (61005-07400-30-2024) 2951 akti, datë 13.12.2024 regjistrimi që i përket personit nën hetim Bexhet Sinani dhe i është shortuar gjyqtarit F.Islamaj, pas rishortimit të datës 13.12.2024, i ka rënë për gjykim gjyqtarës E.Mihali; -nr. (61005-07401-30-2024) 2952 akti, datë 13.12.2024 regjistrimi që i përket personit nën hetim Drilon Sadiku dhe i është shortuar gjyqtarës I.Kacerja, pas rishortimit të datës 13.12.2024, i ka rënë për gjykim gjyqtarës A.Kolgjoka; -nr. (61005-07402-30-2024) 2953 akti, datë 13.12.2024 regjistrimi që i përket personit nën hetim Fatos Çifliku dhe i është shortuar gjyqtarit F.Islamaj, pas rishortimit të datës 13.12.2024, i ka rënë për gjykim gjyqtarit A.Kalaja; -nr. (61005-07403-30-2024) 2954 akti, datë 13.12.2024 regjistrimi që i përket personit nën hetim Elton Kastrioti dhe i është shortuar gjyqtarit D.Hasani, pas rishortimit të datës 13.12.2024, i ka rënë për gjykim gjyqtarës A.Kolgjoka; -nr. (61005-07404-30-2024) 2955 akti, datë 13.12.2024 regjistrimi që i përket personit nën hetim Armand Korça dhe i është shortuar gjyqtarës I.Kacerja, pas rishortimit të datës 13.12.2024, i ka rënë për gjykim gjyqtarit A.Kalaja; -nr. (61008-07405-30-2024) 2956 akti, datë 13.12.2024 regjistrimi që i përket personit nën hetim Toni Philippe

j) vendim "Për zëvendësim dhe caktim gjyqtari për gjykimin e rasteve urgjente" (shkresa nr. 381 prot., datë 16.12.2024), sipas të cilit rezulton se gjyqtarja znj. Edlira Petri, me kërkesën e datës 13.12.2024, drejtuar zv/kryetarës znj. Valdete Hoxha, për arsye familjare e ka në pamundësi objektive të kryejë gatishmërinë në datat 16 dhjetor deri 22 dhjetor 2024 dhe ka kërkuar brenda mundësive, që këtë gatishmëri ta kryejë një javë më vonë pra në datat 23 dhjetor deri 29 dhjetor 2024 dhe të zëvendësohet nga gjyqtari pasues në grafikun e gatishmërisë z. Sokol Pina. Në kërkesë ndër të tjera, kjo gjyqtare shprehet se gjyqtar Sokol Pina, i cili është i gatshëm në ato data, ka shprehur mirëkuptimin dhe pëlqimin e tij që të ndërrojë javën e gatishmërisë me kërkuuesen. Për arsyet e sipërcituara zv/kryetarja e gjykatës bazuar në nenin 37 shkronja "b" të ligjit nr. 98/2016, ka vendosur: "...1. Përditësimin e vendimit nr. 729 prot., dt. 21.12.2023, "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", përditësuar me vendimin nr. 322, datë 23.10.2024, duke zëvendësuar gjyqtaren Edlira Petri, në listën e gatishmërisë për periudhën 16 dhjetor deri 22 dhjetor 2024, me gjyqtarin pasues z. Sokol Pina. 2. Gjyqtarja Edlira Petri do të përmbushë funksionin si gjyqtar i gatshëm në periudhën 23-29 dhjetor 2024, duke zëvendësuar gjyqtarin Sokol Pina...etj".

k) vendim "Për zëvendësim dhe caktim gjyqtari për gjykimin e rasteve urgjente" (shkresa nr. 376/1 prot., datë 24.12.2024), sipas të cilit bëhet e qartë fakti se për periudhën 23 - 29 dhjetor 2024, në grafikun e gatishmërisë janë planifikuar të shqyrtojnë çështjet e karakterit urgjent gjyqtarët znj. Edlira Petri, z. Genti Shala dhe znj. Elona Toro. Në datën 24.12.2024 në këtë gjykata është regjistruar çështja nr. 877 akti material sekret me palë Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe kjo çështje i ka në në short gjyqtarës znj. E. Petri. Në kushtet kur gjyqtarja znj. Edlira Petri ka bërë kërkesë për marrje leje tre ditë, e cila i është miratuar me urdhërin nr. 376 datë 13.12.2024, dhe çështja duhet të gjykohet brenda 48 orëve, duhet të bëhet bërë zëvendësimi i kësaj gjyqtarje. Për arsyet e sipërcituara zv/kryetarja e gjykatës bazuar në nenin 37 shkronja "b" të ligjit nr. 98/2016, ka vendosur: "...Çështja me karakter të ngutshëm nr. 877 akti material sekret datë rregjistrimi 24.12.2024, me palë Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ti kalojë^[59] për shqyrtim gjyqtarës së gatshme znj. E. Toro ...etj".

l) vendim "Për caktim gjyqtari për gjykimin e rasteve urgjente" (shkresa nr. 409 prot., datë 31.12.2024), kur në kushtet ku vendimi nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", për vitin 2024, (vendim i cili është përditësuar, së fundi me vendimin nr. 322 prot., datë 23.10.2024), ka përcaktuar se gjyqtarët janë të gatshëm për një periudhë një javore dhe sipas këtij vendimi, çështjet që

Borrallho dhe i është shortuar gjyqtarit D. Hasani, pas rishortimit të datës 13.12.2024, i ka rënë për gjykim gjyqtarit A. Kalaja; dhe -or. (61005-07406-30-2024) 2957 akti, datë 13.12.2024 regjistrimi që i përket personit nën hetim Enes Molla dhe i është shortuar gjyqtarit F. Islamaj, pas rishortimit të datës 13.12.2024, i ka rënë për gjykim gjyqtarit A. Kalaja.
^[59] Nga zv/kryetarja e gjykatës në këtë rast nuk është zbatuar kërkesa e specifikuar prej saj në vendimin nr. 729 prot., dt. 21.12.2023, "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", përditësuar me vendimin nr. 322, datë 23.10.2024, pasi trajtimi i çështjes duhet të hidhet në short ndërmjet gjyqtarëve z. G. Shala dhe znj. E. Toro. Shif për këtë tek vendimi nr. 729 prot datë 21.12.2023 pjesën e shënimeve ku thuhet: "...Shënime: gj. Përgjithshëm nëse njëri nga gjyqtarët e gatshëm është në pamundësi objektive për ushtrimin e funksionit në periudhën përkatëse, me urdhër të kryetarit çështjet hidhen në short tek gjyqtarët e tjerë që kanë javën e gatishmërisë...etj".

regjistrohen për periudhën 30 dhjetor - 31 dhjetor 2024 (që përfundon viti kalendarik 2024) do të gjykohen nga gjyqtarët Brikena Ukperaj, Valbona Vata dhe Enkela Vlora, zv/kryetari i gjykatës, bazuar në nenin 37 të ligjit nr. 98/2016, dhe vendimin nr. 554, datë 29.12.2022 të KLGJ-së, ka vendosur që për periudhën nga data 30 dhjetor 2024 deri në datën 05.01.2025, çështjet e gatishmërisë dhe të karakterit urgjent, do të gjykohen nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (sipas rendit alfabetik me bazë shkronjën e parë të mbiemrit) si më poshtë vijon: -Gjyqtarët Ukperaj Brikena, Vata Valbona dhe Vlora Enkela;

V. Në tabelën me të dhëna për plotësim nga gjykata në kuadër të temës së inspektimit për procedurat e shorti në gjykata (çështjet e karakterit urgjent), periudha 01.01.2024-31.12.2024, rezulton se janë trajtuar **3085** çështje të karakterit urgjent, për të cilat në kohën e paraqitjes për regjistrim, në disa raste është zbatuar grafiku i gatishmërisë; në disa raste çështjet u kanë kaluar çështjet gjyqtarëve që kanë kryer më parë veprime për to; dhe, në disa raste çështjet u kanë kaluar për gjykim gjyqtarëve që kanë në gjykim çështjen e themelit.

Referuar shënimeve që janë vendosur në RIV, jo në të gjithë rastet rezulton se arsyet e kalimit janë të qarta, pasi kryesekretari apo sekretarja regjistruese, nuk vendosin numrin elektronik të çështjes, aktit, datës së regjistrimit, nr. e vendimit dhe datën që është marrë vendimi apo të dhënat që kanë të bëjnë me çështjen e themelit, duke bërë të vështirë procesin e inspektimit dhe të vetë punës së tyre, kur gjykata e ka të domosdoshme të bëjë veprime me dosjet gjyqësore, në lidhje me caktimin e gjyqtarit (qoftë atij me short, qoftë atij që përjashtohet, dhe qoftë atij që duhet të kalojë çështja për veprim).

Nga analizimi i të dhënave të dërguara nga gjykata dhe për të cilat nuk korrespondonte gjyqtari i gjykimit të masës së sigurimit me gjyqtarin e listës së gadishmërisë ka rezultuar kjo mospërputhje ka ndodhur për shkak të konsideruara të ligjshme dhe konkretisht për shkak se dosja i ka kaluar: (i) gjyqtarit që ka në gjykim çështjen e themelit; (ii) gjyqtarit që ka gjykuar më parë çështjen e themelit apo ka dhënë më herët masa sigurimi; (iii) gabimisht është rishortuar çështja ndërsa ajo është gjykuar nga gjyqtari i gadishmërisë; (iv) për shkak të pamundësisë nga ana shëndetësore të gjyqtarit të gadishmërisë është gjykuar nga një gjyqtar tjetër.

Problematika gjatë gjykimit të këtyre çështjeve u konstatua në rastet e mëposhtme:

a) Me urdhërin e brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. ska prot., datë 31.01.2024), zv/kryetarja, pasi ka konstatuar se në datën 31.01.2024, janë regjistruar 3 (tre) çështje^[60] me afat të ngutshëm dhe u kanë rënë gjyqtarëve E.Mihali, A.Kolgjoka dhe

[60] Nga verifikimi i të dhënave në sistem rezulton se çështja penale me nr. (61005-00629-30-2024) 288 akti datë 31.01.2024 regjistrimi, me kërkuar: Gerald Bushi, me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal", rezulton se në short si gjyqtar relator i ka rënë për gjykim gjyqtarës E.Mihali, çështja penale me nr. (60610-00630-30-2024) 289 akti datë 31.01.2024 regjistrimi, me kërkuar: Kevin Vila, me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal", rezulton se në short si gjyqtar relator i ka rënë për gjykim gjyqtarës A.Kolgjoka, dhe çështja penale me nr. (61005-00639-30-2024) 292 akti datë 31.01.2024 regjistrimi, me kërkuar: Lirim Arifaj, me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal", rezulton se në short si gjyqtar relator i ka rënë për gjykim gjyqtarës L.Celami.

L.Celami, ku referuar javës së gatishmërisë nga data 29 janar - 4 shkurt 2024 gjyqtarë të gatshëm janë A.Kolgjoka, E.Mihali dhe O.Naqellari dhe gabimisht nga ana e specialistit të IT-së në vend të O.Naqellarit është aktivizuar si gjyqtare e gatshme L.Celami, për një ndarje të barabartë të çështjeve, masa e sigurimit me nr. (61005-00639-30-2024) 292 akti, datë 31.01.2024 me kërkuar: Lirim Arifaj me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal" që i ka rënë në short gjyqtarës L.Celami, kjo e fundit të zëvendësohet me gjyqtaren O.Naqellari.

Për këtë rast caktimi i gjyqtarës znj.O.Naqellari, nga zv/kryetarja e gjykatës me urdhër për kalim manualisht çështje, edhe pse kishte ndodhur situata e mësipërme, nuk është bërë në përputhje me rregullat e ndarjes në short të çështjeve, pasi ky rast duhet të trajtohej duke u hedhur çështja në short mes 3 (tre) gjyqtarëve A.Kolgjoka, E.Mihali dhe O.Naqellari, kjo edhe për faktin se nga data 01.02.2023 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ashtu siç e pranon vetë kjo gjykatë, edhe ndarja e çështjeve (masa sigurimi), me karakter të ngutshëm bëhet me short sipas listës së gatishmërisë^[61].

b) Me urdhërin e brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 94 prot., datë 05.03.2024), zv/kryetarja, pasi ka konstatuar se në datën 05.03.2024, janë regjistruar 3 (tre) çështje^[62] me afat të ngutshëm dhe u kanë rënë gjyqtarëve L.Celami, I.Bezati dhe M.Dervishi, ku referuar javës së gatishmërisë nga data 04 mars - 10 mars 2024 gjyqtarë të gatshëm janë I.Brahimi, L.Celami dhe M.Dervishi. Për një ndarje të barabartë të çështjeve, çështja penale me nr. (61005-01405-30-2024) 579 akti, datë 05.03.2024 me kërkuar: Fatmir Dema me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal"^[63] që i ka rënë në short gjyqtarës I.Bezati, ti kalohet manualisht gjyqtarës I.Brahimi, sipas vendimit të zv/kryetarës së gjykatës nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente".

Për këtë rast caktimi i gjyqtarës znj. I.Brahimi, nga zv/kryetarja e gjykatës me urdhër për kalim manualisht çështje, edhe pse kishte ndodhur situata e mësipërme, nuk është bërë në përputhje me rregullat e ndarjes në short të çështjeve, pasi ky rast duhet të trajtohej duke u hedhur çështja në short mes 3 (tre) gjyqtarëve I.Brahimi, L.Celami dhe M.Dervishi, kjo edhe për faktin se nga data 01.02.2023 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të

[61] Të dhënat janë nxjerrë nga "Raporti i i analizës vjetore të veprimtarisë së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024". (Shif faqen 82 të këtij raporti).

[62] Nga verifikimi i të dhënave në sistem rezulton se çështja penale me nr. (61005-01402-30-2024) 577 akti datë 05.03.2024 regjistrimi, me kërkuar: Klajdi Llaka, me objekt: "Vlefësimin si të ligjshëm të "arrestit në flagrancë" të personit nën hetim, ... Caktimin e masës së sigurimit personal "arrest në shtëpi", ", rezulton se në short si gjyqtar relator i ka rënë për gjykim gjyqtarës L.Celami, çështja penale me nr. (61005-01405-30-2024) 579 akti datë 05.03.2024 regjistrimi, me kërkuar: Fatmir Dema, me objekt: "Vlefësimin si të ligjshëm të "arrestit në flagrancë" të personit nën hetim, ... Caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal "arrest në burg", ", rezulton se në short si gjyqtar relator i ka rënë për gjykim gjyqtarës I.Bezati, dhe çështja penale me nr. (61005-01406-30-2024) 580 akti datë 05.03.2024 regjistrimi, me kërkuar: Denald Topi, me objekt: "Vlefësimin si të ligjshëm të "arrestit në flagrancë" të personit nën hetim, ... Caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal "arrest në burg", ", rezulton se në short si gjyqtar relator i ka rënë për gjykim gjyqtarës M.Dervishi.

[63] Objekti i çështjes penale nga zv/kryetarja e gjykatës në urdhërin e brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 94 prot., datë 05.03.2024), është hedhur gabim, pasi ka të bëjë me: "Vlefësimin si të ligjshëm të "arrestit në flagrancë" të personit nën hetim, ... Caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal "arrest në burg", ",

Përgjithshëm, ashtu siç e pranon vetë kjo gjykatë, edhe ndarja e çështjeve (*masa sigurimi*), me karakter të ngutshëm bëhet me short sipas listës së gatishmërisë^[64].

- c) Me datë 18.03.2024, është regjistruar kërkesa penale nr. (61010-01662-30-2024) 666 akti, me kërkuar: Fabion Çeka, me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal "arrest ne burg", e cila po në datën 18.03.2024, i është shortuar gjyqtarës E.Petri^[65]. Në datën 18.03.2024 kjo çështje i është kaluar gjyqtarës D.Goxha me shënimin: "...Arsyeja e Ndryshimit: [Dosja do i kalojë gjyqtarës D.Goxha që ka në gjykim çështjen e themelit.]...etj". Çështja e themelit nr. (53101-00578-30-2024), datë 29.01.2024, fillimisht i ka rënë gjyqtarës B.Ukperaj, ku referuar RIV me datë 12.03.2024 është planifikuar për gjykim nga kjo e fundit me datë 11.04.2024 dhe pastaj është shortuar gabim tek D.Goxha me datë 13.03.2024 me shënimin: "...Arsyeja e Ndryshimit: [Në bazë të vendimit nr.8 dt.26.02.2024 të Këshillit të Gjykatës.]...etj.", dhe me datë 16.04.2024 GMÇ ka ndryshuar, Gjyqtari i Vjetër: [dgoxha], Gjyqtari i Ri: [bukperaj], me shënimin: "...Arsyeja e Ndryshimit: [Dosja është rishortuar gabimisht pasi është çështje me të mitur dhe sipas vendimit të keshillit gjykatës kalon tek gjyqtari që kishte dosjen Brikena Ukperaj.]...etj".

Për këtë rast nuk janë ndjekur rregullat e ndarjes së çështjeve me short për gjyqtarët E.Petri; D.Goxha dhe B.Ukperaj, sa i përket Vendimit nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", për vitin 2024; Vendimit nr.8, datë 26.02.2024 "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore" (*shkresa nr. 85 prot., datë 26.02.2024*).

d) Me urdhërin e brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (*shkresa nr. 141 prot., datë 12.04.2024*), zv/kryetarja, mbi bazën e njoftimit të gjyqtarit z.Fatri Islamaj [në cilësinë e relatorit së çështjes së themelit nr.(50555-00469-30-2024)299 akti datë 25.01.2024], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtari Fatri Islamaj, i cili është në kushtet e pamundësisë objektive (*arsye familjare, lindje fëmijë nga bashkëshortja*) për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr. 885 regjistrimi datë 11.04.2024 me kërkuar: Lulzim Subashi me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtarë në përbërje të trupit gjykues janë gjyqtarët Edlira Petri dhe Marsela Pepi. Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarit Fatri Islamaj, do të bëhet me një anëtar të trupit gjykues, të kolegjit penal^[66].

Për këtë rast caktimi i gjyqtarës znj. E.Petri, nga zv/kryetarja e gjykatës me urdhër për kalim manualisht çështje, edhe pse kishte ndodhur situata e mësipërme, nuk është bërë në përputhje me rregullat e ndarjes në short të çështjeve, pasi ky rast duhet të trajtohej duke u hedhur çështja në short mes 2 (dy) gjyqtarëve E.Petri dhe M.Pepi, kjo edhe për faktin se nga data 01.02.2023 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ashtu siç e pranon vetë kjo gjykatë, edhe ndarja e çështjeve (*masa sigurimi*), me karakter të ngutshëm

^[64] Të dhënat janë nxjerrë nga "Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024", (*Shifrapen 82 të këtij raporti*).

^[65] Nuk jepen arsye pse i ka kaluar gjyqtarës E. Petri, e cila nuk ka qenë e gatshme sipas grafikut të gatishmërisë për periudhën 18.03.2024 deri 24.03.2024, referuar Vendimit nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", për vitin 2024.

^[66] Nga verifikimi i dosjes nr. (61010-02261-30-2024) 885 akti datë 11.04.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues është caktuar gjyqtar Q.Zaimi pas hedhjes së shortit....etj.

bëhet me short sipas listës së gatishmërisë^[67] si dhe duhet të zbatohet vendimi nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", për vitin 2024, ku në pjesën e shënimeve ndër të tjera thuhet se: ".....**Shënim: a).** Përfshitimisht nëse njëri nga gjyqtarët e gatshëm është në pamundësi objektive për ushtrimin e funksionit në periudhën përkatëse, me urdhër të kryetarit çështjet hidhen në short tek gjyqtarët e tjerë që kanë javën e gatishmërisë...etj".

e) Me urdhërin e brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 1598 akti., datë 03.07.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e njoftimit të gjyqtarit z.Fatri Islamaj [në cilësinë e relatorit të çështjes së themelit nr.(50506-03967-30-2024) 2571 akti datë 25.06.2024], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtar Fatri Islamaj, i cili është në kushtet e pamundësisë objektive (për arsye personale) për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr.1598 regjistrimi datë 03.07.2024 me kërkesë: Behar Sokoli me objekt:"Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtar në përbërje të trupit gjykues, janë gjyqtarët Edlira Petri dhe Marsela Pepi. Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarit Fatri Islamaj, do të bëhet me gjyqtaren znj.Edlira Petri në cilësinë e gjyqtarit relator, ndërsa plotësimi i trupës gjyqësore do të bëhet me një anëtar të trupit gjykues, të seksionit penal^[68].

Për këtë rast caktimi i gjyqtarës znj. E.Petri, nga zv/kryetarja e gjykatës me urdhër për kalim manualisht çështje, edhe pse kishte ndodhur situata e mësipërme, nuk është bërë në përputhje me rregullat e ndarjes në short të çështjeve, pasi ky rast duhet të trajtohet duke u hedhur çështja në short mes 2 (dy) gjyqtarëve E.Petri dhe M.Pepi, kjo edhe për faktin se nga data 01.02.2023 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ashtu siç e pranon vetë kjo gjykatë, edhe ndarja e çështjeve (masa sigurimi), me karakter të ngutshëm bëhet me short sipas listës së gatishmërisë^[69] si dhe duhet të zbatohet vendimi nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", për vitin 2024, ku në pjesën e shënimeve ndër të tjera thuhet se: ".....**Shënim: a).** Përfshitimisht nëse njëri nga gjyqtarët e gatshëm është në pamundësi objektive për ushtrimin e funksionit në periudhën përkatëse, me urdhër të kryetarit çështjet hidhen në short tek gjyqtarët e tjerë që kanë javën e gatishmërisë...etj".

Gjithashtu edhe për anëtarin e tretë që është caktuar gjyqtarja D.Goxha, nuk jepet mënyra dhe procedura e provuar me akt të arsyetuar, se me ç'farë lloji shorti u caktua kjo gjyqtare në këtë çështje.

f) Me urdhërin e brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr.1776 akti., datë 26.07.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e kërkesës së gjyqtarit z.Genti Shala [në cilësinë e relatorit të çështjes së themelit nr. (71113-02867-30-2024) 1862 akti datë 13.05.2024], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtar Genti Shala, i cili është në kushtet e pamundësisë objektive, për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr. 1776

^[67] Të dhënat janë nxjerrë nga "Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024". (Shif faqen 82 të këtij raporti).

^[68] Nga verifikimi i dosjes nr. (61010-04193-30-2024) 1598 akti datë 03.07.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues është caktuar gjyqtare D.Goxha (nuk jepet mënyra dhe procedura e provuar me akt të arsyetuar, se me ç'farë lloji shorti u caktua kjo gjyqtare në këtë çështje).

^[69] Të dhënat janë nxjerrë nga "Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024". (Shif faqen 82 të këtij raporti).

regjistrimi datë 25.07.2024 me kërkesë: Urim Zyberaj me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtarë në përbërje të trupit gjykues janë gjyqtarët Brikena Ukperaj dhe Dritan Hasani. Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarit Genti Shala të bëhet me gjyqtarin Dritan Hasani si relator, ndërsa anëtar i tjetër i trupës gjykuese do të bëhet me një anëtar të trupit gjykues, të seksionit penal^[70].

Për këtë rast caktimi i gjyqtarit z. D.Hasani, nga zv/kryetarja e gjykatës me urdhër për kalim manualisht çështje, edhe pse kishte ndodhur situata e mësipërme, nuk është bërë në përputhje me rregullat e ndarjes në short të çështjeve, pasi ky rast duhet të trajtohej duke u hedhur çështja në short mes 2 (dy) gjyqtarëve D.Hasani dhe B.Ukperaj, kjo edhe për faktin se nga data 01.02.2023 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ashtu siç e pranon vetë kjo gjykatë, edhe ndarja e çështjeve (*masa sigurimi*), me karakter të ngutshëm bëhet me short sipas listës së gatishmërisë^[71] si dhe duhet të zbatohet vendimi nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", për vitin 2024, ku në pjesën e shënimeve ndër të tjera thuhet se: ".....**Shënim: a). Përjashtimisht nëse njëri nga gjyqtarët e gatshëm është në pamundësi objektive për ushtrimin e funksionit në periudhën përkatëse, me urdhër të kryetarit çështjet hidhen në short tek gjyqtarët e tjerë që kanë javën e gatishmërisë...etj.**".

Gjithashtu edhe për anëtarin e tretë që është caktuar gjyqtarja D.Goxha, nuk jepet mënyra dhe procedura e provuar me akt të arsyetuar, se me ç'farë lloji shorti u caktua kjo gjyqtare në këtë çështje.

g) Me urdhërin e brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (*shkresa nr.1802 akti., datë 30.07.2024*), zv/kryetarja, mbi bazën e kërkesës së gjyqtarit z.Genti Shala [*në cilësinë e relatorit të çështjes së themelit nr.(50506-04694-30-2024)3055 akti datë 26.07.2024*], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtar Genti Shala, i cili është në kushtet e pamundësisë objektive për arsye familjare, për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr.1802 regjistrimi datë 30.07.2024 me kërkesë:Qamil Farruku me objekt:"Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtarë në përbërje të trupit gjykues janë gjyqtarët Brikena Ukperaj dhe Dritan Hasani. Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarit Genti Shala të bëhet me gjyqtarin Dritan Hasani si relator, ndërsa anëtar i tjetër i trupës gjykuese do të bëhet me një anëtar të trupit gjykues, të seksionit penal^[72].

Për këtë rast caktimi i gjyqtarit z. D.Hasani, nga zv/kryetarja e gjykatës me urdhër për kalim manualisht çështje, edhe pse kishte ndodhur situata e mësipërme, nuk është bërë në përputhje me rregullat e ndarjes në short të çështjeve, pasi ky rast duhet të trajtohej duke u hedhur çështja në short mes 2 (dy) gjyqtarëve D.Hasani dhe B.Ukperaj, kjo edhe për faktin se nga data 01.02.2023 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ashtu siç e pranon vetë kjo gjykatë, edhe ndarja e çështjeve (*masa sigurimi*), me karakter të ngutshëm

^[70] Nga verifikimi i dosjes nr. (61010-04675-30-2024) 1776 akti datë 25.07.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues është caktuar gjyqtare D.Goxhaj (nuk jepet mënyra dhe procedura e provuar me akt të arsyetuar, se me ç'farë lloji shorti u caktua ky gjyqtar në këtë çështje).

^[71] Të dhënat janë nxjerrë nga "Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024", (*Shif fagen 82 të këtij raporti*).

^[72] Nga verifikimi i dosjes nr. (61010-04749-30-2024) 1802 akti datë 30.07.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues është caktuar gjyqtare L.Colami (nuk jepet mënyra dhe procedura e provuar me akt të arsyetuar, se me ç'farë lloji shorti u caktua ky gjyqtar në këtë çështje).

bëhet me short sipas listës së gatishmërisë^[73] si dhe duhet të zbatohet vendimi nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", për vitin 2024, ku në pjesën e shënimeve ndër të tjera thuhet se: ".....**Shënim:** a) Përfjashtimisht nëse njëri nga gjyqtarët e gatshëm është në pamundësi objektive për ushtrimin e funksionit në periudhën përkatëse, me urdhër të kryetarit çështjet hidhen në short tek gjyqtarët e tjerë që kanë javën e gatishmërisë...etj".

Gjithashtu edhe për anëtarin e tretë që është caktuar gjyqtarja L.Celami, nuk jepet mënyra dhe procedura e provuar me akt të arsyetuar, se me ç'farë lloji shorti u caktua kjo gjyqtare në këtë çështje.

h) Me urdhërin e brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 270 prot., datë 17.09.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e njoftimit të gjyqtarit z.Fuat Vjerdha [në cilësinë e relatorit të çështjes së themelit nr. (57260-05359-30-2024) 3337 akti datë 12.09.2024], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtar Fuat Vjerdha, i cili është në kushtet e pamundësisë objektive për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr. 2193 regjistrimi datë 16.09.2024 me kërkesë: Gentjan Liçi me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtar në përbërje të trupit gjykues, janë gjyqtarët Irena Brahimi dhe Genti Dokollari. Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarit Fuat Vjerdha, do të bëhet me një anëtar të trupit gjykues, të seksionit penal^[74].

Për këtë rast caktimi i gjyqtarës znj.I.Brahimi, nga zv/kryetarja e gjykatës me urdhër për kalim manualisht çështje, edhe pse kishte ndodhur situata e mësipërme, nuk është bërë në përputhje me rregullat e ndarjes në short të çështjeve, pasi ky rast duhet të trajtohet duke u hedhur çështja në short mes 2 (dy) gjyqtarëve I.Brahimi dhe G.Dokollari, kjo edhe për faktin se nga data 01.02.2023 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ashtu siç e pranon vetë kjo gjykatë, edhe ndarja e çështjeve (masa sigurimi), me karakter të ngutshëm bëhet me short sipas listës së gatishmërisë^[75] si dhe duhet të zbatohet vendimi nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", për vitin 2024, ku në pjesën e shënimeve ndër të tjera thuhet se: ".....**Shënim:** a) Përfjashtimisht nëse njëri nga gjyqtarët e gatshëm është në pamundësi objektive për ushtrimin e funksionit në periudhën përkatëse, me urdhër të kryetarit çështjet hidhen në short tek gjyqtarët e tjerë që kanë javën e gatishmërisë...etj".

i) Me urdhërin e brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 350 prot., datë 11.11.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e kërkesës së gjyqtarës znj.Brikena Ukperaj [në cilësinë e relatorit të çështjes së themelit nr. (56180-06235-30-2024) 3918 akti datë 17.10.2024], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtare Brikena

^[73] Të dhënat janë nxjerrë nga "Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024". (Shif faqen 82 të këtij raporti).

^[74] Nga verifikimi i dosjes nr. (61010-05425-30-2024) 2193 akti datë 16.09.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues janë caktuar gjyqtarët M.Andoni dhe Q.Zaimi (me short manual për të cilin është mbajtur procesverbal nr. 270/1 prot. datë 18.09.2024). Për shkakun pse nuk ka gjykuar gjyqtari G.Dokollari, kur në përbërje të trupit gjykues, kanë qenë edhe ai dhe duhet të caktohet vetëm një gjyqtar nga dy, justifikimi për mos marrjen pjesë gjën pasqyrim në procesverbalin e mësipërm. (shif për këtë më hollësisht edhe rubrikën e këtij raporti) "6. Zëvendësimi i anëtarit të trupit gjykues dhe plotësimi me anëtar të trupit gjykues".

^[75] Të dhënat janë nxjerrë nga "Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024". (Shif faqen 82 të këtij raporti).

Ukperaj, e cila është në kushtet e pamundësisë objektive (për arsye se nuk ndodhet në gjykatë për periudhën nga data 11 nëntor 2024-14.11.2024 dhe merr pjesë në Konferencën Ndërkombëtare me temë "Rritja e besimit në sistemin gjyqësor organizuar nga IACA dhe që do të zhvillohet në Singapor) për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr. 2680 regjistrimi datë 11.11.2024 me kërkesë: Albert Muja me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtarë në përbërje të trupit gjykues janë gjyqtarët Genti Shala dhe Dritan Hasani. Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarës Brikena Ukperaj, bëhet me gjyqtarin Dritan Hasani si relator, ndërsa anëtar i tjetër i trupës gjykuese do të bëhet me një anëtar të trupit gjykues, të seksionit penal^[76].

Për këtë rast caktimi i gjyqtarit z. D.Hasani, nga zv/kryetarja e gjykatës me urdhër për kalim manualisht çështje, edhe pse kishte ndodhur situata e mësipërme, nuk është bërë në përputhje me rregullat e ndarjes në short të çështjeve, pasi ky rast duhet të trajtohej duke u hedhur çështja në short mes 2 (dy) gjyqtarëve D.Hasani dhe G.Shala, kjo edhe për faktin se nga data 01.02.2023 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ashtu siç e pranon vetë kjo gjykatë, edhe ndarja e çështjeve (masa sigurimi), me karakter të ngutshëm bëhet me short sipas listës së gatishmërisë^[77] si dhe duhet të zbatohet vendimi nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", për vitin 2024, ku në pjesën e shënimeve ndër të tjera thuhet se: ".....**Shënim: a).** Përfashtimisht nëse njëri nga gjyqtarët e gatshëm është në pamundësi objektive për ushtrimin e funksionit në periudhën përkatëse, me urdhër të kryetarit çështjet hidhen në short tek gjyqtarët e tjerë që kanë javën e gatishmërisë...etj".

j) Me urdhërin e brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 370 prot., datë 06.12.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e kërkesës së gjyqtarit z.Dritan Hasani, për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtar Dritan Hasani, i cili është në kushtet e pamundësisë objektive (për arsye se ka njoftuar zv/kryetarën se për arsye familjare nuk mund të paraqitet në punë pasi bashkëshortja ndodhet në spital për lindje fëmije) për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr. 2888 regjistrimi datë 04.12.2024 me kërkesë: Orger Gjyrgji me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtarë në përbërje të trupit gjykues janë gjyqtarët Genti Shala dhe Diamela Goxha. Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarit Dritan Hasani, bëhet me gjyqtarën Diamela Goxha si relator^[78].

Për këtë rast caktimi i gjyqtarës znj. D.Goxha, nga zv/kryetarja e gjykatës me urdhër për kalim manualisht çështje, edhe pse kishte ndodhur situata e mësipërme, nuk është bërë në përputhje me rregullat e ndarjes në short të çështjeve, pasi ky rast duhet të trajtohej duke u

^[76] Nga verifikimi i dosjes nr. (61010-06720-30-2024) 2680 akti datë 11.11.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues është caktuar gjyqtar Q.Zaimi (me short manual për të cilin është mbajtur procesverbal nr. 350/1 prot. datë 13.11.2024). (shif për këtë më hollësisht edhe rubrikën e këtij raporti "6. Zëvendësimi i anëtarit të trupit gjykues dhe plotësimi me anëtar i trupit gjykues").

^[77] Te dhënat janë nxjerrë nga "Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024". (Shif faqen 82 të këtij raporti).

^[78] Nga verifikimi i dosjes nr. (61010-07201-30-2024) 2888 akti datë 04.12.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues janë caktuar gjyqtarët Q. Zaimi (me short manual për të cilin është mbajtur procesverbal nr. 369 prot. datë 02.12.2024). (shif për këtë më hollësisht edhe rubrikën e këtij raporti "6. Zëvendësimi i anëtarit të trupit gjykues dhe plotësimi me anëtar i trupit gjykues"), dhe gjyqtare M.Andoni (me short manual për të cilin është mbajtur procesverbal nr. 370/1 prot. datë 06.12.2024). (shif për këtë më hollësisht edhe rubrikën e këtij raporti "6. Zëvendësimi i anëtarit të trupit gjykues dhe plotësimi me anëtar i trupit gjykues").

hedhur çështja në short mes 2 (dy) gjyqtarëve D.Goxha dhe G.Shala, kjo edhe për faktin se nga data 01.02.2023 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ashtu siç e pranon vetë kjo gjykatë, edhe ndarja e çështjeve (*masa sigurimi*), me karakter të ngutshëm bëhet me short sipas listës së gatishmërisë^[79] si dhe duhet të zbatohet vendimi nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", për vitin 2024, ku në pjesën e shënimeve ndër të tjera thuhet se: ".....**Shënim: a).** Përjashtimisht nëse njëri nga gjyqtarët e gatshëm është në pamundësi objektive për ushtrimin e funksionit në periudhën përkatëse, me urdhër të kryetarit çështjet hidhen në short tek gjyqtarët e tjerë që kanë javën e gatishmërisë...etj".

k) Me urdhërin e brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (*shkresa nr. 371 prot., datë 06.12.2024*), zv/kryetarja, mbi bazën e kërkesës së gjyqtarit z.Dritan Hasani [në cilësinë e relatorit të çështjes së themelit nr. (53813-06300-30-2024) 3959 akti datë 21.10.2024], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtar Dritan Hasani, i cili është në kushtet e pamundësisë objektive (*për arsye familjare nuk mund të paraqitet në punë*) për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr. 2900 regjistrimi datë 05.12.2024 me kërkesë: Orgest Asllani me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtarë në përbërje të trupit gjykues janë gjyqtarët Genti Shala [i cili është në kushtet e pamundësisë objektive, (*për arsye familjare nuk mund të paraqitet në punë*)] dhe Brikena Ukperaj [e cila është në kushtet e pamundësisë objektive, ndodhet jashtë shtetit në mbledhjen plenare të organizuar nga Këshilli i Europës (*Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë*) në Strasburg të Francës, në datat 04.12.2024 deri 06.12.2024]. Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarit Dritan Hasani, të zëvendësohet me një gjyqtar të seksionit penal dhe trupi gjykues të plotësohet me dy anëtar^[80].

Për këtë rast caktimi i gjyqtarës znj. D.Goxha, nga zv/kryetarja e gjykatës me urdhër për kalim manualisht çështje, edhe pse kishte ndodhur situata e mësipërme, nuk është bërë në përputhje me rregullat e ndarjes në short të çështjeve, pasi ky rast duhet të trajtohet duke u hedhur çështja në short mes 2 (dy) gjyqtarëve F.Islamaj dhe L.Kacerja, që ishin dhe gjyqtarë të gatshëm në periudhën 02.12.2024 deri 08.12.2024 kjo edhe për faktin se nga data 01.02.2023 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ashtu siç e pranon vetë kjo gjykatë, edhe ndarja e çështjeve (*masa sigurimi*), me karakter të ngutshëm bëhet me short sipas listës së gatishmërisë^[81] si dhe duhet të zbatohet vendimi nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", për vitin 2024, ku në pjesën e shënimeve ndër të tjera thuhet se: ".....**Shënim: a).** Përjashtimisht nëse njëri nga gjyqtarët e gatshëm është në pamundësi objektive për ushtrimin e funksionit në periudhën përkatëse, me urdhër të kryetarit çështjet hidhen në short tek gjyqtarët e tjerë që kanë javën e gatishmërisë...etj".

[79] Të dhënat janë nxjerrë nga "Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024", (*Shif fagen 82 të këtij raporti*).

[80] Nga verifikimi i dosjes nr. (61010-07245-30-2024) 2900 akti datë 05.12.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues është caktuar gjyqtare D.Goxha në vend të gjyqarit relator Dritan Hasani dhe dy anëtarët e tjerë janë caktuar dy gjyqtarët Q. Zaimi dhe M.Andoni (*me short manual për të cilin është mbajtur procedurë nr. 371/1 prot. datë 06.12.2024*). (*shif për këtë më hollësisht edhe rubrikën e këtij raporti "6. Zëvendësimi i anëtarit të trupit gjykues dhe plotësimi me anëtar i trupit gjykues"*).

[81] Të dhënat janë nxjerrë nga "Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024", (*Shif fagen 82 të këtij raporti*).

l) Me urdhërin e brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 390 prot., datë 20.12.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e njoftimit të gjyqtarit z.Fuat Vjerdha [në cilësinë e relatorit të çështjes së themelit nr. (50506-07101-30-2024) 4442 akti datë 02.12.2024], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtar Fuat Vjerdha, i cili është në kushtet e pamundësisë objektive (është me raport mjekësor) për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr. 3031 regjistrimi datë 20.12.2024 me kërkesë: Hajdar Zylali me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtar në përbërje të trupit gjykues, janë gjyqtarët Irena Brahimi dhe Genti Dokollari. Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarit Fuat Vjerdha, do të bëhet me gjyqtarin z.Genti Dokollari në cilësinë e gjyqtarit relator, ndërsa plotësimi i trupës gjyqësore do të bëhet me gjyqtarën znj. Brikena Ukperaj^[82].

Për këtë rast caktimi i gjyqtarit z. G.Dokollari, nga zv/kryetarja e gjykatës me urdhër për kalim manualisht çështje, edhe pse kishte ndodhur situata e mësipërme, nuk është bërë në përputhje me rregullat e ndarjes në short të çështjeve, pasi ky rast duhet të trajtohej duke u hedhur çështja në short mes 2 (dy) gjyqtarëve G.Dokollari dhe I.Brahimi, kjo edhe për faktin se nga data 01.02.2023 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ashtu siç e pranon vetë kjo gjykatë, edhe ndarja e çështjeve (masa sigurimi), me karakter të ngutshëm bëhet me short sipas listës së gatishmërisë^[83] si dhe duhet të zbatohet vendimi nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", për vitin 2024, ku në pjesën e shënimeve ndër të tjera thuhet se: ".....**Shënim:** a).Përfundimisht nëse njëri nga gjyqtarët e gatshëm është në pamundësi objektive për ushtrimin e funksionit në periudhën përkatëse, me urdhër të kryetarit çështjet hidhen në short tek gjyqtarët e tjerë që kanë javën e gatishmërisë...etj".

Gjithashtu edhe për anëtarin e tretë që është caktuar gjyqtarja B.Ukperaj, nuk është zbatuar procedura e shortit pasi është caktuar me akt manualisht nga zv/kryetarja e gjykatës me arsyen: "...për shkak të natyrës urgjente të çështjes në shqyrtim, afati 48 orë, duhet të kryhet zëvendësimi i gjyqtarit anëtar me një gjyqtar të seksionit penal...etj", në një kohë që rregullat e shortit janë të përcaktuara qartë se si veprohet në këto raste.

m) Me vendim "Për zëvendësim dhe caktim gjyqtari për gjykimin e rasteve urgjente" (shkresa nr. 381 prot., datë 16.12.2024), sipas të cilit rezulton se gjyqtarja znj.Edlira Petri, me kërkesën e datës 13.12.2024, drejtuar zv/kryetarës znj.Valdete Hoxha, për arsye familjare e ka në pamundësi objektive të kryejë gatishmërinë në datat 16 dhjetor deri 22 dhjetor 2024, ka kërkuar brenda mundësive, që këtë gatishmëri ta kryejë një javë më vonë pra në datat 23 dhjetor deri 29 dhjetor 2024 si dhe ka kërkuar që të zëvendësohet nga gjyqtari pasues në grafikun e gatishmërisë z. Sokol Pina. Në kërkesë ndër të tjera, kjo gjyqtare shprehet se gjyqtar Sokol Pina, i cili është i gatshëm në ato data, ka shprehur mirëkuptimin dhe pëlqimin e tij që të ndërrojnë javën e gatishmërisë me kërkuesen. Për

^[82] Nga verifikimi i dosjes nr. (61010-07557-30-2024) 3031 akti datë 20.12.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues është caktuar gjyqtare B.Ukperaj (në urdhër është përmendur arsyeja për shkak të natyrës urgjente të çështjes në shqyrtim, afati 48 orë, duhet të kryhet zëvendësimi i gjyqtarit anëtar me një gjyqtar të seksionit penal).

^[83] Të dhënat janë nxjerrë nga "Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024". (Shifra 82 të këtij raporti).

arsyet e sipërcituara zv/kryetarja e gjykatës bazuar në nenin 37 shkronja "b" të ligjit nr. 98/2016, ka vendosur: "...1.Përditësimin e vendimit nr. 729 prot.,dt.21.12.2023, "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", përditësuar me vendimin nr. 322, datë 23.10.2024, duke zëvendësuar gjyqtaren Edlira Petri, në listën e gatishmërisë për periudhën 16 dhjetor deri 22 dhjetor 2024, me gjyqtarin pasues z.Sokol Pina. 2.Gjyqtarja Edlira Petri do të përmbushë funksionin si gjyqtar i gatshëm në periudhën 23-29 dhjetor 2024, duke zëvendësuar gjyqtarin Sokol Pina...etj".

Edhe pse është lëshuar ky akt për çështjen me nr. (61020-07607-30-2024) 3051 akti datë 24.12.2024 regjistrimi, me kërkuar: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me objekt:"Material sekret", çështja i ka kaluar gjyqtarës E.Tora nga zv/kryetarja e gjykatës me urdhër për kalim manualisht, edhe pse kishte ndodhur situata e mësipërme, nuk është bërë në përputhje me rregullat e ndarjes në short të çështjeve, pasi ky rast duhet të trajtohej duke u hedhur çështja në short mes 2 (dy) gjyqtarëve E.Tora dhe G.Shala, që ishin dhe gjyqtarë të gatshëm në periudhën 23.12.2024 deri 29.12.2024 kjo edhe për faktin se nga data 01.02.2023 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ashtu siç e pranon vetë kjo gjykatë, edhe ndarja e çështjeve (masa sigurimi), me karakter të ngutshëm bëhet me short sipas listës së gatishmërisë^[84] si dhe duhet të zbatohet vendimi nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", për vitin 2024, ku në pjesën e shënimeve ndër të tjera thuhet se: "...Shënim: a).Përfashtimisht nëse njëri nga gjyqtarët e gatshëm është në pamundësi objektive për ushtrimin e funksionit në periudhën përkatëse, me urdhër të kryetarit çështjet hidhen në short tek gjyqtarët e tjerë që kanë javën e gatishmërisë...etj".

n) Me urdhërin e brendshëm"Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 403 prot., datë 30.12.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e kërkesës së gjyqtarit z.Genti Dokollari (në cilësinë e relatorit të çështjes së themelit nr. (50568-05300-30-2024) 3290 akti datë 11.09.2024), për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtar Genti Dokollari, i cili është në kushtet e pamundësisë objektive, për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr. 3118 regjistrimi datë 30.12.2024 me kërkuar: Alfred Dumi me objekt:"Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtarë në përbërje të trupit gjykues janë gjyqtarët Irena Brahimi (e cila është në kushtet e pamundësisë objektive për të marrë pjesë në gjykim, i është miratuar leja 6 ditë pune nga leja vjetore e pakryer e vitit 2024 për periudhën 23.12.2024 - 31.12.2024, me vendimin nr. 368 prot., datë 04.12.2024 të zv/kryetarit të gjykatës) dhe Fuat Vjerdha (i cili është në pamundësi fizike për tu paraqitur në punë, pasi është i sëmurë), Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarit Genti Dokollari, do të bëhet me gjyqtarën Diamela Goxha, ndërsa plotësimi i dy anëtarëve të trupit gjykues do të bëhet me gjyqtarët znj.Lutfije Celami dhe z. Qemal Zaimi^[85].

^[84] Të dhënat janë nxjerrë nga "Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024". (Shif fagen 82 të këtij raporti).

^[85] Nga verifikimi i dosjes nr. (61010-07712-30-2024) 3118 akti datë 30.12.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues është caktuar gjyqtare D.Goxha, në cilësinë e relatorës së çështjes, ndërsa gjyqtarët Lutfije Celami dhe Qemal Zaimi janë caktuar në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues (në urdhër është përmendur arsyeja për shkak të natyrës urgjente të çështjes në shqyrtim, afati 48 orë, duhet të kryhet zëvendësimi i gjyqtarit relator dhe plotësimi i dy anëtarëve të trupit gjykues me dy gjyqtarë të tjerë të seksionit penal).

Për këtë rast caktimi i gjyqtarës znj. D.Goxha, nga zv/kryetarja e gjykatës me urdhër për kalim manualisht çështje, edhe pse kishte ndodhur situata e mësipërme, nuk është bërë në përputhje me rregullat e ndarjes në short të çështjeve, pasi ky rast duhet të trajtohej duke u hedhur çështja në short mes 3 (tre) gjyqtarëve B.Ukperaj; V.Vata dhe E.Vlora, që ishin dhe gjyqtarë të gatshëm në periudhën 30.12.2024 deri 05.01.2025 kjo edhe për faktin se nga data 01.02.2023 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ashtu siç e pranon vetë kjo gjykatë, edhe ndarja e çështjeve (*masa sigurimi*), me karakter të ngutshëm bëhet me short sipas listës së gatishmërisë^[86] si dhe duhet të zbatohet vendimi nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", për vitin 2024, ku në pjesën e shënimeve ndër të tjera thuhet se: "**.....Shënim: a).** Përjashtimisht nëse njëri nga gjyqtarët e gatshëm është në pamundësi objektive për ushtrimin e funksionit në periudhën përkatëse, me urdhër të kryetarit çështjet hidhen në short tek gjyqtarët e tjerë që kanë javën e gatishmërisë...etj".

Gjithashtu edhe për anëtarin e dytë dhe të tretë që janë caktuar gjyqtarja L.Celami dhe Q.Zaimi, nuk është zbatuar procedura e shortit pasi janë caktuar me akt manualisht nga zv/kryetarja e gjykatës me arsyen: "*...për shkak të natyrës urgjente të çështjes në shqyrtim, afati 48 orë, duhet të kryhet zëvendësimi i gjyqtarit anëtar me dy gjyqtar të seksionit penal...etj*", në një kohë që rregullat e shortit janë të përcaktuara qartë se si veprohet në këto raste.

Vendimi nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", për vitin 2024 (*përditësuar me vendimet nr. 173 prot., datë 02.05.2024, shkresa nr. 301 prot., datë 08.10.2024, nr. 322 prot., datë 23.10.2024 dhe nr. 409 prot., datë 31.12.2024*) lëshuar nga zv/kryetari i gjykatës nuk plotëson standardet e kërkuara nga neni 37 shkronja b) dhe neni 2 shkronja c) i ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pasi nuk janë caktuar të gjithë gjyqtarët në short sipas rendit alfabetik, me bazë mbiemrin^[87], mbulon periudhat nga data 01.01.2024 - 25.02.2024, 06.05.2024 - 16.06.2024, 28.10.2024 - 10.11.2024, dhe nga data 30.12.2024 - 05.01.2025, por nuk mbulon periudhat nga data 26.02.2024 deri më 05.05.2024, 17.06.2024 deri më 28.07.2024, 02.09.2024 deri më 27.10.2024 dhe nga data 11.11.2024 deri më 29.12.2024 (*mungon lista e gjyqtarëve të gatishmërisë për këto 4 periudha*). Ky veprim bie ndesh me kërkesat që kërkohet të përmbushen, referuar nenit 37 "Kompetencat e kryetarit të gjykatës", shkronja b) të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në të cilin thuhet se: "*.....b) në fillim të çdo viti miraton një listë, e cila përditësohet kur është e nevojshme, që përcakton gjyqtarët për gjykimet e rasteve urgjente, siç përcaktohet me ligj, sipas rendit alfabetik me bazë mbiemrin, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor...etj*". Konstatohet se zv/kryetarja e gjykatës ka lëshuar 13 urdhëra të brendshëm dhe 1 (një) vendim, duke caktuar manualisht gjyqtarët, në rastin e gjykimeve të çështjeve të karakterit

^[86] Të dhënat janë nxjerrë nga "Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024". (Shif faqen 82 të këtij raporti).

^[87] Nuk është përfshirë gjyqtarja znj. Valdete Hoxha e cila është pjesë e trupave gjyqësore në seksionin penal, pavarësisht se mbulon detyrën e zv/kryetarit të gjykatës dhe ligji nuk e përjashton që të mos marrë pjesë në grafikun e gatishmërisë, ose në të paktën në 50% të rasteve të paraqitura që lidhet me ngarkesën, që ligji ja njeh.

urgjent (në vend të gjyqtarëve të planifikuar më parë, që kishin në fakt këto gjykime dhe që për shkak pamundësie të tyre ato nuk mund të gjykonin^[88]), pa zbatuar kërkesat e vendimit nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", për vitin 2024 (i përditësuar), ku në pjesën e shënimeve ndër të tjera thuhet se: ".....**Shënim: a).** Përrjashtimisht nëse njëri nga gjyqtarët e gatshëm është në pamundësi objektive për ushtrimin e funksionit në periudhën përkatëse, me urdhër të kryetarit çështjet hidhen në short tek gjyqtarët e tjerë që kanë javën e gatishmërisë...etj".

VI. Zv/kryetari i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me aktin e titulluar vendim "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente në muajin gusht" (shkresa nr. 228 prot., datë 01.07.2024), bazuar në nenin 37/b të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pasi ka marrë edhe mendimin e gjyqtarëve, ka disponuar me grafik gatishmërie për gjyqtarët e gatshëm, për gjykimin e masave të sigurimit për periudhën 29 korrik-1 shtator^[89], të cilët do të shqyrtojnë:

- a) masat e sigurimit dhe kërkesat e tjera të hetimit paraparak që ligji i parashikon me afat të ngutshëm; dhe,
- b) gjyqtarët e gatshëm do të shqyrtojnë gjithashtu edhe kërkesat penale me karakter të ngutshëm edhe nëse ky i fundit nuk është gjyqtari që ka dhënë vendimin e parë mbi procedimin përkatës, sipas parashikimeve të nenit 278/2 të K.Pr.Penale, apo nuk është gjyqtari të cilit i është caktuar për gjykim çështja e themelit, i cili do të ishte si regull kompetent për shqyrtimin e kërkesës;

Në këtë vendim zv/kryetari i gjykatës ka përcaktuar edhe procedurën që duhet të ndiqet nëse njëri nga gjyqtarët e gatshëm është në pamundësi objektive për ushtrimin e funksionit në periudhën përkatëse të gatishmërisë, çështjet do të shqyrtohen nga gjyqtarët e tjerë në listë që kanë periudhën e gatishmërisë ose nga një gjyqtar tjetër, i cili është i mundshëm të jetë i pranishëm për shkak të natyrës urgjente të çështjes në shqyrtim. Në rast të paraqitjes së kërkesës për përrjashtim të një prej gjyqtarëve të gatshëm, kjo kërkesë do të shortohet dhe shqyrtohet nga gjyqtarët e gatshëm në të njëjtën periudhë të gatishmërisë.

Në urdhër nuk janë përfshirë të gjithë gjyqtarët në grafik të gatishmërisë për muajin gusht 2024, konkretisht nuk janë përfshirë gjyqtarët Fuat Vjerdha, Alma Ahmeti, Iliba Bezati, Patri Islamaj, Irida Kacerja, Astrit Kalaja, Elona Mihali, Orneta Naqellari, Marsela Pepi, Edlira Petri, dhe Valdete Hoxha si dhe konstatohet se, nuk është ndjekur rendi alfabetik, me bazë mbiemrin.

Urdhëri i kryetarit, plotëson 1 nga 3 standardet e kërkuara nga neni 37 shkronja b) dhe neni 2 shkronja c) i ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e

^[88] Ky fat u konstatua nga inspektimi i tabelës që ka dërguar gjykata për procedurën e shorti në gjykatë (çështjet e karakterit urgjent), periudha 01.01.2024-31.12.2024

^[89] Vendimi "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente në muajin gusht" (shkresa nr. 228 prot., datë 01.07.2024), edhe pse në pjesën arsyetuese argumenton faktin se mbulon me grafik gatishmërie periudhën 29 korrik-1 shtator 2024, rezulton se një pjesë e kësaj periudhe konkretisht datat 03.08.2024 dhe 04.08.2024, nuk ka të caktuar gjyqtar të gatshëm.

Shqipërisë", i ndryshuar: (i) plotëson kriterin në drejtim të kohës së miratimit, sepse urdhëri është nxjerrë në fillim në datën 01.07.2024, para muajit gusht 2024; (ii) urdhëri nuk mbulon të gjithë periudhën nga data 29.07.2024 deri më datë 01.09.2024 (pasi data 03.08.2024 dhe data 04.08.2024 nuk është e mbuluar me gjyqtarë të gatshëm); dhe (iii) urdhëri nuk cakton të gjithë gjyqtarët në short sipas rendit alfabetik, me bazë mbiemrin.

Zv/kryetari i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (në cilësinë si zv/kryetare e deleguar) me aktin e titulluar vendim "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 265 prot., datë 19.08.2024), bazuar në nenin 26 pika 2 dhe nenin 37/b të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pasi është njohur me kërkesën penale nr.1953 regjistri datë 19.08.2024 që i përket kërkuarit: Lirim Durdaj, me objekt: Shuarje mase sigurimi "arrest me burg"^[90], çështje e cila i ka rënë gjyqtarës Alma Kolgjoka, si relatore (ku kjo gjyqtare ushtron edhe detyrën e zv/kryetarës së deleguar), për shkak se vetë kjo gjyqtare ka paraqitur raport mjekësor nr. 5368 regjistri datë 20.08.2024 dhe sipas të cilit dokument është e aftë për punë në datën 23.08.2024, ka vendosur: "...Rishortimin e çështjes midis dy gjyqtareve të tjera të gatshme Arta Duka dhe Diamela Goxha^[91], Plotësimin e trupës gjyqëse me gjyqtarën Edlira Petri...etj".

Urdhëri i brendshëm nr. 265, datë 19.08.2024 "Për zëvendësim gjyqtari", i nxjerrë nga zv/kryetaria e deleguar e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm znj. Alma Kolgjoka, ndërsa është në koherencë me përcaktimet ligjore sa i përket rishortimit për caktimin e kryesuesit të trupës pas pamundësisë së saj për të marrë pjesë, nuk është në koherencë me këto rregulla sa i përket disponimit me plotësimin e trupës gjyqësore me anëtarin e tretë, duke e përcaktuar këtë anëtar nominalisht në këtë akt^[92]. Përcaktimet ligjore parashikojnë që në çdo rast shkaku i mungesës duhet të ketë lindur dhe t'i jetë bërë i ditur Kryetarit para hedhjes së shortit (pika 4, seksioni V i vendimit nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve").

VII.Zv/kryetari i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me aktin e titulluar:

- a) urdhër "Për ndërprerjen e përkohshëm të shortit të çështjeve gjyqësore...etj" (shkresa nr. 245 prot., datë 22.07.2024), nisur nga fakti se muaji gusht është muaji i pushimeve vjetore të gjyqtarëve, bazuar në nenin 26 "Kryetari dhe zëvendëskryetari i gjykatës" pika 2 dhe nenin 37 "Kompetencat e kryetarit të gjykatës" shkronja "h" të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ka urdhëruar ndërprerjen e shortit

^[90] Kjo çështje thuhet në urdhërin e brendshëm nr. 265 prot., datë 19.08.2024, është e natyrës urgjente si çështje në shqyrtim, me afat gjykim 48 orë dhe duhet të kryhet zëvendësimi i gjyqtarës relatore me një gjyqtar të trupit gjyqësor, në kushte të mungesës.

^[91] Referuar tabelës së rishortimeve rezulton se kjo çështje ka nr. (60612-04901-30-2024) 1953 akti datë 19.08.2024 me kërkuar Lirim Durdaj, dhe i ka rënë në rishortimin e datës 20.08.2024, gjyqtarës relatore znj. Diamela Goxha ku si justifikim është vendosur arsyeja: "... Në bazë të urdhërit të brendshëm "për zëvendësim gjyqtari" me nr. 265 prot., datë 19.08.2024...etj"

^[92] Lidhur me këtë konstatim evidendohet fakti se zëvendëskryetari i gjykatës znj. Valdete Hoxha, në urdhërin nr. 228 prot., datë 01.07.2024 ka përcaktuar se në rastet e pamundësisë objektive për ushtrimin e funksionit në periudhën e gadishmërisë çështjet do të shqyrtohen nga gjyqtarët e tjerë në listë që kanë periudhën e gadishmërisë ose nga një gjyqtar tjetër, i cili është i mundshëm të jetë prezent për shkak të natyrës urgjente të çështjes

elektronik në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për periudhën 29.07.2024 deri më 02.09.2024, ku bëjnë përjashtim nga ky urdhër çështjet gjyqësore që do të gjykohen në bazë të vendimit të zv/kryetarit nr. 228 prot., datë 01.07.2024 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente në muajin gusht"; dhe,

- b) urdhër "Mbi mbartjen e dosjeve gjyqësore për vitin e ri kalendarik dhe shortin gjyqësor gjatë kësaj periudhe...etj" (shkresa nr. 399 prot., datë 26.12.2024), bazuar në nenin 37 "Kompetencat e kryetarit të gjykatës" të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ka urdhëruar që procesi i mbartjes së dosjeve gjyqësore për vitin e ri kalendarik në vazhdim, të përfundojë brenda datës 13.01.2025. Shorti i fundit gjyqësor për vitin 2024 do të zhvillohet në datën 27.12.2024 dhe do të rifillojë për vitin në vijim në datën 13.01.2025. Kërkesat për sigurim padie, ose kërkesat e tjera me afat të ngutshëm procedural, urdhër mbrojtje, përjashtim gjyqtari si dhe kërkesat të cilat shqyrtohen sipas vendimit të zv/kryetarit "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente" do të regjistrohen dhe shortohen çdo ditë.

Urdhërat e zv/kryetarit, për pezullimin e ndarjes së çështjeve me short gjatë procesit të mbartjes së dosjeve si dhe gjatë lejes vjetore në muajin gusht, janë marrë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe kërkesat e pikës 14 të kreut III. "Procedurat dhe rregullat e ndarjes së çështjeve me short" të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", në të cilin përcaktohet se: "... 14. Ndarja e çështjeve gjyqësore me short pezullohet gjatë procesit të mbartjes së dosjeve si dhe gjatë lejes vjetore në muajin gusht. Afati i pezullimit përcaktohet me vendim të arsyetuar të Kryetarit të Gjykatës....etj".

Këto urdhëra janë arsyetuar nga zv/kryetari i gjykatës, i cili ka përcaktuar dhe mënyrën se si do të zbatohet nga kryesekretaria e gjykatës, sektori i IT-së, dhe për zbatimin e ndjekjen e tyre ka ngarkuar Kancelarin e Gjykatës. Veç sa më sipër ka urdhëruar që një kopje të shpërdahet gjyqtarëve dhe të shpallen në faqen zyrtare të internetit të gjykatës.

4. Përjashtimet nga hedhja në short e gjyqtarëve^[93].

Në kohën e inspektuar 01 janar 2024 - 31 dhjetor 2024, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë paraqitur nga gjyqtarët 122 kërkesa për heqje dorë nga gjykimi^[94]

^[93] Kjo pikë e raportit përfaqëson largimin e gjyqtarëve nga çështjet gjyqësore: a) - për kërkesa për dorëheqje gjyqtari, të miratuar nga Kryetari e Gjykatës; b) - për kërkesa për përjashtim gjyqtari nga gjykimi, për të cilat ka vendim gjyqësor; dhe c) - për raste kur gjyqtari është larguar për shkak të procedurave të zbatimit të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" ose për arsye të tjera të ligjshme.

^[94] Bëhet fjalë për 122 raste "kërkesa për heqje dorë nga gjyqtarët" të cilët i kanë paraqitur për 78 çështje penale dhe 41 çështje civile (mosrakovdanca në 3 raste qëndron për faktin se në një çështje penale krahas kryesuesit kanë dhënë dorëheqjen edhe dy anëtarët e trupit gjyqësor dhe në një çështje civile krahas njërit anëtar ka dhënë dorëheqje dhe anëtar i dytë i trupit gjyqësor). Gjithashtu referuar shkresës nr. 7987/3 prot., datë 10.07.2025 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në përgjigje të shkresës nr. 1020/4 prot., datë 07.04.2025 të ILD-së, rezulton se gjykata ka përmendur se janë: 126 kërkesa për dorëheqje, por nga verifikimi i tyre rezulton se për 2 (dy) kërkesa janë vendime refuzimi (nr.

për të cilat është pranuar dorëheqja nga zëvendëskryetari për gjyqtarët (*pasi gjykata nuk ka kryetar të emëruar dhe funksionet e tij i kryen ky i fundit*). Nga rastet e dorëheqjeve 78 prej tyre kanë të bëjnë për çështjet e karakterit penal dhe 43 raste kanë të bëjnë për çështjet e karakterit civil. Në vazhdim të kësaj analize nga 122 rastet e "kërkesave për heqje dorë nga gjykimi", në cilësinë e kryesuesit janë 85 raste, po ashtu edhe në cilësinë e anëtarit janë 37 raste. Në mënyrë të përmbedhur rastet për sejcilin gjyqtar sipas Aneksit 2 bashkëlidhur.

Duke krahasuar të dhënat rezultojnë se koha nga bërja e kërkesës për dorëheqje e gjyqtarit deri në miratimin e saj nga zëvendëskryetari i gjykatës varion, në 47 raste brenda ditës, në 15 raste brenda ditës së nesërme, në 8 raste brenda 2 ditëve, në 8 raste brenda 3 ditëve, në 11 raste brenda 4 ditëve, në 7 raste brenda 5 ditëve, në 4 raste brenda 6 ditëve, në 5 raste brenda 7 ditëve, në 2 raste brenda 8 ditëve, në 2 raste brenda 10 ditëve, në 1 rast brenda 12 ditëve, në 2 raste brenda 13 ditëve, në 1 rast brenda 21 ditëve, në 1 rast brenda 23 ditëve, në 1 rast brenda 27 ditëve, në 1 rast brenda 29 ditëve, në 1 rast brenda 32 ditëve, dhe në 2 raste brenda 34 ditëve. Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", nuk cakton afate për veprimin e kryetarit për organizimin e shortit në rastet e zëvendësimit të gjyqtarit, pasi çështja është regjistruar dhe shortuar njëherë, por për analogji nisur nga fakti se nga kjo gjykatë çështjet i shorton çdo ditë në javë, ora 15.⁰⁰, apo në rast të pamundësisë të nesërmen e depozitimit, edhe kjo kategori çështjesh duhet të shortheshin menjëherë për zëvendësimin e anëtarit të trupit gjykues (*ku këtu përfshihen 57 çështje gjyqësore*).

Pas miratimit të dorëheqjeve për rastet e kryesuesit, rezultojnë se çështjet janë rishortuar nëpërmjet sistemit elektronik për të caktuar kryesuesin e ri^[95].

Nga të dhënat e dërguara nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, sa i përket "kërkesave për përjashtim gjyqtari" nga çështjet, në periudhën e inspektimit rezultojnë se janë trajtuar 4 kërkesa për përjashtim^[96] gjyqtari e ndarë kjo, në 1 (*një*) çështje që ka të bëjë e karakterit penal dhe në 3 çështje që kanë të bëjnë të karakterit civil.

Më poshtë në mënyrë të përmbedhur po japim rastet për sejcilin gjyqtar, që është kërkuar përjashtimi dhe që është disponuar me vendimmarrje gjykatë, për "pranim kërkesë", e konkretisht:

21, datë 20.02.2024; dhe nr. 84 datë 27.05.2024); për 3 (tre) vendime të raportuara janë kërkesa të gjyqtarëve (nr. 30/1 vendimi datë 27.02.2024; nr. 32/1 vendimi, datë 29.02.2024; nr. 34/1 vendimi, datë 03.03.2024); për 1 (*një*) vendim është bërë e pidentifikuar se për ç'farë kërkesë për dorëheqje bëhet fjalë (nr. 72/1 vendimi datë 08.05.2024); për 1 (*një*) vendim është bërë e vendimit gjyqësor e Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 461 datë 20.02.2022 dhe nuk kuptohet se për ç'farë kërkesë për dorëheqje bëhet fjalë (nr. 81/1 vendimi datë 08.05.2024); për 2 (dy) vendime të raportuara janë pjesë nga fletët e vendimeve (nr. 103/1 vendimi datë 13.06.2024; nr. 110/1 vendimi datë 28.06.2024). Nga gjykata nuk janë dërguar fare vendimet nr. 73/2 datë 08.05.2024 dhe nr. 106/2 datë 18.06.2024 (të përmendura në shkresë), ndërkohë që në tabelë janë përfshirë edhe 3 (tre) vendime që nuk janë përmendur në shkresë e konkretisht vendimet: nr. 105 datë 18.05.2024; nr. 78 datë 10.05.2024; dhe nr. 120 datë 17.09.2024.

[95] Për këtë referohu tek tabela e titulluar "Informacion mbi shortin: Rishortimet numri total i çështjeve të rishortuara: 6171 nga data: 01/01/2024 në datën: 31/12/2024" dhe "Informacion mbi shortin: Caktimet manuale numri total i çështjeve të caktuara manualisht: 524 nga data: 01/01/2024 në datë 31/12/2024"

[96] Kërkesa për përjashtim në cilësinë e "relatorit" të trupit gjykues të çështjeve janë për 1 magjistrat dhe kërkesa për përjashtim në cilësinë e "anëtarit" të trupit gjykues të çështjeve janë për 3 magjistratë.

- *Gjyqtare Diamela Goxha* është paraqitur gjithësej 1 kërkesë për përjashtim^[97], dhe ka të bëjë 1 në cilësinë e kryesuesit të trupit gjykues;
- *Gjyqtarja Iliba Bezati* është paraqitur gjithësej 1 kërkesë për përjashtim^[98], dhe ka të bëjë 1 në cilësinë e kryesuesit të trupit gjykues;
- *Gjyqtarja Ornela Naqellari* është paraqitur gjithësej 1 kërkesë për përjashtim^[99], dhe ka të bëjë 1 në cilësinë e anëtarës të trupit gjykues; dhe,
- *Gjyqtarja Elona Toro* është paraqitur gjithësej 1 kërkesë për përjashtim^[100], dhe ka të bëjë 1 në cilësinë e anëtarës të trupit gjykues.

Vlen të theksojmë se për rastin e trajtimit të kërkesave për përjashtim të kryesuesit apo anëtarëve të trupit gjykues, nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për gjyqtarët që do të gjykojnë këto kërkesa në rastin e kërkesës së kërkuarit:

- a) Vilson Çobani, ku për gjykimin e çështjes së tij, është caktuar gjyqtare E.Tora, është në përputhje me kërkesat e vendimit të zv/kryetarës së gjykatës nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente" [gjyqtarja ka qenë e gatshme në ditën e paraqitjes së kërkesës (datë 25.03.2024) çështja nr. (71028-01783-30-2024)1146 akti].;
- b) Shoqëria "Focus Media News" shpk, ku për gjykimin e çështjes së saj, është caktuar gjyqtar A.Kolgjoka, nuk është në përputhje me kërkesat e vendimit të zv/kryetarës së gjykatës nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente" [gjyqtarja nuk ka qenë e gatshme në ditën e paraqitjes së kërkesës, (datë 23.02.2024) çështja nr. (90903-00941-30-2024)367 akti, dhe çështja i është caktuar me short normal];
- c) Irena Dimushi (Kita), ku për gjykimin e çështjes së saj, është caktuar gjyqtar A.Kalaja, nuk është në përputhje me kërkesat e vendimit të zv/kryetarës së gjykatës nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente" [gjyqtari nuk ka qenë i gatshëm në ditën e paraqitjes së kërkesës, (datë 09.09.2024) çështja nr. (90903-03668-30-2024)1266 akti, dhe çështja i është caktuar me short normal];
- d) Mentor Rryçi, ku për gjykimin e çështjes së saj është caktuar gjyqtar A.Kalaja, nuk është në përputhje me kërkesat e vendimit të zv/kryetarës së gjykatës nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente" [gjyqtari nuk ka qenë i gatshëm në ditën e paraqitjes së kërkesës, (datë 13.05.2024) çështja nr. (90903-02053-30-2024)824 akti, dhe çështja i është caktuar me short normal];

Sa i përket caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e këtyre kërkesave, pasi këto të fundit janë përjashtuar me vendim gjyqësor, është bërë në dy raste me rishortim për caktimin e

^[97] Për çështjen penale çështjen penale nr. (79000-00745-30-2024) 488 akti datë 05.02.2024, me kërkuar Vilson Çobani, pranuar me vendimin nr. (30-2024-2263) 672, datë 27.03.2024, nga gjyqtare E.Mihali;

^[98] Për çështjen civile nr. (21238-02088-30-2022) 5337 akti, datë 24.10.2022 me palë kërkuar Shoqëria "Focus Media News" sh.p.k, pranuar me vendimin nr. (30-2024-1289) 189, datë 26.02.2024, nga gjyqtare A.Kolgjoka;

^[99] Për çështjen civile nr. (21396-03378-30-2024) 1207 akti, datë 24.07.2024 me palë kërkuar Irena Dimushi (Kita), pranuar me vendimin nr. 900, datë 25.09.2024, nga gjyqtar A.Kalaja;

^[100] Për çështjen civile nr. (21001-04107-30-2017-R) 5531 akti, datë 10.01.2023 me palë kërkuar Mentor Rryçi, pranuar me vendimin nr. 752, datë 19.06.2024, nga gjyqtar A.Kalaja;

relatorit dhe në 2 rastet e tjera gjyqtarët anëtar janë shtuar sipas seksionit përkatës, ku ato marrin pjesë.

Në përputhje me kërkesat e nenit 17 të K.Pr.Penale, gjenden 79 kërkesat e gjyqtarëve për heqje dorë nga gjykimi i çështjes penale dhe miratimi i tyre, nga ana e zv/kryetarit të gjykatës për gjyqtarët.

Në përputhje me kërkesat e nenit 72 të K.Pr.Civile, gjenden edhe 43 kërkesat e gjyqtarëve për heqje dorë nga gjykimi i çështjes civile dhe miratimi i tyre, nga ana e zv/kryetarit të gjykatës për gjyqtarët.

Nga zv/kryetari e kancelari i gjykatës nuk janë trajtuar në short, në datën e miratimit të "kërkesës për dorëheqje" të gjyqtarit për pengesë ligjore çështjet, por as të nesërmen e datës së miratimit, si dhe në ditët më të afërta kur është organizuar shorti, referuar urdhërit për periodicitetin e tij [çdo ditë në javë, ora 15.⁰⁰], kërkesa këto që kërkohet të përmbushen, referuar nenit 25, nenit 37 dhe nenit 39 të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", nuk cakton afate për veprimin e kryetarit për organizimin e shortit në rastet e zëvendësimit të gjyqtarit, pasi çështja është regjistruar dhe shortuar njëherë, por për analogji nisur nga fakti se nga kjo gjykatë çështjet shortohen çdo ditë në javë, ora 15.⁰⁰, edhe kjo kategori çështjesh duhet të shortoheshin menjëherë për zëvendësimin e anëtarit të trupit gjykues.

Trajtimi i kërkesave për caktimin në short të gjyqtarëve që do të gjykojnë "kërkesat për përjashtim", rezulton se në një rast është bërë në përputhje me kërkesat e vendimit të zv/kryetarës së gjykatës nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", ndërsa në tre raste të tjera caktimi i tyre, është bërë duke u caktuar me short normal. Pra në këtë rast nga gjykata janë ndjekur dy praktika për caktimin e këtyre gjyqtarëve për gjykimin e këtyre çështjeve. Ky veprim bie ndesh me kërkesat që kërkohet të përmbushen, referuar nenit 25, nenit 37 dhe nenit 39 të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe kërkesat e vendimit të zv/kryetarës së gjykatës nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente".

Theksoj se në periudhën e inspektimit 01 janar 2024 - 31 dhjetor 2024, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, rezulton se nuk ka pasur raste që gjyqtarët të jenë larguar nga detyra, dhe në këto rrethana nuk rezulton nga zv/kryetarja e gjykatës, të jenë lëshuar urdhëra për marrjen e dosjeve në dorëzim.

Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nuk ka pasur raste që në vitin 2024 të jenë larguar gjyqtarë dhe për rrjedhojë nuk ka akte të lëshuar nga zv/kryetarja e gjykatës, për marrjen e dosjeve në dorëzim dhe ndjekjen në vazhdim të procedurave të tjera për kalimin e çështjeve tek gjyqtarët e tjerë.

Sa i përket kërkesave të gjyqtarëve për përjashtimin nga pjesëmarrja në shorte^[101] dhe mënyrën e trajtimit të tyre nga kryetari i gjykatës, rezultoi se në periudhën objekt të kontrollit tematik, nuk ka pasur raste të veçanta, kur kryetari i gjykatës ka vlerësuar të nevojshme dhe për arsye të justifikuar, të përjashtojë me urdhër të motivuar një ose disa gjyqtarë nga pjesëmarrja në shortin e zakonshëm, caktimet manuale apo rishortimet.

Për kërkesat e gjyqtarëve për përjashtimin nga pjesëmarrja në shorte dhe mënyrën e trajtimit të tyre nga kryetari i gjykatës, rezultoi se nuk ka pasur raste në periudhën objekt inspektimi tematik.

5. Çështjet e hedhura më parë në short.

Referuar dokumentacionit të dërguar nga gjykata, sa i përket procedurave që kanë të bëjnë me çështjet e caktuara me short dhe për të cilat është disponuar më parë nga gjykata me vendim jopërfundimtar të pushimit të gjykimit ose me vendim për kthimin e akteve, kur nga përmbajtja e padisë është i mundur identifikimi se është e njëjta çështje dhe të cilat përjashtohen nga shorti dhe i kalojnë automatikisht të njëjtit gjyqtar, nga vetë natyra e gjykimit që zhvillon kjo Gjykatë, nuk ka në objektin e saj trajtimin e kësaj kategorie gjykimesh, ndaj dhe mbajtja e indeksit për këto çështje nuk është e nevojshme.

6. Zëvendësimi i anëtarit të trupit gjykues dhe plotësimi me anëtar i trupit gjykues.

Referuar dokumentacionit të dërguar nga gjykata rezultoi se në vitin 2024, në lidhje me zëvendësimin e anëtarit të plotësimin e trupit gjykues, pas përzgjedhjes nëpërmjet shortit, në ato çështje gjyqësore, që gjykohen me trup gjykues me tre anëtare, nga zv/kryetarja e gjykatës nuk ka pasur urdhëra të lëshuara për mënyrën se si do të organizohet shorti për rastet kur janë pranuar dorëheqjet e anëtarëve të trupit gjykues. Në rastin e plotësimit të anëtarëve janë pasur parasysh që procedurat e shortit janë organizuar ndërmjet gjyqtarëve që janë pjesë përbërëse e trupave gjykues të caktuar në vendimin e Këshillit të Gjykatës nr. 1, datë 02.02.2023 (shkresa nr. 08 prot., datë 02.02.2023) i ndryshuar^[102], si dhe janë pasur parasysh edhe rastet kur çështjet janë shpallur për gjykim dhe gjyqtarët e trupave gjykues, kanë munguar për arsye të ndryshme në ditët e gjykimit.

Zëvendësimi i anëtarëve në trupat gjykues, është bërë pasi më parë, gjyqtarët relator i janë drejtuar me kërkesa zv/kryetarit për çështjet që është kërkuar zëvendësimi i anëtarit, por ka

^[101] Theksojmë se ka pasur 3 (tre) raste të cilat i kemi trajtuar më lart për përjashtimin e dy gjyqtarëve F.Vjerdha në dy periudha dhe E.Petri në një periudhë nga gjykimi i kërkesave të karakterit urgjent, referuar urdhërave të gatishmërisë. Në vendimeve për gjyqtarin F.Vjerdha rezultoi se zv/kryetarja e Gjykatës, ka lënë rezervën që periudha e gatishmërisë së gjyqtarit të kryhet në një periudhë tjetër, si dhe ky vendim është bazuar nën 37 shkronja "b" të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

^[102] Nga dokumentacioni i dërguar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të verifikimit, rezultoi se ky vendim ka pësuar këto ndryshime gjatë viteve 2023 dhe 2024 me vendimet si vijon: nr.3, datë 24.02.2023 (shkresa nr. 87 prot., datë 24.02.2023); nr.12, datë 04.09.2023 (shkresa nr. 581 prot., datë 04.09.2023); nr.13, datë 29.09.2023 (shkresa nr. 631 prot., datë 29.09.2023); nr.17, datë 31.10.2023 (shkresa nr. 674 prot., datë 31.10.2023); nr. 36, datë 13.12.2023 (shkresa nr. 718 prot., datë 13.12.2023); nr. 7, datë 26.02.2024 (shkresa nr. 84 prot., datë 26.02.2024); nr. 44, datë 08.10.2024 (shkresa nr. 297 prot., datë 08.10.2024) dhe nr. 48, datë 28.10.2024 (shkresa nr. 326 prot., datë 28.10.2024).

dhe raste kur vetë gjyqtarët kanë njoftuar mosparaqitjen e tyre në detyrë dhe nga kjo e fundit (zv/kryetari) rezulton se janë lëshuar këto akte:

1. urdhër i brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 81 akti., datë 08.01.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e kërkesës së gjyqtarit z.Genti Shala [në cilësinë e relatorit të çështjes së themelit nr. (50506-05938-30-2023) 4428 akti datë 16.11.2025], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtar Genti Shala, i cili është në kushtet e pamundësisë objektive (arsye personale) për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr. 81 regjistrimi datë 08.01.2024 me kërkuar: Klodjan Elezi me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtarë në përbërje të trupit gjykues janë gjyqtarët Brikena Ukperaj dhe Dritan Hasani. Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarit Genti Shala, do të bëhet duke i kaluar çështjen si relator gjyqtarit Dritan Hasani, ndërsa për një anëtar tjetër plotësimi do të bëhet nga gjyqtarë të seksionit penal^[103].
2. urdhër i brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 421 akti., datë 15.02.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e njoftimit të gjyqtarit z.Genti Dokollari [në cilësinë e relatorit të çështjes së themelit nr.(53101-05516-30-2023) 4220 akti datë 23.10.2023], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtar Genti Dokollari, i cili është në kushtet e pamundësisë objektive (për arsye shëndetësore) për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr. 421 regjistrimi datë 15.02.15.02.2024 me kërkuar: Valon Muçiçi me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtar në përbërje të trupit gjykues, janë gjyqtarët Irena Brahimi dhe Fuat Vjerdha. Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarit Genti Dokollari, do të bëhet duke i kaluar çështjen si relatore gjyqtarës Irena Brahimi, ndërsa për një anëtarë plotësimi do të bëhet nga gjyqtarë të seksionit penal^[104].
3. urdhër i brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 73 prot., datë 16.02.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e kërkesës së gjyqtarës znj. Miranda Andoni [në cilësinë e relatores së çështjes së themelit nr. (50506-00750-30-2024) 491 akti datë 05.02.2024], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtare Lutfije Celami, e cila është në kushtet e pamundësisë objektive (rast vdekje) për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr. 422 regjistrimi datë 15.02.2024 me kërkuar: Baki Gërdeci me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtarë në përbërje të trupit gjykues janë gjyqtarët Qemal Zaimi dhe Lutfije Celami. Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarës Lutfije Celami, do të bëhet me një anëtar të trupit gjykues, të seksionit penal^[105].

4. urdhër i brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 130 prot., datë

^[103] Nga verifikimi i dosjes nr. (61010-00033-30-2024) 81 akti datë 08.01.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues është caktuar gjyqtare M.Andoni (nuk jepet mënyra dhe procedura e provuar me akt të arsyetuar, se me ç'farë lloji shorti u caktua kjo gjyqtare në këtë çështje).

^[104] Nga verifikimi i dosjes nr. (61010-01033-30-2024) 421 akti datë 15.02.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues është caktuar gjyqtar Q.Zaimi (nuk jepet mënyra dhe procedura e provuar me akt të arsyetuar, se me ç'farë lloji shorti u caktua ky gjyqtar në këtë çështje).

^[105] Nga verifikimi i dosjes nr. (61010-01035-30-2024) 422 akti datë 15.02.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues është caktuar gjyqtare E.Petri.

02.04.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e kërkesës së gjyqtarit z.Genti Shala [në cilësinë e relatorit të çështjes së themelit nr. (55000-03243-30-2023) 2985 akti datë 29.06.2023, përfunduar vendimin nr. 30-2023-5672 datë 17.10.2023], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtare Brikena Ukperaj, e cila është në kushtet e pamundësisë objektive (për t'u paraqitur në punë, pasi është me leje të miratuar për 3 ditë që i përkasin datave 02.04.2024-04.04.2024) për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr. 733 regjistrimi datë 25.03.2024 me kërkesë: Jetmir Kodra me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtarë në përbërje të trupit gjykues janë gjyqtarët Brikena Ukperaj dhe Dritan Hasani. Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarës Brikena Ukperaj, do të bëhet me një anëtar të trupit gjykues, të seksionit penal^[106].

5. urdhër i brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 866 akti., datë 09.04.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e kërkesës së gjyqtarit z.Genti Shala [në cilësinë e relatorit të çështjes së themelit nr. (71113-00269-30-2024) 151 akti datë 19.01.2024], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtari Genti Shala, i cili është në kushtet e pamundësisë objektive (për arsye personale) për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr. 866 regjistrimi datë 09.04.2024 me kërkesë: Albion Billa me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtarë në përbërje të trupit gjykues janë gjyqtarët Brikena Ukperaj dhe Dritan Hasani. Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarit Genti Shala, do të bëhet duke i kaluar çështjen si relatore gjyqtarës Brikena Ukperaj, ndërsa për një anëtar tjetër plotësimi do të bëhet nga gjyqtarë të seksionit penal.^[107]

6. urdhër i brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 147 prot., datë 15.04.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e kërkesës së gjyqtarës znj. Edlira Petri [në cilësinë e relatorës së çështjes së themelit nr.(50506-02052-30-2022)6922 akti datë 08.09.2022], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtar Fatri Islamaj, i cili është në kushtet e pamundësisë objektive (është me leje dy ditore bazuar në Kodin e Punës, neni 96 pika 3, miratuar nga zv/kryetari) për të marrë pjesë në seancën e datës 15.04.2024, ora 09.⁴⁰ në gjykimin e çështjes nr. 825 regjistrimi datë 05.04.2024 me kërkesë: Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër me objekt: "Marrje në pyetje të të arrestuarit Roland Muharremi" dhe ku anëtarë në përbërje të trupit gjykues janë gjyqtarët Fatri Islamaj dhe Marsela Pepi. Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarit Fatri Islamaj, do të bëhet me short me një anëtar të trupit gjykues, të seksionit penal^[108].

^[106] Nga verifikimi i dosjes nr. (60612-01785-30-2024) 733 akti datë 25.03.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues është caktuar gjyqtar G. Dokollari. Kjo çështje i është caktuar në kundërshtim me vendimin nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", për vitin 2024 (i përditësuar) të lëshuar nga zv/kryetarja e gjykatës, kësaj trupe gjykuese, pasi ky trup gjykues (ku kanë qenë ndër të tjerë edhe gjyqtarët G.Shala e D.Hasani) kanë dhënë vendim themeli nr. 30-2023-5672 datë 17.10.2023. Çështja duhet të gjykohej nga gjyqtarët e gatshëm të periudhës 25.03.2024 deri 31.03.2024, ku kanë qenë gjyqtarët Kolgjoka Alma, Mihalit Elona e Nagellari Ornela.

^[107] Nga verifikimi i dosjes nr. (61011-02208-30-2024) 866 akti datë 09.04.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues është caktuar gjyqtar F.Vjerdha (nuk jepet mënyra dhe procedura e provuar me akt të arrestuar, se me çfarë lloji shorti u caktua ky gjyqtar në këtë çështje).

^[108] Nga verifikimi i dosjes nr. (61006-02094-30-2024) 825 akti datë 05.04.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues në vend të gjyqtarit F.Islamaj është caktuar me short manual gjyqtari Q.Zaimi.

7. urdhër i brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 160 prot., datë 19.04.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e njoftimit të gjyqtarës znj. Diamela Goxha [në cilësinë e relatorës së çështjes së themelit nr. (53101-01843-30-2024) 1180 akti datë 27.03.2024], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtare Diamela Goxha, e cila është në kushtet e pamundësisë objektive (për arsye familjare) për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr. 942 regjistrimi datë 19.04.2024 me kërkues: Manxhar Çausi me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtare në përbërje të trupit gjykues, është vetëm gjyqtare Valdete Hoxha, ndërsa anëtari tjetër do të plotësohej me një gjyqtar sipas vendimit të Këshillit të Gjykatës, për plotësimin e trupave gjykues. Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarës Diamela Goxha, do të bëhet duke i kaluar çështjen si relatore gjyqtarës Valdete Hoxha, ndërsa për dy anëtarët e tjerë plotësimi do të bëhet nga gjyqtarë të seksionit penal^[109].

8. urdhër i brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 175 prot., datë 03.05.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e kërkesës së gjyqtarës znj. Miranda Andoni [në cilësinë e relatorës së çështjes së themelit nr. (57260-01377-30-2024) 888 akti datë 04.03.2024], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtare Lutfije Celami, e cila është në kushtet e pamundësisë objektive (është me arsye shëndetësore, pasi është me raport paafësie në punë për periudhën 02.05.2024-03.05.2024) për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr. 1026 regjistrimi datë 02.05.2024 me kërkues: Margent Marku me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtarë në përbërje të trupit gjykues janë gjyqtarët Qemal Zaimi dhe Lutfije Celami. Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarës Lutfije Celami, do të bëhet me një anëtar të trupit gjykues, të seksionit penal^[110].

9. urdhër i brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 182 prot., datë 08.05.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e kërkesës së gjyqtarit z. Qemal Zaimi [në cilësinë e relatorit të çështjes së themelit nr. (53101-02630-30-2024) 1729 akti datë 30.04.2024], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtare Lutfije Celami, e cila është në kushtet e pamundësisë objektive (është në Konferencën Kombëtare me temë, "Adresimi i sfidave mjedisore dhe mekanizmat e zbatimit të legjislacionit mjedisore") për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr. 1057 regjistrimi datë 07.05.2024 me kërkues: Amaraldo Vezi me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtarë në përbërje të trupit gjykues janë gjyqtarët Miranda Andoni dhe Lutfije Celami. Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarës Lutfije Celami, do të bëhet me një anëtar të trupit gjykues, të seksionit penal^[111].

[109] Nga verifikimi i dosjes nr. (61010-02448-30-2024) 942 akti datë 19.04.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues janë caktuar gjyqtarët E. Petri dhe Q. Zaimi.

[110] Nga verifikimi i dosjes nr. (61010-02685-30-2024) 1026 akti datë 02.05.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues është caktuar gjyqtare I. Brahimi.

[111] Nga verifikimi i dosjes nr. (61010-02736-30-2024) 1057 akti datë 07.05.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues është caktuar gjyqtare D. Goxha.

10. urdhër i brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 183 prot., datë 09.05.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e kërkesës së gjyqtarës znj. Brikena Ukperaj [në cilësinë e relatorit të çështjes së themelit nr. (53002-00669-30-2023) 1098 akti datë 27.02.2023], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtar Dritan Hasani, i cili është në kushtet e pamundësisë objektive (ka papajtueshmëri në ushtrimin e profesionit) për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr. 1058 regjistrimi datë 07.05.2024 me kërkuar: Donald Demcellari me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtarë në përbërje të trupit gjykues janë gjyqtarët Dritan Hasani dhe Genti Shala. Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarit Dritan Hasani, do të bëhet me një anëtar të trupit gjykues, të seksionit penal^[112].

11. urdhër i brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 1186 akti., datë 17.05.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e njoftimit të gjyqtarit z. Genti Dokollari [në cilësinë e relatorit të çështjes së themelit nr. (50506-04534-30-2023) 3617 akti datë 08.09.2023], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtar Genti Dokollari, i cili është në kushtet e pamundësisë objektive (për arsye personale) për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr. 1186 regjistrimi datë 17.05.2024 me kërkuar: Endri Gjergo me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtarë në përbërje të trupit gjykues, janë gjyqtarët Fuat Vjerdha dhe Irena Brahimi (e cila është në kushtet e pamundësisë objektive, për arsye personale, për të marrë pjesë në këtë gjykim). Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarit Genti Dokollari, do të bëhet duke i kaluar çështjen si relator gjyqtarit Fuat Vjerdha, ndërsa për dy anëtarët e tjerë plotësimi do të bëhet nga gjyqtarë të seksionit penal^[113].

12. urdhër i brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 1187 akti., datë 17.05.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e njoftimit të gjyqtarit z. Genti Dokollari [në cilësinë e relatorit të çështjes së themelit nr. (53101-02678-30-2024) 1760 akti datë 02.05.2024], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtar Genti Dokollari, i cili është në kushtet e pamundësisë objektive (për arsye personale) për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr. 1187 regjistrimi datë 17.05.2024 me kërkuar: Marsiljan Begu me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtarë në përbërje të trupit gjykues, janë gjyqtarët Fuat Vjerdha dhe Irena Brahimi (e cila është në kushtet e pamundësisë objektive, për arsye personale, për të marrë pjesë në këtë gjykim). Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarit Genti Dokollari, do të bëhet duke i kaluar çështjen si relator gjyqtarit Fuat Vjerdha, ndërsa për dy anëtarët e tjerë plotësimi do të bëhet nga gjyqtarë të seksionit penal^[114].

^[112] Nga verifikimi i dosjes nr. (61010-02737-30-2024) 1058 akti datë 07.05.2024 regjistrimi, rezultoi se në përbërje të trupit gjykues është caktuar gjyqtarë D. Goxha.

^[113] Nga verifikimi i dosjes nr. (60612-03023-30-2024) 1186 akti datë 17.05.2025 regjistrimi, rezultoi se në përbërje të trupit gjykues janë caktuar gjyqtarët D. Hasani dhe D. Goxha (nuk jepet mënyra dhe procedura e provuar me akt të arsyetuar, se me çfarë lloji shorti u caktuan këto gjyqtarë në këtë çështje).

^[114] Nga verifikimi i dosjes nr. (60612-03024-30-2024) 1187 akti datë 17.05.2025 regjistrimi, rezultoi se në përbërje të trupit gjykues janë caktuar gjyqtarët D. Hasani dhe D. Goxha (nuk jepet mënyra dhe procedura e provuar me akt të arsyetuar, se me çfarë lloji shorti u caktuan këto gjyqtarë në këtë çështje).

13. urdhër i brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 207 prot., datë 24.05.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e njoftimit të gjyqtarit z.Fuat Vjerdha [në cilësinë e relatorit të çështjes së themelit nr. (59129-01938-30-2024) 1244 akti datë 02.04.2024], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtar Fuat Vjerdha, i cili është në kushtet e pamundësisë objektive (deri në datën 27.05.2024) për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr. 1254 regjistrimi datë 24.05.2024 me kërkuar: Arnis Vatoci me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtar në përbërje të trupit gjykues, janë gjyqtarët Irena Brahimi dhe Genti Dokollari (i cili është në kushtet e pamundësisë objektive, për të marrë pjesë në këtë gjykim, deri në datën 27.05.2024). Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarit Fuat Vjerdha, do të bëhet duke i kaluar çështjen si relatore gjyqtarës Irena Brahimi, ndërsa për dy anëtarët e tjerë plotësimi do të bëhet nga gjyqtarë të seksionit penal^[115].

14. -urdhër i brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 207/1 prot., datë 28.05.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e kërkesës së gjyqtarit z.Qemal Zaimi [në cilësinë e relatorit të çështjes së themelit nr. (50506-01371-30-2024) 884 akti datë 04.03.2024], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtare Lutfije Celami, e cila është në kushtet e pamundësisë objektive (është me arsye shëndetësore, pasi është me raport paaftësie në punë për periudhën 27.05.2024-03.06.2024) për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr. 1278 regjistrimi datë 27.05.2024 me kërkuar: Shyqyri Peka me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtarë në përbërje të trupit gjykues janë gjyqtarët Miranda Andoni dhe Lutfije Celami. Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarës Lutfije Celami, do të bëhet me një anëtar të trupit gjykues, të seksionit penal^[116].

15. -urdhër i brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 208/1 prot., datë 30.05.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e kërkesës së gjyqtarës znj.Miranda Andoni [në cilësinë e relatorit të çështjes së themelit nr. (53101-01852-30-2024) 1186 akti datë 27.03.2024], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtare Lutfije Celami, e cila është në kushtet e pamundësisë objektive (është me arsye shëndetësore, pasi është me raport paaftësie në punë për periudhën 27.05.2024-03.06.2024) për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr. 1301 regjistrimi datë 29.05.2024 me kërkuar: Rezart Murataj me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtarë në përbërje të trupit gjykues janë gjyqtarët Qemal Zaimi dhe Lutfije Celami. Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarës Lutfije Celami, do të bëhet me një anëtar të trupit gjykues, të seksionit penal^[117].

16. urdhër i brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 216 prot., datë 18.06.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e kërkesës së gjyqtarës znj.Valbona Vata [në

^[115] Nga verifikimi i dosjes nr. (61010-03213-30-2024) 1254 akti datë 24.05.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues janë caktuar gjyqtarët E.Petri dhe M.Pepi.

^[116] Nga verifikimi i dosjes nr. (61010-03265-30-2024) 1278 akti datë 27.05.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues është caktuar gjyqtare D.Goxha.

^[117] Nga verifikimi i dosjes nr. (61010-03326-30-2024) 1301 akti datë 29.05.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues është caktuar gjyqtare I.Brahimi.

cilësinë e relatorit të çështjes], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtare Arta Duka, e cila është në kushtet e pamundësisë objektive (është me leje 4 ditë në zbatim të urdhërit nr. 10767 prot., datë 27.05.2024 të zv/kryetarit për periudhën 18.06.2024-21.06.2024) për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes civile nr. 100 regjistrimi datë 07.06.2024 me palë ndërgjyqësore paditëse: Manola Hysenllari, e paditur: Blerina Hysenllari, me objekt: "Lëshim i urdhërit të mbrojtjes" dhe ku anëtarë në përbërje të trupit gjykues janë gjyqtarët Sokol Pina dhe Arta Duka. Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarës Arta Duka, do të bëhet me short me një anëtar të trupit gjykues, të seksionit civil^[118].

17. -urdhër i brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 226 prot., datë 28.06.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e kërkesës së gjyqtarës znj. Brikena Ukperaj [në cilësinë e relatorit të çështjes së themelit nr. (71113-04008-30-2024) 2600 akti datë 26.06.2024], për zëvendësim gjyqtari, ka urdhëruar që të zëvendësohet gjyqtar Genti Shala, i cili është në kushtet e pamundësisë objektive, për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes nr. 1557 regjistrimi datë 27.06.2024 me kërkuar: Lili Lika me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal" dhe ku anëtarë në përbërje të trupit gjykues janë gjyqtarët Dritan Hasani dhe Genti Shala. Sipas urdhërit zëvendësimi i gjyqtarit Genti Shala, do të bëhet me një anëtar të trupit gjykues, të seksionit penal^[119].

18. -urdhër i brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 264 prot., datë 19.08.2024), zv/kryetarja e deleguar Alma Kolgjoka, pasi është njohur me çështjen nr. 1952 regjistrimi datë 19.08.2024, me kërkuar: Leonard Sufa me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal", ku gjyqtare relatorë është Arta Duka, dhe anëtare gjyqtarët Alma Kolgjoka e Diamela Goxha si dhe në kushtet kur vetë ajo (anëtarja A. Kolgjoka ka qenë në pamundësi objektive për ta gjykuar, pasi ka paraqitur raport mjekësor nr. 5368 rregjistri datë 20.08.2024, sipas të cilit është e aftë për punë me datë 23.08.2024), ka urdhëruar që zëvendësimi i saj, të bëhet me gjyqtarën e seksionit penal Edlira Petri^[120].

19. -urdhër i brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari" (shkresa nr. 275 prot., datë 19.09.2024), zv/kryetarja, mbi bazën e njoftimit të gjyqtarit z. Genti Dokollari [në cilësinë e relatorit të çështjes së themelit nr. (53101-05572-30-2024) 3491 akti datë

^[118] Nga verifikimi i dosjes nr. (90800-02557-30-2024) 100 akti datë 07.06.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues është caktuar gjyqtare M. Dervishi.

^[119] Nga verifikimi i dosjes nr. (61010-04073-30-2024) 1557 akti datë 27.06.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues është caktuar gjyqtare L. Celami (nuk jepet mënyra dhe procedura e provuar me akt të arsyetuar, se me çfarë lloji shorti u caktua kjo gjyqtare në këtë çështje).

^[120] Nga verifikimi i dosjes nr. (60612-04900-30-2024) 1952 akti datë 19.08.2024 regjistrimi, rezulton se në përbërje të trupit gjykues është plotësuar duke u caktuar gjyqtare E. Petri. Urdhëri i brendshëm "Për zëvendësim gjyqtari", (shkresa nr. 264 prot., datë 19.08.2024) i nxjerr nga zv/kryetarja e deleguar e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm znj. Alma Kolgjoka, është marrë në kundërshtim me kompetencat e dhënë nga zv/kryetari i gjykatës znj. Valdete Hoxha, (për personin që i ka deleguar detyrën), për shkak se vendimarrja është fiktive, duke u nisur nga përmbajtja e akteve të cilat lëshuesi i aktit, është bazuar për të nxjerrë këtë akt. Konkretisht vendimarrja është e datës 19.08.2024, ndërkohë që thuhet se të bëhet zëvendësimi i gjyqtarës relatore, pasi ka paraqitur raport nr. 5368 regjistri datë 20.08.2024 (pra si mund të lëshohet një akt, duke u bazuar në një akt tjetër pa ndodhur ngjarja...etj). Gjithashtu plotësimi i anëtarit të trupit gjykues me gjyqtarën E. Petri për gjykimin e çështjes, është bërë me emër të përzgjedhur gjyqtari pa kryer më parë procedurë shorti për përzgjedhjen e tij.

Referuar akteve që ka dërguar gjykata në kuadër të inspektimit sa i përket çështjeve të rishortuara rezulton se ka pasur edhe raste që në vitin 2024 janë rishortuar edhe dosje të ardhura nga ish-Gjykatat e Apelit^[193] në datën 01.02.2023, të cilat janë harruar nga kryesekretaria e gjykatës pa u rishortuar së bashku me dosjet e tjera, në rastet kur gjyqtari relator i tyre i caktuar në gjykatën përkatëse, nuk e ushtron më detyrën e magjistratit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, e konkretisht me:

- a) procesverbalin nr. 67 prot., datë 07.02.2024, një komison i përbërë nga kancelarja e gjykatës znj.L.Balili, k/sekretare znj.R.Kapexhiu, sekretare gjyqësore znj. B.Xhelo, specialist i IT-së z. F.Lili, ka konstatuar se dosja civile me nr. (21246-00604-60-2017) 2450 akti datë 27.04.2017 regjistrimi, me palë ndërgjyqësore paditës: Këshilli i Ministrave, i paditur: A.T.P.Tiranë, Theodhori Koçani, Jani Koçani, Fotina Konomaj, Z.V.RR.P.P Vlorë, Kasem Cenaj, Pajtim Lamçi, me objekt padie: "Detyrim për njohje prona...etj", ka qenë e pezulluar në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe nuk është referuar si e tillë nga kjo gjykatë në momentin e riorganizimit të gjykatave dhe vazhdon të jetë në emrin e gjyqtarës Adelajda Gjuzi, si relatore. Nga procesverbali i seancave gjyqësore nuk rezulton se asnjë anëtar i trupës gjyqësore nuk vazhdon detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Në kushte si më sipër komisioni ka vendosur se duhet të shorthet kjo dosje mes gjyqtarëve civilist^[194] të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- b) procesverbalin e konstatimit nr. 238 prot., datë 11.07.2024, një komison i përbërë nga zv/kryetarja e gjykatës znj.V.Hoxha, kancelarja e gjykatës znj.L.Balili, k/sekretare znj.R.Bubjaku, sekretare gjyqësore znj. B.Xhelo, specialistëve të IT-së z.R.Papa e z.F.Lili, ka konstatuar se dosja penale me nr. (58325-00228-20-2021) 128/20/11 akti datë 17.06.2021 regjistrimi, me të pandehur: Huan Skënderi, Ervin Llaka, Raul Skënderi...etj, të akuzuar: Për kryerjen e veprës penale "Prodhim dhe shitje narkotikësh", ka qenë në gjykim në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, me trup

^[193] Me vendimin nr.505, datë 21.11.2022 "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm", Këshilli i Lartë Gjyqësor, në nenin 1 "Emërtimi dhe selia" si dhe në nenin 6 "Transferimi i çështjeve gjyqësore", ndër të tjera, ka vendosur: a) "...1.Gjykata e Apelit Tiranë emërohet Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. 2.Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm fillon funksionimin më datë 01.02.2023. 3.Selia e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është në Tiranë, në adresën Bulevardi "Zhan D'Ark". 4.Gjykatat e Apelit Durrës, Gjirokastër, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, ndërpresin veprimtarinë më datë 31.01.2023...etj"; dhe, b) "...1.Çështjet gjyqësore të regjistruara në Gjykatën e Apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastër, Korçë, Shkodër dhe Vlorë deri në datën 31.01.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit, transferohen në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. 2.Çështjet gjyqësore që transferohen në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, regjistrohen në regjistrat manualë dhe sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve ICMS. 3.Për zbatimin e pikës 1 dhe 2 të këtij neni ngarkohet Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor...etj".

^[194] Nga të dhënat e nxjerra nga sistemi informatik i menaxhimit të çështjeve gjyqësor, rezulton se kjo çështje është rishortuar në datën 07.02.2024 dhe tek rubrika e shënimeve nga sekretarja regjistruese janë vendosur si arsye: "...Në bazë të procesverbalit datë 07.02.2024 me nr. 67 prot., çështja e gjyqtarës A.Gjuzi duhet të shorthet midis të gjithë gjyqtarëve civilist të Gjykatës së Apelit të Përgjithshëm...etj". Për këtë rast procesverbali nuk është shoqëruar me urdhër nga zv/kryetarja dhe nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative, për të cilën mbetet përgjegjëse zv/kryetarja dhe komisioni i marrjes në dosjezin të disjeve në datën 01.02.2023, kur ka filluar aktivitetin Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

gjykues të përbërë nga gjyqtarët S.Pina (*relator*), dhe anëtarët E. Pëllumbi e M.Buhali. Seanca e fundit e caktuar për shqyrtimin e kësaj çështje është caktuar në datën 16.05.2022 dhe nga Riv-i rezulton se kjo çështje nuk është rishortuar në datën 03.02.2023, pasi Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, i është përcjellë nga Zyra e Shërbimit Gjyrokastër, si dosje në gjykim me relator S.Pina. Me vendimin nr. 188, datë 17.05.2022 të KLGJ-së, rezulton se afati i vendimit, në skemë delegimi për gjyqtarin S.Pina fillon me datë 15.06.2022 dhe se ky i fundit duhet të bëjë dorëzimin e menjëherë të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Apelit Gjyrokastër. Për sa mësipër, në zbatim të vendimit nr. 505 datë 21.11.2022 "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm", neni 7, "Për menaxhimin e çështjeve gjyqësore", kjo dosje duhet të ishte rishortuar në seksionin penal, pasi gjyqtar S.Pina nga data 15.06.2022, nuk duhet të ishte me relator i kësaj çështje në sistem, pais është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës. Në kushte si më sipër komisioni ka vendosur se duhet të shortohet kjo dosje mes gjyqtarëve penalist^[195] të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

- c) procesverbalin e konstatimit nr. 290 prot., datë 25.09.2024, një komison i përbërë nga zv/kryetarja e gjykatës znj.Valdete Hoxha, kancelarja znj.Lertida Balili, k/sekretarja znj.Rudina Kapexhiu, sekretarja gjyqësore znj.Briselda Xhelo, specialisti i IT-së z. Ramiz Papa, dhe znj.Oriana Dervishi Shefe e Zyrave të Shërbimit, për dosjet civile të ish Gjykatës të Apelit Vlorë: -nr. (21246-01274-60-2019)2347 akti, datë 22.07.2019 regjistrimi, me palë paditës: Ferdinand Kolila;dhe nr. (11225-01472-60-2019) 2437 akti, datë 10.09.2019 regjistrimi, me palë paditës: Vladimir Hoxha, të cilat nga verifikimi në sistemin ICMIS kanë rezultuar se nuk janë shortuar në datën 03.02.2023, në zbatim të vendimit nr.505, date 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Këto dy dosje janë me relator gjyqtarin Laurent Fucia, që nuk është pjesë më e gjykatës, si dhe janë gjetur në Zyrën e Shërbimit Vlorë. Në datën 24.09.2024, këto dosje i janë përcjellë Gjykatës të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për t'iu nënshtruar procedurës së shortit. Në kushte si më sipër komisioni ka vendosur se duhet të shortohet këto dosje mes gjyqtarëve civilist^[196] të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Nga informacioni i përcjellë nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në kuadër të materialeve të inspektimit, rezulton se pasi u verifikua raporti që gjeneron sistemi

^[195] Nga të dhënat e nxjerra nga sistemi informatik i menaxhimit të çështjeve gjyqësor, rezulton se kjo çështje është rishortuar në datën 11.07.2024 dhe i ka rënë për gjykim gjyqtarët G.Dokollari dhe tek rubrika e shënimeve nga sekretarja regjistruese janë vendosur si arsye: "...Në bazë të procesverbalit nr.238 prot. datë 11.07.2024, dosja do i nënshtrohet rishortimit ndërmjet gjyqtarëve të seksionit penal...etj". Për këtë rast procesverbali nuk është shoqëruar me urdhër nga zv/kryetarja dhe nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative, për të cilën mbetet përgjegjëse zv/kryetarja dhe komisioni i marrjes në dorëzim të dosjeve në datën 01.02.2023, kur ka filluar aktivitetin Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

^[196] Nga të dhënat e nxjerra nga sistemi informatik i menaxhimit të çështjeve gjyqësor, rezulton se çështje nr. (21246-01274-60-2019)2347 akti, datë 22.07.2019 regjistrimi është rishortuar në datën 16.09.2024 i ka rënë gjyqtarës E.Vlora dhe tek rubrika e shënimeve nga sekretarja regjistruese janë vendosur si arsye: "...Në bazë të procesverbalit "Konstatimi" Nr.290 Prot. dt.25.09.2024. Dosjet duhet të shortohen në zbatim të vendimit nr.505, dt. 21.11.2022 të KLGJ-së...etj" si dhe nr. (11225-01472-60-2019) 2437 akti, datë 10.09.2019 regjistrimi është rishortuar në datën 16.09.2024 i ka rënë gjyqtarit A.Kalaja dhe tek rubrika e shënimeve nga sekretarja regjistruese janë vendosur si arsye: "...Në bazë të procesverbalit "Konstatimi" Nr.290 Prot. dt.25.09.2024. Dosjet duhet të shortohen në zbatim të vendimit nr.505, dt. 21.11.2022 të KLGJ-së...etj". Për këto raste procesverbali nuk është shoqëruar me urdhër nga zv/kryetarja dhe nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative, për të cilën mbetet përgjegjëse zv/kryetarja dhe komisioni i marrjes në dosjezin të disjeve në datën 01.02.2023, kur ka filluar aktivitetin Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

informatik ICMIS për shortin normal për muajin janar 2025, nuk u konstatuan çështje gjyqësore të cilat janë rregjistruar në fund të vitit 2024 nga kryesekretaria e gjykatës dhe që janë hedhur në shortin e muajit janar 2025.

Vlen të theksohet se nga sekretarja regjistruese që merret me regjistrimin e dosjeve në sistem apo punonjësi i IT-së, nuk janë zbatuar sa dhe si duhet urdhërat e drejtuesit të gjykatës, në rastin kur gjyqtarët që kanë pengesa ligjore duhet të përjashtohen me komanda në sistem në kohën që regjistrohet dosja gjyqësore apo rishortohet pasi janë konstatuar raste kur janë hedhur dosje që nuk duhet të rishortoheshin apo caktoheshin manualisht. Veç sa mësipër edhe drejtuesi i gjykatës dhe kancelarja nuk kanë vlerësuar sa dhe si duhet procedurat e shortit apo ndjekjen e veprimtarisë që kryejnë strukturat e administratës gjyqësore të angazhuara në procesin e hedhjes së shortit dhe në rastet kur dosjet janë hedhur gabim, nuk janë mbajtur procesverbale për pasqyrimin e këtyre veprimeve.

Në lidhje me paragrafin sa më lart rezulton se janë mbajtur edhe procesverbale konstatimi për dosje të regjistruara gabim nga sekretarja regjistruese dhe të cilat janë shortuar tek gjyqtarë që nuk duhet tu binin për vetë kolegjin ku ato bënin pjesë në gjykime, e konkretisht me:

- a) -procesverbal konstatimi^[197] nr. 132 prot., datë 03.04.2023, një komison i përbërë nga kancelarja e gjykatës znj.L.Balili, k/sekretare znj.R.Kapexhiu, dhe sekretare gjyqësore znj. F.Danga, kanë konstatuar se gabimisht nga sekretarja regjistruese dosja penale që mban nr. (59129-01983-30-2024) 1244 akti datë 02.04.2024 regjistrimi, është shortuar dhe i ka rënë gjyqtarit te kolegjit penal z. Qemal Zaimi, i cili nuk është kompetent për gjykimin e çështjeve specifike "Për gjykimin e të miturve" dhe dosja duhet të rishortohet tek gjyqtari kompetent. Ndodhur në këto kushte është bërë rishortimi i kësaj çështje mes gjyqtarëve kompetent.
- b) -procesverbal nr. 186 prot., datë 14.05.2024, një komison i përbërë nga kancelarja e gjykatës znj.L.Balili, k/sekretare znj.R.Kapexhiu, sekretare gjyqësore znj. L.Miri, dhe specialisti i IT-së z.R.Papa, kanë konstatuar se me datë 15.06.2023, është regjistruar dosja gjyqësore me nr. 6439 akti e nr. (21313-02441-30-2023) sistemi me palë kërkuese: Arlind Ramadani, me objekt: "Korigjim gabimi material". Pas hedhjes në short kjo dosje i ka rënë gjyqtarës V.Vata, ndërkohë që me datë 26.09.2022 me të njëjtën palë Arlind Ramadani, është regjistruar edhe dosja nr. 394/196 akti e nr. (21249-00321-20-2022) sistemi, me objekt: "Detyrimin e të paditurit për dëmshpërblim për zgjidhjen pa shkaqe të arsyeshme të kontratës së punës" dhe nga shorti i ka rënë për gjykim gjyqtarës A.Ahmeti. Në kushtet si më sipër komisioni ka konkluduar se dosja nr. 6439 akti e nr. (21313-02441-30-2023) sistemi datë 15.06.2023 regjistrimi duhet të jetë pjesë e dosjes nr. 394/196 akti e nr. (21249-00321-20-2022) sistemi datë 26.09.2022 dhe për këtë fakt duhet të bëhet

^[197] Në këtë procesverbal data është hedhur gabim në vit, pasi thahet "03.04.2023", në fakt duhet të jetë "03.04.2024", nr. i çështjes është hedhur gabim (59129-01983-30-2024), në fakt sipas sistemit është (59129-01938-30-2024). Për këtë rast nuk rezulton të jetë lëshuar urdhër i brendshëm nga zv/ kryetarja mbi bazën e procesverbalit të konstatimit të komisionit. Thahet në procesverbal se një kopje i njoftohet zv/kryetarit por rezulton se zv/kryetarja nuk ka nënshkrim për marrjen dijeni të tij. Në rishortimin e datës 11.04.2024, ko dosje i ka rënë gjyqtarit relator z. Funt Vjerdha (në RRV rezulton se shënimeet përmbajne arsyet e poshtëthënara: "... Çështja u rishortua/Çështja i është caktuar GMC-së 177; Arsyetja: Në bazë të procesverbalit nr. 132 prot. dt.03.04.2024, dosja është e seksionit të të miturve. Dosja Rishortohet ndërmjet seksionit me të mitur.....etj ") dhe këto shënime janë hedhur me komanda në sistem të zv/kryetares znj. V.Hoxha.

kalimi i çështjes edhe me sistemin elektronik^[198].

- c) -proçesverbal nr. 194 prot., datë 16.05.2024, një komison i përbërë nga kancelarja e gjykatës znj.L.Balili, k/sekretare znj.R.Kapexhiu, sekretare gjyqësore znj. L.Miri, dhe specialisti i IT-së z.R.Papa, kanë konstatuar se me datë 25.06.2018, është regjistruar dosja gjyqësore me nr. 1902 akti e nr. (21300-02093-30-2018) sistemi me palë kërkuese: Hajri Dushaj..etj, me objekt: "Kërkesë për ndreqje gabimi dhe plotësim vendimi nr. 2715 viti 2018...etj". Pas hedhjes në short kjo dosje i ka rënë gjyqtarit S.Pina, ndërkohë që me datë 14.06.2018 me të njëjtën palë Hajri Dushaj..etj, është regjistruar edhe dosja nr. 4497 akti e nr. (11118-01981-30-2018) sistemi, me objekt: "Shpërblim dëmi pasuror dhe jo pasuror" dhe nga shorti i ka rënë për gjykim gjyqtarës A.Ahmeti. Në kushtet si më sipër komisioni ka konkluduar se dosja nr. 1902 akti e nr. (21300-02093-30-2018) sistemi datë 25.06.2018 regjistrimi duhet të jetë pjesë e dosjes nr. 4497 akti e nr. (11118-01981-30-2018) sistemi, datë 14.06.2018 dhe për këtë fakt duhet të bëhet kalimi i çështjes edhe me sistemin elektronik^[199].
- d) -proçesverbal nr. 211 prot., datë 06.06.2024, një komison i përbërë nga kancelarja e gjykatës znj.L.Balili, k/sekretare znj.R.Kapexhiu, sekretare gjyqësore znj.L.Miri, dhe specialisti i IT-së z.R.Papa, kanë konstatuar se janë regjistruar në sistem dosja gjyqësore me nr. 435 akti me objekt: "Njohje të vendimit të huaj...etj" dhe dosja nr. 98 akti me objekt: "Lëshim urdhër mbrojtje" ku pas hedhjes në short këto dosje, i ka rënë gjyqtarës V.Hoxha, që nuk bën pjesë në seksionin civil por në seksionin penal.Aktivizimi i gjyqtarës V.Hoxha është bërë gabimisht tek opsioni i çështjeve civile të veçanta dhe në këto kushte kanë konkluduar, që dosjet të rishortohen ndërmjet gjyqtarëve të seksionit civil^[200].
- e) -proçesverbal nr. 232 prot., datë 08.07.2024, një komison i përbërë nga kancelarja e gjykatës znj.L.Balili, k/sekretare znj.R.Bubjaku, dhe sekretaret gjyqësore

^[198] Ky proçesverbal rezulton se nga komisioni nuk i është dërguar për miratim zv/kryetarës së gjykatës, që kjo e fundit të lëshonte urdhër të mbrendshëm për kryerjen e procedurave në vazhdim, si dhe nuk i është dërguar për njohje gjyqtarës znj. A.Ahmeti që kishte dosjen bazë atë me nr. (21249-00321-20-2022) 394/196 akti, datë 26.09.2022 regjistrimi, për të disponuar në lidhje me këtë fakt. Gjithashtu nga verifikimi në sistemin informatik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore të gjykatës, rezulton se për çështjen civile nr. (21313-02441-30-2023) 6439 akti datë 15.06.2023 regjistrimi me kërkuess: Arlind Ramadani, në datën 17.05.2024, me short manual tek RJV në pjesën e shënimeve është vendosur si arsye: "... GMC ka ndryshuar. Gjyqtari i Vjetër: [v.vata], Gjyqtari i Ri: [Aahmeti], Arsyeja e Ndryshimit: [Në bazë të proçesverbalit nr.186 prot. dt.14.05.2024, dosja do kalojë tek gjyqtare A.Ahmeti.]...etj", ndërkohë që rezulton se përsëri në vitin 2025 është trajtuar në rishort tek gjyqtarja E.Vlora. Pra rezulton se aktet e mbajtuara në këtë formë, nuk e kanë përmbyllur procedurën, për të cilin komisioni e ka nisur, duke bërë përgjegjës në rradhë të parë komisionin, dhe në rradhë të dytë zv/kryetarën e gjykatës znj. V.Hoxha.

^[199] Ky proçesverbal rezulton se nga komisioni nuk i është dërguar për miratim zv/kryetarës së gjykatës, që kjo e fundit të lëshonte urdhër të mbrendshëm për kryerjen e procedurave në vazhdim, si dhe nuk i është dërguar për njohje gjyqtarës znj. A.Ahmeti që kishte dosjen bazë atë me nr. (11118-01981-30-2018) 4497 akti, datë 14.06.2018 regjistrimi, për të disponuar në lidhje me këtë fakt. Pra rezulton se aktet e mbajtuara në këtë formë, nuk e kanë përmbyllur procedurën, për të cilin komisioni e ka nisur, duke bërë përgjegjës në rradhë të parë komisionin, dhe në rradhë të dytë zv/kryetarën e gjykatës znj. V.Hoxha.

^[200] Ky proçesverbal rezulton se nga komisioni nuk i është dërguar për miratim zv/kryetarës së gjykatës, që kjo e fundit të lëshonte urdhër të mbrendshëm për kryerjen e procedurave në vazhdim. Pra rezulton se aktet e mbajtuara në këtë formë, nuk e kanë përmbyllur procedurën, për të cilin komisioni e ka nisur, duke bërë përgjegjës në rradhë të parë komisionin, dhe në rradhë të dytë zv/kryetarën e gjykatës znj. V.Hoxha (pasi shorti është hedhur në sistem me komanda të saj). Në sistem dy çështjet kanë këto të dhëna: nr. (90006-02511-30-2024) 435 akti datë 05.06.2024 regjistrimi me kërkuess: Armir Cara dhe me objekt: "...Njohjen dhe dhënien fuqi në Republikën e Shqipërisë të vendimit të gjykatës së huaj, me nr. 1807/2019, RG n. 4364/2019, datë 29.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bergamo, Seksioni i Parë Civil, Itali...etj", ku në rishortim i ka rënë gjyqtarës I.Bezuti dhe nr. (90800-02528-30-2024) 98 akti datë 06.06.2024 regjistrimi me paditëse: Fatbardha Ulbrich, dhe me objekt: "...Lëshimin e urdhër të menjëhershëm të mbrojtjes...etj", ku në rishortim i ka rënë gjyqtarës A.Koljoka.

znj.A.Licollari e znj. L.Vladi, kanë konstatuar se është regjistruar në sistem dosja gjyqësore me nr. 1632 akti datë 05.07.2024 regjistrimi dhe nr. (61010-04259-30-2024) sistemi, me palë kërkuese: Adhurim Qehajaj me objekt: "Shuarjen e masës së sigurimit "Arrest në burg", ku pas hedhjes në short kjo dosje, i ka rënë gabimisht gjyqtarës E.Petri, me argumentin se ka dosjen e themelit për shqyrtim. Gjyqtarja relatore znj. E.Petri pasi ka studiuar detajet e dosjes penale të themelit që ka për shqyrtim gjyqësor, ka kthyer dosjen nr. 1632 akti datë 05.07.2024...etj, në kryesekretari të gjykatës, me argumentin se: "... nuk i përket të njëjtin procedim penal...etj". Në këto kushte komisioni ka konkluduar, që dosja të rishortohen mes gjyqtarëve të gatshëm të grafikut të datave 01-07 korrik 2024, periudhë gjatë të cilës dosja penale nr. 1632 akti datë 05.07.2024, ka ardhur për regjistrim pranë kësaj gjykate.^[201]

f) -procesverbal nr. 257 prot., datë 22.07.2024, një komison i përbërë nga kancelarja e gjykatës znj.L.Balili, sekretare gjyqësore znj.L.Miri, dhe specialisti i IT-së z.R.Papa, kanë konstatuar se janë regjistruar në sistem me datë 19.07.2024 kërkesat civile me nr. 539 akti e nr. çështje (90006-03303-30-2024) me kërkuës: Daniela Salaj me objekt: "Njohje të vendimit të huaj...etj" si dhe kërkesa nr.543 akti e nr. çështje (90006-03309-30-2024) me kërkuës: Ardiana Martinaj me objekt: "Njohje të vendimit të huaj...etj". Pas kryerjes së regjistrimit sekretarja regjistruese i ka kërkuar specialistit të IT-së, të bëjë kalimin tek gjyqtare Elona Mihali, të dosjes nr. 539 akti e nr. çështje (90006-03303-30-2024) datë 19.07.2024 regjistrimi, pasi ishte kërkesë e pushuar më parë, po nga kjo gjyqtare me nr. 306 vendimi datë 29.04.2024 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Gabimisht nga ana e specialistit të IT-së kërkesa civile me nr.543 akti e nr. çështje (90006-03309-30-2024) datë 19.07.2024 regjistrimi i ka kaluar gjyqtarës Elona Mihali në vend të kërkesës nr. 539 akti e nr. çështje (90006-03303-30-2024) datë 19.07.2024 regjistrimi.^[202]

g) -procesverbal konstatimi nr.263 prot., datë 19.08.2024, një komison i përbërë nga zv/kryetarja e deleguar znj. A.Kolgjoka, k/sekretare znj.R.Kapexhiu, sekretare gjyqësore znj.S.Gjoka, dhe specialisti i IT-së z.R.Papa, kanë konstatuar se janë

^[201] Ky procesverbal rezulton se nga komisioni nuk i është dërguar për miratim zv/kryetarës së gjykatës, që kjo e fundit të lëshonte urdhër të mbrendshëm për kryerjen e procedurave në vazhdim. Dosja penale nr. (61010-04259-30-2024) 1632 akti datë 05.07.2024 regjistrimi, pasi është rishortuar i ka rënë për gjykim gjyqtarit G.Dokollari që ka qenë i gatshëm në periudhën nga data 01.07.2024 deri 07.07.2024, ku krahas tij të gatshëm kanë qenë edhe dy gjyqtarët A.Duka dhe D.Goxha. Nga verifikimi në sistemin informatik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore parë në gjykatës rezulton se gjyqtarja znj. E.Petri ka për gjykim çështjen penale që ka këto të dhëna: nr. (53812-01123-30-2023) 1455 akti datë 15.03.2023, dosje për të cilën vetë kjo gjyqtare ka relatuar se dy dosjet nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën pasi kanë procedime të ndryshme penale.

^[202] Ky procesverbal rezulton se nga komisioni nuk i është dërguar për miratim zv/kryetarës së gjykatës, që kjo e fundit të lëshonte urdhër të mbrendshëm për kryerjen e procedurave në vazhdim. Pra rezulton se aktet e mbajtuara në këtë formë, nuk e kanë përmbushur procedurën, për të cilin komisioni e ka nisur, duke bërë përgjegjësis në radhë të parë komisionin, dhe në radhë të dytë zv/kryetarën e gjykatës znj. V.Hoxha (pasi shorti është hedhur në sistem me komanda të saj). Nga verifikimi në sistem rezulton se kërkesa civile nr. (90006-03303-30-2024) 539 akti datë 19.07.2024 regjistrimi me me kërkuës: Daniela Salaj me objekt: "Njohje të vendimit të huaj...etj", i është kaluar në short në datë 19.07.2024 gjyqtarës I.Bezati dhe me datë 22.07.2024 gjyqtarës E.Mihali me arsye e ndryshimit: "Dosja do i kalojë gjyqtare E.Mihali, pasi ka gjykuar kërkesën më parë dhe ka vendosur pushimin e çështjes", ndërsa kërkesa civile me nr. (90006-03309-30-2024) 543 akti datë 19.07.2024 regjistrimi me kërkuës: Ardiana Martinaj (pasi në sistem është janë hedhur këto gjenaralitete të kërkuës dhe jo Ardiana Martinaj) me objekt: "Njohje të vendimit të huaj...etj" i është kaluar në short manual të datës 19.07.2024 gjyqtarës E.Mihali, me arsye të caktimit manual: "Dosja do i kalojë gjyqtarës E.Mihali si gjyqtare që ka gjykuar më parë çështjen", por në këtë rast edhe pse komisioni e pranon se e ka hedhur gabim këtë çështje nuk ka bërë rishortim të saj për të rregulluar gabimin, por ja ka kaluar për gjykim po gjyqtarës E.Mihali.

regjistruar në sistem dosja gjyqësore me nr. (60612-04900-30-2024) akti dhe nr. (60612-04901-30-2024) akti ku pas hedhjes në short këto dosje, u kanë rënë gjyqtarëve të gatshëm për periudhën 12-18 gusht 2024 dhe se kjo ka ndodh për shkak të mos ndryshimit të urdhërit të gatishmërisë, ku gjyqtarë të gatshëm janë A.Kolgjoka, A.Duka dhe D.Goxha [referuar vendimit "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente në muajin gusht" (shkresa nr. 228 prot., datë 01.07.2024).]. Ndodhur në këto kushte komisioni ka vendosur që dy dosjet të rishortohen tek gjyqtarët e gatshëm^[203].

- h) -procesverbal konstatimi nr. 295 prot., datë 07.10.2024, një komison i përbërë nga zv/kryetarja e gjykatës znj.V.Hoxha, kancelarja e gjykatës znj.L.Balili, k/sekretare znj.R.Bubjaku, sekretare gjyqësore znj.B.Xhelo dhe specialisti i IT-së z.R.Papa, kanë konstatuar se dosja penale që mban nr. (52102-04742-30-2024) 3090 akti datë 29.07.2024 regjistrimi, që i përket të pandehurit Arjan Tase, është shortuar dhe i ka rënë gjyqtarit relator z.D.Hasani. Sipas verifikimit të vendimit trashigimtarët e viktimës që janë prindërit (Bledar Avdia dhe Ermira Mamica) dhe vet viktimja ka qenë e mitur. Kjo dosje është shprehur komisioni, duhet të shortohet në bazë të vendimit nr. 1, datë 02.02.2023 të Këshillit të Gjykatës tek gjyqtarët që gjykojnë të miturit, konkretisht tek gjyqtarët L.Celami, E.Petri, B.Ukperaj dhe F.Vjerdha, pasi gjyqtari D.Hasani, nuk është kompetent për gjykimin e çështjeve specifike "Për gjykimin e të miturve". Ndodhur në këto kushte është bërë rishortimi^[204] i kësaj çështje mes gjyqtarëve kompetent L.Celami, E.Petri, B.Ukperaj dhe F.Vjerdha.
- i) -procesverbal konstatimi nr. 296 prot., datë 07.10.2024, një komison i përbërë nga zv/kryetarja e gjykatës znj.V.Hoxha, kancelarja e gjykatës znj.L.Balili, k/sekretare znj.R.Bubjaku, sekretare gjyqësore znj.B.Xhelo dhe specialisti i IT-së z.R.Papa, kanë konstatuar se dosja penale që mban nr. (53101-01650-30-2017) 4030 akti datë 12.06.2017 regjistrimi, që i përket të pandehurëve Enrik Ismalaj, Agjelo Muska, e Amarildo Meslani, është rishortuar me datë 03.02.2023 dhe i ka rënë gjyqtarit relator z.V.Hoxha. Sipas verifikimit të vendimit Enrik Ismalaj ka qenë e mitur në kohën e kryerjes së veprës penale. Kjo dosje është shprehur komisioni, duhet të shortohet në bazë të vendimit nr. 1, datë 02.02.2023 të Këshillit të Gjykatës tek

^[203] Për çështjen gjyqësore nr. (60612-04900-30-2024) 1952 akti datë 19.08.2024 regjistrimi me kërkuar: Leonard Sufa dhe me objekt: "...Shuarjen e masës së sigurimit personal "Arrest në shtëpi"...etj", ku në short i ka rënë fillimisht gjyqtarës I.Brahimi dhe në rishortim i ka rënë gjyqtarës A.Duka, çështje të cilën e kanë gjykuar krahas gjyqtarës A. Duka (relatore) edhe gjyqtarët E.Petri dhe D.Goxha (anëtarë), kemi dhënë shpjegime të detajuara në pjesë të mësipërme të këtij raporti konkretisht tek rubrika "6. Zëvendësimi i anëtarit të trupit gjyqësor dhe plotësimi me anëtar i trupit gjyqësor". Në këtë pjesë të raportit gjen pasqyrim edhe fakti pse gjyqtare A. Kolgjoka, nuk ka gjykuar, ndonëse ka qenë e gatshme, ku në vend të saj ka gjykuar gjyqtare E.Petri. Thëksoj se për caktimin e gjyqtarës E.Petri nuk ka asnjë akt të zv/kryetarit që të legjitimoi caktimin e saj si anëtare në këtë çështje.

Për çështjen gjyqësore nr. (60612-04901-30-2024) 1953 akti datë 19.08.2024 regjistrimi me kërkuar: Lirim Durdaj dhe me objekt: "...Shuarjen e masës së sigurimit personal "Arrest në shtëpi"...etj", ku në short i ka rënë fillimisht gjyqtarës L.Celami dhe në rishortim i ka rënë gjyqtarës A.Kolgjoka, çështje të cilën e kanë gjykuar krahas gjyqtarës D.Goxha (relatore) edhe gjyqtarët E.Petri dhe A.Duka (anëtarë), kemi dhënë shpjegime të detajuara në pjesë të mësipërme të këtij raporti konkretisht tek rubrika "1. Transparenca e dokumentimit të përgatitjes së shortit". Në këtë pjesë të raportit gjen pasqyrim edhe fakti pse gjyqtare A. Kolgjoka, nuk ka gjykuar, ndonëse ka qenë e gatshme, ku në vend të saj ka gjykuar gjyqtare E.Petri.

^[204] Nga verifikimi në sistem i çështjes penale nr. (52102-04742-30-2024) 3090 akti datë 29.07.2024 regjistrimi, që i përket të pandehurit Arjan Tase...etj, rezulton se pas rishortimit kjo çështje në datën 07.10.2024 i ka rënë për gjykim gjyqtarës E.Petri dhe tek arsyja e ndryshimit është vendosur shënimi: [Në bazë të procesverbalit 295 prot. dt.07.10.2024, dosja do shortohet ndërmjet gjyqtarëve të seksionit me të mitur.]. Në përbërje të trupit gjyqësor janë caktuar dy anëtarë M.Pepi dhe F.Islamaj, por nuk është mbajtur asnjë akt nga zv/kryetarja, për mënyrën se si janë caktuar këto dy anëtarë në përbërje të trupit gjyqësor.

gjyqtarët që gjykojnë të miturit, konkretisht tek gjyqtarët L.Celami, E.Petri, B.Ukperaj dhe F.Vjerdha. Ndodhur në këto kushte është bërë rishortimi^[205] i kësaj çështje me gjyqtarëve L.Celami, E.Petri, B.Ukperaj dhe F.Vjerdha, të cilët janë kompetent për gjykimin e çështjeve me të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur viktimë nga vepra penale.

Gjata verifikimit të raporteve që gjeneron sistemi informatik i menaxhimit të çështjeve gjyqësore, rezulton se janë shortuar manualisht apo rishortuar çështje tek gjyqtarët në një kohë që ka përfunduar gjykimi i tyre, gjë e cila ka ardhur si rezultat i mos evidentimit të saktë të çështjeve që duhet të trajtoheshin në këtë procedura, qoftë nga kryesekretaria apo punonjësi i IT-së, qoftë nga kancelari e zëvendëskryetari dhe i mosmbylljes së çështjeve në sistem nga sekretarët e seancave që janë marrë me procesin gjyqësor (dhe që kanë punuar pranë gjyqtarëve që kanë gjykuar këto raste) si dhe lëvizjen e dosjeve me komanda në sistem nga njëri përdorues tek tjetri.

Nga analiza e këtyre të dhënave u konstatuan probleme në rastet e hedhjes së shortit për:

a) caktimet manuale si:

-shënimet jo gjithmonë pasqyrojnë justifikimin ligjor që e kanë detyruar drejtuesin e gjykatës të kalojë çështjen tek gjyqtari;

-nuk vendosin në arsye si justifikim numrin elektronik të çështjes gjyqësore që gjyqtari ka gjykuar më parë, me qëllim që të bëhet lidhja me çështjeve që duhet të gjykohen nga i njëjti gjyqtar (gjyqtari i seancës së hetimit paraprak);

-nuk vendosin në arsye numrin dhe datën e urdhërit të grafikut të gadishmërisë, i cili përbën shkak ligjor që çështja i kalohet gjyqtarit të caktuar për gjykimin e çështjeve urgjente (konkretisht për kërkesat penale gjatë hetimeve paraprake);

-janë vendosur shënime se dosjet janë hedhur gabim ose janë hedhur kur ato kanë qenë të përfunduara, por për vetë faktin se nuk i kanë mbyllur gjyqtarët edhe në sistem ato përsëri janë caktuar në gjyqtarë të tjerë;

-sistemi i ICMIS në raportin që gjeneron nuk pasqyron veprimet në kronologji, që kanë ndodhur në caktimin e shortit manual, pasi jep gjyqtarin që ka pasur çështjen fillimisht dhe nëse kjo çështje, është shortuar në vazhdim mbi më shumë se një gjyqtar, ai pasqyron gjyqtarin që i është caktuar të fundit, duke bërë që arsyet e shënimeve të mos gjejnë përputhje me veprimin që është bërë në fakt me dosjen.

Për 3 (tre) raste çështjet u ishin kaluar për të kryer veprime gjyqtarëve jo në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që janë në fuqi dhe bëhet fjalë për çështjen nr. (61010-06782-30-2023) 2627 akti datë regjistrimi 29.12.2023; -nr. (90006-05420-30-2024) 992 akti datë regjistrimi 20.12.2024; -nr. (21314-00194-20-2019) 60 akti datë regjistrimi 19.03.2019; për të cilat zv/kryetarja dhe kancelarja e gjykatës nuk kanë zbatuar procedurat ligjore të shortimit manual të tyre.

^[205] Nga verifikimi në sistem i çështjes penale nr. (53101-01650-30-2017) 4030 akti datë 12.06.2017 regjistrimi, që i përket të pandehurëve Enrik Ismailaj, Agjelo Muska, e Amarildo Meslani...etj, rezultoi se pas rishortimit kjo çështje në datën 07.10.2024 i ka rënë për gjykim gjyqtarës E.Petri dhe tek arsyetja e ndryshimit është vendosur shënimi: [Në bazë të procesverbalit 296 prot. dt.07.10.2024, dosja do shortohet ndërmjet gjyqtarëve të seksionit me të mitur.]. Në përbërje të trupit gjykoës janë caktuar dy anëtarët M.Pepi dhe F.Islamaj, por nuk është mbajtur asnjë akt nga zv/kryetarja, për mënyrën se si janë caktuar këto dy anëtarë në përbërje të trupit gjykoës.

b) rishortimet si:

- shënimet jo gjithmonë pasqyrojnë justifikimin ligjor që e kanë detyruar drejtuesin e gjykatës që të rishortojë çështjen;

- nuk kanë vendosur në arsye si justifikim numrin dhe datën e vendimit të kryetarit të gjykatës, apo të këshillit të gjykatës, kur ka pasur raste të tilla, që dosjet janë rishortuar për shkak të këtyre vendimarrjeve;

- nuk kanë vendosur në arsye si justifikim vendimarrjen e gjykatës me treguesit numër elektronik/ fizik dhe datë vendimi, e cila ka pranuar përjashtimin e gjyqtarit nga çështja, kur ka pasur raste të tilla;

- në disa raste çështjet janë rishortuar gabim tek disa gjyqtarë të tjerë kur dosja ka qenë e planifikuar nga trupi gjykues për gjykimin e themelit; si dhe,

- sistemi i ICMIS në raportin që gjeneron nuk pasqyron veprimet në kronologji, që kanë ndodhur në rishortimin e çështjeve, pasi jep gjyqtarin që ka pasur çështjen fillimisht dhe nëse kjo çështje, është rishortuar në vazhdim mbi më shumë se një gjyqtar, ai pasqyron gjyqtarin që i është caktuar të fundit, duke bërë që arsyet e shënimeve të mos gjejnë përputhje me veprimin që është bërë në fakt me dosjen.

Për 2 (dy) raste çështjet u ishin kaluar për të kryer veprime gjyqtarëve jo në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që janë në fuqi dhe bëhet fjalë për çështjen-nr. (31005-00220-50-2016) 1012 akti datë regjistrimi 19.02.2016; si dhe -nr. (71036-00781-30-2024) 518 akti datë regjistrimi 06.02.2024; për të cilat zv/kryetarja dhe kancelerja e gjykatës nuk kanë zbatuar procedurat ligjore të rishortimit të tyre.

Janë rishortuar 4 (katër) dosje të ardhura: - 3 (tre) nga ish-Gjykata e Apelit Vlorë; dhe, -1 (një) nga ish-Gjykata e Apelit Gjirokastrë, të cilat nuk janë marrë në dorëzim së bashku me dosjet e tjera të këtyre dy gjykatave, në datën 01.02.2023 dhe që i kanë pasur për gjykim si relatorë, gjyqtarë që nuk e ushtrojnë më detyrën e magjistratit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Rishortimi i këtyre dosjeve me kaq vonesë, për shkak të kësaj problematike ka bërë që dosjet të mos vihen në lëvizje nga trupat gjykues, duke u bërë përgjegjës punonjësit e zyrave të shërbimit të këtyre dy gjykatave, komisioni i ngritur nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe zv/kryetarja e gjykatës, të cilët nuk kanë zbatuar kërkesat e nenit 6 "Transferimi i çështjeve gjyqësore", pika "b" të vendimit nr.505, datë 21.11.2022 "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm", të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në të cilin ndër të tjera thuhet se: "... b) "...1.Çështjet gjyqësore të regjistruara në Gjykatën e Apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë deri në datën 31.01.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit, transferohen në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.2.Çështjet gjyqësore që transferohen në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, regjistrohen në regjistrat manualë dhe sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve ICMIS. 3.Për zbatimin e pikës 1 dhe 2 të këtij neni ngarkohet Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor....etj". Gjithashtu për këto dosje, rezulton se nga zv/kryetarja e gjykatës nuk është disponuar me urdhër për mënyrën se kujt kategorie gjyqtarësh duhej t'u rishortoheshin.

Gjatë këtij inspektimi u konstatuan edhe problematika të tilla si:

- nuk është marrë asnjë nismë për rregullimin e defekteve në sistemin e menaxhimit të çështjeve, me qëllim që problematika e pasqyrimin gabim të informacionit në raportet e shortit manual dhe rishortimeve, sa i përket veprimeve të bëra në kronologji me dosjet të mos ndodhë;

- nuk janë zbatuar sa dhe si duhet urdhërat e drejtuesit të gjykatës, në ato raste kur gjyqtarët që kanë pengesa ligjore duhet të përjashtohen me komanda në sistem në kohën që regjistrohet dosja gjyqësore apo rishortohet, pasi janë konstatuar raste kur janë hedhur dosje që nuk duhet të rishortoheshin apo caktoheshin manualisht, këtu përfshi edhe mospërzgjedhjen e saktë të dosjeve që nuk duhet të rishortoheshin, që ka ndodhë në disa raste;

- drejtuesi i gjykatës dhe kancelarja nuk kanë vlerësuar sa dhe si duhet procedurat e shortit apo ndjekjen e veprimtarisë që kryejnë strukturat e administratës gjyqësore të angazhuara në procesin e hedhjes së shortit në rastet kur dosjet janë hedhur gabim nuk janë mbajtur procesverbale për pasqyrimin e këtyre veprimeve.

Veprimet e mësipërme nuk janë në koherencë me udhëzuesit për sistemin ICMIS "Funksionalitetet dhe të drejtat e përdoruesve në sistemin ICMIS", të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë në janar 2016, si dhe me kërkesat e Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore" si dhe rregulloret e brendshme që parashikojnë detyrat për të gjithë punonjësit e administratës gjyqësore.

b) Ngarkesa sasiore e gjyqtarëve

Lidhur me ngarkesën sasiore të secilit gjyqtar që është pjesë e trupës gjyqësore e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në periudhën e inspektuar 01 janar 2024 - 31 dhjetor 2024, është konstatuar se ajo varion nga **253-1861** çështje. Të dhënat konkrete, sipas gjyqtarëve, janë:

1. Gjyqtarës Alma Ahmeti përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **613** çështje;
2. Gjyqtarës Alma Kolgjoka përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **628** çështje;
3. Gjyqtarës Anila Karanxha përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **1844** çështje;
4. Gjyqtarës Arta Duka përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **628** çështje;
5. Gjyqtarës Astrit Kalaja përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **619** çështje;
6. Gjyqtarës Brikena Ukperaj përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **912** çështje;
7. Gjyqtarës Diamela Goxha përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **1265** çështje;
8. Gjyqtarës Dritan Hasani përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **545** çështje;
9. Gjyqtarës Edlira Petri përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **519** çështje;
10. Gjyqtarës Elona Mihali përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **602** çështje;
11. Gjyqtarës Elona Toro përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **621** çështje;
12. Gjyqtarës Enkela Vlora përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **1861** çështje;
13. Gjyqtarës Fatri Islamaj përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **480** çështje;
14. Gjyqtarës Fuat Vjerdha përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **490** çështje;
15. Gjyqtarës Genti Dokollari përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **525** çështje;
16. Gjyqtarës Genti Shala përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **508** çështje;

17. Gjyqtarës Iliba Bezati përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **561** çështje;
18. Gjyqtarës Irena Brahimi përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **505** çështje;
19. Gjyqtarës Irida Kacerja përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **584** çështje;
20. Gjyqtarës Lutfije Celami përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **503** çështje;
21. Gjyqtarës Marsela Dervishi përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **579** çështje;
22. Gjyqtarës Marsela Pepi përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **893** çështje;
23. Gjyqtarës Miranda Andoni përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **952** çështje;
24. Gjyqtarës Ornela Naqellari përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **573** çështje;
25. Gjyqtarës Qemal Zaimi përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **906** çështje;
26. Gjyqtarës Sokol Pina përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **607** çështje;
27. Gjyqtarës Valbona Vata përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **632** çështje;
28. Gjyqtarës Valdete Hoxha përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithsej **253** çështje.

Nga analiza e këtyre të dhënave, konstatohet se gjyqtarët kanë patur diferenca të vogla në ndarjen e çështjeve. Zv/Kryetarës së Gjykatës znj.Valdete Hoxha, për vitin 2024 i janë caktuar 253 çështje, që zënë 1.25 % të ngarkesës mesatare të gjyqtarëve.Referuar raporteve të shortit rezultojnë se ajo është aktivizuar për pjesëmarrje në short në masën 50% dhe jo si gjyqtarët e tjerë në masën 100%. Në këtë mënyrë, ajo ka diferencuar vetveten në ngarkesë sasiore, sipas pikës 6, kreu V. Përjashtimi i gjyqtarit nga shorti të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", sipas të cilit thuhet se: "...6. Kryetari i gjykatave të mëdha mund të marrë një ngarkesë pune, jo më pak se 50% të ngarkesës së çdo gjyqtari, ndërsa kryetari i gjykatave të një madhësie mesatare e atyre të vogla, një ngarkesë pune jo më pak se 75% të ngarkesës së punës së një gjyqtari...etj".

Edhe gjyqtarët e tjerë kanë numër të vogël çështjesh për gjykim të cilat kanë të bëjnë me faktin se i janë nënshtruar procedurave të shortit jo të gjithë në të njëjtën kohë, pasi emërimet e tyre janë bërë në kohë të ndryshme, por konstatohet se për pjesëmarrjen në short në masën 50% të ngarkesës në punë, për muajit prill 2024 dhe maj 2024, janë përjashtuar nga shorti edhe gjyqtarët znj. Brikena Ukperaj; znj.Marsela Pepi; znj.Miranda Andoni; dhe z.Qemal Zaimi, për të cilët gjatë inspektimit nga gjykata, u dërgua akti i titulluar vendim nr.ska, datë __.03.2024"Për përjashtimin pjesërisht të gjyqtarit nga ndarja me short e çështjeve" (shkresa nr. 124 prot., datë 28.03.2024), i lëshuar nga zv/kryetarja e gjykatës^[206]. Në këtë mënyrë, nga zv/kryetarja e gjykatës janë respektuar kërkesat e

^[206] Ndër të tjera në këtë akt argumentohet se: "...me vendimin nr. 8, datë 26.02.2024, është bërë rindarja me short e çështjeve ka gjyqtarët D.Goxha;B.Ukperaj;M.Pepi; M.Andoni; dhe Q.Zaimi, marrin çështje të cilat nuk janë shpallur për gjykim nga gjyqtarët F.Islamaj; V.Hoxha; G.Shala;E.Petri; L.Celami; D.Hasani; F.Vjerdha;I.Brahimi dhe G.Dokollari, të ngarkuar si relator...etj. Nga të dhënat e ngarkesës së çështjeve penale ka rezultuar se totali i tyre është 12.399 të tilla.Shpërndarja e kësaj ngarkese mes gjyqtarëve është e pabarabartë.Sa i përket mesatares për gjyqtar, është bërë një përlogaritje sipas të cilës, duke konsideruar numrin e riaktualizuar të gjyqtarëve në detyrë në seksionin penal, pra 14, kjo mesatare rezultoi në rreth 887 çështje. Me shkresën nr. 110 prot., datë 18.03.2024 të zv/kryetarit ju kërkua kancelarit të gjykatës dhe specialistëve të IT-së informacion mbi ecurinë e procesit të rindarjes me short të çështjeve penale sipas vendimit nr. 8 datë 26.02.2024 të Këshillit të Gjykatës. Në përgjigje të kësaj shkrese specialistët e IT-së me shkresën nr. 120 prot., datë 21.03.2024 informojnë se është kryer procesi i rindarjes me short të çështjeve penale sipas vendimit nr. 8 dt 26.02.2024 të Këshillit të Gjykatës dhe ka rezultuar që gjyqtarët Miranda Andoni, Qemal Zaimi, Brikena Ukperaj dhe Marsela Pepi, kanë marrë një ngarkesë më të lartë se mesatarja për gjyqtar të seksionit penal, kjo për arsye se programi i menaxhimit të dosjeve nuk të ofron mundësi ndryshimi koeficienti të pjesëmarrësve (pasi koeficienti nuk mund të ndryshohet nga përdoruesi, është statik 25%; 50%; 75%; dhe 100%), në short është zgjedhur koeficienti 50% për të katër

Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", Kreu V'Përfashtimi i gjyqtarit nga shorti", pika 5 ku parashikohet se: "... 5. Në rast nevojë të diktuar nga ngarkesa e pabarabartë e punës midis gjyqtarëve, kur mekanizmi i rindarjes së çështjeve nuk mund të realizohet, kryetari me vendim të arsyetuar, përjashton plotësisht ose pjesërisht gjyqtarin nga ndarja me short e çështjeve, deri në sigurimin për aq sa është e mundur, e një ngarkese pune të barabartë midis gjyqtarëve...etj".

Nga analiza e këtyre të dhënave, konstatohet se gjyqtarët kanë patur diferenca të vogla në ndarjen e çështjeve.

Kryetarës të Gjykatës Valdete Hoxha, i janë caktuar 253 çështje, që zënë 1.25 % të ngarkesës mesatare të gjyqtarëve.Referuar raporteve të shortit rezulton se ajo është aktivizuar për pjesëmarrje në short në masën 50% dhe jo si gjyqtarët e tjerë në masën 100%. Në këtë mënyrë, ajo ka diferencuar vetveten në ngarkesë sasiore, sipas pikës 6, kreu V. Përfashtimi i gjyqtarit nga shorti të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", sipas të cilit thuhet se: "...6. Kryetari i gjykatave të mëdha mund të marrë një ngarkesë pune, jo më pak se 50% të ngarkesës së çdo gjyqtari, ndërsa kryetari i gjykatave të një madhësie mesatare e atyre të vogla, një ngarkesë pune jo më pak se 75% të ngarkesës së punës së një gjyqtari...etj". Edhe gjyqtarët e tjerë kanë numër të vogël çështjes për gjykim të cilat kanë të bëjnë me faktin se i janë nënshtruar procedurave të shortit jo të gjithë në të njëjtën kohë. Vlen të theksojmë se për muajt prill 2024 dhe maj 2024, janë përjashtuar nga shorti në masën e 50% të ngarkesës në punë edhe gjyqtarët znj. Brikena Ukperaj; znj.Marsela Pepi; znj.Miranda Andoni; dhe z.Qemal Zaimi, për të cilët gjatë inspektimit nga gjykata u dërgua vendim nr.ska, datë __.03.2024"Për përjashtimin pjesërisht të gjyqtarit nga ndarja me short e çështjeve" (shkresa nr. 124 prot., datë 28.03.2024), i lëshuar nga zv/kryetarja e gjykatës. Në këtë mënyrë, nga zv/kryetarja e gjykatës janë respektuar kërkesat e Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", Kreu V'Përfashtimi i gjyqtarit nga shorti", pika 5 ku parashikohet se: "... 5. Në rast nevojë të diktuar nga ngarkesa e pabarabartë e punës midis gjyqtarëve, kur mekanizmi i rindarjes së çështjeve nuk mund të realizohet, kryetari me vendim të arsyetuar, përjashton plotësisht ose pjesërisht gjyqtarin nga ndarja me short e çështjeve, deri në sigurimin për aq sa është e mundur, e një ngarkese pune të barabartë midis gjyqtarëve...etj".

8. Afatet e shortimit të çështjeve

Nga verifikimi i historikut të shpërndarjes së çështjeve gjyqësore me short në periudhën 01 janar 2024 - 31 dhjetor 2024, u konstatua se në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të

gjyqtarët i cili e ka zburuar ngarkesën e gjyqtarëve në krahasim me gjyqtarët e tjerë, por përsëri kjo ngarkesë ka mbetur më e lartë se ngarkesa mesatare...etj". Për këto arsye zv/kryetarja e gjykatës ka vendosur: "...1.Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (seksioni penal) z.Qemal Zaimi; znj.Miranda Andoni; znj.Brikena Ukperaj; dhe znj. Marsela Pepi, për sigurimin për aq sa është e mundur e një ngarkese pune të barabartë midis gjyqtarëve do të ngarkohen me nga 50% të çështjeve gjyqësore për periudhën 1 prill 2024 deri 1 qershor 2024...etj".

Përgjithshëm janë regjistruar të reja dhe shortuar 13814^[207] çështje gjyqësore të llojeve të ndryshme [10729 çështje në short normal dhe që përbëhen: (2882 çështje penale themeli; 1843 kërkesa penale; 4532 çështje civile themeli; 1472 kërkesa civile); dhe 3085^[208] kërkesa penale të "karakterit urgjent"].

Nga kontrolli i raporteve të përgjithshme që gjeneron Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, rezulton se për:

- a) -2882 çështje penale themeli; -1843 kërkesa penale; -4532 çështje civile themeli; -1472 kërkesa civile; shorti është hedhur në 255 raste ditën e regjistrimit të çështjes (ose për 10396 çështje); në 60 raste ditën e nesërme të regjistrimit të çështjes (ose për 211 çështje); në 2 raste 2 ditë pas datës së regjistrimit të çështjes (ose për 10 çështje); në 16 raste 3 ditë pas datës së regjistrimit të çështjes (ose për 71 çështje); në 6 raste 4 ditë pas datës së regjistrimit të çështjes (ose për 35 çështje); në 3 raste 5 ditë pas datës së regjistrimit të çështjes (ose për 4 çështje); në 1 rast 6 ditë pas datës së regjistrimit të çështjes (ose për 1 çështje); dhe në 1 rast 13 ditë pas datës së regjistrimit të çështjes (ose për 1 çështje);
- b) -262 çështje gjyqësore të hedhura në short manual, (ky i fundit është hedhur në: -106 raste brenda ditës së regjistrimit të çështjes apo daljes së aktit nga zv/kryetari për caktimin manual të çështjes apo disponimit të vendimit të ndërmjetëm të trupit gjykues për moskompetencën funksionale; -23 raste brenda 1 ditë nga regjistrimi i çështjes; -7 raste brenda 2 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -8 raste brenda 3 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -9 raste brenda 4 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -4 raste brenda 5 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -2 raste brenda 6 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -9 raste brenda 9 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 10 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -3 raste brenda 12 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -2 raste brenda 14 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -9 raste brenda 15 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -18 raste brenda 16 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 17 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -3 raste brenda 19 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -7 raste brenda 20 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -10 raste brenda 24 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -2 raste brenda 28 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 29 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 30 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 31 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 32 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -2 raste brenda 34 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 35 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 43 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 46 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -2 raste brenda 51 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -3 raste brenda 56 ditëve nga regjistrimi i çështjes;

^[207] Referuar të dhënave të pasqyruara në aktin e titullur "Raporti i i analizës vjetore të veprimtarisë së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024", kjo e fundit ka pasqyruar si çështje të regjistruara të reja në vitin 2024 se janë 13888 çështje gjyqësore, kur në fakt janë 13814 çështje gjyqësore (Shifra e 76 të këtij raporti).

^[208] Referuar të dhënave të dërguara nëpërmjet tabelës për këtë kategori çështjesh rezultoi se nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, kjo gjykatë ka dërguar të dhëna për 3088 çështje por nga përponimi i tyre në kuadër të inspektimit, ka rezultuar se 2 (dy) çështje ato me nr. (61005-03803-30-2024) 1458 akti datë 19.06.2024 regjistrimi që i përket personit nën hetim: Oltjan Kukeli; nr. (60614-03808-30-2024) 1465 akti datë 19.06.2024 regjistrimi që i përket kërkuarës: Shokëria "Dast" sh.a. janë regjistruar 2 (dy) herë, ndërsa çështja nr. (61010-04516-30-2024) 1722 akti, datë 22.07.2024 regjistrimi, me palë kërkuar: Arben Hysi, është regjistruar gabim dhe është bërë mbyllja e saj nga me procesverbal komisioni që e kemi trajtuar në këtë raport inspektimi. Duke u hequr këto 3 (tre) çështje mbeten 3085 çështje të regjistruara të karakterit urgjent.

-1 rast brenda 84 ditëve nga regjistrimi i çështjes; - 1 rast brenda 101 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 156 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 161 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -3 raste brenda 191 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 200 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 218 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 244 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -6 raste brenda 303 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 331 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -3 raste brenda 340 ditëve nga regjistrimi i çështjes; - 1 rast brenda 400 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 403 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 461 ditëve nga regjistrimi i çështjes; dhe, -1 rast brenda 527 ditëve nga regjistrimi i çështjes;);

- c) -6132 çështje gjyqësore të hedhura në rishortim, (ky i fundit është hedhur në: -33 raste brenda ditës së regjistrimit të çështjes apo daljes së aktit nga zv/kryetari për rishortim të çështjes apo disponimit të vendimit të ndërmjetëm të trupit gjykues për moskompetencën funksionale;-31 raste brenda 1 ditë nga regjistrimi i çështjes; - 758 raste brenda 2 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -719 raste brenda 3 ditëve nga regjistrimi i çështjes;-332 raste brenda 4 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -12 raste brenda 5 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -10 raste brenda 6 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -6 raste brenda 7 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -3 raste brenda 8 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -544 raste brenda 9 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -3 raste brenda 10 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 11 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -2 raste brenda 12 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -4 raste brenda 13 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -3 raste brenda 14 ditëve nga regjistrimi i çështjes;-1382 raste brenda 15 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -201 raste brenda 16 ditëve nga regjistrimi i çështjes;-1 rast brenda 17 ditëve nga regjistrimi i çështjes;-1 rast brenda 21 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 23 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 25 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -5 raste brenda 27 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 28 ditëve nga regjistrimi i çështjes;-1 rast brenda 29 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 36 ditëve nga regjistrimi i çështjes;-480 raste brenda 44 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -633 raste brenda 45 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -396 raste brenda 53 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -210 raste brenda 56 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -346 raste brenda 57 ditëve nga regjistrimi i çështjes; - 1 rast brenda 65 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 191 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 192 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -2 raste brenda 295 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 383 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 385 ditëve nga regjistrimi i çështjes; -1 rast brenda 486 ditëve nga regjistrimi i çështjes; dhe, -3 raste nuk përcaktohet afati i ditëve nga regjistrimi i çështjes;).

Për rastet e shortit normal edhe pse shorti është hedhur në këtë mënyrë vlen të theksohet se ora e hedhjes së shortit, vetëm në 16 raste është në orar (në orën 15.⁰⁰ siç është përcaktuar në urdhërin nr.3 prot., datë 04.01.2024 "Për caktimin e orës së shortit të çështjeve gjyqësore", lëshuar nga zv/kryetari i gjykatës) [ose për 844 çështje], ndërsa për 96 raste shorti është hedhur përpara orës së shortit (ose për 4350 çështje) dhe për 143 raste shorti është hedhur pas orës së tij (ose për 5535 çështje). Rastet variojnë para orës 15.⁰⁰, nga 5

orë e 3 (tre) minuta deri në 1 (një) minutë dhe pas orës 15.⁰⁰ nga 1 (një) minutë deri në 1 orë e 2 (dy) minuta.

Gjatë vitit 2024 janë hedhur 255 raunde shorti normal, nga të cilat: -191 raste janë hedhur në një datë (ose për 9267 çështje); -58 raste, 2 (dy) herë në ditë (ose për 1371 çështje) [përmendim këtu datat 12.01.2024; 01.02.2024; 04.03.2024; 18.03.2024; 19.03.2024; 02.04.2024; 04.04.2024; 05.04.2024; 19.04.2024; 09.05.2024; 05.06.2024; 13.06.2024; 26.06.2024; 19.07.2024; 11.09.2024; 04.10.2024; 09.10.2024; 21.10.2024; 23.10.2024; 01.11.2024; 04.11.2024; 05.11.2024; 06.11.2024; 07.11.2024; 08.11.2024; 18.11.2024; 11.12.2024; 13.12.2024 dhe 20.12.2024]; dhe -6 raste, 3 (tre) herë në ditë (ose për 91 çështje) [përmendim këtu datat 08.05.2024; dhe 30.10.2024].

Referuar të dhënave të administruara në funksion të materialeve të inspektimit, rezultoi se:

- a) hedhja e shorti nuk është realizuar çdo ditë, fakt i cili u konstatua për datën: - 25.01.2024 (ku 2 çështje^[209] mbanin datë 23.01.2024 regjistrimi të cilat, janë trajtuar në shortin e datës 25.01.2024, kur duhej të hidheshin në short në datën 23.01.2024 ose në datën 24.01.2024, datë në të cilën s'është organizuar asnjë short); dhe, si dhe;
- b) ka çështje që nuk janë hedhur në short jo në ditën e regjistrimit por as të nesërmen e regjistrimit, madje këto raste variojnë nga 2 (dy) deri në 13 (trembëdhjetë) ditë nga regjistrimi, ku përmendim datat: -15.01.2024^[210] (ku 25 çështje mbanin datë 11.01.2024 regjistrimi dhe 24 çështje mbanin datë 12.01.2024 regjistrimi, të cilat janë trajtuar në shortin e datës 15.01.2024); -16.01.2024^[211] (ku 1 çështje mbante datë 11.01.2024 regjistrimi dhe është trajtuar në shortin e datës 16.01.2024); - 29.01.2024^[212] (ku 1 çështje mbante datë 26.01.2024 regjistrimi dhe është trajtuar në shortin e datës 29.01.2024); -05.02.2024^[213] (ku 6 çështje mbanin datë 02.02.2024 regjistrimi dhe është trajtuar në shortin e datës 05.02.2024); - 07.02.2024^[214] (ku 1 çështje mbante datë 01.02.2024 regjistrimi dhe është trajtuar në shortin e datës 05.02.2024); -20.02.2024^[215] (ku 2 çështje mbanin datë 16.02.2024 dhe 15.02.2024 regjistrimi dhe janë trajtuar në shortin e datës

^[209] Çështja gjyqësore nr. (23012-00241-30-2024) akti datë 23.01.2024 dhe nr. (21258-00242-30-2024) akti datë 23.01.2024.

^[210] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 15/01/2024 ora : 15:08:04 numri total i çështjeve të shortuara : 137 lloji shortit: short normal..."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

^[211] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 16/01/2024 ora: 14:58:28 numri total i çështjeve të shortuara : 16 lloji shortit: short normal..."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

^[212] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 29/01/2024 ora : 15:15:56 numri total i çështjeve të shortuara : 65 lloji shortit: short normal..."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

^[213] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 05/02/2024 ora: 15:15:08 numri total i çështjeve të shortuara : 54 lloji shortit: short normal..."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

^[214] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 07/02/2024 ora: 15:14:40 numri total i çështjeve të shortuara : 55 lloji shortit: short normal..."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

^[215] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 20/02/2024 ora: 15:25:41 numri total i çështjeve të shortuara : 67 lloji shortit: short normal..."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

20.02.2024); -26.02.2024^[216] (ku 1 çështje mbante datë 23.02.2024 regjistrimi dhe është trajtuar në shortin e datës 26.02.2024); -18.03.2024^[217] (ku 2 çështje mbajnë datë 13.03.2024 regjistrimi dhe janë trajtuar në shortin e datës 18.03.2024); -15.04.2024^[218] (ku 1 çështje mbante datë 12.04.2024 regjistrimi dhe është trajtuar në shortin e datës 15.04.2024); -13.05.2024^[219] (ku 1 çështje mbante datë 09.05.2024 regjistrimi dhe është trajtuar në shortin e datës 13.05.2024); -20.05.2024^[220] (ku 1 çështje mbante datë 17.05.2024 regjistrimi dhe është trajtuar në shortin e datës 20.05.2024); -03.06.2024^[221] (ku 1 çështje mbante datë 31.05.2024 regjistrimi dhe është trajtuar në shortin e datës 03.06.2024); -10.06.2024^[222] (ku 1 çështje mbante datë 07.06.2024 regjistrimi dhe është trajtuar në shortin e datës 10.06.2024); -18.06.2024^[223] (ku 4 çështje mbanin datë 14.06.2024 regjistrimi dhe janë trajtuar në shortin e datës 18.06.2024); -01.07.2024^[224] (ku 16 çështje mbanin datë 28.06.2024 regjistrimi dhe 2 çështje mbanin datë 27.06.2024 regjistrimi të cilat janë trajtuar në shortin e datës 01.07.2024); -15.07.2024^[225] (ku 2 çështje mbanin datë 12.07.2024 regjistrimi dhe janë trajtuar në shortin e datës 15.07.2024); -22.07.2024^[226] (ku 2 çështje mbanin datë 19.07.2024 regjistrimi dhe janë trajtuar në shortin e datës 22.07.2024); -09.09.2024^[227] (ku 1 çështje mbante datë 06.09.2024 regjistrimi dhe është trajtuar

^[216] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 26/02/2024 ora : 15:07:31 numri total i çështjeve të shortuara : 58 lloji shortit: short normal.."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

^[217] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 18/03/2024 ora : 14:56:32 numri total i çështjeve të shortuara : 56 lloji shortit: short normal.."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

^[218] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 15/04/2024 ora : 14:55:18 numri total i çështjeve të shortuara : 38 lloji shortit: short normal.."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

^[219] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 13/05/2024 ora : 14:55:50 numri total i çështjeve të shortuara : 29 lloji shortit: short normal.."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

^[220] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 20/05/2024 ora : 14:52:44 numri total i çështjeve të shortuara : 44 lloji shortit: short normal.."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

^[221] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 03/06/2024 ora : 14:55:19 numri total i çështjeve të shortuara : 86 lloji shortit: short normal.."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

^[222] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 10/06/2024 ora : 14:52:36 numri total i çështjeve të shortuara : 61 lloji shortit: short normal.."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

^[223] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 18/06/2024 ora : 14:52:43 numri total i çështjeve të shortuara : 78 lloji shortit: short normal.."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

^[224] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 01/07/2024 ora : 14:59:22 numri total i çështjeve të shortuara : 65 lloji shortit: short normal.."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

^[225] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 15/07/2024 ora : 15:08:02 numri total i çështjeve të shortuara : 53 lloji shortit: short normal.."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

^[226] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 22/07/2024 ora : 15:03:41 numri total i çështjeve të shortuara : 54 lloji shortit: short normal.."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

^[227] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 09/09/2024 ora : 14:59:17 numri total i çështjeve të shortuara : 69 lloji shortit: short normal.."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

në shortin e datës 09.09.2024); -16.09.2024^[228] (ku 1 çështje mbante datë 03.09.2024 regjistrimi dhe është trajtuar në shortin e datës 16.09.2024); - 14.10.2024^[229] (ku 1 çështje mbante datë 11.10.2024 regjistrimi dhe është trajtuar në shortin e datës 14.10.2024); -21.10.2024^[230] (ku 1 çështje mbante datë 18.10.2024 regjistrimi dhe është trajtuar në shortin e datës 21.10.2024); - 18.11.2024^[231] (ku 4 çështje mbanin datë 15.11.2024 regjistrimi dhe janë trajtuar në shortin e datës 18.11.2024); -10.12.2024^[232] (ku 2 çështje mbanin datë 06.12.2024 regjistrimi dhe janë trajtuar në shortin e datës 10.12.2024); - 16.12.2024^[233] (ku 7 çështje mbanin datë 13.12.2024 regjistrimi dhe janë trajtuar në shortin e datës 16.12.2024); dhe, -26.12.2024^[234] (ku 8 çështje mbanin datë 24.12.2024 regjistrimi dhe janë trajtuar në shortin e datës 26.12.2024). Ky veprim i kryer nga zv.kryetari bie ndesh me urdhërin nr.3 prot., datë 04.01.2024 "Për caktimin e orës së shortit të çështjeve gjyqësore", lëshuar prej tij, kërkesat e pikës 3 të kreut III, "Procedurat dhe rregullat e ndarjes së çështjeve me short", të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", si dhe kërkesat e ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, lidhur me përgjegjësinë që ka kryetari për menaxhimin e përgjithshëm gjyqësor (nenet 37 shkronja "h" e 26 pika 2 të këtij ligji).

Vlen të theksohet se nga data 01.02.2023 edhe ndarja e çështjeve (*masa sigurimi*), me karakter të ngutshëm, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm bëhet me short sipas listës së gatishmërisë^[235]. Nga verifikimi i të dhënave për regjistrimin dhe shortimin e çështjeve urgjente (*kërkesat penale gjatë hetimeve paraprake*) konstatohet se për vitin 2024, ato janë regjistruar dhe shortuar brenda të njëjtës dite. Edhe për këto çështje mbetem problem hedhja e tyre përpara dhe pas orarit të orës së përcaktuar në urdhërin nr.3 prot., datë 04.01.2024 "Për caktimin e orës së shortit të çështjeve gjyqësore", lëshuar nga zv/kryetari i gjykatës.

[228] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 16/09/2024 ora: 15:05:51 numri total i çështjeve të shortuara : 67 lloji shortit: short normal.."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

[229] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 14/10/2024 ora: 15:03:36 numri total i çështjeve të shortuara : 67 lloji shortit: short normal.."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

[230] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 21/10/2024 ora: 15:09:02 numri total i çështjeve të shortuara : 57 lloji shortit: short normal.."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

[231] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 18/11/2024 ora: 15:03:55 numri total i çështjeve të shortuara : 36 lloji shortit: short normal.."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

[232] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 10/12/2024 ora: 15:10:43 numri total i çështjeve të shortuara : 57 lloji shortit: short normal.."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

[233] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 16/12/2024 ora: 15:12:25 numri total i çështjeve të shortuara : 39 lloji shortit: short normal.."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

[234] Shif aktin e titulluar "Informacion mbi shortin data : 26/12/2024 ora: 15:02:11 numri total i çështjeve të shortuara : 42 lloji shortit: short normal.."etj, që shoqëron dokumentacionin e administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në kuadër të inspektimit tematik.

[235] Të dhënat janë nxjerrë nga "Raporti i i analizës vjetore të veprimtarisë së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024". (Shif faqen 82 të këtij raporti).

Nga analiza e këtyre të dhënave konstatohet se jo në të gjitha rastet është zbatuar data dhe ora e shortit, madje as hedhja e shortit në ditën e nesërme të punës (kur kjo ka qenë e pamundur siç është përcaktuar në urdhërin e hedhjes së shortit) si dhe ka raste kur shorti është hedhur për çështje të cilat janë regjistruar nga dy ditë deri në 13 ditë (të cilat janë 122 çështje dhe kapin vlerën prej 1.14 % të totalit të çështjeve), ndërsa ora e hedhjes së shortit, vetëm në 16 raste është në orar (në orën 15:⁰⁰ siç është përcaktuar në urdhërin nr.3 prot., datë 04.01.2024 "Për caktimin e orës së shortit të çështjeve gjyqësore", lëshuar nga zv/kryetari i gjykatës), ndërkohë që për rastet e tjera variojnë nga më para orës 15:⁰⁰ (që shorti është hedhur për 96 raste) dhe pas kësaj ore (që shorti është hedhur për 143 raste). Referuar nenit 25, nenit 37 dhe nenit 39 të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", ka cënuar mënyrën transparente të dokumentimit të përgatitjes së shortit, afatet e organizimit të shortit dhe mënyrën e njoftimit paraprak të tij dhe ky veprim bën përgjegjës kryesekretaren e gjykatës, sekretarën regjistruese, punonjësin e IT-së, kancelarën e gjykatës dhe vetë zv/kryetarin e gjykatës.

Gjatë verifikimit të raportit për çështjet e shortuara rezulton se shorti është hedhur në orar, për 844 çështje ose 7.86 % të tyre, përpara orarit të shortit për 4350 çështje ose 40.54 % të tyre dhe pas orarit të shortit për 5535 çështje ose 51.58 % të tyre, për të cilat kryesekretaria e gjykatës nuk ka arsye justifikimi të dokumentuar për hedhjen e tyre në short. Ky veprim bie ndesh me urdhërin nr.3 prot., datë 04.01.2024 "Për caktimin e orës së shortit të çështjeve gjyqësore", të lëshuar nga zv/kryetaria e gjykatës dhe kërkesat e Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore".

Problem mbetet shortimi i dosjeve në mënyrë manuale dhe rishortimi i tyre, pasi kryesekretaria e gjykatës, nuk i bën veprimet në rastet manuale ditën e miratimit të veprimit për dosjen, apo e shumta të nesërmen e tyre, (ku rezulton se veprimi maksimal në sistem është bërë pas 527 ditëve nga regjistrimi i çështjes) po ashtu edhe në rastin e rishortimeve, (ku rezulton se veprimi maksimal në sistem është bërë pas 486 ditëve nga regjistrimi i çështjes). Referuar nenit 25, nenit 37 dhe nenit 39 të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", ka cënuar mënyrën transparente të dokumentimit të përgatitjes së shortit, afatet e organizimit të shortit dhe mënyrën e njoftimit paraprak të tij dhe ky veprim bën përgjegjës kryesekretaren e gjykatës, sekretarën regjistruese, punonjësin e IT-së, kancelarën e gjykatës dhe vetë zv/kryetarin e gjykatës.

Lidhur me çështjet urgjente, është respektuar kurdoherë dhe në kohë optimale menjëhershëmëria e regjistrimit dhe shortimit të tyre në përputhje me kërkesat e pikës 3 të kreut III. "Procedurat dhe rregullat e ndarjes së çështjeve me short", dhe pikës 1 të kreut IV. "Përjashtimi i çështjeve gjyqësore nga shorti", të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", dhe nenit 2 pika "c" e ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e

Shqipërisë", i ndryshuar. Edhe për këto çështje mbetëm problem hedhja e tyre përpara dhe pas orarit të orës së përcaktuar në urdhërin nr.3 prot., datë 04.01.2024 "Për caktimin e orës së shortit të çështjeve gjyqësore", lëshuar nga zv/kryetari i gjykatës. Ky veprim bën përgjegjës kryesekretaren e gjykatës, sekretarën regjistruese, punonjësin e IT-së, kancelarën e gjykatës dhe vetë zv/kryetarin e gjykatës.

Nga analiza e këtyre të dhënave konstatohet se jo në të gjitha rastet është zbatuar data dhe ora e shortit, madje as hedhja e shortit në ditën e nesërme të punës (kur kjo ka qenë e pamundur siç është përcaktuar në urdhërin e hedhjes së shortit) si dhe ka raste kur shorti është hedhur për çështje të cilat janë regjistruar nga dy ditë deri në 13 ditë (të cilat janë 122 çështje dhe kapin vlerën prej 1.14 % të totalit të çështjeve), ndërsa ora e hedhjes së shortit, vetëm në 16 raste është në orar (në orën 15:⁰⁰ siç është përcaktuar në urdhërin nr.3 prot., datë 04.01.2024 "Për caktimin e orës së shortit të çështjeve gjyqësore", lëshuar nga zv/kryetari i gjykatës), ndërkohë që për rastet e tjera variojnë nga më para orës 15:⁰⁰ (që shorti është hedhur për 96 raste) dhe pas kësaj ore (që shorti është hedhur për 143 raste). Referuar nenit 25, nenit 37 dhe nenit 39 të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", ka cënuar mënyrën transparente të dokumentimit të përgatitjes së shortit, afatet e organizimit të shortit dhe mënyrën e njohimit paraprak të tij.

Gjatë verifikimit të raportit për çështjet e shortuara rezultoi se shorti është hedhur në orar, për 844 çështje ose 7.86 % të tyre, përpara orarit të shortit për 4350 çështje ose 40.54 % të tyre dhe pas orarit të shortit për 5535 çështje ose 51.58 % të tyre, për të cilat kryesekretaria e gjykatës nuk ka arsye justifikimi të dokumentuar për hedhjen e tyre në short. Ky veprim bie ndesh me urdhërin nr.3 prot., datë 04.01.2024 "Për caktimin e orës së shortit të çështjeve gjyqësore", të lëshuar nga zv/kryetaria e gjykatës dhe kërkesat e Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore".

Lidhur me çështjet urgjente, është respektuar kurdohëri dhe në kohë optimale menjëhershmeria e regjistrimit dhe shortimit të tyre në përputhje me kërkesat e pikës 3 të kreut III. "Procedurat dhe rregullat e ndarjes së çështjeve me short", dhe pikës 1 të kreut IV. "Përfashtimi i çështjeve gjyqësore nga shorti", të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", dhe nenit 2 pika "c" e ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

9. Shortimi i çështjeve sipas gjyqtarit specifik

Në periudhën e inspektuar 01 janar 2024 deri në 31 dhjetor 2024, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë paraqitur gjithësej **1620** kërkesa penale me objekt: "Vlefësimet e arrestit në flagrancë apo të ndalimit, caktimi i masave të sigurimit personal". Në **1517** raste kërkesat janë gjykuar nga gjyqtarët në respektim të planifikimit të gatishmërisë, në përputhje me nenin 37 shkronja b) të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin

e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe pikën 1 të kreut IV. "Përjashtimi i çështjeve gjyqësore nga shorti", të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore"; në 73 raste kërkesat janë gjykuar nga gjyqtarë që kanë kryer më parë veprime hetimi paraprak për to (ndonëse rezulton se në 6 çështje ato kanë qenë edhe të gatshëm, pasi këto çështje janë regjistruar në kohën kur ato kishin edhe grafikun e gatishmërisë); si dhe, në 30 raste kërkesat janë gjykuar nga gjyqtarë që janë rishortuar, pasi ka dalë e nevojshme që për këto çështje të bëhej rishortim (edhe për këto çështje rezulton se në 7 raste ato kanë qenë edhe të gatshëm, pasi këto çështje janë regjistruar në kohën kur ato kishin edhe grafikun e gatishmërisë).

Në të njëjtën periudhë janë paraqitur 1465 kërkesa penale (ku kërkuar janë si prokuroria dhe vetë të të pandehurit) gjatë hetimeve paraprake që kanë lidhje me procedime penale e që përbëhen nga: - 11 kërkesa për vlefësim e lejim përgjimi (ku rezulton se në 9 çështje ato kanë qenë edhe të gatshëm, pasi këto çështje janë regjistruar në kohën kur ato kishin edhe grafikun e gatishmërisë); - 514 kërkesa për shuarje mase sigurimi (ku rezulton se në 79 çështje ato kanë qenë edhe të gatshëm, pasi këto çështje janë regjistruar në kohën kur ato kishin edhe grafikun e gatishmërisë); - 72 kërkesa për humbje e fuqisë së paraburgimit për kërkuar e caktim mase sigurimi (ku rezulton se në 11 çështje ato kanë qenë edhe të gatshëm, pasi këto çështje janë regjistruar në kohën kur ato kishin edhe grafikun e gatishmërisë); - 29 kërkesa për zgjatje afati paraburgimi, (ku rezulton se në 4 çështje ato kanë qenë edhe të gatshëm, pasi këto çështje janë regjistruar në kohën kur ato kishin edhe grafikun e gatishmërisë); - 2 kërkesa për deklarim ike e të pandehurit (ku rezulton se në 2 çështje ato kanë qenë edhe të gatshëm, pasi këto çështje janë regjistruar në kohën kur ato kishin edhe grafikun e gatishmërisë); - 480 kërkesa për zëvendësim mase sigurimi personal (ku rezulton se në 185 çështje ato kanë qenë edhe të gatshëm, pasi këto çështje janë regjistruar në kohën kur ato kishin edhe grafikun e gatishmërisë); - 42 kërkesa për informacion nga gjykata për hetime të kryera dhe për të cilën kërkohet rishqyrtimi i masës së sigurimit (ku rezulton se në 7 çështje ato kanë qenë edhe të gatshëm, pasi këto çështje janë regjistruar në kohën kur ato kishin edhe grafikun e gatishmërisë); - 1 kërkesë për paraqitje (marrje) e të dhënave kompjuterike, për procedim penal; - 38 kërkesa për revokim mase sigurimi (ku rezulton se në 12 çështje ato kanë qenë edhe të gatshëm, pasi këto çështje janë regjistruar në kohën kur ato kishin edhe grafikun e gatishmërisë); - 19 kërkesa për vendosje e masës së sigurimit pasuror, sekuestro preventive për procedimin penal (ku rezulton se në 12 çështje ato kanë qenë edhe të gatshëm, pasi këto çështje janë regjistruar në kohën kur ato kishin edhe grafikun e gatishmërisë); - 229 kërkesa për kërkesa për marrje në pyetje të personit dhe verifikim të kushteve të zbatimit të masës së sigurimit (ku rezulton se në 139 çështje ato kanë qenë edhe të gatshëm, pasi këto çështje janë regjistruar në kohën kur ato kishin edhe grafikun e gatishmërisë); - 4 kërkesa për kërkesa për caktim mase mjeksore (ku rezulton se në 3 çështje ato kanë qenë edhe të gatshëm, pasi këto çështje janë regjistruar në kohën kur ato kishin edhe grafikun e gatishmërisë); dhe - 24 kërkesa të tjera (ku rezulton se në 11 çështje ato kanë qenë edhe të gatshëm, pasi këto çështje janë regjistruar në kohën kur ato kishin edhe grafikun e gatishmërisë). Këto kërkesa me hedhjen e shortit i kanë kaluar si gjyqtarit të gatshëm, sipas përcaktimeve të nenit 278/2 të

K.Pr.Penale, ashtu dhe gjyqtarëve që nuk janë të gatshëm që kanë kryer veprime hetimi paraprak për to.

Kryetari i Gjykatës ka nxjerrë 10 vendime dhe 2 urdhëra, për "Miratimin/përditësimin e listës vjetore që përcakton gjyqtarët për gjykimin e rasteve urgjente", konkretisht: - vendim: "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente" (shkresa nr. 729 prot., datë 21.12.2023); - urdhër "Për zëvendësim gjyqtari për gjykimin e rasteve urgjente" (shkresa nr. 20 prot., datë 10.01.2024); - vendim "Për zëvendësim dhe caktim gjyqtari për gjykimin e rasteve urgjente" (shkresa nr. 97 prot., datë 06.03.2024); - vendim "Për caktim gjyqtari për gjykimin e rasteve urgjente" (shkresa nr. 173 prot., datë 02.05.2024); - vendim "Për zëvendësim dhe caktim gjyqtari për gjykimin e rasteve urgjente" (shkresa nr. 213 prot., datë 14.06.2024); - vendim "Për zëvendësim dhe caktim gjyqtari për gjykimin e rasteve urgjente" (shkresa nr. 239 prot., datë 11.07.2024); - vendim "Për caktim gjyqtari për gjykimin e rasteve urgjente" (shkresa nr. 301 prot., datë 08.10.2024); - vendim "Për caktim gjyqtari për gjykimin e rasteve urgjente" (shkresa nr. 322 prot., datë 23.10.2024); - urdhër i brendshëm "Për rishortim çështje penale" (shkresa nr. 375 prot., datë 13.12.2024); - vendim "Për zëvendësim dhe caktim gjyqtari për gjykimin e rasteve urgjente" (shkresa nr. 381 prot., datë 16.12.2024); - vendim "Për zëvendësim dhe caktim gjyqtari për gjykimin e rasteve urgjente" (shkresa nr. 376/1 prot., datë 24.12.2024); dhe - vendim "Për caktim gjyqtari për gjykimin e rasteve urgjente" (shkresa nr. 409 prot., datë 31.12.2024).

Theksoj se për periudhën e muajit gusht që përkon me lejen e zakonshme nga kryetari i gjykatës është lëshuar vendim "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente në muajin gusht" (shkresa nr. 228 prot., datë 01.07.2024), që përmban procedurën që do të ndiqet dhe gjyqtarët e ngarkuar për gjykimet urgjente që do të regjistrohen nga data 29 korrik 2024, deri më 01 shtator 2024 (por në këtë vendim konstatohet se mbetet e pa mbledhur me gjyqtarë të gatshëm periudha 03 gusht-04 gusht 2024).

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe për këtë kategori çështjes është mbajtur edhe një procesverbal konstatimi nr. 248 prot., datë 23.07.2024, nga një komision i përbërë nga gjyqtare znj. Valbona Vata; kancelarja e gjykatës znj. Lertida Balili; k/sekretarja Rudina Bubjaku; sekretarja gjyqësore regjistruese Alina Licollari, sekretaret gjyqësore znj. Briselda Xhelo e znj. Albana Bicprendi; si dhe specialisti i IT-së z. Ramiz Papa, lidhur me kërkesën penale me nr. (61010-04516-30-2024) sistemi, nr. 1722 akti, datë 22.07.2024 regjistrimi, me palë kërkues: Arben Hysi, me objekt: "Shuarje mase sigurimi". Kërkesa e mësipërme i ka kaluar për gjykim gjyqtarës relatore Valbona Vata, për shkak se ka gjykuar masën e sigurimit. Nga verifikimi i kërkesës sipas komisionit ka rezultuar se pala i është drejtuar Zyrës së Financës dhe në thelb, kërkon kthimin e garancisë pasurore, pasi masa i është shuar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë. Për sa më lartë, komisioni ka konkluduar se kjo kërkesë nuk duhet të ishte regjistruar si "shuarje mase" por duhet t'i kalonte për veprim Drejtorisë së Financës dhe Menaxhimit Financiar.

Në këto rrethana do të kryhet mbyllja e çështjes së më sipërme në sistemin ICMIS pranë Gjykatës të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm^[236].

Nga të dhënat e dërguara rezultoi se **3085** çështjet e gjykuara nga gjykata si çështje të karakterit urgjent, janë shpërndarë e gjykuar nga gjyqtarët si më poshtë:

1. -Gjyqtarës Alma Ahmeti i janë caktuar gjithësej **107** çështje gjyqësore;
2. -Gjyqtarës Alma Kolgjoka i janë caktuar gjithësej **109** çështje gjyqësore;
3. -Gjyqtarës Anila Karanxha i janë caktuar gjithësej **13** çështje gjyqësore;
4. -Gjyqtarës Arta Duka i janë caktuar gjithësej **133** çështje gjyqësore;
5. -Gjyqtarët Astrit Kalaja i janë caktuar gjithësej **126** çështje gjyqësore;
6. -Gjyqtarës Brikena Ukperaj i janë caktuar gjithësej **124** çështje gjyqësore;
7. -Gjyqtarës Diamela Goxha i janë caktuar gjithësej **128** çështje gjyqësore;
8. -Gjyqtarët Dritan Hasani i janë caktuar gjithësej **166** çështje gjyqësore;
9. -Gjyqtarës Edlira Petri i janë caktuar gjithësej **132** çështje gjyqësore;
10. -Gjyqtarës Elona Mihali i janë caktuar gjithësej **97** çështje gjyqësore;
11. -Gjyqtarës Elona Toro i janë caktuar gjithësej **127** çështje gjyqësore;
12. -Gjyqtarës Enkela Vlora i janë caktuar gjithësej **24** çështje gjyqësore;
13. -Gjyqtarët Fatri Islamaj i janë caktuar gjithësej **116** çështje gjyqësore;
14. -Gjyqtarët Fuat Vjerdha i janë caktuar gjithësej **110** çështje gjyqësore;
15. -Gjyqtarët Genti Dokollari i janë caktuar gjithësej **154** çështje gjyqësore;
16. -Gjyqtarët Genti Shala i janë caktuar gjithësej **150** çështje gjyqësore;
17. -Gjyqtarës Iliba Bezati i janë caktuar gjithësej **73** çështje gjyqësore;
18. -Gjyqtarës Irena Brahimi i janë caktuar gjithësej **135** çështje gjyqësore;
19. -Gjyqtarës Irida Kacerja i janë caktuar gjithësej **100** çështje gjyqësore;
20. -Gjyqtarës Lutfije Celami i janë caktuar gjithësej **135** çështje gjyqësore;
21. -Gjyqtarës Marsela Dervishi i janë caktuar gjithësej **96** çështje gjyqësore;
22. -Gjyqtarës Marsela Pepi i janë caktuar gjithësej **114** çështje gjyqësore;
23. -Gjyqtarës Miranda Andoni i janë caktuar gjithësej **162** çështje gjyqësore;
24. -Gjyqtarës Ornela Naqellari i janë caktuar gjithësej **90** çështje gjyqësore;
25. -Gjyqtarët Qemal Zaimi i janë caktuar gjithësej **123** çështje gjyqësore;
26. -Gjyqtarët Sokol Pina i janë caktuar gjithësej **105** çështje gjyqësore;
27. -Gjyqtarës Valbona Vata i janë caktuar gjithësej **117** çështje gjyqësore; dhe,
28. -Gjyqtarës Valdete Hoxha i janë caktuar gjithësej **19** çështje gjyqësore.

Nga analiza e këtyre të dhënave vetëm në 14 (*katërmbëdhjetë*) raste nga zv/kryetarja e gjykatës, janë shkelur rregullat e përcaktuara në grafikun e gadishmërisë për gjykimin e rasteve urgjente, apo të çështjeve të karakterit urgjent, pasi çështjet nuk kanë kaluar tek gjyqtari i radhës në gatishmëri (*shif për këtë të dhënat e hedhura në pjesën e më sipërme të këtij raporti inspektimi*).

10. Verifikimi i ankesave

^[236] Në këtë komision nuk ka marrë pjesë zv/kryetarja e gjykatës dhe para se të mbahet procesverbal i nuk është disponuar me akt të shkruar pse duhej të bëhej mbyllja e kësaj çështje në sistem. Komisioni ka vepruar pa një akt të lëshuar më parë nga zv/kryetari i gjykatës.

Në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, referuar të dhënave të marra në Zyrën e Arkiv-Protokollit dhe pranë Drejtorisë së Hartimit të Akteve dhe Shërbimeve Juridike për vitin 2024^[237], është paraqitur asnjë ankesë për organizimin e shortit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Konkretisht referuar emailit të datës 24.12.2025, të dërguar nga Drejtoria e Hartimit të Akteve dhe Shërbimeve Juridike pranë Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në përgjigje të emailit të datës 23.12.2025, të kryetarit të grupit të inspektimit, vihemi në dijeni se pranë ILD-së, është depozituar ankesa e av. Eduard Mullaraj në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë të posaçme^[238] i shtetases znj. Liljana Gjonaj, ankesë e cila është regjistruar me nr. 2956 prot., date 12.11.2024, dhe ka të bëjë me veprimtarinë e magjistrates znj. Lutfije Celami, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në kohën e shkeljes së pretenduar si dhe sipas ankuesit edhe me mënyrën e organizimit të shortit nga ana e zv/kryetarës së gjykatës znj. Valdete Hoxha.

Av. Eduard Mullaraj krahas pretendimeve që parashtrohet në ankesë ndaj vënies në lëvizje të dosjes për gjykim, ndër të tjera kërkon: "...-Ti vihet në dispozicion shorti i hedhur mbi këtë dosje dhe ngarkesën e gjyqtarës znj. Lutfije Celami.-Të merren masa përsa i përket abuzivitetit mbi hedhjen e shortit dhe caktimin e seancës gjyqësore të kësaj çështje me të pandehur Kristjan Cenaj, për veprën penale "Vjedhje me pasoje vdekjen" e parashikuar nga neni 141 dhe 25 i Kodit Penal, dhe dënimin e tij me burgim të përjetshëm...etj".

Kjo ankesë aktualisht është në fazën e shqyrtimit fillestar, dhe paraprakisht bëhet fjalë për çështjen penale nr. (53109-05247-30-2024) 3258 akti, datë 10.09.2024 regjistrimi, që i përket palëve ndërgjyqësore, kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezë, i pandehur: Kristjan Cenaj, i akuzuar: Për kryerjen e veprës penale "Vjedhja me pasoje vdekjen" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 141 dhe 25 i K.Penal, viktimitë e veprës penale: Liljana Gjonaj (trashëgimtare e viktimitë Mariglen Gjonaj), e shortuar në shortin e datës 10.09.2024 dhe që i ka rënë për shqyrtim gjyqësor magjistratës znj. Lutfije Celami, në cilësinë e relatorës së trupit gjykues.

Kjo praktikë ankesë do të trajtohet më vete nga inspektori përgjegjës, i caktuar për ndjekjen e ankesës sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016, "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar.

Theksoj se ankesa të depozituara pranë vetë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nuk ka pasur nga përdoruesit e gjykatës (përfshirë këtu: gjyqtar, kancelar,

^[237] Në datën 22.12.2025, ju drejtuaam Zyrës së Arkiv-Protokollit, ndërsa në datën 23.12.2025 Drejtorisë së Hartimit të Akteve dhe Shërbimeve Juridike, pranë ILD-së me: "Kërkesë për informacion dhe dokumentacion".

^[238] Prokurë e posaçme nr. 2093 rep., nr. 1314 kol., datë 16.05.2022 nga notere Majlinda L.Gjini...etj.

sekretar gjyqësor, kryesekretar, sekretar regjistruar, përfaqësues të organit të akuzës... etj)^[239].

11. Të tjera

Me shkresën nr. 2201 prot., datë 17.07.2025, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kërkoj nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndër të tjera dërgimin e një kopje të manualit të përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, *(përfshirë rubrikën e shortimit elektronik)* ^[240], që Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar për këtë qëllim *(së bashku me publikimet periodikisht të këtij manuali, nëse ka pasur të tilla)*.

Në përgjigje të shkresë së dërguar nga ILD, me nr. 4102/1 prot., datë 29.07.2025 *(regjistruar me nr. 2201/1 prot., datë 29.07.2025)*, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka dërguar:

a) Dokumentin me emërtimin "Manual udhëzues për zhvillimet përmirësimet që janë kryer për sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS të gjykatave të shkallës së parë, gjykatave të apelit dhe gjykatave administrative, në zbatim të kontratës nr. 5666/7 prot., datë 17.03.2022, lidhur mes palëve: Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe subjektit "Kreatx" sh.p.k, me objekt "Mirëmbajtje, mbajtje në funksion të pandërprerë, zhvillim, përmirësim, modifikim të sistemeve të menaxhimit të çështjeve gjyqësore në gjykata", i përbërë nga dyzet e pesë faqe;

b) Dokumentin me emërtimin "Manual udhëzues mbi zhvillimet që janë kryer për sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatës Administrative të Apelit, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, bazuar në kontratën nr. 71/6 prot., datë 20.02.2023 lidhur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor", i përbërë nga tetëdhjetë e tre faqe; dhe,

c) Dokumentin me emërtimin "Raport analitik mbi zhvillimet që janë kryer në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS në vitin 2024 *(shkallë gjyqësori apel, shkallë e parë e juridiksionit të përgjithshëm, administrative)*", i përbërë nga tetëdhjetë e dy faqe...etj.

Në aktet e mësipërme prezantohen zhvillimet e sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS gjykatat e shkallës së parë, apelit, administrative, të cilat janë kryer në vitin 2022; 2023 dhe vitin 2024.

^[239] Referuar shkresës nr. 7987/3 prot., datë 10.07.2025 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në përgjigje të shkresës nr. 1020/4 prot., datë 07.04.2025 të ILD-së.

^[240] Kjo kërkesë bazohet në pikën 15 Kreu III "Procedurat dhe rregullat e ndarjes së çështjeve me short" të Vendimi të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", në të cilin thuhet se: "...15. Këshilli i Lartë Gjyqësor publikon periodikisht manualin e përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, përfshirë rubrikën e shortimit elektronik...etj".

1. Rregullimi ligjor mbi bazën e të cilit gjykata organizon procedurat e shortit.

Për organizimin e procedurave të ndarjes së çështjeve me short, gjykata bazohet kryesisht në ligjin nr. 98/2016, dhe në kërkesat e Vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 554, datë 29.12.2022, dhe nr. 724, datë 7.12.2023.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, referuar bazës ligjore të mësipërme, konkretisht nenit 25 pika 4 të ligjit nr. 98/2016, kryen rregullisht inspektime të ndarjes së çështjeve me short, si dhe kontrollon raportet e sistemit elektronik të paktën një herë në vit.

Vlen të theksojmë se Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, përfshin kompetencën e saj tokësore në territorin e Bashkisë Shkodër Malësi e Madhe dhe Pukë^[242]. Ajo ka në organikën e saj 15 gjyqtarë. Për periudhën në të cilën do të bëhet inspektimi kjo gjykatë është drejtuar nga gjyqtar zëvendëskryetar z. Sokol Shehu deri më datë 25.09.2024 dhe nga data 01.10.2024 zëvendëskryetare Eglë Mirashi. Aktualisht drejtohet nga gjyqtari Enri Rista.

Nga analiza e punës së Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër gjatë vitit 2024 rezulton se numri i gjyqtarëve në raport me organikën e miratuar ka qenë me mungesa. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nga 15 (pesëmbëdhjetë) gjyqtarë që ka në organikë^[243], ka funksionuar me 10 (dhjetë) gjyqtarë për katërmujorin e parë, me 9 (nëntë) gjyqtarë për tetë mujorin e parë 8 (tetë) gjyqtarë gjatë muajit shtator dhe përsëri me emërimin e katër magjistratëve të rinj, gjatë katërmujorit të fundit me 10 (dhjetë) gjyqtarë ^[244].

Pranë kësaj gjykate kanë funksionuar seksionet civil, penal dhe penal për të mitur ku më poshtë për shkak të ndryshimeve të shpeshta në trupë gjyqësore që ka patur gjykata referohet vetëm ndarja e fundvitit si vijon:

- Seksioni civil përbëhet nga gjyqtarët: Arta Llazari, Eni Naqellari, Tefte Xhanari, Enri Ristadhe Irida Barkaj .

^[241] Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër vazhdon funksionimin nga data 1.5.2023 me emërtimin Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, sipas vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 139, datë 28.03.2023 për "Fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër".

^[242] Në bazë të Vendimi të Këshillit të Gjykatës, nr. 23/I datë 20.11.2024 ka vendosur: Ndryshimin e selisë së gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në godinën e Ish Gjykatës së Apelit Shkodër - Rruga "Et'hem Osmani", Shkodër.

^[243] Kjo trupë gjyqësore pësoi ndryshime gjatë vitit 2024, për shkak të transferimeve, shkarkimeve dhe gjithashtu emërimeve të reja të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me datë 25.04.2024 me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor është transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, magjistrati Besmir Stroka. Me datë 31.07.2024 po ashtu me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor është transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, magjistrati Arbër Çela. Me datë 25.09.2024 me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor është transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, magjistrati Sokol Shehu. Me datë 04.09.2024 me vendim të komisionit të Pavarur të Kualifikimit është vendosur shkarkimi i gjyqtarit Tonin Sterkaj.

^[244] Me datë 02.10.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka emëruar magjistratë: Me vendimin nr. 564, datë 02.10.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është emëruar gjyqtarja Eni Naqellari. Me vendimin nr. 566, datë 02.10.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është emëruar gjyqtarja Tefte Xhanari. Me vendimin nr. 568, datë 02.10.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është emëruar gjyqtari Enri Rista. Me vendimin nr. 570, datë 02.10.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është emëruar gjyqtarja Irida Barkaj.

- Seksioni penal përbëhet nga gjyqtarët: Egla Mirashi, Orgent Nazaj, Elona Mërtiri, Albert Kera dhe Anisa (Tepelena) Brinja;
- Pranë kësaj gjykate, Dhoma Penale ka funksionuar me Seksionin për të Mitur, të përbërë nga gjyqtarë të specializuar në këtë fushë, që gjykojnë njëkohësisht edhe çështjet për të rritur, konkretisht për vitin 2024 ky seksion është përbërë nga gjyqtarët Sokol Shehu, Arbër Çela, Tonin Sterkaj, Besmir Stoka dhe Orgent Nazaj dhe në vijim pas riorganizimit në muajin tetor 2024 nga gjyqtarët Egla Mirashi, Orgent Nazaj dhe Albert Kera.

Nga analiza e punës së Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër gjatë vitit 2024 rezulton se bazuar në ndryshimin me 50% të trupës gjyqësore, si dhe përbërjes së seksioneve, referuar largimeve dhe transferimeve të magistratëve si dhe emërimeve të reja, pas vendimmarrjes në parim për rishortimet nga Këshilli i Gjykatës, nga ana e zv. kryetares së gjykatës me vendimin nr. 138, datë 23.10.2024, u vendos rishortimi i çështjeve gjyqësore.

Për periudhën e inspektuar, organika e gjykatës nuk është e plotësuar me 15 gjyqtarë, aq sa janë në organikë, por kanë qenë efektiv 10 gjyqtarë.

2. Sistemi elektronik i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore që gjykata ka për ndarjen e çështjeve gjyqësore me short.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, ka në përdorim Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, të njohur si ICMIS. Nëpërmjet këtij sistemi gjykata bën regjistrimin e çështjeve, hedhjen në short të tyre si dhe realizon në vazhdim procedurat e zhvillimit të gjykimeve, duke përfshirë këtu procedurat e planifikimit e menaxhimit të secilës çështje gjyqësore.

Nga të dhënat e dërguara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, në funksion të inspektimit me objekt: "Mbi ndarjen e çështjeve me short, si edhe kontrollin e raporteve të sistemit elektronik në gjykata për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024", për të cilin ILD, ka lëshuar vendimin nr. 17, datë 01.04.2025, rezulton se nga Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, janë nxjerrë e dërguar:

- a) raporti periodik për shortimin normal të çështjeve, për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024;
- b) raporti periodik për shortet e realizuara në mënyrë manuale për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024;
- c) raporti për çështjet të cilat janë rishortuar për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024;
- d) raporti periodik për shortimin të çështjeve, për periudhën 01.01.2024 - 31.01.2024, dhe
- e) tabelat e plotësuara me të dhënat që ILD i ka dërguar në funksion të realizimit të inspektimit, dhe që na janë vënë në dispozicion.

Në periudhën e inspektimit nga aktet e dërguara nga gjykata me shkresën nr. 699/2 prot., datë 27.05.2025, në pikën 3 të saj shprehet se Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për vitin 2024, shortimi i çështjeve *nuk është hedhur vetëm në datën*

28.06.2024, kjo për shkak të pavarura nga ana e gjykatës me njoftim të AKSHIT dhe KLGJ-së. Ndërkohë është pezulluar për shkak të mbartjes, dhe lejeve vjetore. Referuar urdhërit nr. 86, datë 28.06.2024 ndërprerja është bërë nga data 28.06.2024 deri më datë 01.07.2024 ora 08:00.

3. Transparenca e dokumentimit të përgatitjes së shortit.

Në kohën e inspektuar 01 janar - 31 dhjetor 2024, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ushtronin detyrën magjistratët Arbër Çela, Tonin Sterkaj, Sokol Shehu, Arta Llazari Besmir Stroka, Orgent Nazaj, Albert Keraj, Egla Mirashi, Elona Mërtiri, Anisa Brinja (Tepelena), Enri Rista, Eni Naqellari, Teftë Xhanari dhe Irida Barkaj.

Për periudhën e inspektuar, të gjithë gjyqtarët efektivë janë përfshirë të gjithë në short.

Nga aktet e administruara gjatë inspektimit rezulton se funksionimi i gjykatës sa i përket shortimit të çështjeve ka vijuar me të njëjtin akt rregullator, të nxjerrë nga zv/kryetari i gjykatës konkretisht Urdhëri i brendshëm nr. 5, datë 19.01.2023, titulluar "Për hedhjen e shortit elektronik në sistemin ICMIS", dalë në zbatim të vendimit nr.554, datë 29.12.2022. Nëpërmjet këtij akti, ndër të tjera, është urdhëruar: "1. Hedhja e shortit elektronik për ndarjen e çështjeve të regjistruara në sistemin e menaxhimit të çështjeve në gjykatë prej datës 23.01.2023 e në vijim do të realizohen çdo ditë zyrtare pune nga dita e hënë deri ditën e premte të çdo jave, në orën 14:00. ...". Përfundim nga ky urdhër kanë bërë çështjet e përcaktuara në kreun "IV" dhe "V" të Vendimit nr. 554 datë 29.12.2022, të Këshillit të Lartë të Gjyqësor "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore"^[245].

Zv/Kryetari i gjykatës për vitin 2024 ka lëshuar urdhër në lidhje me procedurat e hedhjes së shortit të çështjeve në përputhje me vendimin e KLGJ nr. 554, datë 29.12.2022. Në këtë gjykatë rezulton se është zbatuar orari i përcaktuar në Urdhërin e Zv/Kryetarit.

Zv/kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, ka nxjerrë disa akte konkretisht:

- Urdhëri nr. 149 datë 19.12.2023, me të cilin është urdhëruar: "pezullimi i hedhjes së shortit të çështjeve gjyqësore të paraqitura në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nga datën 22.12.2023 deri më datë 10.01.2024 për shkak të procesit të mbartjes së dosjeve në këtë gjykatë. Përfundim nga ky urdhër çështjet e parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale dhe Civile si dhe ligjet e tjera për

^[245] Pika 2 e urdhrit parashikon se: "2. Përfundim nga ky urdhër përbëjnë çështjet e përcaktuara në kreun "IV" dhe "V" të Vendimit nr. 554 datë 29.12.2022, të Këshillit të Lartë të Gjyqësor "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore". Konkretisht përfundohen nga ndarja me short: a) Kërkesat për të cilat ligji parashikon afate shqyrtimi, jo më shumë se 72 orë për gjykatën e shkallës së parë, të cilat shqyrtohen nga gjyqtarët e listës së gatishmërisë, në zbatim të shkronjës "b", të nenit 37, të Ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; b) Kërkesat e paraqitura rishtazi, për të cilat ligji procedural parashikon shqyrtimin nga gjyqtari i hetimeve paraqitur apo nga gjyqtari i seancës paraqitur; c) Çështjet e caktuara me short, për të cilat është disponuar më parë nga gjykata me vendim jopërfundimtar, si edhe çdo vendim tjetër, që pa e zgjidhur çështjen në themel, i jep fund procesit gjyqësor të filluar sipas ligjit; d) Çështjet gjyqësore për të cilat është pranuar gjykimi i shkurtuar; e) Çdo kërkesë apo çështje gjyqësore për të cilat ligji ka parashikuar shqyrtimin nga i njëjti trup gjyqësor.

gjykimin e veçanta si çështje me karakter të ngutshëm, të cilat do të shqyrtohen në përputhje me urdhërin e brendshëm të nxjerrë nga kryetari për përcaktimin e listës së gatishmërisë për gjykimin e çështjeve me karakter të ngutshëm.”.

- Urdhëri nr. 93 datë 22.07.2024 me të cilin urdhëron: Pezullimin e hedhjes së shortit të çështjeve gjyqësore të paraqitura në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nga datën 26.07.2024 deri më datë 09.09.2024 për shkak të lejes vjetore të administratës dhe trupës gjyqësore të kësaj gjykate, duke përjashtuar disa çështje që kërkojnë gjykim të veçantë ose çështje që kanë karakter të ngutshëm^[246].
- Urdhëri nr. 195 datë 17.12.2024, me të cilin urdhëron: Pezullimin e hedhjes së shortit të çështjeve gjyqësore të paraqitura në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nga datën 23.12.2024 deri më datë 13.01.2025 për shkak të procesit të mbartjes së dosjeve në këtë gjykatë duke përjashtuar disa çështje që kërkojnë gjykim të veçantë ose çështje që kanë karakter të ngutshëm^[247].
- Urdhëri nr.86, datë 28.06.2024, “Mos hedhjen e shortit elektronik në sistemin ICMIS të datës 28.06.2024”^[248] kjo për shkak të njoftimit të bërë nga Drejtoria e IT-së dhe Menaxhimit të Çështjeve pranë KLGJ, që ka informuar mbi prezencën e aktorëve të jashtëm që kryejnë sulme me qëllime dashakeqëse në drejtim të infrastrukturave shtetërore.
- Urdhëri nr.15, datë 29.01.2024, “Për hedhjen e shortit elektronik të çështjes civile me nr. Regj. Them. 650/1920 (21013-01591-51-2023) datë regjistrimi 11.10.2023”, për shkak se një gjyqtar ka ndryshuar seksionin në të cilën ndodhej^[249].
- Urdhëri nr.17, datë 31.01.2024, “Për hedhjen e shortit elektronik të çështjes penale me Nr. Regj. Them. 80/2136 (58326-03264-51-2023) datë regjistrimi 10.11.2023,” për shkak disa gjyqtarë kanë papajtueshmëri^[250].

^[246] Përjashtohen nga ky urdhër çështjet e parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale dhe Civile si dhe ligjet e tjera për gjykimin e veçanta si çështje me karakter të ngutshëm, të cilat do të shqyrtohen në përputhje me urdhërin e brendshëm të nxjerrë nga kryetari për përcaktimin e listës së gatishmërisë për gjykimin e çështjeve me karakter të ngutshëm.

^[247] Përjashtohen nga ky urdhër çështjet e parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale dhe Civile si dhe ligjet e tjera për gjykimin e veçanta si çështje me karakter të ngutshëm, të cilat do të shqyrtohen në përputhje me urdhërin e brendshëm të nxjerrë nga kryetari për përcaktimin e listës së gatishmërisë për gjykimin e çështjeve me karakter të ngutshëm.

^[248] Bazuar në e-mailin zyrtar të sjellë nga Drejtoria e IT-së dhe Menaxhimit të Çështjeve pranë KLGJ, ku thuhet “Në vijim të një takimi urgjent të zhvilluar ditën e sotme pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, jemi informuar mbi prezencën e aktorëve të jashtëm që kryejnë sulme me qëllime dashakeqëse në drejtim të infrastrukturave shtetërore. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike ka sugjeruar që duke filluar nga dita e sotme në orën 12:30 deri ditën e hënës date 01.07.2024, të ndërpriten shërbimet online që ofrohen nga institucionet”. Sa më sipër ju njoftojmë se shërbimet si më poshtë do të ndërpriten deri në datën 01.07.2024 ora 08:00. Shërbimi i ofrimit të postës elektronike zyrtare, Shërbimi i Email-it; Portali eëë. gjykata. gov. al; Portali e-shërbime.klgj. al; Portali eëë.klgj.al; Për këtë shkak lidhja VPN me KLGJ nuk është funksionale dhe nuk mund të realizohet shortimi elektronik i çështjeve. Për këtë arsye urdhëroj: Moshedhjen e shortit të dates 28.06.2024.

^[249] Për shkak se me vendimin nr. 14 datë 24.10.2023 të Këshillit të Gjykatës gjyqtari Orgent Nazaj ka kaluar nga Seksioni civil në seksionin penal, lind nevoja e plotësimit të trupës për gjykimin e kësaj çështje me gjyqtar të dhomës civile, ndaj dhe është urdhëruar hedhjen sipas shortit elektronik me datë 29.01.2024 të çështjes Nr. Regj. Them. 650/1920 (21013-01591-51-2023) datë regjistrimi 11.10.2023, mes gjyqtarëve të tjerë të dhomës civile konkretisht gjyqtarët Arta Lazari, Albert Keraj, Egla Mirashi, Elona Mërtiri.

^[250] Për shkak se një pjesë e gjyqtarëve të seksionit penal kanë papajtueshmëri për gjykimin e kësaj çështje, lind nevoja e plotësimit të trupës për gjykimin e kësaj çështje me gjyqtar të dhomës civile, ndaj dhe është urdhëruar hedhja sipas shortit elektronik me datë 31.01.2024 të çështjes Nr. Regj. Them. 80/2136 (58326-03264-51-2023) datë regjistrimi 10.11.2023, mes gjyqtarëve të tjerë të dhomës civile konkretisht gjyqtarët Arta Lazari, Albert Keraj, Egla Mirashi, Elona Mërtiri.

- Urdhëri nr.20, datë 07.02.2024, "Për hedhjen e shortit elektronik të çështjes penale me Nr. Regj. Them. 8/89 (500124-02729-51-2023) datë regjistrimi 27.09.2023", për shkak se disa gjyqtarë kanë papajtueshmëri^[251].
- Urdhëri nr.21, datë 07.02.2024, "Për hedhjen e shortit elektronik të çështjes penale me Nr. Regj. Them. 32 (500113-00386-51-2023) datë regjistrimi 31.01.2024," për shkak se disa gjyqtarë kanë papajtueshmëri^[252].
- Urdhëri nr.23, datë 23.02.2024, "Për hedhjen e shortit elektronik të çështjes penale me Nr. Regj. Them. 8/89 (500124-02729-51-2023) datë regjistrimi 27.09.2023" për shkak se disa gjyqtarë kanë papajtueshmëri^[253].
- Urdhëri nr.31, datë 12.03.2024, "Për hedhjen e shortit elektronik të çështjes penale me Nr. Regj. Them. 406 (58325-00167-51-2024) datë regjistrimi 16.01.2024" për shkak se disa gjyqtarë kanë papajtueshmëri^[254].
- Urdhëri nr.43, datë 02.04.2024, "Për hedhjen e shortit elektronik të çështjes penale me Nr. Regj. Them. 36 (58325-00824-51-2024) datë regjistrimi 26.02.2024" për shkak se disa gjyqtarë kanë papajtueshmëri^[255].
- Urdhëri nr.44, datë 08.04.2024, "Për hedhjen e shortit elektronik të çështjes penale me Nr. Regj. Them. 42 (500124-01028-51-2024) datë regjistrimi 18.03.2024" për shkak se disa gjyqtarë kanë papajtueshmëri^[256].
- Urdhëri nr.48, datë 22.04.2024, "Për hedhjen e shortit elektronik të çështjes penale me Nr. Regj. Them. 1056 (52102-013228-51-2024) datë regjistrimi 12.04.2024" për shkak se disa gjyqtarë kanë papajtueshmëri^[257].

^[251] Rezulton se një pjesë e gjyqtarëve të seksionit penal kanë papajtueshmëri për gjykimin e kësaj çështje. Për këtë arsye lind nevoja e plotësimit të trupës për gjykimin e kësaj çështje me gjyqtar të dhomës civile. Urdhëroj: Hedhjen sipas shortit elektronik me datë 06.02.2024 të çështjes Nr. Regj. Them. 8/89 (500124-02729-51-2023) datë regjistrimi 27.09.2023. Shorti do të hidhet mes gjyqtarëve të tjerë të dhomës civile konkretisht gjyqtarët Arta Lazari, Albert Keraç, Elona Mërtiri, Egla Mirashi dhe Anisa Brinja.

^[252] Rezulton se një pjesë e gjyqtarëve të seksionit penal kanë papajtueshmëri për gjykimin e kësaj çështje. Për këtë arsye lind nevoja e plotësimit të trupës për gjykimin e kësaj çështje me gjyqtar të dhomës civile. Urdhëroj: Hedhjen sipas shortit elektronik me datë 07.02.2024 të çështjes Nr. Regj. Them. 32 (500113-00386-51-2023) datë regjistrimi 31.01.2024. Shorti do të hidhet mes gjyqtarëve të tjerë të dhomës civile konkretisht gjyqtarët Arta Lazari, Albert Keraç, Elona Mërtiri, Egla Mirashi dhe Anisa Brinja.

^[253] Rezulton se një pjesë e gjyqtarëve të seksionit penal kanë papajtueshmëri për gjykimin e kësaj çështje. Për këtë arsye lind nevoja e plotësimit të trupës për gjykimin e kësaj çështje me gjyqtar të dhomës civile. Urdhëroj: Hedhjen sipas shortit elektronik me datë 23.02.2024 të çështjes Nr. Regj. Them. 8/89 (500124-02729-51-2023) datë regjistrimi 27.09.2023. Shorti do të hidhet mes gjyqtarëve të tjerë të dhomës civile konkretisht gjyqtarët Arta Lazari, Albert Keraç, Elona Mërtiri, Egla Mirashi.

^[254] Rezulton se një pjesë e gjyqtarëve të seksionit penal kanë papajtueshmëri për gjykimin e kësaj çështje. Për këtë arsye lind nevoja e plotësimit të trupës për gjykimin e kësaj çështje me gjyqtar të dhomës penale. Urdhëroj: Hedhjen sipas shortit elektronik me datë 12.03.2024 të çështjes Nr. Regj. Them. 406 (58325-00167-51-2024) datë regjistrimi 16.01.2024. Shorti do të hidhet mes gjyqtarëve të tjerë të dhomës penale konkretisht gjyqtarët Arbër Çela dhe Tonin Sterkaj.

^[255] Rezulton se një pjesë e gjyqtarëve të seksionit penal kanë papajtueshmëri për gjykimin e kësaj çështje. Për këtë arsye lind nevoja e plotësimit të trupës për gjykimin e kësaj çështje me gjyqtar të dhomës penale. Urdhëroj: Hedhjen sipas shortit elektronik me datë 02.04.2024 të çështjes Nr. Regj. Them. 36 (58325-00824-51-2024) datë regjistrimi 26.02.2024. Shorti do të hidhet mes gjyqtarëve të tjerë të dhomës penale konkretisht gjyqtarët Arbër Çela dhe Orgent Nazaj.

^[256] Rezulton se një pjesë e gjyqtarëve të seksionit penal kanë papajtueshmëri për gjykimin e kësaj çështje. Për këtë arsye lind nevoja e plotësimit të trupës për gjykimin e kësaj çështje me gjyqtar të dhomës penale. Urdhëroj: Hedhjen sipas shortit elektronik me datë 08.04.2024 të çështjes Nr. Regj. Them. 42 (500124-01028-51-2024) datë regjistrimi 18.03.2024. Shorti do të hidhet mes gjyqtarëve të tjerë të dhomës penale konkretisht gjyqtarët Arbër Çela dhe Orgent Nazaj.

^[257] Rezulton se një pjesë e gjyqtarëve të seksionit penal kanë papajtueshmëri për gjykimin e kësaj çështje. Për këtë arsye lind nevoja e plotësimit të trupës për gjykimin e kësaj çështje me gjyqtar të dhomës penale. Urdhëroj: Hedhjen sipas shortit elektronik me datë 08.04.2024 të çështjes Nr. Regj. Them. 1056 (52102-013228-51-2024) datë regjistrimi 12.04.2024. Shorti do të hidhet mes gjyqtarëve të tjerë të dhomës penale konkretisht gjyqtarët Besmir Stroka dhe Orgent Nazaj.

- Urdhëri nr.61, datë 13.05.2024, "Për hedhjen e shortit elektronik të çështjes penale me Nr. Regj. Them. 297/2218 (52605-03391-51-2023) datë regjistrimi 22.11.2023" për shkak se disa gjyqtarë kanë papajtueshmëri^[258].
- Urdhëri nr.65, datë 14.05.2024, "Për hedhjen e shortit elektronik të çështjes civile me Nr. Regj. Them. 610/183/1789 (21013-02334-51-2022) datë regjistrimi 27.10.2022" për shkak se disa gjyqtarë kanë papajtueshmëri^[259].
- Urdhëri nr.67, datë 22.05.2024, "Për hedhjen e shortit elektronik të çështjes civile me Nr. Regj. Them. 664/1626 (21233-01126-51-2023) datë regjistrimi 12.06.2023" për shkak se disa gjyqtarë kanë papajtueshmëri^[260].
- Urdhëri nr.68, datë 27.05.2024, "Për hedhjen e shortit elektronik të çështjes penale me Nr. Regj. Them. 221/367/489/1262 (21013-01407-51-2021) datë regjistrimi 15.07.2021" nxjerrë për shkak se disa magistratë kanë papajtueshmëri^[261].
- Urdhërin nr.81, datë 21.06.2024, "Për hedhjen e shortit elektronik të çështjes penale me Nr. Regj. Them. 606/192/1924 (21013-02585-51-2022) datë regjistrimi 15.10.2022" nxjerrë për shkak se disa gjyqtarë kanë papajtueshmëri^[262].
- Urdhërin nr.82, datë 21.06.2024, "Për hedhjen e shortit elektronik të çështjes penale me Nr. Regj. Them. 574/1482 (21013-00866-51-2023) datë regjistrimi 08.05.2023" nxjerrë për shkak se disa gjyqtarë kanë papajtueshmëri^[263].
- Urdhërin nr.110, datë 18.09.2024, "Për hedhjen e shortit elektronik të çështjes penale me Nr. Regj. Them. 1465 (58325-002297-51-2024) datë regjistrimi 09.07.2024" nxjerrë për shkak se disa gjyqtarë kanë papajtueshmëri^[264].

^[258] Rezulton se një pjesë e gjyqtarëve të seksionit penal kanë papajtueshmëri për gjykimin e kësaj çështje. Për këtë arsye lind nevoja e plotësimit të trupës për gjykimin e kësaj çështje me gjyqtar të dhomës civile. Urdhëroj: Hedhjen sipas shortit elektronik me datë 13.05.2024 të çështjes Nr. Regj. Them. 297/2218 (52605-03391-51-2023) datë regjistrimi 22.11.2023. Shorti do të hidhet mes gjyqtarëve të tjerë të dhomës civile konkretisht gjyqtarët Arta Lazari, Albert Keraj, Elona Mërtiri, Egla Mirashi dhe Anisa Brinja.

^[259] Rezulton se një pjesë e gjyqtarëve të seksionit civil kanë papajtueshmëri për gjykimin e kësaj çështje. Për këtë arsye lind nevoja e plotësimit të trupës për gjykimin e kësaj çështje me gjyqtar të tjerë të dhomës civile. Urdhëroj: Hedhjen sipas shortit elektronik me datë 14.05.2024 të çështjes Nr. Regj. Them. 610/183/1789 (21013-02334-51-2022) datë regjistrimi 27.10.2022. Shorti do të hidhet mes gjyqtarëve të tjerë të dhomës civile konkretisht gjyqtarët Albert Keraj, Anisa Brinja (Tepelena), Elona Mërtiri, Egla Mirashi.

^[260] Rezulton se një pjesë e gjyqtarëve të seksionit civil kanë papajtueshmëri për gjykimin e kësaj çështje. Për këtë arsye lind nevoja e plotësimit të trupës për gjykimin e kësaj çështje me gjyqtar të tjerë të dhomës civile. Urdhëroj: Hedhjen sipas shortit elektronik me datë 22.05.2024 të çështjes Nr. Regj. Them. 664/1626 (21233-01126-51-2023) datë regjistrimi 12.06.2023. Shorti do të hidhet mes gjyqtarëve të tjerë të dhomës civile konkretisht gjyqtarët Albert Keraj, Anisa Brinja (Tepelena), Elona Mërtiri, Egla Mirashi.

^[261] Rezulton se një anëtar i trupës është larguar me lëvizje paralele. Për këtë arsye lind nevoja e plotësimit të trupës për gjykimin e kësaj çështje me gjyqtar të dhomës civile. Urdhëroj: Hedhjen sipas shortit elektronik me datë 27.05.2024 të çështjes Nr. Regj. Them. 221/367/489/1262 (21013-01407-51-2021) datë regjistrimi 15.07.2021. Shorti do të hidhet mes gjyqtarëve të tjerë të dhomës civile konkretisht gjyqtarët Anisa Brinja, Elona Mërtiri, Egla Mirashi.

^[262] Rezulton se një anëtar i trupës ka kaluar nga seksioni civil në atë penal. Për këtë arsye lind nevoja e plotësimit të trupës për gjykimin e kësaj çështje me gjyqtar të dhomës civile. Urdhëroj: Hedhjen sipas shortit elektronik me datë 21.06.2024 të çështjes Nr. Regj. Them. 606/192/1924 (21013-02585-51-2022) datë regjistrimi 15.10.2022. Shorti hidhet mes gjyqtarëve të tjerë të dhomës civile konkretisht gjyqtarët Albert Keraj, Anisa Brinja (Tepelena), Elona Mërtiri, Egla Mirashi.

^[263] Rezulton se një anëtar i trupës ka kaluar nga seksioni civil në atë penal. Për këtë arsye lind nevoja e plotësimit të trupës për gjykimin e kësaj çështje me gjyqtar të dhomës civile. Urdhëroj: Hedhjen sipas shortit elektronik me datë 21.06.2024 të çështjes Nr. Regj. Them. 574/1482 (21013-00866-51-2023) datë regjistrimi 08.05.2023. Shorti do të hidhet mes gjyqtarëve të tjerë të dhomës civile konkretisht gjyqtarët Albert Keraj, Anisa Brinja (Tepelena), Elona Mërtiri, Egla Mirashi.

^[264] Rezulton se një anëtar i trupës është transferuar me lëvizje paralele. Për këtë arsye lind nevoja e plotësimit të trupës për gjykimin e kësaj çështje me gjyqtar të dhomës penale. Urdhëroj: Hedhjen sipas shortit elektronik me datë 18.09.2024 të çështjes Nr. Regj. Them. 1465 (58325-002297-51-2024) datë regjistrimi 09.07.2024. Shorti do të hidhet mes gjyqtarëve të tjerë të dhomës penale konkretisht gjyqtarët Sokol Shehu, Orgent Nazaj dhe Egla Mirashi.

- Urdhëri nr. 111, datë 23.09.2024, "Për hedhjen e shortit elektronik të çështjes penale me Nr. Regj. Them. 1313 (01908) datë regjistrimi 05.07.2024" nxjerrë për shkak se disa gjyqtarë kanë papajtueshmëri^[265].
- Urdhëri nr.132, datë 14.10.2024, "Për hedhjen e shortit elektronik të çështjes penale me Nr. Regj. Them. 297/2218 (52605-03391-51-2023) datë regjistrimi 22.11.2023" nxjerrë për shkak se disa gjyqtarë kanë papajtueshmëri^[266].
- Urdhëri nr.150, datë 05.11.2024, "Për hedhjen e shortit elektronik të çështjes penale me Nr. Regj. Them. 1433 (71107-02212-51-2024) datë regjistrimi 28.06.2024" nxjerrë për shkak se disa gjyqtarë kanë papajtueshmëri^[267].
- Urdhëri nr.157, datë 11.11.2024, "Për hedhjen e shortit elektronik të çështjes penale me Nr. Regj. Them. 1170 (52104-01544-51-2024) datë regjistrimi 30.04.2024" nxjerrë për shkak se disa gjyqtarë kanë papajtueshmëri^[268].
- Urdhërin nr.158, datë 11.11.2024, "Për hedhjen e shortit elektronik të çështjes penale me Nr. Regj. Them. 1491 (53107-02369-51-2024) datë regjistrimi 17.07.2024" nxjerrë për shkak se disa gjyqtarë kanë papajtueshmëri^[269].
- Urdhërin nr.185, datë 06.12.2024, "Për hedhjen e shortit elektronik të çështjes civile me Nr. Regj. Them. 1697 (21013-00879-51-2023) datë regjistrimi 28.06.2024" nxjerrë për shkak se disa gjyqtarë kanë papajtueshmëri^[270].
- Urdhërin nr.186, datë 06.12.2024, "Për hedhjen e shortit elektronik të çështjes penale me Nr. Regj. Them. 1526 (52102-02443-51-2024) datë regjistrimi 25.07.2024" nxjerrë për shkak se disa gjyqtarë kanë papajtueshmëri^[271].
- **Vendimi nr. 138, datë 23.10.2024, "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër", është bërë rihedhja në short e shumë çështjeve për shkak se gjatë muajit shtator, trupa gjyqësore e**

^[265] Rezulton se një anëtar i trupës ka papajtueshmëri. Për këtë arsye lind nevoja e plotësimit të trupës për gjykimin e kësaj çështje me gjyqtar të dhomës civile. Urdhëroj: Hedhjen sipas shortit elektronik me datë 23.09.2024 të çështjes Nr. Regj. Them. 1313 (01908) datë regjistrimi 05.07.2024. Shorti do të hidhet mes gjyqtarëve të tjerë të dhomës civile konkretisht gjyqtarët Arta Lazari, Albert Keraj, Elona Mërtiri, Egla Mirashi dhe Anisa Brinja.

^[266] Rezulton se një anëtar i trupës është Tonin Sterkaj dhe një tjetër ka papajtueshmëri. Për këtë arsye lind nevoja e plotësimit të trupës për gjykimin e kësaj çështje me gjyqtar të dhomës penale. Urdhëroj: Hedhjen sipas shortit elektronik me datë 14.10.2024 të çështjes Nr. Regj. Them. 297/2218 (52605-03391-51-2023) datë regjistrimi 22.11.2023. Shorti do të hidhet mes gjyqtarëve të tjerë të dhomës penale konkretisht gjyqtarët Egla Mirashi, Albert Keraj, Elona Mërtiri, dhe Anisa Brinja.

^[267] Rezulton se janë se me urdhër të brendshëm 130 datë 10.10.2024, janë shortuar dosjet e gjyqtarit Sokol Shehu. Për këtë arsye lind nevoja e plotësimit të trupës për gjykimin e kësaj çështje me gjyqtar të dhomës penale. Urdhëroj: Hedhjen sipas shortit elektronik me datë 05.11.2024 të çështjes Nr. Regj. Them. 1433 (71107-02212-51-2024) datë regjistrimi 28.06.2024. Shorti do të hidhet mes gjyqtarëve të tjerë të dhomës penale konkretisht gjyqtarët Elona Mërtiri, Albert Keraj, dhe Anisa Brinja (Tepelena).

^[268] Rezulton se një anëtarë i trupës ka papajtueshmëri. Për këtë arsye lind nevoja e plotësimit të trupës për gjykimin e kësaj çështje me gjyqtar të dhomës penale. Urdhëroj: Hedhjen sipas shortit elektronik me datë 11.11.2024 të çështjes Nr. Regj. Them. 1170 (52104-01544-51-2024) datë regjistrimi 30.04.2024. Shorti do të hidhet mes gjyqtarëve të tjerë të dhomës penale konkretisht gjyqtarët Egla Mirashi dhe Albert Keraj.

^[269] Rezulton se një anëtarë i trupës ka papajtueshmëri. Për këtë arsye lind nevoja e plotësimit të trupës për gjykimin e kësaj çështje me gjyqtar të dhomës penale. Urdhëroj: Hedhjen sipas shortit elektronik me datë 11.11.2024 të çështjes Nr. Regj. Them. 1491 (53107-02369-51-2024) datë regjistrimi 17.07.2024. Shorti do të hidhet mes gjyqtarëve të tjerë të dhomës penale konkretisht gjyqtarët Elona Mërtiri, dhe Anisa Brinja (Tepelena).

^[270] Rezulton se një anëtar i trupës ka kaluar nga seksioni civil në atë penal. Për këtë arsye lind nevoja e plotësimit të trupës për gjykimin e kësaj çështje me gjyqtar të tjerë të dhomës civile. Urdhëroj: Hedhjen sipas shortit elektronik me datë 06.12.2024 të çështjes Nr. Regj. Them. 1697 (21013-00879-51-2023) datë regjistrimi 28.06.2024. Shorti do të hidhet mes gjyqtarëve të tjerë të dhomës civile konkretisht gjyqtarët Arta Lazari, Eni Naqellari, Teftë Xhanari, Enri Rista, Irida Barkaj.

^[271] Rezulton se një anëtarë i trupës ka papajtueshmëri. Për këtë arsye lind nevoja e plotësimit të trupës për gjykimin e kësaj çështje me gjyqtar të dhomës penale. Urdhëroj: Hedhjen sipas shortit elektronik me datë 06.12.2024 të çështjes Nr. Regj. Them. 1526 (52102-02443-51-2024) datë regjistrimi 25.07.2024. Shorti do të hidhet mes gjyqtarëve të tjerë të dhomës penale konkretisht gjyqtarët Elona Mërtiri, dhe Anisa Brinja (Tepelena).

Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, ka pësuar ndryshime të theksuara për shkak të shkarkimeve, transferimeve dhe emërimeve të magjistratëve. Në këtë urdhër të nxjerrë është evidentuar fakti i riformimit të Këshillit të Gjykatës në përputhje me vendimin nr. 71 datë 20.05.2019 të KLGJ-së, të transferimit të gjyqtarit Sokol Shehu, i cili ka ushtruar edhe funksionin e zv. Kryetarit, dhe të zgjedhjes nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të zëvendëskryetares së gjykatës, të vetë gjyqtarës znj. Egla Mirashi, si dhe është evidentuar edhe fakti i emërimit të katër magjistratëve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, dhe konkretisht Eni Naqellari, Enri Rista, Irida Bakaj dhe Teftë Xhanari. Ndaj ndodhur para këtyre ndryshimeve si në këshill dhe në trup gjyqësor me datë 07.10.2024 u mbledh Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, i cili me vendimin nr. 21.07.10.2024 vendosi:

- Seksioni penal të përbëhet nga magjistratët: Egla Mirashi, Orgent Nazaj, Elona Mërtiri, Albert Keraj dhe Anisa (Tepelena) Brinja.
- Seksioni penal për të mitur të përbëhet nga magjistratët: Egla Mirashi, Orgent Nazaj, dhe Albert Keraj.
- Seksioni civil të përbëhet nga magjistratët: Arta Lazari, Eni Naqellari, Enri Rista, Irida Bakaj dhe Teftë Xhanari.

Gjithashtu, në urdhër është evidentuar edhe fakti i kërkesave të bëra nga disa gjyqtarë (Arta Llazari^[272], Orgent Nazaj^[273], Egla Mirashi^[274], Albert Keraj^[275], Elona Mërtiri^[276], Anisa Brinja (Tepelena)^[277]. Është grumbulluar informacion sa i përket ngarkesës së gjyqtarëve në fushën civile deri më datë 23.10.2024, ku ka rezultuar se:

- Gjyqtarja Egla Mirashi, ka në shqyrtim 65 çështje civile, nga të cilat referohen në kërkesë se për 53 çështje gjykimi akoma nuk ka filluar, më saktë, për të cilat nuk është nxjerrë akoma urdhëri për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore;
- Gjyqtari Orgent Nazaj, ka në shqyrtim 70 çështje civile, nga të cilat referohen në kërkesë se për 63 çështje gjykimi akoma nuk ka filluar, më saktë, për të cilat nuk është nxjerrë akoma urdhëri për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore;
- Gjyqtare Elona Mërtiri, ka në shqyrtim 128 çështje civile, nga të cilat referohen në kërkesë se për 108 çështje gjykimi akoma nuk ka filluar, më saktë, për të cilat nuk është nxjerrë akoma urdhëri për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore;
- Gjyqtari Albert Keraj, ka në shqyrtim 151 çështje civile, nga të cilat referohen në kërkesë se për 131 çështje gjykimi akoma nuk ka filluar, më saktë, për të cilat nuk është nxjerrë akoma urdhëri për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore;
- Gjyqtare Anisa (Tepelena) Brinja, ka në shqyrtim 129 çështje civile, nga të cilat referohen në kërkesë se për 109 çështje gjykimi akoma nuk ka filluar, më saktë,

^[272] Gjyqtarja Arta Llazari me kërkesën nr. 1684/3 prot, datë 7.10.2024 dhe kërkesës nr. 1767 prot., datë 14.10.2024 me argumentin se për shkak të rishortimeve ka marrë ngarkesë nga viti 2022 e në vijim, duke mbajtur një ngarkesë mbi 600 dosje në gjykim, dhe në kushtet e shtimit të gjyqtarëve të rinj;

^[273] Gjyqtari Orgent Nazaj me kërkesën nr.1684/12 datë 23.10.2024;

^[274] Gjyqtarja Egla Mirashi me kërkesën nr.1684/8, datë 23.10.2024;

^[275] Gjyqtari Albert Keraj me kërkesën nr. 1684/9, datë 22.10.2024;

^[276] Gjyqtarja Elona Mërtiri me kërkesën nr. 1684/11, datë 22.10.2024; ;

^[277] Gjyqtarja Anisa (Tepelena) Brinja me kërkesën nr.1684/10, datë 22.10.2024.



për të cilat nuk është nxjerrë akoma urdhëri për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore;

- Gjyqtare Arta Llazari, ka në shqyrtim 613 çështje e civile, nga të cilat referohen në kërkesë se për 438 çështje gjykimi akoma nuk ka filluar, më saktë, për të cilat nuk janë kryer as veprimet përgatitore.

Ndaj për të gjitha sa më sipër, në urdhër është arsyetuar se: "... për të ruajtur numrin mesatar të çështjeve që marrin në shqyrtim gjyqtarët e rinj të caktuar në dhomën civile, me qëllim sigurimin e barazisë së shpërndarjes, efencës dhe objektivitetit ..." është disponuar me: • Së pari: çështjet e gjyqtarëve Eglia Mirashi, Orgent azaj, Albert Keraj, Anisa (Tepelena) Brinja dhe Elona Mërtiri, si gjyqtare të cilët kanë ndryshuar seksion (referuar nenit 7, pika 6 të vendimit nr. 724, datë 07.12.2023 "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore" të Këshillit të Lartë Gjyqësor duhet të rishortohen sipas listave të depozituara nga ana e tyre referuar më sipër. • Së dyti: çështjet e gjyqtarës Alia Llazari nuk mund të shortohen në tërësi sipas listës së paraqitur nga ana e saj, pasi prishet ekuilibri dhe barazia e shpërndarjes së çështjeve, tek gjyqtarët e rinj të cilët mbingarkohen më shumë se vetë gjyqtarja që paraqet kërkesën për rishortim. ... etj.

Në rindarjen e çështjeve me short do të mbahet në konsiderate ngarkesa aktuale e secilit gjyqtar, si dhe parashikimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me rastin e emërimit të katër gjyqtarëve të rinj në këtë gjykatë, në datë 02.10.2024. Për secilin gjyqtar do të bëhet rindarja e çështjeve gjyqësore me short. Sa me sipër, Vendosa: 1. Rindarjen me short të çështjeve civile, si më poshtë vijon:

- 53 (pesëdhjetë e tre) çështje në ngarkim të gjyqtarës Eglia Mirashi referuar listës nr. 1684/8 prot., datë 23.10.2024.
 - 63 (gjashtëdhjetë e tre) çështje në ngarkim të gjyqtarit Orgent Nazaj, referuar listës nr. 1684/12 prot, datë 23.10.2024.
 - 109 (njëqind e nëntë) çështje në ngarkim të gjyqtarës Anisa (Tepelena) Brinja, referuar listës nr.1684/10 prot., datë 23.10.2024.
 - 192 (njëqind e nëntëdhjetë e dy) çështje në ngarkim të gjyqtarës Arta Llazari për çështjet e referuara në pjesën arsyetuese sipas aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.
 - 108 (njëqind e tetë) çështje në ngarkim të gjyqtarës Elona Mërtiri, referuar listës nr. 1684/11 prot., datë 22.10.2024.
 - 131 (njëqind e tridhjetë e një) çështje në ngarkim të gjyqtarit Albert Keraj, referuar listës nr. 1684/9 prot, date 22.10.2024, ...".^[278]
- Vendim nr. 138/1, datë 28.10.2024, "Për një ndryshim në vendimin nr. 138 datë

^[278] Në vijim në urdhër është përcaktuar: "1 ... 2. Një kopje e vendimit i komunikohet gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe administratës gjyqësore, një kopje i dërgohet për dijeni Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe një kopje afishohet për publikan. 3. Depozitimin e dosjeve gjyqësore për të cilat në këtë vendim është disponuar për rishortim, të administruar dhe numërtuara nga ana e sekretarisë gjyqësore pranë gjyqtarëve sipërcituar, me listë të protokollluar, ku një kopje do përfshihet në protokoll, një kopje do i bashkohet këtij vendimi, një kopje do i vendoset në dispozicion kryesekretarisë. 4. Rishortimi i çështjeve të sipërcituara do të realizohet me datë 28.10.2024 ora 10:00 dhe do të bëhet mes gjyqtarëve Eni Naqellari, Enri Rista, Irida Barkaj dhe Tefë Xhamari. 5. Ngarkohet kancelaria dhe specialistët e IT-së së gjykatës për zbatimin e këtij vendimi. 6. Këtij vendimi i bashkohet listat e gjyqtarëve: për Eglia Mirashi shkresa me nr. 1684/8 prot., date 23.10.2024; për Orgent Nazaj shkresa me nr.1684/12 prot., date 23.10.2024 për Anisa (Tepelena) Brinja shkresa me nr.1684/10 prot., datë 23.10.2024, për Elona Mërtiri shkresa me nr. 1684/11 prot., datë 22.10.2024, për gjyqtarin Albert Keraj shkresa me nr. 1684/9 prot., datë 22.10.2024, për çështjet e gjyqtarës Arta Llazari. Aneksi i përpunuar nga sektori i statistikave.

23.10.2024" ku, ndër të tjera, është vendosur^[279]:

1. Ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 138, datë 23.10.2024, si më poshtë vijon:
2. Rindarjen me short të çështjeve civile për gjyqtaret Egla Mirashi, Orgent Nazaj dhe Anisa (Tepelena) Brinja, duke ndryshuar numrin e çështjeve për rishortim si më poshtë:
 - 52 (pesëdhjetë e dy) çështje në ngarkim të gjyqtarës Egla Mirashi, sipas pjesës arsyetuese;
 - 61 (gjashtëdhjetë e një) çështje në ngarkim të gjyqtarit Orgent Nazaj, sipas pjesës arsyetuese;
 - 108 (njëqind e tetë) çështje në ngarkim të gjyqtarës Anisa (Tepelena) Brinja, sipas pjesës arsyetuese.
3. Depozitimim e dosjeve gjyqësore nga ana e gjyqtarëve Albert Keraj, Elona Mërtiri dhe Arta Llazari, sipas vendimit nr. 138, datë 23.10.2024, për rishortim brenda datës 29.10.2024, të administruara dhe të numëruara nga ana e sekretarisë gjyqësore pranë gjyqtarëve të sipërcituar, me listë të protokolluar, ku një kopje do të përfshihet në protokoll, një kopje do t'i bashkëngjitet këtij vendimi dhe një kopje do t'i vendoset në dispozicion kryesekretarisë.
4. Ngarkohet Kryesekretaria në përpunimin dhe përgatitjen e çështjeve të përshkruara në pikën 3, për t'i rishortuar ato në datat: 29.10.2024 për gjyqtarin

^[279] Në këtë vendimmarrja ndër të tjera është arsyetuar se: "Gjatë procesit të përpunimit të dosjeve gjyqësore nga ana e sekretarisë gjyqësore, në bashkëpunim me sekretaren regjistruese pranë kryesekretarisë, janë konstatuar probleme në listat e depozituara nga sekretarët, duke ndryshuar kështu edhe numrin e dosjeve që do t'i nënshtrohen rishortimit, konkretisht si vijon: - Për gjyqtaren Egla Mirashi, nga lista e depozituar me nr. 1684/8 prot., datë 23.10.2024, konstatohet se është përfshirë dosja me nr. 1385 (21249-00336-51-2024), datë 01.03.2024, e pasqyruar me nr. rendor 23 të listës për rishortim. Në lidhje me këtë dosje rezultoi të jetë disponuar me vendimin nr. 51-2024-4020, datë 08.10.2024, nga ana e kësaj gjyqtareje. Në të tilla kushte, përfundimisht listës së gjyqtarës Egla Mirashi me nr. 1684/8, datë 23.10.2023, prej 54 çështjeve i hiqen ato me nr. rendor 28 (e cila nuk është përfshirë si numër në sasinë e vendimuar me vendimin nr. 138, datë 23.10.2024, në të cilin janë referuar 53 çështje për rishortim) dhe ajo me nr. rendor 23, për të cilën u relatua me procesverbalin nr. 1850/2, datë 28.10.2024, që është shpallur më përpara dhe nuk duhej të ishte përfshirë në listë. Sa më sipër, referuar për gjyqtaren Egla Mirashi, duhet të rishortohen gjithsej 52 (pesëdhjetë e dy) çështje gjyqësore, të referuara në listën me nr. 1684/8 prot., datë 23.10.2024, duke përjashtuar çështjet me nr. rendor 23 dhe 28. - Për gjyqtarin Orgent Nazaj, nga lista e depozituar me nr. 1684/12 prot., datë 23.10.2024, konstatohet se janë përfshirë: (i) Dosja me nr. 80/448/1162 (21235-01193-51-2021), datë 14.06.2021^[279], e pasqyruar me nr. rendor 49 të listës për rishortim; (ii) Dosja me nr. 1411 (10940-00722-51-2023), datë 11.04.2023^[279], e pasqyruar me nr. rendor 56 të listës për rishortim. Në të tilla kushte, përfundimisht listës së gjyqtarit Orgent Nazaj me nr. 1684/12, datë 23.10.2024, prej 64 çështjeve i hiqen ato me nr. rendor 45 (e cila nuk është përfshirë si numër në sasinë e vendimuar me vendimin nr. 138, datë 23.10.2024), si dhe ato me nr. rendor 49 dhe 56, për të cilat u relatua me procesverbalin nr. 1850/3, datë 28.10.2024, pasi njëra është shpallur më përpara dhe tjetra, pas miratimit të kërkesës për heqje dorë, është rishortuar dhe nuk duhej të ishte përfshirë në listë. Sa më sipër, referuar për gjyqtarin Orgent Nazaj, duhet të rishortohen gjithsej 61 (gjashtëdhjetë e një) çështje gjyqësore, të referuara në listën me nr. 1684/12 prot., datë 23.10.2024, duke përjashtuar çështjet me nr. rendor 45, 49 dhe 56. - Për gjyqtaren Anisa (Tepelena) Brinja, nga lista e depozituar me nr. 1684/10 prot., datë 23.10.2024, konstatohet se është përfshirë dosja me nr. sistemi (10900-02439-51-2021), datë 20.12.2021, e pasqyruar me nr. rendor 105 të listës për rishortim. Në lidhje me këtë dosje rezultoi të jetë disponuar me vendimin e datës 15.10.2024 për bashkimin e saj me dosjen gjyqësore me nr. 1530 (10900-00588-51-2024), datë 23.04.2024, dosje kjo e referuar në numrin rendor 61. Në të tilla kushte, përfundimisht listës së gjyqtarës Anisa (Tepelena) Brinja me nr. 1684/10, datë 23.10.2023, prej 110 çështjeve i hiqen ato me nr. rendor 15 (e cila nuk është përfshirë si numër në sasinë e vendimuar me vendimin nr. 138, datë 23.10.2024, në të cilin janë referuar 109 çështje për rishortim) dhe ajo me nr. rendor 105, për të cilën u relatua me procesverbalin nr. 1850/4, datë 28.10.2024, pasi është bashkuar me atë të përshkruar në numrin rendor 61. Sa më sipër, referuar për gjyqtaren Anisa (Tepelena) Brinja, duhet të rishortohen gjithsej 108 (njëqind e tetë) çështje gjyqësore, të referuara në listën me nr. 1684/10 prot., datë 23.10.2024, duke përjashtuar çështjet me nr. rendor 15 dhe 105. Sa i përket gjyqtarëve Albert Keraj, Elona Mërtiri dhe Arta Llazari, nga ana e këtyre të fundit nuk janë depozituar në datën e parashikuar për rishortim dosjet gjyqësore, për arsye të vonësave në administrimin e dosjeve dhe planifikimeve ditore të gjyqtarëve. Në të tilla kushte, për shkak të ngarkesës që ka sistemi për të përfunduar rishortimin e një numri shumë të madh çështjesh, si dhe duke qenë se nga ana e tre gjyqtarëve nuk janë depozituar dosjet gjyqësore për shkaqet e mësipërme, konstatohet se shorti nuk mund të hidhet në një datë për të gjithë gjyqtarët.

Albert Keraj; 30.10.2024 për gjyqtaren Elona Mërtiri; dhe 31.10.2024 për gjyqtaren Arta Llazari.

5. Në rast të konstatimit në vijim të pasaktësive me listat e përpiluara nga secili gjyqtar, të mbahet një procesverbal nga ana e kryesekretarisë dhe sekretarisë gjyqësore pranë gjyqtarit përkatës, të cilit i rishortohen dosjet.
6. Pjesët e tjera të vendimit nr. 138, datë 23.10.2024, mbeten të pandryshuara.

Zv/kryetari i gjykatës ka nxjerrë akte me të cilat ka urdhëruar ndërprerjen e shortit në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Po ashtu ka nxjerr urdhër për shortimin e çështjeve specifike për shkak të papajtueshmërisë që kanë gjyqtarët specifik ose për shkak të kalimit nga një seksion në tjetër, ose për mos ushtrimin të detyrës pranë asaj gjykate. Këto akte janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Vetëm në dy raste plotësimi i anëtarëve të trupës është bërë nga sistemi sepse kishte gjyqtar të pa konsumuar brenda seksionit, për këtë është mbajtur procesverbal.

Nga verifikimi i shortit normal konstatohet që çështjet gjyqësore që paraqiten në gjykatë rezultojnë se nuk regjistrohen menjëherë në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve nga sekretaria gjyqësore, sipas kategorive të sistemit, por ka raste që regjistrohen edhe në ditë pushimi, në kundërshtim me kërkesat e nenit 25 të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe kërkesat e pikës 1 të kreut III "Procedurat dhe rregullat e ndarjes së çështjeve me short" të Vendimit të KLGJ-së nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore". *Data e Regjistrimit: 21.01.2024 për çështjen nr. (21234-00110-51-2024) sistemi, nga verifikimi në kalendar kjo datë është ditë e diel ditë pushimi; për çështjen nr. (520003-00823-51-2024) sistemi konstatohet që është datë e Dorëzimit: 24.02.2024; për çështjen nr. (58325-00824-51-2024) sistemi konstatohet që është datë e Dorëzimit: 24.02.2024, nga verifikimi në kalendar kjo datë është ditë e shtunë ditë pushimi, çështjen nr. (520003-01413-51-2024) sistemi konstatohet që është datë e Dorëzimit: 21.04.2024*.

Nga informacioni i përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër me shkresën nr. 699/2 prot., datë 27.05.2025 regjistruar me nr. 1326/30 prot., datë 28.06.2024, rezultojnë se me Urdhërin e Kryetarit të Gjykatës për përcaktimin e gjyqtarëve për gjykimet rasteve urgjente, praktika Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, ka qenë e tillë: Kryetari i gjykatës çdo fund muaji ka përcaktuar listën e gatishmërisë së gjyqtarëve që do gjykojnë çështje e përcaktuara si të ngutshme në afatet e gjykimin sipas Kodeve të Procedurës Penale dhe Civile, si dhe ligje të tjera (Ligji "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" apo ai "Për dhënien e ndihmës ligjore falas"), duke i renditur me rend alfabetik referuar mbiemrit të tyre. Pjesërisht kjo praktikë ka vijuar edhe gjatë vitit 2024 për shkak të ndryshimeve të shumta të trupës gjyqësore gjatë këtij viti, si dhe emërimeve dhe shkarkimeve të gjyqtarëve (shih urdhrat tek aneksi 3 bashkëlidhur).

Secili nga këto akte, përbën një vendim të kryetarit (Zv/Kryetarit në mungesë të Kryetarit), që në pamjet të parë plotëson 1 nga 3 standardet e kërkuar nga neni 37 shkronja b) dhe neni 2 shkronja c) i ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e

Shqipërisë”, i ndryshuar: (i) por nuk plotëson kriterin në drejtim të kohës së miratimit, sepse vendimi nuk është nxjerrë në fillim të muajit janar për të gjithë vitin, por në periudha të ndryshme të vitit, kjo për shkak të ndryshimeve të shpeshta të trupës; (ii) vendimet në vazhdim mbulojnë të gjithë periudhën nga data 01.01.2024 deri më 05.01.2025; dhe (iii) secili prej tyre cakton të gjithë gjyqtarët në short sipas rendit alfabetik, me bazë mbiemrin. Vetëm një gjyqtar ka kërkuar përjashtimin nga gatishmëria për arsye të motivuar.

4. Përjashtimet nga hedhja në short e gjyqtarëve^[280].

Nga aktet e administruara gjatë inspektimit, referuar pikës 8 të shkresës rezulton se nga ana e Zv/Kryetarit të Gjykatës me urdhër të brendshëm është vendosur ulja jo më pak se 75 % të ngarkesës në shpërndarjen e çështjeve gjyqësore në shortin elektronik të gjyqtarit Sokol Shehu, i cili ushtron funksionet e Kryetarit në përputhje me nenin 26 pika 2 e Ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”; Me të njëjtin arsyetim si më sipër është vendosur ulja e ngarkesës së zv/Kryetares së re të zgjedhur znj. Egla Mirashi. Urdhëri nr. 10, datë 18.01.2024; Urdhëri nr. 135, datë 17.10.2024, si më poshtë:

- Urdhër nr. 10 datë 18.01.2024 “Për uljen e ngarkesës”, për uljen e ngarkesës së gjyqtarit Sokol Shehu, me detyrë zëvendëskryetar pranë kësaj gjykate, i cili ushtron funksionet e Kryetarit në masën jo më pak se 75% të një gjyqtari^[281].
- Urdhër nr. 135 datë 17.10.2024 “Për uljen e ngarkesës” për uljen e ngarkesës së gjyqtarit Egla Mirashi, me detyrë zëvendëskryetar pranë kësaj gjykate, i cili ushtron funksionet e Kryetarit në masën jo më pak se 75% të një gjyqtari^[282].
- Urdhër nr.49 datë 26.04.2024 “Për përjashtimin e gjyqtarit Besmir Stroka nga procedura e shortit”, për shkak se vendim nr. 214 datë 25.04.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është transferuar me procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
- Urdhër nr.100 datë 02.09.2024 “Për përjashtimin e gjyqtarit Arbër Çela nga procedura e shortit”, për shkak se me vendim nr. 472 datë 31.07.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;
- Urdhër nr. 103 datë 05.09.2024 “Për përjashtimin e gjyqtarit Tonin Sterkaj nga

[280] Kjo pikë e raportit përfshin largimin e gjyqtarëve nga çështjet gjyqësore: a)-për kërkesa për dorëheqje gjyqtari, të miratuara nga Kryetari e Gjykatës; b)-për kërkesa për përjashtim gjyqtari nga gjykimi, për të cilat është ka vendim gjyqësor; dhe c)-për raste kur gjyqtari është larguar për shkak të procedurave të zbatimit të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ose për arsye të tjera të ligjshme.

[281] Mëshëtitur në ligjin nr. 98/2016, “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, konkretisht në nenin 26 pika 2, në cilësinë e zv/Kryetarit të Gjykatës që ushtron kompetencat e kryetarit në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 554, datë 29.12.2022 “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore”, kreu V, pika 6, si dhe ngarkesës së madhe administrative që zv/Kryetari që ushtron funksionet e Kryetarit ka aktualisht për shkak të procedurave që po zhvillohen, përfundimin e analizës vjetore të vitit 2023, gjithashtu masa të tjera organizative që duhet të ndërmerren me grupet e punës në funksion të mirëadministrimit të veprimtarisë së gjykatës, urdhëroj: “Uljen e ngarkesës së gjyqtarit Sokol Shehu, me detyrë zëvendëskryetar pranë kësaj gjykate, i cili ushtron funksionet e Kryetarit në masën jo më pak se 75% të një gjyqtari”.

[282] Mëshëtitur në ligjin nr. 98/2016, “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, konkretisht në nenin 26 pika 2, në cilësinë e zv/Kryetarit të Gjykatës që ushtron kompetencat e kryetarit në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 554, datë 29.12.2022 “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore”, kreu V, pika 6, si dhe ngarkesës së madhe administrative që zv/Kryetari që ushtron funksionet e Kryetarit ka aktualisht për shkak të procedurave që po zhvillohen, dhe masa të tjera organizative që duhet të ndërmerren me grupet e punës në funksion të mirëadministrimit të veprimtarisë së gjykatës, urdhëroj: “Uljen e ngarkesës së gjyqtarit Egla Mirashi, me detyrë zëvendëskryetar pranë kësaj gjykate, i cili ushtron funksionet e Kryetarit në masën jo më pak se 75% të një gjyqtari”.

procedura e shortit", për shkak se me datë 04.09.2024 me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është vendosur: "shkarkimi nga detyra". Gjithashtu është urdhëruar ndryshimi i pjesshëm i urdhërit nr. 91/1, datë 29.07.2024 lidhur me gatishmërinë për të mitur e muajit shtatorë 2024, duke ndërprerë menjëherë gatishmërinë për gjyqtarin Tonin Sterkaj dhe ditët e mbetura nga gatishmëria e tij deri më datë 30.09.2024 i shtohen periudhës së gatishmërisë së gjyqtarit pasardhës të gatishëm sipas rendit alfabetik Orgent Nazaj. Gjithashtu çështjet e ngutshme të mbetura të pashqyrtuara nga gjyqtari Tonin Sterkaj të cilat i janë caktuar për shqyrtim për shkak të qenies i gatshëm për periudhën 01-30 shtator 2024 do ti kalojnë gjyqtarit pasardhës të gatshëm dhe konkretisht: Çështja administrative penale me nr. 625 (02574) datë ardhje 03.09.2024; Çështja administrative penale me nr. 624 (02573) datë ardhje 03.09.2024; dhe Çështja administrative penale me nr. 413 (01853) datë ardhje 27.05.2024; ndërsa, Çështja administrative penale me nr. 619 (02544) datë ardhje 01.09.2024, i kalon gjyqtarit Sokol Shehu si gjyqtar i hetimeve.

- Urdhër nr. 115 datë 26.09.2024 "Për përjashtimin e gjyqtarit Sokol Shehu nga procedura e shortit", për shkak se me vendim nr. 541 datë 25.09.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është transferuar me procedurën e transferimit të përkohshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë,

Zv/kryetari i gjykatës sipas kuadrit ligjor në fuqi ka lëshuar Urdhëra në lidhje me procedurat e përjashtimit të gjyqtarëve nga hedhja së shortit të çështjeve. Këto akte vijnë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

o **Kërkesat për dorëheqje nga çështja si dhe kërkesat për përjashtim** ^[283].

Në kohën e inspektuar 01 janar 2024 - 31 dhjetor 2024, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, janë miratuar nga Zv/kryetari **81** ^[284] "kërkesa për heqje dorë nga gjykimi".

Pas miratimit të dorëheqjeve rezulton se procedurat e shortit për plotësimin e anëtarëve zëvendësues të tyre, janë ndjekur nga zv/kryetari dhe kancelari i gjykatës, ku për këto raste është proceduar me mënyrën e shortit elektronik në **63** raste dhe në **18** raste është proceduar me mënyrën e shortit manual. Theksoj se shorti manual rezulton të jetë zhvilluar për rastet kur, për shkaqe procedurale çështja ka kaluar tek gjyqtari që ka pushuar çështjen më parë, apo kur është përjashtuar gjyqtari dhe çështja i ka kaluar gjyqtarit të radhës në grafik të gatishmërisë si dhe në rastet kur ka qenë masë sigurimi dhe i ka kaluar gjyqtarit të radhës në grafik.

[283] Kjo pikë e raportit përfshin largimin e gjyqtarëve nga çështjet gjyqësore: a)-për kërkesa për dorëheqje gjyqtari, të miratuara nga Kryetari e Gjykatës; b)-për kërkesa për përjashtim gjyqtari nga gjykimi, për të cilat është ka vendim gjyqësor; dhe c)-për raste kur gjyqtari është larguar për shkak të procedurave të zbatimit të ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" ose për arsye të tjera të ligjshme.

[284] Sipas tabelave të përcjella nga gjykata

Më poshtë në mënyrë të përmbledhur po japim rastet për secilin gjyqtar, që ka paraqitur kërkesa për dorëheqje dhe që janë miratuar, e konkretisht:

- *Gjyqtare Egla Mirashi* i është pranuar në 2 çështje kërkesa dorëheqje, ku 4 kërkesa janë për çështje penale dhe 5 kërkesa janë për çështje civile;
- *Gjyqtari Besmir Stroka* i është pranuar në 2 çështje kërkesa dorëheqje, për çështje penale;
- *Gjyqtari Arbër Çela* i është pranuar në 5 çështje kërkesa dorëheqje, për çështje penale;
- *Gjyqtari Tonin Sterkaj* i është pranuar në 1 çështje kërkesa dorëheqje, për çështje penale;
- *Gjyqtare Arta Llazari* i është pranuar në 18 çështje kërkesa dorëheqje, për çështje civile;
- *Gjyqtari Orgent Nazaj* i është pranuar në 14 çështje kërkesa për dorëheqje, ku 13 kërkesa janë për çështje penale dhe 1 kërkesa është për çështje civile;
- *Gjyqtare Elona Mërtiri* i është pranuar në 6 çështje kërkesa për dorëheqje, ku 4 kërkesa janë për çështje penale dhe 2 kërkesa janë për çështje civile;
- *Gjyqtari Albert Kera* i është pranuar në 4 çështje kërkesa për dorëheqje, ku 1 kërkesa është për çështje penale dhe 3 kërkesa janë për çështje civile;
- *Gjyqtare Anisa (Tepelena) Brinja* i është pranuar në 7 çështje kërkesa për dorëheqje, ku 3 kërkesa janë për çështje penale dhe 4 kërkesa janë për çështje civile;
- *Gjyqtare Eni Naqellari* i është pranuar në 3 çështje kërkesa dorëheqje, ku 2 kërkesa janë për çështje penale dhe 1 kërkesa është për çështje civile;
- *Gjyqtare Tefte Xhanari* i është pranuar në 4 çështje kërkesa dorëheqje, për çështje civile;
- *Gjyqtare Irida Barkaj* i është pranuar në 5 çështje kërkesa për dorëheqje, ku 1 kërkesa është për çështje penale dhe 4 kërkesa janë për çështje civile;

Praktikat e heqjes dorë përmbajnë vendimin e kryetarit, kërkesën e gjyqtarit dhe RIV-in e çështjes ku është ekzekutuar vendimi (*shënuar çështja më poshtë vetëm sa i përket numrit unik në sistem*) dhe etiketuar veprimi i shortit.

Duke krahasuar të dhënat rezulton se koha nga bërja e kërkesës për dorëheqje e gjyqtarit deri në miratimin e saj nga zv/kryetari i gjykatës varion, nga 1 ditë, deri në 3 ditë, në raste të veçanta kalon edhe më shumë.

Ajo që vlen të theksohet është fakti se nga data e miratimit të kërkesës për dorëheqje, deri në datën e shortit përgjithësisht është respektuar afati i përgjithshëm që këto çështje të shortohen të nesërmen e datës miratimit të dorëheqjes, por ka pasur edhe raste që janë shortuar pas 3 ditë ose më shumë. Vendimi nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", kreu IV, pika 4-të, fjalja e fundit parashikon se në rastet kur çështja nuk mund të shqyrtohet nga i njëjti trup gjykues, ajo përfshihet në shortin elektronik të radhës. Ky vendim cakton afate për veprimin e kryetarit për organizimin e shortit në rastet e zëvendësimit të gjyqtarit, pasi çështja është regjistruar dhe shortuar njëherë, por për analogji nisur nga fakti se nga kjo gjykatë çështjet shortohen ditën e depozitimit apo të nesërmen e depozitimit, edhe kjo kategori çështjesh duhet të shortoheshin menjëherë për zëvendësimin e anëtarit të trupit gjykues.

Nga të dhënat e dërguara nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, sa i përket kërkesave për përjashtim gjyqtari nga çështjet, na janë dërguar rastet që gjyqtarët kanë disponuar me vendimmarrje për kërkesa të tilla.

Më poshtë në mënyrë të përmbledhur po japim rastet për secilin gjyqtar, që është paraqitur kërkesa për përjashtim, e konkretisht:

- Gjyqtari Besmir Stroka është pranuar në 1 rast kërkesa për përjashtim;
- Gjyqtari Sokol Shehu është pranuar në 2 raste kërkesa për përjashtim;

Nga analiza e akteve nxirret përfundimi se në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nuk janë konstatuar problematika në hedhjen në short të dosjeve pas miratimit të kërkesës për heqje dorë nga zv/kryetari i gjykatës tek gjyqtarët e tjerë të cilat janë kaluar me anë të shorti. Kërkesat janë bërë në përputhje me parashikimet e neni 73 i K.Pr.Civile, të gjitha këto dosje kanë kaluar ose te gjyqtari që ka gjykuar më parë çështjen ose ka kaluar në shorte elektronik ndërmjet gjyqtarëve.

Në përputhje me kërkesat e nenit 17 të K.Pr.Penale, gjenden edhe kërkesat e gjyqtarëve për heqje dorë nga gjykimi i çështjes penale dhe miratimi i tyre, nga ana e kryetarit të gjykatës për gjyqtarët.

5. Çështjet e hedhura më parë në short

1. Çështje në ngarkim të gjyqtarëve të pezulluar ose të larguar nga sistemi;

Theksoj se në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për rastet që gjyqtarët janë larguar nga detyra e për rrjedhojë zv/kryetari i gjykatës dhe Këshilli i gjykatës kanë nxjerr akte për rindarjen e dosjeve me short mes gjyqtarëve të seksionit përkatës konkretisht:

- Urdhër nr.55 datë 02.05.2025 "Për shortimin e dosjeve që kanë qenë në gjykim te gjyqtari Besmir Stroka". Për shkak se me vendimin nr. 214 datë 25.04.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është transferuar gjyqtari Besmir Stroka me procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, çmohet e nevojshme që dosjet që kanë qenë për gjykim pranë këtij gjyqtari të rishortohen te gjyqtarët e tjerë të Dhomës Penale. Sa më sipër Urdhëroj: - Hedhjen në short elektronik (sistemi ICMIC) të dosjeve që kanë qenë në gjykim pranë gjyqtarit Besmir Stroka. - Urdhërohet Aleksandër Rudaj, i ngarkuar me detyrën e administratorit të sistemit për menaxhimin e çështjeve gjyqësore, të pasqyroj këtë urdhër në sistemin elektronik të instaluar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
- Urdhër nr.112 datë 24.09.2024 "Për rishortimin e dosjeve që kanë qenë në gjykim te gjyqtari Tonin Sterkaj", duke qenë se me vendimin e datës 04.09.2024 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është vendosur: "shkarkimi nga detyra subjekti të rivlerësimit Tonin Sterkaj dhe si rrjedhojë është pezulluar nga të gjitha funksionet e tij". Në vijim drejtuesi i gjykatës, bazuar në ligjin nr. 98/2016, ka vendosur që dosjet që kanë qenë për

gjykim pranë këtij gjyqtari të rishortohen te gjyqtarët e tjerë të Dhomës Penale. Ndaj për këtë qëllim është urdhëruar:

- Hedhjen në short elektronik (*sistemi ICMIC*) dosjeve që kanë qenë në gjykim pranë gjyqtarit Tonin Sterkaj. Të gjitha çështjet sipas listës së mëposhtme të hidhen në short mes gjyqtarëve të dhomës penale.
 - Do shortohen mes anëtarve të trupit gjykues gjyqtarit Sokol Shehu dhe gjyqtarit Orgent Nazaj për përcaktimin e kryesuesit të trupit gjykues sipas vendimit të datës 01.07.2024. dosja penale ...etj.
 - Do ti kaloj gjyqtarit Orgent Nazaj si gjyqtari i vetëm i mbetur, nga trupa gjykuese, sipas vendimit të datës 19.03.2024. dosja penale ...etj.
 - Do ti kaloj gjyqtarit Sokol Shehu si gjyqtari i vetëm i mbetur, nga trupa gjykuese, sipas vendimit të datës 15.01.2024. dosja penale.....etj.
 - Do ti kaloj gjyqtarës Arta Llazari si gjyqtare e vetme e mbetur, nga trupa gjykuese, sipas vendimit të datës 13.05.2024. dosja penale....etj.
 - Urdhërohet Aleksandër Rudaj, i ngarkuar me detyrën e administratorit të sistemit për menaxhimin e çështjeve gjyqësore, të pasqyroj këtë urdhër në sistemin elektronik të instaluar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
- Urdhër nr.113 datë 25.09.2024 "Për shortimin e dosjeve që kanë qenë në gjykim te gjyqtari Arbër Çela", duke qenë se me vendimin nr. 472 datë 31.07.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është pranuar kërkesa e gjyqtarit për transferimin e përkohshëm të tij në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një periudhë prej një viti, çmohet e nevojshme që dosjet që kanë qenë për gjykim pranë këtij gjyqtari të rishortohen te gjyqtarët e tjerë të Dhomës Penale. Sa më sipër Urdhëroj:
- Hedhjen në short elektronik (*sistemi ICMIC*) dosjeve që kanë qenë në gjykim pranë gjyqtarit Arbër Çela.
 - Të gjitha çështjet sipas listës së mëposhtme të hidhen në short mes gjyqtarëve të dhomës penale Sokol Shehu, Orgent Nazaj dhe Egla Mirashi.
 - Do shortohen mes anëtarve të trupit gjykues gjyqtarit Sokol Shehu dhe gjyqtarit Orgent Nazaj për përcaktimin e kryesuesit të trupit gjykues sipas vendimit të datës 23.05.2024. dosja penale....etj
 - Do ti kaloj gjyqtarit Sokol Shehu si gjyqtari i vetëm i mbetur, nga trupa gjykuese, sipas vendimit të datës 13.05.2024. dosja penale....etj.
 - Çështja civile e mëposhtme të hidhet në short mes gjyqtarëve të Dhomës Civile.
 - Urdhërohet Aleksandër Rudaj, i ngarkuar me detyrën e administratorit të sistemit për menaxhimin e çështjeve gjyqësore, të pasqyroj këtë urdhër në sistemin elektronik të instaluar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
- Urdhër nr.130 datë 10.10.2024 "Për shortimin e dosjeve që kanë qenë në gjykim te gjyqtari Sokol Shehu", duke qenë se me vendimin nr. 541 datë 25.09.2024 të Këshillit

të Lartë Gjyqësor është transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një periudhë prej një viti, çmohet e nevojshme që dosjet që kanë qenë për gjykim pranë këtij gjyqtari të rishortohen te gjyqtarët e tjerë të Dhomës Penale.

Sipas vendimit nr. 21 datë 07.10.2024 "Për riorganizimin e seksioneve dhe ndarjen e trupave gjyqësore" të Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, seksioni penal përbëhet nga gjyqtarët: Egla Mirashi, Orgent Nazaj, Elona Mërtiri, Albert Keraj dhe Anisa (Tepelena) Brinja. Gjyqtarët Elona Mërtiri, Albert Keraj dhe Anisa (Tepelena) Brinja, kanë qenë pjesë e seksionit civil deri më datë 07.10.2024. Në këto kushte bazuar në parimin e barazisë së shpërndarjes, ngarkesa mes gjyqtarëve dhe objektivitetit, dosjet që kanë qenë për gjykim pranë gjyqtarit Sokol Shehu, do të rishortohen pranë gjyqtarëve Elona Mërtiri, Albert Keraj dhe Anisa (Tepelena) Brinja duke përjashtuar nga shorti gjyqtarët Egla Mirashi dhe Orgent Nazaj. Sa më sipër urdhëroj:

- Hedhjen në short elektronik (sistemi ICMIC) dosjeve që kanë qenë në gjykim pranë gjyqtarit Sokol Shehu.
 - Të gjitha çështjet sipas listës së mëposhtme të hidhen në short mes gjyqtarëve të dhomës penale Sokol Shehu, Elona Mërtiri, Albert Keraj dhe Anisa (Tepelena) Brinja.
 - Do shortohen mes anëtarve të trupit gjykues gjyqtarit Egla Mirashi dhe gjyqtarit Orgent Nazaj për përcaktimin e kryesuesit të trupit gjykues sipas vendimit të datës 10.09.2024.
 - Urdhërohet Aleksandër Rudaj, i ngarkuar me detyrën e administratorit të sistemit për menaxhimin e çështjeve gjyqësore, të pasqyroj këtë urdhër në sistemin elektronik të instaluar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
- Urdhër nr.137 datë 23.10.2024 "Për rishortimin e dosjes penale me nr. regj. Them. 1259 (53200-01778), datë e ardhjes 20.05.2024, në ngarkim të të pandehurveetj, që kanë qenë në gjykim te gjyqtari Sokol Shehu", duke qenë se me vendimin nr. 541 datë 25.09.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një periudhë prej një viti, dhe me urdhërin nr. 130 datë 10.10.2024, dosjet që kanë qenë për gjykim pranë këtij gjyqtari janë rishortohen te gjyqtarët e tjerë të Dhomës Penale.

Sipas vendimit nr. 21 datë 07.10.2024 "Për riorganizimin e seksioneve dhe ndarjen e trupave gjyqësore" të Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, seksioni penal përbëhet nga gjyqtarët: Egla Mirashi, Orgent Nazaj, Elona Mërtiri, Albert Keraj dhe Anisa (Tepelena) Brinja. Gjyqtarët Elona Mërtiri, Albert Keraj dhe Anisa (Tepelena) Brinja, kanë qenë pjesë e seksionit civil deri më datë 07.10.2024. Në këto kushte bazuar në parimin e barazisë së shpërndarjes, ngarkesa mes gjyqtarëve dhe objektivitetit, dosjet që kanë qenë për gjykim pranë gjyqtarit Sokol Shehu, do të rishortohen pranë gjyqtarëve Elona Mërtiri, Albert Keraj dhe Anisa (Tepelena) Brinja duke përjashtuar nga shorti gjyqtarët Egla Mirashi dhe

Orgent Nazaj, prandaj dhe dosja penale me nr. regj. Them. 1259 (53200-01778), në ngarkim të të pandehurve.....etj, është rishortuar pranë gjyqtarit Albert Keraj.

Çështja penale me nr. regj. Them. 1259 (53200-01778), datë e ardhjes 20.05.2024, në ngarkim të të pandehurve.....etj, ka qenë në gjykim pranë gjyqtarit Arbër Çela. Me urdhër nr. 113 datë 25.09.2024, kjo çështje është shortuar mes anëtarëve të trupit gjykues gjyqtarit Sokol Shehu dhe gjyqtarit Orgent Nazaj, për përcaktimin e kryesuesit të trupit gjykues, sipas vendimit të datës 23.05.2024, dhe ka kaluar gjyqtarit Sokol Shehu. Me urdhërin nr. 130 të datës 10.10.2024 kjo çështje do të duhet të kishte kaluar për gjykim pranë gjyqtarit Orgent Nazaj në cilësinë e relatorit, si anëtar i vetëm i mbetur i trupës gjyqësore.

Fakti i sa më sipër u konstatua nga gjyqtari Albert Keraj i cili me kërkesën e datës 22.10.2024 parashtroj me shkrim, ndreqjen e këtij gabimi në procedurën e shortit. Sa më sipër Urdhëroj:

- o Kalimin e çështjes penale me nr. regj. Them. 1259 (53200-01778), datë e ardhjes 20.05.2024, në ngarkim të të pandehurve.....etj, për veprën penaleetj gjyqtarit Orgent Nazaj.
- o Urdhërohet Aleksandër Rudaj, i ngarkuar me detyrën e administratorit të sistemit për menaxhimin e çështjeve gjyqësore, të pasqyroj këtë urdhër në sistemin elektronik të instaluar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Nga analiza e akteve të mësipërme që kanë të bëjnë me rastet e trajtimit të çështjeve gjyqësore që kishin për trajtim gjyqtarët e larguar nga funksioni i gjyqtarit të asaj gjykate, rezulton se nga ana e zv/kryetarit si dhe Këshilli i Gjykatës janë nxjerrë akte për rishortimin e çështjeve me short të cilat kanë qenë në ngarkim të magjistratëve të larguar ose transferuar.

Sa i përket kërkesave të gjyqtarëve për përjashtimin nga pjesëmarrja në shorte dhe mënyrën e trajtimit të tyre nga kryetari i gjykatës, rezulton se në periudhën objekt të kontrollit tematik, nuk ka pasur raste.

Për kërkesat e gjyqtarëve për përjashtimin nga pjesëmarrja në shorte dhe mënyrën e trajtimit të tyre nga kryetari i gjykatës, rezulton se nuk ka pasur raste që gjyqtarët të kenë kërkuar përjashtime nga shorti.

2. Çështje të hedhur më parë në short për të cilat është disponuar më parë nga gjykata

Referuar dokumentacionit të dërguar nga gjykata, sa i përket procedurave që kanë të bëjnë me çështjet e caktuara me short dhe për të cilat është disponuar më parë nga gjykata me vendim jo përfundimtar të pushimit të gjykimit ose me vendim për kthimin e akteve, kur nga përmbajtja e padisë është i mundur identifikimi se është e njëjta çështje dhe të cilat përjashtohen nga shorti dhe i kalojnë automatikisht të njëjtit gjyqtar, rezultoi se në vitin

2024, janë ri-paraqitur për gjykim 84 çështje e ndarë kjo në 40 çështje të karakterit civil dhe 44 çështje të karakterit penal^[285].

Nga verifikimi i të dhënave konstatohet se këto çështje janë regjistruar për shortim në sistemin elektronik, i janë caktuar me short elektronik gjyqtarëve që kishin vendosur më parë pushimin e gjykimit apo të kthimit të akteve. Si përfundim, për këtë kategori çështjesh, është zbatuar kriteri nënligjor, për përjashtimin e këtyre çështjeve nga shorti dhe kalimin automatikisht të njëjtit gjyqtar. Me përjashtim të rasteve kur magjistrati që kishte disponuar me vendim jo përfundimtar nuk ushtron më detyrën pranë gjykatës ose ka kaluar nga një seksion në tjetrin, për këto raste është vendosur kalimi në short.

Pas informacionit të kërkuar nga ILD mbi mbajtjen e indeksit gjykata me shkresën nr. 699/2 prot., datë 27.05.2025, informon se Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, grumbullon të dhëna mbi çështjet dhe përfundimin e tyre në sistemin elektronik prej vitit 2005 e në vijim, konkretisht për vitin 2005-2010 ka funksionuar sistemi ARK-it dhe nga tetori 2010 e në vijim sistemi ICMIS, i cili grumbullon dhe përpunon të dhëna gjyqësore për çdo çështje të paraqitur për gjykim. Referuar kësaj, procedura e regjistrimit të çështjeve fillon me verifikimin në sistem të palëve pasqyruar në kërkesëpadi, konkretisht kontrolli përmes emrit të palës në sistem nga ku gjenerohen të dhëna nëse kjo çështje është pushuar apo vendosur kthimi i akteve^[286]. Në të tilla kushte kjo gjykatë nuk ka mbajtur regjistër të çështjeve të pushuara.

Theksoj se nuk mbahet indeksi i çështjeve të pushuara apo të kthiera për identifikimin e këtyre çështjeve nga Kancelari (apo Kryesekretari) i gjykatës, gjë e cila do të lehtësonte gjetjen e vendimeve, si edhe do të evidentonte në padi datën e paraqitjes së saj në gjykatë, në kohën që çështja regjistrohet për gjykim e hidhet në sistemin elektronik.

Nga verifikimi i të dhënave të raporteve të shortit manual dhe rishortimeve që gjeneron sistemi elektronik ICMIS rezultoi se në disa raste ishin depozituar për shqyrtim gjyqësor çështje të pushuara apo rikthyera, por që kancelari i gjykatës dhe kryesekretaria nuk i kishin kaluar direkt gjyqtarit me short manual që duhet ta gjykonte atë çështje, po ashtu rezulton që nuk janë hedhura në tabelën që ju kërkua për plotësim, ç'ka të çon në konkluzionin se pasja e një indeksi të tillë është i domosdoshëm për menaxhimin e çështjeve dhe për rrjedhojë shortin dhe kalimin automatikisht të këtyre çështjeve tek i njëjti gjyqtar. Konkretisht nga pasqyrat e çështjeve manuale të përcjella nga gjykata të emërtuar, si informacion mbi shortin: caktimet manuale numri total i çështjeve të caktuara manualisht: 735", ku rezultojnë; çështja me nr. Akti 1009 fizik e nr. (520003-01220-51-2024) sistemi; çështja nr. Akti 2044/1075 fizik e nr.(21001-01468-51-2024) sistemi^[287]; dhe çështja nr. Akti 1657 fizik e nr. (23004-00812-51-2024)... etj.

^[285] Këto vlera janë marrë nga tabelle e përcjellë nga gjykata

^[286] Në shkresë konstatohet se nga ana e zv. Kryetares është orientuar për mbajtjen e indeksit por sërish nuk është zbatuar nga personi përgjegjës.

^[287] Si gjyqtarja që ka vendosur kthimin e akteve me vendimin nr 472 (2680) datë 6.6.2024

Mbajtja e indeksit të çështjeve të pushuara apo të kthyer nga kancelari i gjykatës dhe që do të bënte lehtësimin e gjetjen e vendimeve si dhe do të evidentonte në padi datën e paraqitjes së saj në gjykatë.

6. Zëvendësimi i anëtarit të trupit gjykues dhe plotësimi me anëtar i trupit gjykues.

Referuar dokumentacionit të dërguar nga gjykata rezulton se në vitin 2024, në lidhje me plotësimin e trupit gjykues, pas përzgjedhjes nëpërmjet shortit, në ato çështje gjyqësore, që gjykohen me trup gjykues me tre anëtarë, nga Këshilli i Gjykatës ka pasur vendime të lëshuara për mënyrën se si do të organizohet shorti për këto raste si dhe procesverbale të dokumentimit të kësaj veprimtarie (Informacion të detajuar shih aneksi 3 bashkëlidhur).

Në rastin e zëvendësimit të anëtarit të trupit gjykues apo të plotësimit me anëtarë të trupit gjykues në periudhën objekt inspektimi nuk u konstatuan problematika.

7. Të dhënat mbi organizimin e shortit

a) Çështjet e shortuara

Nga analiza e të dhënave statistikore të përpunuara konstatohet se në periudhën 01 janar 2024 -31 dhjetor 2024, në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, janë regjistruar të reja gjithësej **5056**^[288] çështje gjyqësore që përbëhen nga: **880** çështje civile me palë, **266** çështje civile pa palë, **1669** çështje penale **963** kërkesa penale; dhe **1278** çështje gjyqësore të "karakterit urgjent" që përbëhen nga, çështje gjyqësore të karakterit penal (*kërkesa penale masa sigurimi, lejim përgjimi, shuarje mase sigurimi, zëvendësim mase sigurimi, kontroll banese, deklarim ikje, përjashtim gjyqtari*) dhe çështje të karakterit civil (*sigurim padie, lëshim urdhër i menjëhershëm mbrojtje, përjashtim gjyqtari...etj*).

Referuar të dhënave në tabelat statistikore rezulton se i janë nënshtruar trajtimit me short normal **3533** çështje gjyqësore, çështje gjyqësore të rishortuara **922** çështje, trajtimit me short manual **1523** çështje gjyqësore, këtu përfshihen edhe çështje gjyqësore i kanë kaluar për shqyrtim gjyqtarit të planifikuar për periudhën e gatishmërisë nga kryetari i gjykatës.

Referuar rasteve të vrojtura për arsyet e hedhura në tabelë nga drejtuesi i gjykatës (*dhe shpjegimeve të marra gjatë përpunimit të të dhënave pranë kryesekretarisë së gjykatës*), sa i përket shorteve të caktimeve manuale, rezulton se:

- a) -shënimet përgjithësisht pasqyrojnë justifikimin ligjor që e kanë detyruar drejtuesin e gjykatës të kalojë çështjen tek gjyqtari^[289];
- b) -nuk vendosin në arsye si justifikim numrin elektronik të çështjes gjyqësore që

[288] Nga analiza vjetore e gjykatës konstatohet se numri i çështjeve të reja të regjistruara është 5111 çështje.

[289] Çështja nuk është e karakterit të ngutshëm por i nënshtrohet shortit, Gj. Orgent Nazaj si gjyqtari që ka dhënë vendimin me nr.803(5008) dt.20.11.2023 për të cilin kërkohet ndrejtja e gabimit.

gjyqtari ka gjykuar më parë, me qëllim që të bëhet lidhja mes çështjeve që duhet të gjykohen nga i njëjti gjyqtar (qoftë ky edhe gjyqtari i seancës së hetimit paraprak) [290], [291], dhe,

c) -sistemi i ICMIS në raportin që gjeneron nuk pasqyron veprimet në kronologji, që kanë ndodhur në caktimin e shortit manual, pasi jep gjyqtarin që ka pasur çështjen fillimisht dhe nëse kjo çështje, është shortuar në vazhdim mbi më shumë se një gjyqtar, ai pasqyron gjyqtarin që i është caktuar të fundit, duke bërë që arsyet e shënimeve të mos gjejnë përputhje me veprimin që është bërë në fakt me dosjen.

Referuar rasteve të vrojtuar për arsyet e hedhura në tabelë nga drejtuesi i gjykatës (dhe shpjegimeve të marra gjatë përpunimit të të dhënave), sa i përket rishortimeve, rezultojnë se:

- a) -shënimet përgjithësisht pasqyrojnë justifikimin ligjor që e kanë detyruar drejtuesin e gjykatës që të rishortojë çështjen;
- b) -nuk kanë vendosur në arsye si justifikim numrin dhe datën e vendimit të kryetarit të gjykatës, apo të këshillit të gjykatës, kur ka pasur raste të tilla, që dosjet janë rishortuar për shkak të këtyre vendimarrjeve;
- c) -në disa raste çështjet janë rishortuar gabim tek disa gjyqtarë të tjerë kur dosja ka qenë e planifikuar nga trupi gjykues për gjykimin e themelit...etj;
- d) -nuk kanë vendosur në arsye si justifikim vendimarrjen e gjykatës me treguesit numër elektronik/ fizik dhe datë vendimi, e cila ka pranuar përjashtimin e gjyqtarit nga çështja, kur ka pasur raste të tilla;
- e) -konstatohen se për çështjet janë të përsëritura;
- f) -sistemi i ICMIS në raportin që gjeneron nuk pasqyron veprimet në kronologji, që kanë ndodhur në rishortimin e çështjeve, pasi jep gjyqtarin që ka pasur çështjen fillimisht dhe nëse kjo çështje, është rishortuar në vazhdim mbi më shumë se një gjyqtar, ai pasqyron gjyqtarin që i është caktuar të fundit, duke bërë që arsyet e shënimeve të mos gjejnë përputhje me veprimin që është bërë në fakt me dosjen; dhe,
- g) -nuk është zbatuar urdhëri i zv/Kryetares për rishortimin menjëherë por i shtrirë ditë, urdhëri mban datën 23.10.2024, rishortimet janë bërë në datat 28-30-10-2024, po ashtu nuk është zbatuar ora në kundërshtim me urdhërin për shortet;

Në 922 çështjet gjyqësore të rishortuara, procedura gjyqësore ka të bëjë për rastet kur gjyqtarëve u është miratuar dorëheqja apo janë përjashtuar dhe për rastet kur janë larguar gjyqtarët për shkak dorëheqje apo pezullimi nga detyra qoftë për afat të shkurtër qoftë për afat të gjatë, si dhe në rastin e transferimeve sipas vendimeve të KLGJ.

Nga informacioni i përcjellë në rrugë elektronike nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në përgjigje të shkresës së ILD-së së, rezultojnë se pasi u verifikua raporti që gjeneron sistemi informatik ICMIS për shortin normal për muajin

[290] Gj.Anisa Tepelena Brinja si gjyqtarja që ka dhënë vendimin për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes

[291] Gj.Elona Mërtiri si gjyqtarja që po gjykon çështjen në themel, Gj.Albert Keraj ka gjykuar çështjen në fazën e hetimeve, Gjyqtare A.Lazari ka shpallur moskopesencën dhe dërgimin e çështjes pranë gjyqtarit që po gjykon çështjen.

janar 2025, u konstatuan se 110 çështje gjyqësore të cilat janë regjistruar në fund të vitit 2024 nga kryesekretaria e gjykatës dhe që janë hedhur në shortin e muajit janar 2025^[292]. Vlen të theksohet se nga sekretarja regjistruese që merret me regjistrimin e dosjeve në sistem apo punonjësi i IT-së, nuk janë zbatuar sa dhe si duhet urdhërat e drejtuesit të gjykatës, në rastin kur gjyqtarët që kanë pengesa ligjore duhet të përjashtohen me komanda në sistem në kohën që regjistrohet dosja gjyqësore. Veç sa mësipër edhe drejtuesi i gjykatës dhe kancelari nuk kanë vlerësuar sa dhe si duhet procedurat e shortit apo ndjekjen e veprimtarisë që kryejnë strukturat e administratës gjyqësore të angazhuara në procesin e hedhjes së shortit.

Nga analiza e këtyre të dhënave u konstatuan probleme në rastet e hedhjes së shortit për:

a) caktimet manuale si:

- shënimet përgjithësisht pasqyrojnë justifikimin ligjor që e kanë detyruar drejtuesin e gjykatës të kalojë çështjen tek gjyqtari;
- nuk vendosin në arsye si justifikim numrin elektronik të çështjes gjyqësore që gjyqtari ka gjykuar më parë, me qëllim që të bëhet lidhja mes çështjeve që duhet të gjykohen nga i njëjti gjyqtar (*qoftë ky edhe gjyqtari i seancës së hetimit paraprak*);
- sistemi i ICMIS në raportin që gjeneron nuk pasqyron veprimet në kronologji, që kanë ndodhur në caktimin e shortit manual, pasi jep gjyqtarin që ka pasur çështjen fillimisht dhe nëse kjo çështje, është shortuar në vazhdim mbi më shumë se një gjyqtar, ai pasqyron gjyqtarin që i është caktuar të fundit, duke bërë që arsyet e shënimeve të mos gjejnë përputhje me veprimin që është bërë në fakt me dosjen;

b) rishortimet si:

- shënimet jo gjithmonë pasqyrojnë justifikimin ligjor që e kanë detyruar drejtuesin e gjykatës që të rishortojë çështjen;
- nuk kanë vendosur në arsye si justifikim numrin dhe datën e vendimit të kryetarit të gjykatës, apo këshillit të gjykatës, kur ka pasur raste të tilla, që dosjet janë rishortuar për shkak të këtyre vendimmarrjeve;
- në disa raste çështjet janë rishortuar gabim tek disa gjyqtarë të tjerë, kur dosja ka qenë e planifikuar nga trupi gjykues për gjykimin e themelit...etj;
- nuk kanë vendosur në arsye si justifikim vendimmarrjen e gjykatës me treguesit numër elektronik/fizik dhe datë vendimi, e cila ka pranuar përjashtimin e gjyqtarit nga çështja, kur ka pasur raste të tilla;
- konstatohen se për çështjet janë të përsëritura;
- sistemi i ICMIS në raportin që gjeneron nuk pasqyron veprimet në kronologji, që kanë ndodhur në caktimin e shortit manual, pasi jep gjyqtarin që ka pasur çështjen fillimisht dhe nëse kjo çështje, është shortuar në vazhdim mbi më shumë se një gjyqtar, ai pasqyron gjyqtarin që i është caktuar të fundit, duke bërë që arsyet e shënimeve të mos gjejnë përputhje me veprimin që është bërë në fakt me dosjen

^[292] Për çështjen nr. 520005-00027-51-2025, datë dorëzimi është 23.12.2023

-nuk është zbatuar Urdhëri i zv. Kryetares për rishortimin menjëherë por i shtrirë ditë, Urdhëri mbanë datën 23.10.2024, rishortimet janë bërë në datat 28-30-10.2024, po ashtu nuk është zbatuar ora në kundërshtim me Urdhërin për shortet.

b) Ngarkesa sasiore e gjyqtarëve

Lidhur me ngarkesën sasiore të secilit gjyqtar që është pjesë e trupës gjyquese e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër në periudhën e inspektuar janar 2024 - dhjetor 2024, është konstatuar se ajo varion **207 - 789** çështje^[293]. Të dhënat konkrete, sipas gjyqtarëve, janë:

1. Gjyqtarit Sokol Shehu përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithësej **513** çështje. Këto çështje i kanë kaluar gjyqtarit, **392** nëpërmjet shortit normal, **87** nëpërmjet rishortimit, **34** nga shorti manual (në këtë përfshihen edhe çështjet e karakterit urgjent).
2. Gjyqtarës Eglja Mirashi përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithësej **559** çështje. Këto çështje i kanë kaluar gjyqtarit, **295** nëpërmjet shortit normal, **84** nëpërmjet rishortimit, **180** nga shorti manual (në këtë përfshihen edhe çështjet e karakterit urgjent).
3. Gjyqtarit Besmir Stroka përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithësej **245** çështje. Këto çështje i kanë kaluar gjyqtarit, **219** nëpërmjet shortit normal, **3** nëpërmjet rishortimit, **23** nga shorti manual (në këtë përfshihen edhe çështjet e karakterit urgjent).
4. Gjyqtar Arbër Cela përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithësej **473** çështje. Këto çështje i kanë kaluar gjyqtarit, **407** nëpërmjet shortit normal, **34** nëpërmjet rishortimit, **32** nga shorti manual (në këtë përfshihen edhe çështjet e karakterit urgjent).
5. Gjyqtarit Tonin Sterkaj përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithësej **469** çështje. Këto çështje i kanë kaluar gjyqtarit, **416** nëpërmjet shortit normal, **25** nëpërmjet rishortimit, **28** nga shorti manual (në këtë përfshihen edhe çështjet e karakterit urgjent).
6. Gjyqtarës Arta Llazari përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithësej **414** çështje. Këto çështje i kanë kaluar gjyqtarit, **218** nëpërmjet shortit normal, **3** nëpërmjet rishortimit, **193** nga shorti manual (në këtë përfshihen edhe çështjet e karakterit urgjent).
7. Gjyqtarit Orgent Nazaj përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithësej **789** çështje. Këto çështje i kanë kaluar gjyqtarit, **596** nëpërmjet shortit normal, **112** nëpërmjet rishortimit, **81** nga shorti manual (në këtë përfshihen edhe çështjet e karakterit urgjent).
8. Gjyqtarës Elona Mërtiri përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithësej **584** çështje. Këto çështje i kanë kaluar gjyqtarit, **271** nëpërmjet shortit normal, **61** nëpërmjet rishortimit, **252** nga shorti manual (në këtë përfshihen edhe çështjet e karakterit urgjent).
9. Gjyqtarit Albert Kera përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithësej **572** çështje. Këto çështje i kanë kaluar gjyqtarit, **270** nëpërmjet shortit normal, **53** nëpërmjet rishortimit, **249** nga shorti manual (në këtë përfshihen edhe çështjet e karakterit urgjent).
10. Gjyqtarës Anisa (Tepelena) Brinja përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithësej **294** çështje. Këto çështje i kanë kaluar gjyqtarit, **266** nëpërmjet shortit normal, **68** nëpërmjet rishortimit, **260** nga shorti manual (në këtë përfshihen edhe çështjet e karakterit urgjent).
11. Gjyqtarës Eni Nagellari përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithësej **212** çështje.

^[293] Këtu bëjmë fjalë vetëm për gjyqtarët që janë në organikën e gjykatës dhe jo për gjyqtarët që janë deleguar nga KLG për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.

Këto çështje i kanë kaluar gjyqtarit, **43** nëpërmjet shortit normal, **117** nëpërmjet rishortimit, **52** nga shorti manual (në këtë përfshihen edhe çështjet e karakterit urgjent).

12. Gjyqtarës **Teftë Xhanari** përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithësej **208** çështje. Këto çështje i kanë kaluar gjyqtarit, **42** nëpërmjet shortit normal, **119** nëpërmjet rishortimit, **47** nga shorti manual (në këtë përfshihen edhe çështjet e karakterit urgjent).

13. Gjyqtarit **Enri Rista** përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithësej **207** çështje. Këto çështje i kanë kaluar gjyqtarit, **49** nëpërmjet shortit normal, **113** nëpërmjet rishortimit, **45** nga shorti manual (në këtë përfshihen edhe çështjet e karakterit urgjent).

14. Gjyqtarës **Irida Barkaj** përgjatë vitit 2024 i janë caktuar gjithësej **209** çështje. Këto çështje i kanë kaluar gjyqtarit, **49** nëpërmjet shortit normal, **113** nëpërmjet rishortimit, **47** nga shorti manual (në këtë përfshihen edhe çështjet e karakterit urgjent).

Në kuadër të këtij inspektimi pasi u verifikuan të dhënat e hedhura nga gjykata, është konstatuar se informacioni i plotësuar në tabela nuk pasqyron ngarkesën e saktë të gjykatës për secilin gjyqtar^[294] (për periudhën 01.01-31.12.2024), sa i përket numrit të çështjeve që gjyqtarët kanë marrë në short normal, short manual, dhe rishortim, pasi si qëllim inspektimi ka pasur vetëm analizimin e lëvizjes së çështjeve për efekt të procedurave të shortit normal manual apo rishortimit të çështjeve dhe hedhjen e shënimeve që ka bërë drejtuesi i gjykatës, si arsye justifikimi që e kanë detyruar atë të trajtoj çështjet në short manual apo rishortim.

Nga analiza e këtyre të dhënave, konstatohet se gjyqtarët kanë diferenca të vogla në ndarjen e çështjeve. Zv/kryetari i gjykatës **Sokol Shehu**, i janë caktuar **513** çështje. Referuar raporteve të shortit rezulton se ai është aktivizuar për pjesëmarrje në short si dhe gjyqtarët e tjerë. Zv/kryetaria e gjykatës **Egla Mirashi**, i janë caktuar **559** çështje. Referuar raporteve të shortit rezulton se ai është aktivizuar për pjesëmarrje në short si gjyqtarët e tjerë. Gjyqtarët e tjerë kanë marrë pjesë të gjithë në short dhe i janë nënshtruar procedurave të shortit por jo të gjithë në të njëjtën kohë, pasi emërimet e tyre janë bërë në kohë të ndryshme.

8. Afatet e shortimit të çështjeve

Nga verifikimi i historikut të shpërndarjes së çështjeve gjyqësore me short në periudhën 01 janar 2024 - 31 dhjetor 2024, u konstatua se në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër janë regjistruar të reja dhe shortuar **5056** çështje gjyqësore të llojeve të ndryshme **3533** çështje në short normal dhe që përbëhen: [(1617 çështje penale themeli; 898 kërkesa penale; 823 çështje civile themeli; 195 kërkesa civile); dhe **1523**

^[294] Referuar raporteve që ku gjeneruar sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore pranë gjykatës, rezulton se kjo gjë ka ndodhur për shkak se në tabelën e shortit normal nuk janë hequr çështjen e vitit 2024 që pas shortit është caktuar manualisht apo çështjen që pas shortit është rishortuar, (për çështjen e caktuar manualisht apo rishortuar nuk janë hequr rastet që ajo mund të jetë caktuar manualisht apo rishortuar disa herë kur caktimi manual apo rishortimi, ka lind i nevojshëm dhe se gjyqtarit që çështja i ka në rënë me short manual apo rishortim i është llogaritur si ngarkesë). Për efekt ngarkese çështja duhet t'i llogarritet si ngarkesë vetëm gjyqtarit të fundit. Ky problem është edhe tek çështjet e caktuara manualisht në vitin 2024, ku nuk janë hequr rastet që çështja mund të jetë rishortuar, ku edhe këtu për efekt ngarkese çështja duhet t'i llogarritet si ngarkesë vetëm gjyqtarit të fundit. Gjithashtu në caktimin manual apo rishortim nuk janë llogaritur edhe rastet që për dosjet e para vitit 2024, nuk janë hequr rastet kur ato u kanë kaluar disa gjyqtarëve, ku edhe këtu për efekt ngarkese çështja duhet t'i llogarritet si ngarkesë vetëm gjyqtarit të fundit.

kërkesa të "karakterit urgjent" dhe që përbëhen nga kërkesa penale të "karakterit urgjent" dhe kërkesa civile të "karakterit urgjent".

Gjatë vitit 2024 janë hedhur 205 raunde shorti normal dhe shortet manuale si dhe rishortimet janë hedhur kur ka qenë e nevojshme në datat dhe oraret kur është hedhur shorti normal.

Në periudhën objekt të kontrollit të inspektimit tematik, nga gjykata u paraqit komunikim email me KLGj-në, për dokumentimin e shtyrjes së datës dhe orës së shortit, i mbajtur nga kryetari i gjykatës, gjyqtarët, kancelari apo kryesekretari i gjykatës, dhe punonjësi i IT-së. Për rastet e shtyrjes kanë qenë të justifikuara për arsye se kishte dyshime për sulm kibernetik të njoftuar nga AKSHI, urdhëri është pasqyruar më sipër konkretisht, urdhër nr. 86 datë 28.06.2024.

Nga verifikimi i të dhënave për regjistrimin dhe shortimin e çështjeve urgjente (kërkesat penale gjatë hetimeve paraprake) konstatohet se ato janë regjistruar dhe shortuar brenda të njëjtës ditë por ka dhe raste që kanë kaluar të nesërmen e regjistrimit.

Nga analiza e këtyre të dhënave nisur nga fakti se ka urdhër të lëshuar nga kryetari për hedhjen e shortit e caktimin e orës, konstatohet se në të gjitha rastet, që zënë 100 % të volumit të çështjeve, është respektuar orari i zhvillimit të shortit.

Lidhur me çështjet urgjente, është respektuar në kohë optimale menjëhershëmëria e regjistrimit dhe shortimit të tyre në përputhje me vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 554, datë 29.12.2023 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore".

9. Shortimi i çështjeve sipas gjyqtarit specifik

Në periudhën e inspektuar 01 janar 2024 deri në 31 dhjetor 2024, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër janë paraqitur gjithsej 364 kërkesa penale me objekt: "vlerësimet e arrestit në flagrancë apo të ndalimit", janë paraqitur gjithsej 49 kërkesa penale me objekt: "Kërkesa për caktim të masave të sigurimit personal", janë paraqitur gjithsej 78 kërkesa penale me objekt: "Kërkesa për lejim e vlefshëm të ligjshëm përgjimi", janë paraqitur gjithsej 5 kërkesa penale me objekt: "Kërkesa për kontroll banese", janë paraqitur gjithsej 64 kërkesa penale me objekt: "Kërkesa për shuarje mase sigurimi", janë paraqitur gjithsej 2 kërkesa penale me objekt: "Humbje e fuqisë së paraburgimit për kërkuesin caktim mase sigurimi", janë paraqitur gjithsej 3 kërkesa penale me objekt: "Zgjatje afati paraburgimi", janë paraqitur gjithsej 2 kërkesa penale me objekt: "Deklarim ikje", janë paraqitur gjithsej 122 kërkesa penale me objekt: "Zëvendësim mase sigurimi", janë paraqitur gjithsej 3 kërkesa penale me objekt: "rishqyrtimi i masës së sigurimit", janë paraqitur gjithsej 3 kërkesa penale me objekt: "Paraqitje (marrje) e të dhënave kompjuterike, për procedim penal", janë paraqitur gjithsej 8 kërkesa penale me objekt: "Revokim mase sigurimi", janë paraqitur gjithsej 7 kërkesa penale me objekt: "Vendosje e masës së sigurimit pasuror, sekuestro preventive për procedimin penal", janë paraqitur gjithsej 37 kërkesa penale me objekt: "Kërkesë për marrje në pyetje të personit

dhe verifikim të kushteve të zbatimit të masës së sigurimit”, janë paraqitur gjithsej **45** kërkesa penale me objekt: “Ankim ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal”, janë paraqitur gjithsej **12** kërkesa penale “Të tjera”, janë paraqitur gjithsej **26** kërkesa civile me objekt: “Kërkesë për sigurim padie”, janë paraqitur gjithsej **312** kërkesa civile me objekt: “Paditë me objekt lëshim urdhër i menjëhershëm mbrojtje”, janë paraqitur gjithsej **136** kërkesa civile “Të tjera”.

Nga të dhënat e dërguara rezultojnë se **1278** kërkesat penale me objekt: “vlerësimet e arrestit në flagrancë apo të ndalimit dhe caktimi i **masave të sigurimit**”, si dhe kërkesa civile, janë shpërndarë e gjykuar nga gjyqtarët si më poshtë:

- Kryetarit të Gjykatës Sokol Shehu i janë caktuar gjithsej 13 çështje gjyqësore;
- Gjyqtarës Eglar Mirashi i janë caktuar gjithsej 163 çështje gjyqësore;
- Gjyqtarit Besmir Stroka i janë caktuar gjithsej 10 çështje gjyqësore;
- Gjyqtarit Arbër Çela i janë caktuar gjithsej 5 çështje gjyqësore;
- Gjyqtarit Tonin Sterkaj i janë caktuar gjithsej 13 çështje gjyqësore;
- Gjyqtarës Arta Lazari i janë caktuar gjithsej 156 çështje gjyqësore;
- Gjyqtarit Orgent Nazaj i janë caktuar gjithsej 50 çështje gjyqësore;
- Gjyqtarës Elona Mërtiri i janë caktuar gjithsej 224 çështje gjyqësore;
- Gjyqtarit Albert Keraj i janë caktuar gjithsej 225 çështje gjyqësore;
- Gjyqtarës Anisa Brinja Tepelena i janë caktuar gjithsej 235 çështje gjyqësore;
- Gjyqtarës Eni Naqellari i janë caktuar gjithsej 49 çështje gjyqësore;
- Gjyqtarës Tefte Khanari i janë caktuar gjithsej 46 çështje gjyqësore;
- Gjyqtarit Enri Rista i janë caktuar gjithsej 44 çështje gjyqësore;
- Gjyqtarës Irida Barkaj i janë caktuar gjithsej 45 çështje gjyqësore;

Nga analiza e këtyre të dhënave nuk konstatohet shkelje e rregullave për gjykimin e çështjes nga gjyqtari specifik, veç specifikimit të arsyeve në ato raste që e kanë detyruar drejtuesin e gjykatës t’u kalojë gjyqtarëve çështjen për të cilën ato kanë gjykuar më parë dhe që kanë kryer veprime të hetimit paraprak për këto raste.

10. Verifikimi i ankesave

Në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, referuar të dhënave të marra në Zyrën e Arkiv-Protokollit dhe pranë Drejtorisë së Hartimit të Akteve dhe Shërbimeve Juridike për vitin 2024^[295], nuk është paraqitur asnjë ankesë për organizimin e shortit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Ndërsa në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, gjyqtarja Arta Lazari ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 138 datë 23.10.2024, si dhe pranimin e rindarjes së çështjeve civile. Nga zv/kryetarja me shkresën nr. 1867/1 datë 31.10.2024, është vlerësuar se nuk ka vend për ndryshimin e vendimit nr. 138 datë 23.10.2024, sa i

^[295] Referuar emalit të datës 18.12.2024, të dërguar nga Sektori i Arkiv-Protokollit pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në përgjigje të emalit të datës 24.12.2025, të kryetarit të grupit të inspektimit.

përket rishortimit të çështjeve të magistrates Arta Llazari, në masën e kërkuar gjithsej 438 (çështje).

Theksojmë se ankesa të tjera të depozituara pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, nuk ka pasur nga përdoruesit e gjykatës (përfshirë këtu: gjyqtar, kancelar, sekretar gjyqësor, kryesekretar, sekretar regjistruar, përfaqësues të organit të akuzës...etj)^[296].

11. Të tjera.

Me shkresën nr. 2201 prot., datë 17.07.2025, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kërkoi nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndër të tjera dërgimin e një kopje të manualit të përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, (përfshirë rubrikën e shortimit elektronik)^[297], që Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar për këtë qëllim (së bashku me publikimet periodikisht të këtij manuali, nëse ka pasur të tilla).

Në përgjigje të shkresë së dërguar nga ILD, me nr. 4102/1 prot., datë 29.07.2025 (regjistruar me nr. 2201/1 prot., datë 29.07.2025), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka dërguar:

a) Dokumentin me emërtimin “Zhvillimet e sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS gjykata e shkallëve të tjera të gjyqësorit që janë kryer në vitin 2021”, i përbërë nga njëzet faqe;

b) Dokumentin me emërtimin “Manual udhëzues për zhvillimet përmirësimet që janë kryer për sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS të gjykatave të shkallës së parë, gjykatave të apelit dhe gjykatave administrative, në zbatim të kontratës nr. 5666/7 prot., datë 17.03.2022, lidhur mes palëve: Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe subjektit “Kreatx” sh.p.k, me objekt “Mirëmbajtje, mbajtje në funksion të pandërprerë, zhvillim, përmirësim, modifikim të sistemeve të menaxhimit të çështjeve gjyqësore në gjykata”, i përbërë nga dyzet e pesë faqe;

c) Dokumentin me emërtimin “Manual udhëzues mbi zhvillimet që janë kryer për sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatës Administrative të Apelit, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, bazuar në kontratën nr. 71/6 prot., datë 20.02.2023 lidhur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, i përbërë nga tetëdhjetë e tre faqe; dhe,

d) Dokumentin me emërtimin “Raport analitik mbi zhvillimet që janë kryer në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS në vitin 2024 (shkallë gjyqësori apel, shkallë e

^[296] Referuar shkresës nr. 699/2 prot., datë 27.05.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, në përgjigje të shkresës të ILD-së.

^[297] Kjo kërkesë bazohet në pikën 15 Kreu III “Procedurat dhe rregullat e ndarjes së çështjeve me short” të Vendimi të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 554, datë 29.12.2022 “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore”, në të cilin thuhet se: “...15. Këshilli i Lartë Gjyqësor publikon periodikisht manualin e përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, përfshirë rubrikën e shortimit elektronik...etj”.

parë e juridiksionit të përgjithshëm, administrative)", i përbërë nga tetëdhjetë e dy faqe...etj.

Në aktet e mësipërme prezantohen zhvillimet e sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS gjykatat e shkallës së parë, apelit, administrative, të cilat janë kryer në vitin 2021; 2022; 2023 dhe vitin 2024.

I. GJETJET E INSPEKTIMIT TË NDARJES SË ÇËSHTJEVE ME SHORT

Referuar qëllimit dhe objektivit të inspektimit, analizimit të të dhënave të grumbulluara nga ky inspektim, trajtimi në mënyrë shteruese i problematikave të dala gjatë realizimit të inspektimit si dhe nga këqyrja e dokumentacionit e bërë nga grupi i inspektimit në gjykatat që ju nënshtuan inspektimit rezultojnë se:

A. Gjykata e Lartë

1. Lidhur me aktet e nxjerra nga kryetari gjykatës, në muaj të caktuar, që ndërpret shortimin e çështjeve, rezultojnë se referuar dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Lartë, ka raste të ndërprerjes së shortimit të çështjeve, ku me urdhërin nr. 188 prot., datë 30.07.2024 "Për pezullimin e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore", është pezulluar ndarja e çështjeve me short nga datat 01 gusht-28 gusht 2024.
2. Në lidhje me kalimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve nga një kolegji në tjetrin si dhe shpërndarjen e ngarkesës midis gjyqtarëve, nuk rezultojnë se ka patur lëvizje të shpeshta.
3. Në lidhje me pjesëmarrjen e kryetarit të gjykatës sa i përket ngarkesës në shorte nga verifikimi i dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Lartë, rezultojnë se kryetari i gjykatës nuk ka diferencim nga gjyqtarët e tjerë në ngarkesën me çështje.
4. Lidhur me rindarjen e çështjeve nëpërmjet rishortimit, dhe për pasojë kalimin e çështjeve të gjyqtarët e tjerë, rezultojnë se në përgjithësi nuk është ndjekur rregulli i rishortimit menjëherë të tyre. Ka pasur raste të rindarjes të çështjeve për shkak të largimit të gjyqtarit nga çështja.
5. Lidhur me mosfunksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore rezultojnë se: Gjykata e Lartë përdor sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve CCMIS, i cili nuk ka pasur probleme përgjatë periudhës së inspektimit për vitin 2024.
6. Gjatë këtij inspektimi ka rezultuar se gjykata ka dërguar informacionin tabelar të kërkuar në kuadër të këtij inspektimi, por që informacioni i paraqitur ka qenë me pasaktësi të cilat janë konstatuar gjatë verifikimit dhe analizimit të akteve që vetë gjykata ka dërguar. Theksojmë për sa mësipër se verifikimi është bërë edhe në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore.

B. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

1. Në lidhje me nxjerrjen e akteve sa i përket mënyrës së ndarjes së çështjeve me short, konform kërkesave të Vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", dhe nr. 724, datë 7.12.2023 "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore" rezulton se kryetari i Gjykatës ka lëshuar urdhër nr. 3 prot., datë 04.01.2024, akt i cili konsiderohet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Nga verifikimi në faqen zyrtare të internetit të gjykatës nuk rezulton i publikuar Urdhëri për caktimin e datës dhe orës së shortit, si dhe nuk janë publikuar raportet për rezultatet e shortimit, caktimit manual dhe rishortimit të çështjeve, e duke sjellë kështu mungesë të transparencës që duket se ka limituar mundësinë e palëve dhe publikut për të verifikuar nëse shorti është realizuar në përputhje me rregullat dhe parimet e drejtësisë.
2. Pavarësisht se është përcaktuar ora në të cilën do të shorthen çështjet rezulton se në shumicën e rasteve shorti është hedhur para dhe pas orës së caktuar për këtë qëllim, si dhe ka raste kur ai nuk është hedhur çdo ditë, ndonëse ka patur çështje të cilat duhet të shortheshin.
3. Në dokumentacionin e administruar për këtë gjykatë janë evidentuar 2 (dy) akte të ndërprerjes së shortimit të çështjeve në një datë tjetër, për periudhë që korrespondon me lejen vjetore të paguar (*muaji Gusht*) dhe për procesin e mbartjes së dosjeve në fund të vitit 2024 dhe fillim të vitit 2025.
4. Lidhur me disponimin e akteve për ndarjen e gjyqtarëve në seksione duke respektuar afatin 2 vjeçar të nenit 23 të ligjit nr. 98/2016, rezulton se Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, ka realizuar ndarjen e gjyqtarëve në dhoma penale apo civile [Vendimin nr.1, datë 02.02.2023 "Mbi krijimin e seksioneve dhe caktimin e gjyqtarëve në trupat gjykues, si dhe për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur viktimë nga vepra penale", vendim i cili ka pësuar ndryshime në vazhdim, (me vendimin nr. 7, datë 26.02.2024; dhe Vendimin nr. 44, datë 08.10.2024), për shkak të largimit të gjyqtarëve dhe emërimeve të reja].
5. Në lidhje me shpërndarjen e ngarkesës midis gjyqtarëve dhe pjesëmarrjen e tyre në shorte, rezulton se gjyqtarët kanë pasur diferenca të vogla, në lidhje me ngarkesën të cilat kanë ardhur për shkak se jo të gjithë i janë nënshtruar shortit në të njëjtën kohë, pasi emërimet e tyre në këtë gjykatë janë në periudhë kohore të ndryshme. Nga dokumentacioni i përcjellë nga gjykata, për përjashtimin nga pjesëmarrja në shorte dhe për të cilat kryetari i gjykatës të ketë vlerësuar të nevojshme dhe për arsye të justifikuara, të përjashtojë me urdhër të motivuar një ose disa gjyqtarë nga pjesëmarrja në shortin e zakonshëm, caktimet manuale apo rishortimet nuk ka, por ka 3 (tre) raste për përjashtimin nga shorti i gatishmërisë, të gjyqtarit Fuat Vjerdha për arsye objektive (*gjendje e rënduar shëndetësore i shtruar në Spitalin Rajonal të qytetit Shkodër*), dhe të gjyqtarës Edlira Petri, për kërkesë për dhënie leje 3 (tre) ditë pune. Gjyqtarët e tjerë

janë përjashtuar nga gjykimi i çështjes në bazë të kërkesës së tyre, për dorëheqje nga gjykimi dhe si pasojë e kërkesave të palëve, për përjashtim nga gjykimi i çështjeve. Vlen të theksojmë se për muajt prill 2024 dhe maj 2024, janë përjashtuar nga shorti në masën e 50% të ngarkesës në punë edhe gjyqtarët znj. Brikena Ukperaj; znj.Marsela Pepi; znj.Miranda Andoni; dhe z.Qemal Zaimi, për të cilët gjatë inspektimit nga gjykata u dërgua vendim nr. ska datë __.03.2024 "Për përjashtimin pjesërisht të gjyqtarit nga ndarja me short e çështjeve" (shkresa nr. 124 prot., datë 28.03.2024), i lëshuar nga zv/kryetarja e gjykatës. Në këtë mënyrë, nga zv/kryetarja e gjykatës janë respektuar kërkesat e Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", Kreu V'Përjashtimi i gjyqtarit nga shorti", pika 5 ku parashikohet se: "... 5. Në rast nevojë të diktuar nga ngarkesa e pabarabartë e punës midis gjyqtarëve, kur mekanizmi i rindarjes së çështjeve nuk mund të realizohet, kryetari me vendim të arsyetuar, përjashton plotësisht ose pjesërisht gjyqtarin nga ndarja me short e çështjeve, deri në sigurimin për atë sa është e mundur, e një ngarkese pune të barabartë midis gjyqtarëve...etj".

6. Lidhur me disponimin e akteve për ndarjen e gjyqtarëve në trupa gjykues, duke respektuar afatin 2 vjeçar të nenit 23 të ligjit nr. 98/2016, rezulton se Këshilli i Gjykatës bazuar në dispozitat e ligjit nr. 98/2016, ka caktuar në datën 26.02.2024, në seksionin penal 14 gjyqtarë, ndërsa në seksionin civil 12 gjyqtarë, duke miratuar e krijuar 9 trupa gjykuese: 5 në seksion penal dhe 4 në seksionin civil; me datë 08.10.2024 ka caktuar në seksionin penal 14 gjyqtarë, ndërsa në seksionin civil 13 gjyqtarë, duke miratuar e krijuar 10 trupave gjykues: 5 në seksionin penal dhe 5 në seksionin civil, dhe në datën 28.10.2024 ka caktuar në seksionin penal 14 gjyqtarë, ndërsa në seksionin civil 14 gjyqtarë, duke miratuar e krijuar 10 trupave gjykues: 5 në seksionin penal dhe 5 në seksionin civil. Ndarja e gjyqtarëve në këto trupa, në të treja rastet është edhe duke marrë në konsideratë përvojën profesionale dhe fushën e tyre të interesit. Këshilli i Gjykatës në vendimmarrjen e datës 02.02.2023, i ndryshuar, ka përcaktuar 4 gjyqtarët të cilët do të gjykojnë çështjet penale me të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur viktimë nga vepra penale.
7. Në lidhje me nxjerrjen e akteve sa i përket grafikut të gatishmërisë për gjykimin e çështjeve të karakterit urgjent, Kryetari i Gjykatës ka disponuar me Urdhëra përkatës që rregullojnë gatishmërinë e gjyqtarëve në gjykimin e masave të sigurimit personal dhe kërkesave të tjera të hetimit paraprak. Aktet në rastin e kësaj gjykate përcaktojnë se gjyqtarët e gatshëm, për gjykimin e masave të sigurimit do të shqyrtojnë kërkesa të karakterit të ngutshëm. Mbulimi i periudhës së fillim vitit me gjyqtarë të gatshëm është rregulluar me një akt të dalë në fund të vitit 2023 [datë 21.12.2023, shkresa nr. 729 prot., (përditësuar me vendimet nr. 173 prot., datë 02.05.2024, shkresa nr. 301 prot., datë 08.10.2024, nr. 322 prot., datë 23.10.2024 dhe nr. 409 prot., datë 31.12.2024),] i cili rregullon periudhën e gatishmërisë për gjykimin e masave të sigurimit nga 01 janar 2024-25 shkurt 2024. Në vijim ka akte të këtij karakteri që mbulon periudhat nga data 06.05.2024 -16.06.2024, 28.10.2024 -10.11.2024, dhe nga data 30.12.2024 - 05.01.2025, por nuk mbulon periudhat nga data 26.02.2024 deri më 05.05.2024, 17.06.2024 deri më 28.07.2024, 02.09.2024 deri më 27.10.2024 dhe nga data

11.11.2024 deri më 29.12.2024 (mungon lista e gjyqtarëve të gatishmërisë për këto 4 periudha). Gjatë zbatimit në praktikë nuk është ndjekur në fakt lista e gjyqtarëve të gatshëm për rastin e gjykimeve (kjo edhe për shkak se ka pasur urdhëra të zv/kryetarës për ndryshim në grafike).

8. Në lidhje me pjesëmarrjen e kryetarit të gjykatës (zv/kryetarit) sa i përket ngarkesës në shorte rezultojnë se nga verifikimi i dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Kryetari i gjykatës (zv/kryetari) ka marrë 50 % të ngarkesës së gjyqtarëve të tjerë, duke qenë kështu brenda standartit të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore".
9. Lidhur me rindarjen e çështjeve nëpërmjet rishortimit, dhe për pasojë kalimin e çështjeve të gjyqtarët e tjerë, rezultojnë se në rastet e çështjeve nga gjykimi i të cilave është miratuar dorëheqja e gjyqtarit ose është përjashtuar nga gjykimi, rezultojnë se çështja nuk është shortuar menjëherë në short, por as në ditët më të afërta të caktuar për short që kanë qenë çdo ditë ora 15:⁰⁰. Në rastet e dorëheqjeve të gjyqtarëve nga çështja deri në miratimin e kërkesës apo refuzimin e saj nga zëvendëskryetari i gjykatës rezultojnë se ka kaluar një kohë e konsiderueshme. Sa i përket 2 (dy) rasteve të rishortimit të çështjeve, të cilat janë bërë për shkak të emërimit të 3 (tre) gjyqtarëve të rinj, rezultojnë se zv/kryetari i gjykatës nuk ka disponuar me urdhër për rishortimin e çështjeve, por mbi bazën e propozimit të saj, ka vendimmarrje të Këshillit të gjykatës lidhur me këtë procedurë. Kjo procedurë e ndjekur nga zv/kryetari i gjykatës nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht kërkesat e Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 724, datë 7.12.2023 "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore", neni 5 "Rastet e rindarjes me short të çështjeve gjyqësore" shkronja gj) "shtimi i gjyqtarëve në gjykatë", neni 7 pika 7 e tij, si dhe kërkesat e ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, (nenet 25 dhe 38 shkronja "ç" të këtij ligji), pasi: "...Kryetari i gjykatës është autoriteti që vendos për rindarjen me short të çështjeve në rastin e shtimit të gjyqtarëve në gjykatë, si dhe për përcaktimin e rrethit të çështjeve që do të rishortohen, me qëllim që ngarkesa e punës për gjyqtarët e ardhur rishtazi në gjykatë, për aq sa është e mundur, të përfshijë çështje të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre në gjykatë....etj" dhe jo Këshilli i Gjykatës.
10. Lidhur me mosfunksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore rezultojnë se: Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm përdor sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve ICMIS, i cili ka pasur probleme për më shumë se dy ditë pune, përgjatë periudhës së inspektimit për vitin 2024^[298], të evidentuara në raport. Pavarësisht sa më lart rezultojnë se për caktimin e relatorit për çështjet penale me afat të ngutshëm, janë hedhur në short manual 6 (gjashhtë) çështje nga komisioni i përbërë nga zv/kryetarja

^[298] Rezultojnë se është mbajtur edhe 1 (një) procesverbal që pasqyron problematikën në sistem, nga kryetari i gjykatës, kancelari, kryesekretari i gjykatës, dhe punonjësi i IT-së dhe që ka të bëjë me emalin e datës 28.06.2024 ora 12:¹⁷ të KLGJ-së, ku është urdhëruar gjykata të ndërpresë shërbimet, për shkak të shpëputjes së VPN që KLGJ do të bëjë rregullime në sistem dhe për këtë fakt edhe zv/kryetarja e gjykatës ka lëshuar edhe urdhërin e brendshëm nr. 224 prot., datë 28.06.2024.

e gjykatës znj.V.Hoxha, gjyqtarët L.Celami, I.Brahimi, M.Dervishi, kancelarja L.Balili, kryesekretare R.Bubjaku, sekretarët gjyqësore B.Xhelo, A.Liqollari, dhe punonjësi i IT-së R.Papa dhe pas verifikimit në RIV në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, rezultoi se dosjet janë kaluar tek gjyqtarët në datën 01.07.2024.

11. Konstatohet se në rastin e shorteve manuale janë trajtuar: -23 çështje gjyqësore që kanë të bëjnë me çështje të përfunduara nga gjyqtarët dhe që janë hedhur gabimisht; -144 çështje që kanë pasur probleme me kalimin e tyre nga userat e vjetër tek userat e rinj të gjyqtarëve dhe që duhej më parë të bëheshin veprime administrative në sistem me qëllim vazhdimin e planifikimit të tyre për gjykim; si dhe -10 çështje të cilat kanë qenë të planifikuara nga trupi gjykues për gjykimin e themelit, të cilat nuk duhet të përfshiheshin në shortin manual. Për rastet e më sipërme nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore" si dhe rregulloret e brendshme që parashikojnë detyrat për të gjithë punonjësit e administratës gjyqësore dhe urdhërat e brendshëm të lëshuar nga zv/kryetari i gjykatës për qëllimet e mësipërme nga sekretarët regjistruar, specialisti i IT-së, kryesekretarët gjyqësore dhe zv/kryetarja e gjykatës.
12. Gjatë veprimtarisë së hedhjes dhe regjistrimit të çështjeve në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore, janë konstatuar mangësi sa i përket zbatimit të udhëzuesit për sistemin ICMIS "Funksionalitetet dhe të drejtat e përdoruesve në sistemin ICMIS", të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë në janar 2016, si dhe të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore" si dhe rregulloret e brendshme që parashikojnë detyrat për të gjithë punonjësit e administratës gjyqësore dhe urdhërat e brendshëm të lëshuar nga zv/kryetari i gjykatës për qëllimet e mësipërme. Të tilla mangësi janë: *i)* në rastet e zbatimit të grafikut të gatishmërisë nuk janë çaktivizuar llogaritë e gjyqtarëve, të cilëve u ka mbaruar gatishmëria, dhe nuk janë aktivizuar llogaritë të atyre gjyqtarëve që u ka filluar gatishmëria, duke sjellë si pasojë regjistrime të gabuara dhe kalime të dosjeve tek gjyqtarët të cilëve nuk duhet të ishin përfshirë në short; *ii)* nuk janë kryer verifikime paraprake të çështjeve të paraqitura, me qëllimin përjashtimin nga ndarja me short për gjyqtarët që kishin pengesa për gjykimin e çështjes, ose që çështja duhej t'u kalohej pa short atyre.
13. Në rastin e organizimit të shorteve manuale për caktimin e gjyqtarëve që do të gjykojnë "kërkesat për përjashtim të gjyqtarëve në çështje", zëvendësimit të anëtarit të trupit gjykues apo të plotësimit me anëtarë të trupit gjykues në periudhën objekt inspektimi, u konstatua se trajtimi i kërkesave për caktimin në short manual të gjyqtarëve që do të jenë pjesë e trupave gjykues, rezultoi se është bërë pa qenë të pranishëm në 39 raste gjyqtarët, në 15 raste zv/kryetari i gjykatës në short, në 1 (një) rast s'ka as urdhër as procesverbal për organizimin e shortit si dhe në 15 raste organizimi i shortit është bërë pasi më parë kancelarja e gjykatës ka zhvilluar mbledhje me kryesekretarën dhe dy sekretare gjyqësore dhe në disa raste edhe me punonjësin e IT-së. Këto veprime përfshirë edhe mospjesëmarrjen në short të gjyqtarëve apo dhe rastin që s'ka urdhër nga zv/kryetari për organizim shorti, bien ndesh me kërkesat e ligjit që kërkohet të



përmbushen, referuar nenit 23 "Krijimi i seksioneve dhe i trupave gjykuese në gjykata", pika 6, të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar në të cilin thuhet se: "...6 Në rast se gjyqtari duhet zëvendësuar përkohësisht në ushtrimin e detyrës në trupin gjykues, trupi gjykues plotësohet nga gjyqtarë të trupave të tjerë gjykues të të njëjtit seksion. Zëvendësimi i përkohshëm i gjyqtarëve bëhet me short....etj", si dhe pikës 2 Kreu IV "Ndarja e çështjeve me short manual" të Vendimi të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", në të cilin thuhet se: "...2.Ndarja e çështjeve me short manual realizohet nga Kancelari, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Gjykatës, si dhe pjesëmarrjen e gjyqtarëve të gjykatës, pasi janë njoftuar paraprakisht për zhvillimin e shortit manual....etj".

14. Në rastin e zëvendësimit të anëtarit të trupit gjykues me anëtarë të tjerë të seksionit penal, në periudhën objekt inspektimi, u konstatua se trajtimi i kërkesave për zëvendësim gjyqtari, në 45 (dyzet e pesë) raste është bërë me urdhër të miratuar nga zv/kryetari i gjykatës, por nga rastet e mësipërme në: -19 (nëntëmbëdhjetë) prej tyre rezulton se janë pranuar të zëvendësohen gjyqtarët, pa paraqitur arsye objektive (por vetëm në urdhërat e zv/kryetarit, përmendet termi për "arsye objektive", por se ç'farë nënkuptohet me to, nuk jepen detaje apo dokumenta justifikues) të mosparaqitjes në punë në ditët e gjykimin të kërkesave me karakter të ngutshëm gjykimi; - 25 raste ka arsye justifikuese të përmendura në urdhëra; dhe në - 1 (një) rast urdhëri nuk ka asnjë arsye pse është bërë zëvendësim gjyqtari. Gjithashtu është konstatuar se në 2 (dy)^[299] raste zëvendësimi i gjyqtarit nga zv/kryetari i gjykatës, është bërë me gjyqtar, të cilët nuk kanë qenë të gatshëm në periudhën pasardhëse të listës së grafikut të gatishmërisë. Ky veprim bie ndesh me kërkesat që kërkohej të përmbushen nga zv/kryetari i gjykatës, referuar nenit 23 "Krijimi i seksioneve dhe i trupave gjykuese në gjykata", pika 6, dhe nenit 37 "Kompetencat e kryetarit të gjykatës" shkronja "b" të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe urdhërit të grafikut të gatishmërisë që ka lëshuar vetë zv/kryetari i gjykatës, për gjykimin e çështjeve të karakterit urgjent. Nga 45 rastet e më sipërme në 7 prej tyre, nuk jepet mënyra dhe procedura e provuar me akt të arsyetuar, se me ç'farë lloji shorti u caktuan këto gjyqtarë në këto çështje^[300].

15. Në lidhje me përjashtime e gjyqtarëve nga shorti në periudha të caktuara gjatë periudhës së inspektimit (mungesa disa ditore me leje / me raport mjekësor / për shkak të ngarkesës / shkaqe të tjera të mungesave), rezulton se për periudhën e verifikuar konstatohet se në këtë gjykatë përjashtime të gjyqtarit nga shorti i përgjithshëm nuk ka. Në raport janë evidentuar rastet, kur gjyqtari është përjashtuar nga shorti për çështje të karakterit të

^[299] Çështja me nr. (60612-01785-30-2024) 733 akti datë 25.03.2024 regjistrimi dhe nr. (61010-07712-30-2024) 3118 akti datë 30.12.2024 regjistrimi.

^[300] Bëhet fjalë për çështjet gjyqësore nr. (61010-00033-30-2024) 81 akti datë 08.01.2024; nr. (61010-01033-30-2024) 421 akti datë 15.02.2024 regjistrimi; nr. (61011-02208-30-2024) 866 akti datë 09.04.2024 regjistrimi; nr. (60612-03023-30-2024) 1186 akti datë 17.05.2025 regjistrimi; nr. (60612-03024-30-2024) 1187 akti datë 17.05.2025 regjistrimi; nr. (61010-04073-30-2024) 1557 akti datë 27.06.2024 regjistrimi; nr. (61010-04193-30-2024) 1598 akti datë 03.07.2024 regjistrimi; nr. (61010-04675-30-2024) 1776 akti datë 25.07.2024 regjistrimi; nr. (61010-04749-30-2024) 1802 akti datë 30.07.2024 regjistrimi; nr. (61010-05583-30-2024) 2227 akti datë 19.09.2024 regjistrimi.

ngutshëm, duke u zëvendësuar me gjyqtar tjetër ndonëse mungesa e tyre e justifikuar në gjykatë është për pak ditë.

16. Shënimet që përdoren si arsye justifikimi në rastin e caktimit të çështjeve në mënyrë manuale apo dhe rishortimeve: nuk pasqyrojnë justifikimin ligjor që e kanë detyruar drejtuesin e gjykatës të kalojë çështjen tek gjyqtari. Këto raste janë evidentuar qartësisht në raport në pjesën ku flitet për këtë gjykatë.
17. Për shkak të përfshirjes së gjyqtarëve në short nga punonjësi i IT-së, të cilët nuk e kanë javën e gatishmërisë dhe që duhet të gjykojnë çështje të karakterit urgjent, ka bërë që 2 (dy) çështje^[301] t'u kalojnë për gjykim gjyqtarëve të planifikuar si të gatshëm. Për këto dy raste nuk ka asnjë procesverbal konstatimi të mbajtur nga punonjësi i IT-së, sekretarja regjistruese dhe kryesekretarja ku të evidentohet këto çështje të hedhura gabim, ç'ka përbën përgjegjësi por mospërbushje të detyrës dhe mos zbatimit të urdhërit të zv/kryetarit punonjësin e IT-së. Nga zv/kryetarja e gjykatës me anën e dy urdhërave këto çështje u kanë kaluar me short manual dy gjyqtarëve që duhet që kishin grafikun e gatishmërisë, por që për shkak të mos planifikimit të tyre në sistem, ka bërë që çështjet t'ju kalon gabimisht dy gjyqtarëve të parë. Kalimi në short manual me urdhër nga zv/kryetarja duke mos aplikuar më pas rishortimin mes 3 (tre) gjyqtarëve që kanë grafikun e gatishmërisë, konsiderohet mos zbatim i rregullave të ndarjes së çështjeve.
18. Sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore sa i përket caktimit të çështjeve në rastet e shortimit në mënyrë manuale dhe rishortimit të tyre, kur një çështje shortohet manualisht apo rishortohet më shumë se një herë tek rubrika që bën fjalë për gjyqtarin e vjetër dhe të ri, raporti vjetor i dalë nga sistemi, pasqyron vetëm gjyqtarin e fundit dhe të parafundit, por nuk eidenton gjyqtarin e mëhershëm, kur ka patur disa rishortime të të njëjtës çështje, dhe për rrjedhojë shënimet e hedhura për çështjet nuk përkojnë me faktin për të cilën çështja është shortuar në njërin prej këtyre dy mënyrave. Pra ky informacion nuk evidentohet i njëjtë mes RIV-it dhe raportit që gjeneron sistemi^[302].
19. Në urdhërin e zv.kryetarës së gjykatës që ka miratuar grafikun e gatishmërisë për muajin gusht 2024, rezulton se nuk janë përfshirë të gjithë gjyqtarët dhe konkretisht Fuat Vjerdha, Alma Ahmeti, Iliba Bezati, Fatri Islamaj, Irida Kacerja, Astrit Kalaja, Elona Mihali, Ornela Naqellari, Marsela Pepi, Edlira Petri, dhe Valdete Hoxha si dhe konstatohet se, nuk është ndjekur rendi alfabetik, me bazë mbiemrin. Gjithashtu urdhëri

[301] Çështja me nr. (61005-00639-30-2024) 292 akti, datë 31.01.2024 regjistrimi hedhur në short për gjyqtarën znj. L.Celami, kaluar me urdhër gjyqtarës që duhet të ishte e gatshme znj.O.Naqellari dhe nr. (61005-01405-30-2024) 579 akti, datë 05.03.2024 regjistrimi hedhur në short për gjyqtarën znj. I.Bezati, kaluar me urdhër gjyqtarës që duhet të ishte e gatshme znj. I.Brahimi.

[302] Konkretisht çështja penale me nr. (70101-00916-30-2024) 612 akti, datë 09.02.2024 regjistrimi, referuar shortit të datës 09.02.2024 i ka rënë për gjykim gjyqtarit F.Islamaj. Sipas RIV-it kjo çështje në zbatim të vendimit nr.8, datë 26.02.2024 të Këshillit të Gjykatës është rishortuar në datën 01.03.2024 duke i kaluar gjyqtarës znj.D.Goxha. Në vazhdim në datën 17.03.2025, është rishortuar ku si arsye është vendosur: "Në bazë të urdhërit të Zv/kryetarës së Gjykatës" dhe i ka rënë për gjykim gjyqtarit z.A.Mustafaj. Në datën 29.09.2025, është rishortuar përsëri ku si arsye është vendosur: "Në bazë të urdhërit nr.20407 prot.dt.26.09.2025 të Zv/kryetarës së Gjykatës për rindarjen me short të dosjeve", duke i kaluar përsëri gjyqtarit z.A.Mustafaj. Kjo çështje referuar raportit që gjeneron sistemi informatik për shortin manual të titulluar: "Informacion mbi shortin: Caktimet Manuale, për periudhën nga data:01.01.2024 në datën: 31.12.2024", pasqyron si datë caktimi 01.03.2024 dhe gjyqtar të vjetër znj. D.Goxha, gjyqtar të ri z. A.Mustafaj dhe si arsye: "Në bazë të vendimit nr.8 dt.26.02.2024 të këshillit të gjykatës".

i brendshëm nr. 265, datë 19.08.2024 "Për zëvendësim gjyqtari", i nxjerrë nga zv/kryetarja e deleguar e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm znj. Alma Kolgjoka, ndërsa është në koherencë me përcaktimet ligjore sa i përket rishortimit për caktimin e kryesuesit të trupës pas pamundësisë së saj për të marrë pjesë, nuk është në koherencë me këto rregulla sa i përket disponimit me plotësimin e trupës gjyqësore me anëtarin e tretë, duke e përcaktuar këtë anëtar nominalisht në këtë akt.

20. Trajtimi i kërkesave për caktimin në short të gjyqtarëve që do të gjykojnë "kërkesat për përjashtim", rezulton se në një rast është bërë në përputhje me kërkesat e vendimit të zv/kryetarës së gjykatës nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", ndërsa në tre raste të tjera caktimi i tyre, është bërë duke u caktuar me short normal. Pra në këtë rast nga gjykata janë ndjekur 2 (dy) praktika për caktimin e këtyre gjyqtarëve për gjykimin e këtyre çështjeve. Ky veprim bie ndesh me kërkesat që kërkohet të përmbushen, referuar nenit 25, nenit 37 dhe nenit 39 të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe kërkesat e vendimit të zv/kryetarës së gjykatës nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente".

21. Janë rishortuar 4 (katër) dosje të ardhura: - 3 (tre) nga ish-Gjykata e Apelit Vlorë; dhe, -1 (një) nga ish-Gjykata e Apelit Gjirokastrë, të cilat nuk janë marrë në dorëzim së bashku me dosjet e tjera të këtyre dy gjykatave, në datën 01.02.2023 dhe që i kanë pasur për gjykim si relatorë, gjyqtarë që nuk e ushtrojnë më detyrën e magjistratit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Rishortimi i këtyre dosjeve me kaq vonesë, për shkak të kësaj problematike ka bërë që dosjet të mos vihen në lëvizje nga trupat gjykues, duke u bërë përgjegjës punonjësit e zyrave të shërbimit të këtyre dy gjykatave, komisoni i ngritur nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe zv/kryetarja e gjykatës, të cilët nuk kanë zbatuar kërkesat e nenit 6 "Transferimi i çështjeve gjyqësore", pika "b" të vendimit nr.505, datë 21.11.2022 "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm", të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në të cilin ndër të tjera thuhet se: "... b) "...1.Çështjet gjyqësore të regjistruara në Gjykatën e Apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë deri në datën 31.01.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit, transferohen në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.2.Çështjet gjyqësore që transferohen në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, regjistrohen në regjistrat manualë dhe sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve ICMIS. 3.Për zbatimin e pikës 1 dhe 2 të këtij neni ngarkohet Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor....etj". Gjithashtu për këto dosje, rezulton se nga zv/kryetarja e gjykatës nuk është disponuar me urdhër për mënyrën se kujt kategorie gjyqtarësh duhej t'u rishortoheshin.

22. Për 4 (katër) raste çështjet u kanë kaluar për të kryer veprime gjyqtarëve jo në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që janë në fuqi dhe bëhet fjalë për çështjet: nr. (61010-06782-30-2023) 2627 akti datë regjistrimi 29.12.2023; -nr. (21314-00194-20-2019) 60 akti datë regjistrimi 19.03.2019; -nr. (31005-00220-50-2016) 1012 akti datë regjistrimi 19.02.2016; si dhe -nr. (71036-00781-30-2024) 518 akti datë regjistrimi 06.02.2024, për

të cilat, nuk janë zbatuar procedurat ligjore të shortimit manual dhe të rishortimit të këtyre çështjeve.

23. Për 15 (pesëmbëdhjetë) ^[303] raste zv/kryetarja e gjykatës ka lëshuar: -13 urdhëra të brendshëm; 1 (një) vendim; si dhe -1 (një) rast nuk ka akt, duke caktuar manualisht gjyqtarët, në rastin e gjykimeve të çështjeve të karakterit urgjent (në vend të gjyqtarëve të planifikuar më parë, që kishin në fakt këto gjykime dhe që për shkak pamundësie të tyre ato nuk mund të gjykonin^[304]), pa zbatuar kërkesat e vendimit nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", për vitin 2024 (i përditësuar), ku në pjesën e shënimeve ndër të tjera thuhet se: "... **Shënim: a).** Përfashtimisht nëse njëri nga gjyqtarët e gatshëm është në pamundësi objektive për ushtrimin e funksionit në periudhën përkatëse, me urdhër të kryetarit çështjet hidhen në short tek gjyqtarët e tjerë që kanë javën e gatishmërisë...etj".
24. Në një rast është konstatuar se nuk janë zbatuar kërkesat e Vendimit nr. 729 prot., datë 21.12.2023 "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", si dhe të Vendimit nr.8, datë 26.02.2024 "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore" pasi një çështje penale themeli, është rindarë me short jashtë kriterëve të përcaktuara në këto akte, çka ka pasuar që edhe kërkesa penale e karakterit urgjent e lidhur me këtë çështje themeli, të gjykohet nga gjyqtari të cilit i kaloi dosja e themelit^[305].
25. Gjatë këtij inspektimi ka rezultuar se gjykata ka dërguar informacionin tabelar të kërkuar në kuadër të këtij inspektimi, por që informacioni i paraqitur ka qenë me pasaktësi të cilat janë konstatuar gjatë verifikimit dhe analizimit të akteve që vetë gjykata ka dërguar. Theksojmë për sa mësipër se verifikimi është bërë edhe në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore.

C. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

1. Në lidhje me nxjerrjen e akteve sa i përket mënyrës së ndarjes së çështjeve me short, konform vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore"^[306], rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë të

^[303] Çështja nr. (61005-00639-30-2024); nr. (61005-01405-30-2024); nr. (61010-01662-30-2024); nr. (61010-02261-30-2024); nr. (61010-04193-30-2024); nr. (61010-04675-30-2024); nr. (61010-04749-30-2024); nr. (61010-05425-30-2024); nr. (61010-06720-30-2024); nr. (61010-07201-30-2024); nr. (61010-07245-30-2024); nr. (61010-07557-30-2024); nr. (61020-07607-30-2024); nr. (61010-07712-30-2024). Në këto raste përfshihet dhe çështja me nr. (61010-06782-30-2023/2627 akti datë 29.12.2023, që i përket kërkuar: Enea Gjergjova, për të cilën relatore ka qenë Valdete Hoxha dhe anëtare E. Petri dhe I. Brahimi, ku seneca e datës 29.12.2023 është shtyrë me datë 02.01.2024. Për shkak të pamundësisë objektive për zhvillimin e gjykimit relatorja e çështjes me anë të komunikimit telefonik ka urdhëruar kalimin e çështjes si relatore te gjyqtarja e trupit gjyqësor Edlira Petri dhe plotësimin e trupit gjyqësor me gjyqtarën Miranda Andoni, e gatshme në atë periudhë. Caktimi i relatorës E. Petri është bërë pa short kur ka qenë pjesë e trupit gjyqësor edhe I. Brahimi si dhe caktimi i gjyqtarës M. Andoni nuk është bërë me short pasi të gatshme kanë qenë në atë periudhë edhe gjyqtarët A. Ahmeti dhe I. Bezati dhe bëhet përgjegjëse zv/ kryetarja e gjykatës V. Hoxha.

^[304] Ky fat u konstatua nga inspektimi i tubelës që ka dërguar gjykata për procedurat e shorti në gjykatë (çështjet e karakterit urgjent), periudha 01.01.2024-31.12.2024.

^[305] Kërkesa penale nr. (61010-01662-30-2024) 666 akti, datë 18.03.2024 regjistrimit, me kërkuar: Fabion Çeka, me objekt: "Shuarje e masës së sigurimit personal "arrest ne burg", çështja e themelit nr. (53101-00578-30-2024), datë 29.01.2024 dhe që është pjesë përbërëse e 14 rasteve të përmendura më lart;

^[306] Botuar në fletoren zyrtare nr. 1, datë 04 janar 2023

Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, ka urdhër specifik për mënyrën e ndarjes së çështjeve me short.

2. Shortimi i çështjeve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është bërë në përputhje me datën dhe orën e hedhjes së shortit të përcaktuar në Urdhërin e nxjerrë për këtë qëllim, nr. 5, datë 19.01.2023.
3. Sa i përket evidentimit të çështjeve gjyqësore që paraqiten në gjykatë ato regjistrohen në regjistrin manual të çështjeve dhe hidhen menjëherë në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve nga sekretaria gjyqësore, sipas kategorive të sistemit. Në 4 raste konstatohet që është bërë regjistrimi i çështjeve në ditë pushimi^[307].
4. Lidhur me aktet e nxjerra nga kryetari gjykatës, në muaj të caktuar, që ndërpret/pezullon shortimin e çështjeve, rezulton se nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër; janë nxjerrë Urdhëra të pezullimit të shortit kryesisht për dy periudha, që përkojnë me fundin ose fillimin e vitit (*mbartja e dosjeve*) ashtu dhe me periudhën e lejeve vjetore të paguara (*muaji Gusht*). Edhe në një rast, jo të zakonshëm, ka ndodhur pezullimi i hedhjes së çështjeve me short, kjo për shkaqe të pavarura nga ana e gjykatës^[308].
5. Janë nxjerrë akte me të cilat është urdhëruar ndërprerja e shortit akte këto që janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Po ashtu ka nxjerr urdhër për shortimin e çështjeve specifike për shkak të papajtueshmërisë që kanë gjyqtarët specifik ose për shkak të kalimit nga një seksion në tjetër, apo për mos ushtrim nga gjyqtari të detyrës pranë asaj gjykate.
6. Gjykata ka funksionuar me seksione, bazuar kjo në aktet e nxjerra nga për këtë qëllim, duke respektuar afatin 2 vjeçar të nenit 23 të ligjit nr. 98/2016, si dhe ka funksionuar pranë seksionit penal dhe seksioni për gjykimin e çështjeve me të mitur.
7. Në lidhje me rindarjen e çështjeve në ato raste kur zëvendësohet gjyqtari pasi çështja është regjistruar dhe shortuar njëherë (*rishortimi*) rezulton se në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër rindarja me short e çështjeve përgjithësisht është bërë në një kohë të shpejtë, ndërsa ka raste kur rishortimi nuk është bërë menjëherë por është shtrirë në kohë, pas 5-7 ditësh.
8. Në lidhje me çështjet e caktuara me short dhe për të cilat është disponuar më parë nga gjykata me vendim jopërfundimtar të pushimit të gjykimit ose me vendim për kthimin e akteve rezulton se në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm nuk

^[307] Çështja nr. (21234-00110-51-2024) sistemi, mban datë dorëzimi dhe regjistrimi 21.01.2024 datë e cila rezulton në kalendar ditë e diel, ditë pushimi; Çështja nr. (520003-00823-51-2024) sistemi mban datë dorëzimi dhe regjistrimi 24.02.2024 datë e cila rezulton në kalendar ditë e shtunë, ditë pushimi; Çështja nr. (58325-00824-51-2024) sistemi mban datë dorëzimi dhe regjistrimi 24.02.2024 datë e cila rezulton në kalendar ditë e shtunë, ditë pushimi; Çështja nr. 520003-01413-51-2024 mban datë dorëzimi dhe regjistrimi 21.04.2024 datë e cila rezulton në kalendar ditë e diel, ditë pushimi]

^[308] Referuar urdhërit nr. 86, datë 28.06.2024, është bërë ndërprerja për periudhën nga 28.06.2024 deri në datë 01.07.2024 ora 08:00, për arsye se ka patur dyshime për sulm kibernetik të njoftuar nga AKSHIL.

mbajnë një indeks alfabetik i çështjeve për të cilat gjykata ka disponuar me vendim jo përfundimtar. Përgjithësisht gjykatat kanë vendosur në dispozicion tabelat e sistemit për çështjet e shortuara manualisht, dhe nga verifikimi i tyre rezulton se nga mosmbajtja e këtij indeksi bëhet i pamundur identifikimi i këtyre çështjeve.

9. Shënimet që përdoren si arsye justifikimi në rastin e caktimit të çështjeve në mënyrë manuale apo dhe rishortimeve: nuk pasqyrojnë justifikimin ligjor që e kanë detyruar drejtuesin e gjykatës të kalojë çështjen tek gjyqtari. Këto raste janë evidentuar qartësisht në raport në pjesën ku flitet për këtë gjykatë.
10. Sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore sa i përket caktimit të çështjeve në rastet e shortimit në mënyrë manuale dhe rishortimit të tyre, kur një çështje shortohet manualisht apo rishortohet më shumë se një herë tek rubrika që bën fjalë për gjyqtarin e vjetër dhe të ri, raporti vjetor i dalë nga sistemi, pasqyron vetëm gjyqtarin e fundit dhe të parafundit, por nuk evidenton gjyqtarin e mëhershëm, kur ka patur disa rishortime të të njëjtës çështje, dhe për rrjedhojë shënimet e hedhura për çështjet nuk përkojnë me faktin për të cilën çështja është shortuar në njërin prej këtyre dy mënyrave. Pra ky informacion nuk evidentohet i njëjtë mes RIV-it dhe raportit që gjeneron sistemi.
11. Gjatë këtij inspektimi ka rezultuar se gjykata ka dërguar informacionin tabelar të kërkuar në kuadër të këtij inspektimi, por që informacioni i paraqitur ka qenë me pasaktësi të cilat janë konstatuar gjatë verifikimit dhe analizimit të akteve që vetë gjykata ka dërguar. Theksojmë për sa mësipër se verifikimi është bërë edhe në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore.

II. KONKLuzionet

1. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, është konstatuar se regjistrohen çështje gjyqësore që paraqiten në gjykatë në ditë pushimi veprim i kryer jo në përputhje me kërkesat e nenit 25 të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe kërkesat e vendimit nr. 554, datë 29.12.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", dhe që është detyrë e kancelarit të gjykatës i cili mbikëqyr sekretarinë gjyqësore për rregullimin e këtij fenomeni.
2. Gjykatat e përfshira në këtë inspektim, konkretisht Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm kanë të publikuar në faqen zyrtare të internetit të gjykatës vendimin lidhur me datën dhe orën e shortit, ndërkohë që Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nuk ka të publikuar vendimin lidhur me datën dhe orën e shortit.
3. Mosfunksionim të sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore është konstatuar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm si dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, që përdorin sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve ICMIS, ku ka patur probleme për një periudhë 3 (tre) ditore, raste të

evidentuara në raport.

4. Konstatohen raste pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ku për 6 (gjashtë) çështje gjyqësore të karakterit urgjent, janë hedhur e regjistruar gabim në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore, të cilat u kanë kaluar në ngarkim gjyqtarëve që nuk kanë qenë në listën e gadishmërisë, për të cilat punonjësi i IT-së nuk kishte bërë më parë ndryshimet përkatëse, raste këto të evidentuara në raport.
5. Zëvendëskryetarja e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në disa raste (14 raste) ka caktuar manualisht gjyqtarët, për gjykimin e çështjeve të karakterit urgjent (në vend të gjyqtarëve të planifikuar më parë, që kishin në fakt këto gjykime dhe që për shkak pamundësie të tyre ato nuk mund të gjykonin¹³⁹⁹), duke mos qenë në koherencë me kërkesat e vendimit nr. 729 prot., datë 21.12.2023, "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", të miratuar nga ana e saj për këtë qëllim.
6. Konstatohen se ka raste/çështje të regjistruar gabim, duke i kaluar tek gjyqtarë të tjerë, raste këto për të cilat nuk ka akte shkresore për justifikimin e veprimeve të kryera në këto raste. Janë konstatuar edhe raste pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të cilat ndonëse statusi i çështjeve në fakt ka qenë të përfunduara me vendim, të planifikuara për gjykim, në sistem, në disa prej këtyre rasteve janë kryer veprime në shortin manual duke ua kaluar gjyqtarëve të tjerë, raste këto të evidentuara në raport. Ka dhe raste të tjera, të evidentuara në raport ku janë kryer veprime në sistem ndërkohë që magjistratët kanë patur në përdorim user të vjetër të gjykatave nga ato kanë ardhur.
7. Në lidhje me përjashtime e gjyqtarëve nga shorti në periudha të caktuara gjatë periudhës së inspektimit (mungesa disa ditore me leje / me raport mjekësor / për shkak të ngarkesës / shkaqe të tjera të mungesave), rezulton se për periudhën e verifikuar konstatohet në të gjitha gjykatat përjashtime të gjyqtarëve nga shorti, kryesisht për shkak të lejeve vjetore, angazhimeve jashtë shtetit, në rastet e ngarkesës si zv/kryetar të gjykatave, përgjithësisht rastet janë shoqëruar me kërkesa, procesverbale ose Urdhëra të zv/kryetarëve të gjykatave. Në raport janë evidentuar raste kur gjyqtarët janë përjashtuar nga shorti edhe për çështje jo të karakterit të ngutshëm, ndonëse mungesa e tyre e justifikuar në gjykatë është për pak ditë / ose në disa raste është bërë si balancimi lejes vjetore të pakryer.
8. Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është konstatuar se për shkak të mos çregjistrimit në sistem të gjyqtarëve që kanë përfunduar grafikun e gatishmërisë me gjyqtarët të cilët janë në radhën e këtij grafiku, rezulton se çështjet gjyqësore u kalojnë përsëri gjyqtarëve që u ka mbaruar ky grafik.
9. Lidhur me gjenerimin e raporteve vjetore nga sistemi i menaxhimit të çështjeve

¹³⁹⁹ Ky fat u konstatua nga inspektimi i tabelës që ka dërguar gjykata për procedurat e shorti në gjykatë (çështjet e karakterit urgjent), periudha 01.01.2024-31.12.2024



gjyqësore sa i përket caktimit të çështjeve në mënyrë manuale dhe rishortimit të tyre, në rastet kur një çështje rishortohet më shumë se një herë tek rubrika që bën fjalë për gjyqtarin e vjetër dhe të ri, raporti vjetor i dalë nga sistemi, pasqyron vetëm gjyqtarin e fundit dhe të parafundit, por nuk evidenton gjyqtarin e mëhershëm, kur ka patur disa rishortime të të njëjtës çështje. Pra ky informacion nuk evidentohet në bazë vjetore siç evidentohet edhe në raportet mujore.

10. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, vijon të mos mbahet indeks për regjistrimin e çështjeve të caktuara me short dhe për të cilat është disponuar më parë nga gjykata me vendim jopërfundimtar të pushimit të gjykimit ose me vendim për kthimin e akteve, të evidentuara këto raste në seksionin "5. Çështje e hedhura më parë short" të këtij raporti.
11. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të cilat përdorin sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS, është konstatuar se nuk pasqyrohen saktësisht arsyet në rast të kalimit automatik të çështjeve pranë të njëjtit gjyqtar, nëpërmjet sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore.
12. Në rastet e rishortimeve nga ana e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nuk bëhet një studim paraprak të listës së çështjeve që do t'i nënshtrohen rishortimit, pasi janë konstatuar më vonë raste që disa dosje nuk duhet që ti ishin nënshtuar këtij procesi të rishortimit.
13. Në rastet e rishortimeve nga ana e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, vendimmarrja për këtë qëllim është bërë nga Këshilli i Gjykatës, ndërkohë që bazuar në pikat 6 dhe 7 të Vendimit nr. 724, datë 07.12.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, "Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore" kryetari i gjykatës është nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin e këtij procesi.

Në përmbyllje të këtij inspektimi tematik u konstatua se në pjesën më të madhe të rasteve nga gjykatat subjekt inspektimi, ishin zbatuar aktet ligjore e nënligjore mbi ndarjen me short të çështjeve gjyqësore. Si praktika të mira, të cilat duhet të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme dhe koherente nga gjykatat e të gjitha niveleve duke evidentuar, si më poshtë:

- a) drejtuesit e gjykatave kishin nxjerrë Urdhëra me qëllim normimin e procedurave të hedhjes së shortit të çështjeve ku kishin përcaktuar ditët, oraret kur do të bëhet hedhja e shortit;
- b) drejtuesit i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër si dhe i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm kanë lëshuar, urdhër në lidhje me përcaktimin e gjyqtarëve për gjykimet e rasteve urgjente, sipas përcaktimeve ligjore, me rend alfabetik me bazë mbiemrin;
- c) drejtuesit e gjykatave kanë mbajtur procesverbalet përkatëse si për dokumentimin e hedhjes së shortit të çështjeve në mënyrë manuale, për rastet kur Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, ka qenë jashtë funksionit, për dokumentimin

e hedhjes së shortit të çështjeve në mënyrë manuale, si dhe për dokumentimin e shortit në mënyrë manuale për zgjedhjen e anëtarëve që kanë bërë zëvendësimin apo plotësimin e anëtarëve të trupave gjykues për çështje të caktuara, ku në këto procedura kanë marrë pjesë edhe gjyqtarët;

- d) drejtuesi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka mbajtur Urdhëra, për marrjen në dorëzim të dosjeve në lidhje me rastet kur gjyqtarët që kanë pasur në shqyrtim çështjet ishin larguar nga detyra.

III. REKOMANDIMET

Përmbushja e qëllimit të këtij inspektimi, është e lidhur ngushtë jo vetëm me monitorimin e performancës dhe efektivitetin e veprimtarisë së kryetarëve të gjykatave në drejtim të ndarjes së çështjeve gjyqësore me short por dhe me parashtrimin e rekomandimeve të cilat synojnë rritjen e transparencës në procedurën e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore, në funksion të parimeve të objektivitetit dhe barazisë së shpërndarjes të çështjeve.

A. Për gjykatat subjekte të inspektimit^[310]

Rekomandim 1.

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të marrë masat e duhura, që në kuadër të garantimit të transparencës dhe gjurmimit të ndarjes së çështjeve me short të publikojë në faqen zyrtare të gjykatës vendimin për caktimin e ditës, orës dhe vendin e hedhjes së shortit, për të qenë në koherencë me parashikimet e ligjit nr. 98/2016 dhe vendimmarrjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor, që rregullon këtë proces.

Rekomandim 2.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër i rekomandohet që të vijojë me krijimin dhe administrimin e regjistrit të posaçëm (*indeks*) për çështjet e caktuara me short, për të cilat është disponuar më parë nga gjykata me vendim jopërfundimtar. Regjistri të përmbajë emrin e mbiemrin e palëve ndërgjyqëse, numrin, datën e vendimit si dhe gjyqtarin që ka dhënë vendimin.

Rekomandim 3.

Të gjitha gjykatave u rekomandohet të krijojnë dhe të administrojnë një regjistër të posaçëm (*indeks*) për regjistrimin e të gjitha kërkesave për heqje dorë të gjyqtarëve nga gjykimi i çështjeve, apo dhe kërkesat për përjashtim gjyqtari, ku të reflektohet dhe vendimmarrja lidhur me këto kërkesa.

Rekomandim 4.

^[310] Rekomandimet me numër 1, 2, 3, 6 dhe 7 janë të përsëritura dhe rekomanduar edhe nga raporti mbi ndarjen e çështjeve me short për vitin 2023.

Në rast të paraqitjes së kërkesave për ndryshime në grafikun e Urdhërave të gatishmërisë nga ana e gjyqtarëve, drejtuesit e gjykatave të të gjitha niveleve të reflektojnë në aktet përkatëse që do të nxjerrin për këtë qëllim arsyet e këtij ndryshimi. Aktet që rregullojnë shqyrtimin e çështjeve të karakterit urgjent të pasqyrojnë në mënyrë të detajuar të gjithë kategoritë e çështjeve që shqyrtohen nga ky gjyqtar.

Rekomandim 5.

Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, rekomandohet që veprimtaria e sekretarisë gjyqësore sa i përket pranimit dhe regjistrimit të çështjeve, të ushtrohet përgjatë ditëve zyrtare të punës dhe vetëm për çështje të cilat kanë karakter urgjent, pranimi dhe regjistrimi i tyre të bëhet edhe në ditë pushimi a festash zyrtare.

Rekomandim 6.

Për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, rekomandohet që në shqyrtimin e kërkesave për caktimin në short manual të gjyqtarëve që do të gjykojnë "kërkesat për përjashtim", "zëvendësim të anëtarit të trupit gjykues" apo të "plotësimit me anëtarë të trupit gjykues", kryetari i gjykatës të marrë masat e nevojshme organizative për caktimin e këtyre gjyqtarëve në përbërje të trupave gjykues, pasi më parë ndarja e çështjeve me short manual të jetë realizuar nga Kancelari, nën mbikëqyrjen e tij, si dhe me pjesëmarrjen e gjyqtarëve të gjykatës, *(pasi këto të fundit të jenë njoftuar paraprakisht për zhvillimin e shortit manual...etj)*. Përzgjedhja e gjyqtarëve të jetë e dokumentuar me procesverbale për këtë proces.

Rekomandim 7.

Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të cilat përdorin sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS, rekomandohet që drejtuesit e gjykatave të pasqyrojnë saktësisht arsyet në rast të kalimit automatik të çështjeve pranë të njëjtit gjyqtar, nëpërmjet sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, në funksion të parimeve të transparencës dhe gjurmimit.

Rekomandim 8.

Përjashtimi i gjyqtarit nga shorti në rastet e mungesës në detyrë të tij për shkaqe të justifikuara, të bëhet nga drejtuesi i gjykatës, vetëm për ato çështje që lidhen me afate të ngutshme shqyrtimi në përputhje me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor që rregullon procedurën e ndarjes së çështjeve me short dhe jo për të gjitha çështjet. Në këto raste, shkak për të cilin bëhet përjashtimi i gjyqtarit, të jetë i shoqëruar, sipas arsyes së prezantuar nga gjyqtari, me dokumentacionin justifikues, si dhe në Urdhërin e dalë për këtë qëllim të jepet shkak i specifik i mungesës së gjyqtarit në detyrë.

B. Për Këshillin e Lartë Gjyqësor^[311]

Rekomandohet:

1. Të marrë masat e duhura rregullatore dhe administrative me qëllim që gjykatat e të gjitha niveleve të përdorin një sistem të unifikuar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore me qëllim që të garantojë efikasitetin gjyqësor, transparencën, gjurmimin dhe aksesin e drejtpërdrejtë të ILD-së në raportet që do gjenerohen nga ky sistem me qëllim përmbushjen e kompetencave inspektuese të ILD-së. Deri në realizimin e plotë të një sistemi të unifikuar, për gjykatat të cilat kanë në përdorim sistemet elektronike CCMIS dhe ARK-it, të bëhen rregullimet e nevojshme teknike, me qëllim gjenerimin e raporteve periodike të gjurmimit apo sipas kërkesave të ILD-së për shortet elektronike, caktimet e shorteve manuale dhe rishortimet.
2. Të marrë masat në mënyrë që të garantojë një uniformitet të akteve që nxjerrin drejtuesit e gjykatave të të gjitha niveleve, për aq sa është i mundur edhe miratimin e modeleve standarde të tyre. Ky standardizim të përfshijë edhe regjistrat dhe indeksat e ndryshme që gjykata detyrimisht, duhet t'i përdorë në procesin e ndarjes së çështjeve me short.
3. Në vlerësim të gjetjeve të raporteve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me fokus ndarjen e çështjeve të short të shihet mundësia e trajnimit të administratës gjyqësore lidhur me këtë proces.

C. Për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë

Rekomandohet:

1. Në lidhje me problematikat e evidentuara në Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të vlerësohet mundësia e kryerjes së një procesi verifikimi, për 15 (pesëmbëdhjetë) raste ku zëvendëskryetarja ka caktuar manualisht gjyqtarët, për gjykimin e çështjeve të karakterit urgjent *(në vend të gjyqtarëve të planifikuar më parë, që kishin në fakt këto gjykime dhe që për shkak pamundësie të tyre ato nuk mund të gjykonin.)* duke mos qenë në koherencë me kërkesat e vendimit nr. 729 prot., datë 21.12.2023, "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente", të miratuar nga ana e saj për këtë qëllim si dhe për 4 (katër) raste, ku çështjet u kanë kaluar gjyqtarëve, nëpërmjet shortimit manual dhe të rishortimit, por që në këto procedura, nuk janë zbatuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, që kanë lidhje me ndarjen e çështjeve me short. Procesi i verifikimit të bëhet me qëllim identifikimin e elementeve faktikë dhe juridikë mbi përgjegjësinë disiplinore të subjekteve përgjegjës apo adresimin e tyre pranë organeve kompetente.
2. Ndjekja në mënyrë sistematike e ecures së zbatimit të rekomandimeve të evidentuara në këtë raport sipas gjykatave.

^[311] Rekomandimet me numër 1 dhe 2, janë të përsëritura dhe rekomanduar edhe nga raporti mbi ndarjen e çështjeve me short për vitin 2023

Propozime

Bazuar në nenin 147/d, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenin 194, pika 4 dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar,

PROPOZOJMË:

1. Përfundimin e inspektimit tematik të nisur me vendimin nr. 17, datë 01.04.2025 "Mbi ndarjen e çështjeve me short, si edhe kontrollin e raporteve të sistemit elektronik në Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për periudhën 01.01.2024-31.12.2024", të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Caktimin e periudhës nga data 15 Shkurt 2026 deri më 15 Gusht 2026, si periudhë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.
3. Të njoftohen gjykatat subjekt i këtij inspektimi, duke i'u dërguar një kopje të Raportit të Inspektimit.
4. Të njoftohet Këshilli i Lartë Gjyqësor me Raportin e Inspektimit.

INSPEKTORËT

Eugen Nasufi



Albert Kazia





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Aneksi 1

❖ GJYKATA E LARTË

○ Tabela e çështjeve të shpërndara me short elektronik

